



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 22 QERSHOR 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTOJNË
KRYETARJA E KUVENDIT
LINDITA NIKOLLA
DHE NËNKRYETARJA
ERMONELA FELAJ

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 15.06.2023 *(neni 44, pika 2 e Rregullores)*.
2. Njoftime *(neni 44, pika 3 e Rregullores)*.
3. Raporti i veprimtarisë vjetore të Bankës së Shqipërisë për vitin 2022 *(neni 69 i ligjit nr. 8269/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 103*

i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).

Paraqitja e raportit nga titullari - jo më shumë se 20 minuta

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)*.

Koha e votimit të projektrezolutës.

4. Raporti i veprimtarisë vjetore të Avokatit të Popullit për vitin 2022 *(neni 63 i Kushtetutës, neni 26 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”” dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës).*

Paraqitja e raportit nga Avokati i Popullit - jo më shumë se 20 minuta.

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)*.

Koha e votimit të projektrezolutës.

5. Raporti i veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2022 *(neni 32 i ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)*.

Paraqitja e raportit nga kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik - jo më shumë se 20 minuta

Shprehet për projektrezolutën Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Pyetje

Zhvillimi i debatit *(nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)*.

Koha e votimit të projektrezolutës.

6. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për "Përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech"*(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*.

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

7. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të

Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla-Pulaj për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar" *(në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë absolute votash për miratim)*.

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurisë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

8. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"*(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*.

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

9. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social"*(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*.

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

10. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim.*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurisë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

11. Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Europiane.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit.

12. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës. *(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: "çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe, nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta". Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)*

Ermonela Felaj - Mirëmëngjesi!

Meqenëse kourumi për fillimin e seancës është i plotë, seancën plenare e deklaroj të hapur. Në bazë të nenit 30 të Rregullores së Kuvendit, më lejoni t'ju bëj të njohur rendin e ditës për seancën e sotme plenare, duke i ftuar të gjithë kolegët, që mbasi të kemi bërë pjesën formale, më pas të kalojmë te pjesa e diskutimeve që i përkasin debatit parlamentar.

Sot në rendin e ditës kemi:

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Fillojmë me çështjet e rendit të ditës.

Kolegë, pika e parë është miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar, të datës 15 qershor 2023.

Procesverbali ju është vënë në dispozicion. Ka ndonjë deputet vërejtje për procesverbalin? Nëse nuk ka, kalojmë në votim.

Kush është dakord me procesverbalin?

Faleminderit!

Miratohet.

Kalojmë te njoftimet.

Ju njoftoj se gjatë kësaj jave janë depozituar dy akte në Kuvend nga Këshilli i Ministrave, titujt e të cilave i gjeni në sistemin këtu në sallë.

Ju njoftoj se kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe një grup deputetësh, në bazë të nenit 103, pika 8 e Rregullores, kanë paraqitur kërkesë për diskutime për të gjitha raportet vjetore të institucioneve, që përfshihen në rendin e ditës të seancave tona plenare.

Konferenca e Kryetarëve ka rënë dakord, konform nenit 103, pika 8 e Rregullores, të caktojë një debat për çdo raport, me kohë 1 orë e 30 minuta për secilin prej tyre. Në bazë të nenit 48, pika 3, koha do të jetë e ndarë në mënyrë përpjesëtimore ndërmjet grupeve, përfshirë këtu edhe deputetët e pavarur ose ata jashtë grupeve parlamentare.

Po ashtu, dëshiroj t'ju njoftoj se Guvernatori i Bankës së Shqipërisë nuk do të paraqitet sot për të raportuar për veprimtarinë e institucionit që ai drejton, për shkak se merr pjesë në një konferencë ndërkombëtare jashtë vendit. Kështu që, ky raportim nuk do të zhvillohet në këtë seancë plenare, por do të shtyhet për në seancën pasardhëse.

Ju njoftoj se në Kuvend është paraqitur një kërkesë nga një grup deputetësh për formalizimin e Grupit Vullnetar për Popullsinë dhe Zhvillimin.

Gjithashtu, ju bëj me dije se në datën 21 qershor është mbledhur Konferenca e Kryetarëve, e cila ka diskutuar për draftprogramin dhe kalendarin 3-javor për periudhën në vijim të këtij sesioni. Në Konferencë nuk ka pasur konsensus për programin e punës së Kuvendit të Shqipërisë, ndërkohë që për kalendarin e punës është rënë dakord.

Në zbatim të nenit 26, pika 6, të Rregullores së Kuvendit, ju ftoj të votojmë programin e punës për 3 javët në vijim.

Kush është dakord me programin e punës?

Miratohet programi i punës së Kuvendit.

Faleminderit!

Vazhdojmë me rendin e ditës.

Fjalën e ka zoti Shehu.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Dakord.

Po, zoti Berisha.

Sali Berisha - Zonja drejtuese e seancës,

Zonja deputete,

Zotërinj deputetë,

Jam këtu për të dënuar me ashpërsinë më të madhe dhe për të kërkuar futjen urgjente në rendin e ditës të masakrës që u krye në kampin e muxhahedinëve të popullit. Jam këtu, gjithashtu, për të deklaruar sot, se në këtë moment ndihem më shumë se kurrë njëri prej tyre, ndihem një muxhahedin, luftëtar i lirisë, dhe që t'u shpreh atyre ndjenjat e mia më të singërta të mbështetjes dhe të simpatisë. Sot ndihem muxhahedin, sepse qeveria amorale e këtij vendi vrau në bukë të vet,

në strehë të vet, një luftëtar lirie. Sot ndihem muxhahedin më shumë se kurrë, sepse aktakuza e djeshme, që lexuam, është historia më e turpshme për një vend. Ajo ishte shkruar në Teheran. Aktakuza bazohej e tëra në shpifje dhe në trillime të shërbimeve të ajatollahëve ndaj luftëtarëve të lirisë. Aktakuza përbante elemente të poshtërimit ekstrem të Shqipërisë dhe shqiptarëve, sikur nuk është një vend anëtar i NATO-s, por sikur është një vend vasal i Iranit. Vetëm për Sirinë e Asadit, mund të shkruhej në atë mënyrë.

A mund të ktheheshin shpifjet dhe trillimet e shërbimeve sekrete të ajatollahëve, të cilat që nga mëngjesi deri në darkë, ditën dhe natën, konspirojnë kundër vendeve të lira, dhe të merreshin ato për bazë për të ushtruar reprezaljen më të turpshme në historinë e një vendi?! Ndaj, kërkoj largimin e menjëhershëm të ministrit të Brendshëm. Gjithashtu, kërkoj të mbajmë një minutë heshtje për martirin e lirisë, që ra për t'u bërë i pavdekshëm, që e vranë në bukë të vet këta të pabesë, që e vranë në shtrat të vet, këta të pabesë.

Ju ftoj të mbajmë një minutë heshtje në nderim të kujtimit të tij!

Ermonela Felaj - Përfundoi koha.

Në bazë të nenit 49 të Rregullores së Kuvendit, dëshiron të flasë dikush për propozimin e zotit Berisha?

Jo. Atëherë, kalojmë në votim.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Ju lutem, ka një propozim për rendin e ditës? Të mos flasim të gjithë në të njëjtën kohë.

Fjalën e ka zoti Balla.

(Deputeti Sali Berisha ndërhyr pa mikrofon nga salla.)

Zoti Berisha, ju lutem, ka përfunduar koha juaj për procedurë!

Taulant Balla – Zonja drejtuese e seancës,

Ka një procedurë për prezantimin e kërkesave për ndryshimin e rendit të ditës, të cilat duhet të paraqiten përpara fillimit të seancës.

Sali Berisha - Ka një situatë urgjente.

Taulant Balla - Nuk ka asnjë kërkesë të tillë të depozituar sipas Rregullores së Kuvendit.

(Deputeti Sali Berisha ndërhyr pa mikrofon nga salla.)

Taulant Balla – Teknika, do t'ia mbyllni mikrofonin këtij zhurmuesit? Zonja drejtuese e

seancës, do t'ia mbyllni mikrofonin këtij zhurmuesi?

Ky që bën sikur i dhemb barku për atë që po heton drejtësia shqiptare, bën të njëjtën gjë sa herë që drejtësia bën detyrën e vet, por Kuvendi i Shqipërisë as nuk mund të përfshihet dhe as nuk mund të ndërhyjë në çështje që i takojnë vetëm drejtësisë. Koha kur politika apo vetë Kuvendi përfshihet në çështjet e drejtësisë, ka marrë fund njëherë e përgjithmonë në themelet që po ngrihet drejtësia e re, ndaj Kuvendi i Shqipërisë nuk mund të ndërhyjë dhe as të përfshihet kurrsesi. Kjo është një çështje ku Policia e Shtetit ka zbatuar fjalë për fjalë dhe pikë për pikë vendimin dhe urdhrin e prokurorisë dhe në rastin në fjalë, të një institucioni tek i cili të gjithë kemi besim, sikurse është Prokuroria Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Kështu që, në këtë këndvështrim, ju lutem, zonja drejtuese e seancës, përdorimi për qëllime politike i një ngjarjeje si kjo, ku një person ka humbur jetën dhe do të jetë drejtësia që do të përcaktojë si ka ndodhur, është diçka që ky vend dhe ky popull kanë 32 vjet që e dinë fare mirë, se personi që sapo foli bën edhe korbin, edhe skifterin.

Ndërkohë, ne duhet të vazhdojmë me çështjet e rendit të ditës. Zonja drejtuese e seancës, ne nuk mund të hedhim në votim diçka që nuk ekziston. Këta nuk e mësuam kurrë se për të ndryshuar rendin e ditës ka një procedurë dhe një model të vendosur nga Rregullorja e Kuvendit. Kështu që nuk ka nevojë për votim, por do të ecim vetëm përpara me çështjet e rendit të ditës.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Balla!

Zoti Shehu, e keni kërkuar fjalën për procedurë?

Tritan Shehu - Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

E kërkova fjalën kur ju hodhët në votim programin, por nuk ma dhatë. Dua t'ju them se unë votova kundër, ndaj mendoj se së paku, sipas Rregullores, kam të drejtë të shpjegoj votën time.

Ju, zonja drejtuese e seancës, Kryesia e Kuvendit, Kryetarja, e cila nuk është sot këtu, në mënyrë krejtësisht arbitrare, në mospërputhje me Rregulloren, përsëri nuk keni futur për diskutim kërkesën tonë për mocion me debat dhe rezolutë për gjenocidin serb në Kosovë në vitet '90.

Dikush mund të thotë se po e përsërisim vazhdimisht, kurse unë po ju them se do ta përsërisim vazhdimisht derisa të plotësohet një kërkesë dhe e drejtë e tillë e deputetëve në bazë të Rregullores, derisa ky Kuvend së paku të pranojë të diskutojë këtë çështje kaq të rëndësishme, veçanërisht në këto momente që po kalon Kosova, kur ultranacionalizimi serb ka marrë revansh. Për të krijuar stabilitetin e rajonit, paqen e rajonit, marrëdhëniet normale midis vendeve, është e detyrueshme të dënohet ai gjenocid, të pranohet ai gjenocid dhe t'u kërkohej autorëve që, së paku, të kërkojnë falje.

Ky është një parim evropian, që Europa e ndjek kudo, një parim që ne duhet ta zbatojmë në parlamentin tonë, pasi parlamenti i Kosovës e ka miratuar, e ka votuar dhe e ka kërkuar këtë gjë. Gjithashtu, është detyra jonë, e nderuar zonja drejtuese e seancës, t'i rekomandojmë qeverisë nëpërmjet asaj rezolute të asistojë qeverinë e Kosovës pranë organizmave ndërkombëtare, meqenëse ajo nuk është anëtare e OKB-së, për ta ngritur këtë çështje dhe për t'u njohur zyrtarisht nga ata organizma gjenocidi serb në Kosovë në vitet '90. Fatkeqësisht, përsëri në mënyrë arbitrare, në programin që ju paraqitet, unë nuk e pashë diçka të tillë.

Unë kam kërkuar disa herë shpjegime pse ndodh kjo gjë, por nuk jepet asnjë shpjegim. Shpjegimi i vetëm është këmbëngulja e Vuçiqit që kjo çështje të mos diskutohet në parlamentet e vendeve të tjera, që, siç duket, është ai që vendos dhe bën edhe programin e parlamentit tonë.

Kjo është e turpshme, është në kundërshtim të plotë me sovranitetin e parlamentit tonë, është në kundërshtim të plotë me Rregulloren e parlamentit tonë, është në kundërshtim të plotë me të vërtetën historike të ngjarjeve dhe të asaj që duhet bërë në këtë rajon për të krijuar stabilitetin e rajonit tonë. Pra, kjo bie ndesh me të gjitha parimet.

Ne do të ngulim përsëri këmbë në këtë gjë, duke ju denoncuar ju për një shkelje të rëndë të Rregullores dhe për një shkelje shumë të rëndë të parimeve universale, siç është njohja e gjenocideve, dënimi i gjenocideve dhe kërkesa ndaj autorëve për të kërkuar falje për gjenocidin e shkaktuar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Shehu!

Kalojmë në çështjet e rendit të ditës.

Çështja e parë është raportimi i Avokatit të Popullit për vitin 2022.

Në bazë të nenit 103, pika 2, të Rregullores dhe ligjit nr. 8454 të vitit 1999 “Për Avokatin e Popullit” sot këtë raport do ta paraqesë Avokatja e Popullit, zonja Erinda Ballanca, të cilën e ftoj të hyjë në sallë.

Faleminderit, zonja Ballanca!

Sipas nenit 103, pika 7, të Rregullores, do të keni fjalën për 20 minuta. Mandej kolegët do të kenë mundësinë t’ju drejtojnë pyetje lidhur me raportimin tuaj.

Fjala për ju, zonja Ballanca.

Faleminderit!

Erinda Ballanca - Shumë faleminderit!

Të nderuar deputetë, përfaqësues të zgjedhësve shqiptarë në këtë institucion që përfaqëson vullnetin e qytetarëve tanë!

Sot jam përpara jush me kënaqësi të veçantë për t’ju prezantuar raportin mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në vend për vitin 2022. Më së shumti, ky është një rast dhe një mundësi për të folur për të drejtat e njeriut.

Së pari, dua të falënderoj Kuvendin e Shqipërisë dhe komisionet parlamentare për këtë rrugëtim të gjatë e bashkëpunues, që kemi pasur gjatë mandatit tim në krye të Avokatit të Popullit. Sigurisht, nuk ka qenë gjithnjë e lehtë, kemi pasur edhe qëndrime të ndryshme, por e rëndësishme për institucionin e Avokatit të Popullit është që problematikat të dëgjohen dhe mundësisht të adresohen. Sigurisht që shumëçka është bërë, por ka edhe më shumë për të bërë.

Unë gjej rastin nga kjo foltore t’i drejtohem Kuvendit për të thënë që momenti ideal për përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut është pikërisht procesi i aderimit në BE. Hapja e negociatave dhe plotësimi i kushteve gjatë këtij procesi ka rezultuar për secilin nga vendet, që e kanë kaluar këtë eksperiencë, si momenti më i mirë për avancimin e të drejtave të njeriut. Pikërisht në këtë kuadër unë do t’u kërkoja Kuvendit dhe komisioneve përgjegjëse të kenë sa më shumë vëmendje në çështjet e adresimit të problematikave të të drejtave të njeriut.

Ne, në fakt, me modesti e them, jemi vërtet krenarë që ia kemi dalë në këta 6 vjet të rrisim bashkëpunimin me Kuvendin, ta çojmë përpara agjendën e të drejtave të njeriut, të diskutojmë për tema, që në vitin e parë të punës sime nuk ishin fare në debatet parlamentare, nuk ishin fare në zë

për t’u diskutuar. Të arrijmë dhe ta çojmë përpara problematikën, për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve dhe për t’u bërë një shoqëri, e cila e ka miradministrimin dhe mirëqeverisjen në vëmendje të saj. Pas 6 vjetësh në këtë detyrë, për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë, në rezolutën që Komisioni i Ligjeve ka sjellë për ta miratuar në Kuvend, përdoret termi “miradministrim”. Është një hap i madh përpara, sepse tregon përgjegjësinë e institucioneve shqiptare për të njohur dhe për të krijuar një të drejtë të re të njeriut, miradministrimin, e cila nuk është në Kushtetutën e Shqipërisë, por ama është shumë e rëndësishme për ecurinë tonë në kuadër të anëtarësimit në BE. Çdo punonjës i administratës shtetërore ka detyrën e vet të jetë miradministrues i të mirave dhe t’i çojë përpara të gjitha çështjet që u përkasin qytetarëve.

Duke administruar ankesat e qytetarëve shqiptarë, ne kemi hartuar rekomandime për institucionet e shtetit në çdo nivel, duke u kërkuar atyre të jenë më humane, më respektuese të të drejtave themelore, si dhe më pranë standardit europian drejt të cilit synojmë të gjithë.

Kemi publikuar raporte vit pas viti, edhe këtë vit kemi sjellë në Kuvend shumë raporte, duke ofruar baza të gjera të dhënash, nga studimi i të cilave, kushdo që është i interesuar për mbarëvajtjen e shtetit shqiptar, mund të mësojë shumë dhe prej të cilave mund të ndërtohen politika efektive që u shërbejnë qytetarëve: nga të drejtat e grave apo grupeve vulnerabël, tek arsimit dhe shëndetësia; nga trajtimi në burgje tek të drejtat pronësore dhe ato të pakicave; nga të drejtat politike të minimumit jetik, i cili duket se është duke ardhur gjithnjë e më tepër në diskursin politik dhe në koshiencën e çdo politikani në vendin tonë. Përcaktimi i minimumit jetik dhe miratimi i tij është një pritshmëri e qytetarëve.

Më duhet të them se në vitin 2014, për herë të parë, Avokati i Popullit hartoi një raport për minimumin jetik. Ne e rimorëm këtë tezë në vitin 2019 dhe e paraqitëm përsëri. Sigurisht ne nuk mëtojmë të japim aty formulën perfekte dhe ekzakte, por nëpërmjet atij raporti ne kemi paraqitur një vizion tonin se si duhet të llogaritet vlera e minimumit jetik, e cila do të duhet të trajtohet nga ana e organeve ligjëbërëse, sigurisht edhe ekzekutive të ministrisë përkatëse, për t’u dhënë mundësinë qytetarëve për një jetë dinjitoze.

Jemi të ndërgjegjshëm, në fakt, se veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit, nëse kryhet siç duhet, bie ndesh vazhdimisht me interesat apo me atë që pritet të ndodhë në vend. Sigurisht, ne jemi zëri kritik, jemi dora e shtrirë e parlamentit dhe zëri kritik i parlamentit. Më besoni, nuk është aspak interesante të jesh gjithmonë kritik, por kritika, nëse është konstruktive dhe nëse arrin qoftë dhe një hap më të vogël përpara, është pozitive, sepse, në fund të fundit, arrijmë të marrim një shërbim më të mirë, një vëmendje më të madhe nga ana e shtetit për qytetarët.

Veprimtaria e Avokatit të Popullit shtrihet në dy kolona të mëdha, dhe kjo është shumë e rëndësishme për ta thënë gjithmonë: njëra është trajtimi i ankesave dhe për trajtimin e ankesave ju keni statistika të hollësishme në raportin tonë vjetor. Ana tjetër është promovimi dhe janë të drejtat që ne promovojmë, standardet ku ne duam të shkojmë.

Mund të them se viti i kaluar, që ka qenë për adresimin e ankesave të qytetarëve, ka qenë një vit rekord dhe kemi pasur numrin më të madh, të themi, të trokitjes së qytetarëve në derën tonë, pasi jo gjithmonë kanë ankesa, se ne bëjmë edhe këshillime, orientime, i drejtojmë se ku mund ta zgjidhin hallin e tyre. Numri total i ankesave për vitin e kaluar ka qenë 6264. Nga këto ankesa, një pjesë e madhe e tyre mund të mos kenë qenë të drejtuar drejtpërsëdrejti për institucionin tonë, por ama ka qenë një shqetësim që ata kanë pasur, zgjidhje e një problematike, trajtim ose rruga si kjo problematikë mund të zgjidhet.

Nga ana tjetër, kemi kryer 1826 hetime administrative, 40% e të cilave kanë qenë kërkesa të paraqitura në vitin 2022 dhe të tjerat kërkesa që janë paraqitur në vitet e mëparshme. Përtej këtyre hetimeve administrative që kemi kryer, gjithmonë me një staf të kufizuar dhe me kapacitete të kufizuara njerëzore, kemi arritur atë që besoj se është arritje e rëndësishme për çdo institucion.

Së pari, kemi arritur që një numër shumë i madh rastesh, rreth 823 prej tyre, të zgjidhen pa pasur nevojë për një rekomandim. Ky është sukcesi kryesor i Avokatit të Popullit që vetëm nëpërmjet fillimit të një rasti dhe ndërmjetësimit të tij të arrijë një rezultat për shqetësimin e qytetarit.

Më tej kemi adresuar 249 raporte me rekomandime, të cilat në vetvete kanë përfshirë

1312 zëra nënrekomandimesh. E them këtë, sepse një raport i inspektimit apo një rekomandim i Avokatit të Popullit përcakton më shumë se një kërkesë apo ka në vetvete më shumë se një kërkesë për institucionet shtetërore. Ne u kemi adresuar dhe u kemi drejtuar rekomandime 653 institucioneve.

Gjithashtu, vitin e kaluar, për mënyrën si ne e kemi ndryshuar raportimin e statistikave, kjo edhe mbi bazën e kërkesave të Komisionit të Ligjeve, kemi arritur të kuptojmë se ka një përmirësim të nivelit të zbatimeve të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Tashmë ne nuk e bëjmë raportimin vetëm mbi bazën e rekomandimeve, pra mbi bazën e 242 raporteve të rekomandimeve që kemi dërguar, por kemi nxjerrë një statistikë për nënrekomandimet. Natyrisht, ka shumë për të bërë, por aty ka një rritje, pasi për vitin e kaluar, sipas statistikave, ne kemi 48% të rekomandimeve të pazbatuara dhe 47% të zbatuara, pra ka rritje krahasimisht me vitin e kaluar. Vitin e kaluar shifra e nënrekomandimeve të zbatuara ka qenë 27% dhe kemi 5% pa përgjigje. Këto janë vetëm disa statistika të cilat ju lehtësisht mund t'i gjeni në raportin e Avokatit të Popullit, por, nga ana tjetër, vlejnjë për të kuptuar sasinë e punës që kemi bërë si institucion gjatë vitit të kaluar.

Institucionet e të drejtave të njeriut janë pasqyrë apo shëmbëlltyrë e shtetit dhe e nivelit të shtetit të së drejtës në një vend. Nëse kemi një institucion të fortë, që dëgjohej, nga ana tjetër, është një shtet i fortë që e ka vëmendjen ndaj të drejtave të njeriut. Pse e them këtë? Ne nuk kemi fuqi detyruese, ne jemi i vetmi institucion që nuk ka asnjë mjet detyrues, ka vetëm mjetin për të treguar standardin dhe ka vetëm rekomandimin, dhe të jesh i fuqishëm nëpërmjet rekomandimit, është shumëfish më e vështirë sesa të jesh i fuqishëm duke vendosur një gjobë apo duke marrë një masë penalizuese.

Besoj se këto ishin disa nga pikat kryesore, të cilat doja t'i trajtoja në fjalën time. E gjej me vend që duhet të shumëfishojmë forcat për të çuar më përpara agjendën e të drejtave të njeriut.

I kam kërkuar, që prej dy vjetësh tashmë, Kuvendit të Shqipërisë, nëpërmjet raportimeve të mia vjetore, se ka ardhur koha të përmirësojmë katalogun e të drejtave të njeriut në vend për ta bërë atë në linjë me Kartën Europiane të të Drejtave të Njeriut të Bashkimit Europian, pasi

është instrumenti që trajton apo ka të drejtat e njeriut më moderne aktualisht në fushën e të drejtave të njeriut. Në këtë aspekt do të doja të tregonim një model më të mirë.

Unë e kuptoj që nëpërmjet anëtarësimit në BE, Karta do të bëhet pjesë e legjislacionit të brendshëm, po asgjë nuk na ndalon ne për të treguar një model të mirë dhe për të treguar dedikimin dhe vokacionin e Republikës së Shqipërisë ndaj të drejtave të njeriut, të miratojmë paraprakisht komponentët e Kartës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Kjo do të ishte kërkesa ime kryesore, qëllimi kryesor apo kërkesa kryesore e Avokatit të Popullit për Kuvendin për vitin në vijim.

Ju falënderoj dhe jam e hapur për pyetje!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ballanca!

Zonja Bushka, a dëshironi të shpreheni për rezolutën, apo kur të merrni fjalën?

Klotilda Bushka - Faleminderit, zonja Felaj!

Meqenëse unë kam radhën për të folur për raportin, për ekonomi kohe do t'i përmbledh në të njëjtin fjalim edhe rezolutën, edhe fjalët e mia.

Ermonela Felaj- Faleminderit!

Nga stafi i Kuvendit njoftohem se zonja Çupi ka një pyetje për zonjën Ballanca.

Zonja Çupi, a dëshironi ta parashtroni pyetjen? Unë e kam pyetjen, por, nëse dëshironi ta parashtroni vetë.

Dhurata Çupi - Faleminderit!

Faleminderit për raportin, zonja Ballanca!

Faleminderit edhe për të gjithë drejtimin e atij institucioni! Duhet të jemi shumë transparentë dhe të drejtpërdrejtë: ju i keni ndryshuar fytyrën atij institucioni dhe i keni dhënë çdo vit që keni drejtuar, dinjitetin e duhur. Kështu që keni të gjitha falënderimet, besoj edhe në emër të opozitës, edhe të grupit.

Unë shtroj vazhdimisht pyetjen për një shqetësim të madh që ka sot shoqëria shqiptare, për çështjen e minimumit jetik, për të cilën kam bërë edhe një seancë interpelance me ministren e Shëndetësisë, por e kam diskutuar edhe me ju gjatë raportimit në Komisionin e Ligeve. Ju keni disa raporte në disa vite, pra, në tri vitet e fundit keni tri raporte, dhe në raportin e vitit të fundit, në dijeninë time, është rreth 200 mijë lekë të vjetër masa e minimumit jetik.

A mund të na sqaroni lidhur me studimin e këtij raporti dhe çfarë duhet të bëjë qeveria, çfarë duhet të bëjë parlamenti, në mënyrë që këtë ngërç, zgjidhjen e çështjes së minimumit jetik, ta zgjidhim një herë e mirë?

Erinda Ballanca – Faleminderit, zonja Çupi, për pyetjen!

Kjo është një çështje, e cila hyn në kuadër të mandatit promovues të Avokatit të Popullit. Në këtë raport e kemi hartuar së bashku me ndihmën e ekspertëve të UNDP-së, sepse studimi kërkon trajtimin e shumë elementeve. Raporti që ne kemi bërë, jo më kot ka qenë një raport që nuk ka përcaktuar një shifër fikse, por ka përcaktuar një formulë me zëra të ndryshëm, pasi ne besojmë se kjo vlerë duhet të ndryshojë vit pas viti, duke u ndikuar nga elementet e konsumit, inflacioni, vlera e shportës dhe elemente të tjera.

Në vitin 2019, kur ne kemi bërë llogaritjen, kjo vlerë ka qenë 17 845 lekë për person, kuptohet që për familjet vlera do të jetë sipas personave që janë në një familje. Po t'i vendosësh të tëra këto elemente në atë formulë që ne kemi propozuar, vit pas viti del një shifër tjetër. Përcaktimi i minimumit jetik është i rëndësishëm, sepse ka jo vetëm masën e ndihmës ekonomike, që duhet qartësisht të adresohet prej saj, por edhe përcaktimin e masës së pensionit, përcaktimin e detyrimeve ushqimore për fëmijët dhe vlera të tjera, të cilat janë shumë të rëndësishme, që njerëzve t'u japim dinjitetin e tyre human dhe të trajtohen me dinjitet.

Sigurisht që skema e ndihmës ekonomike nuk mund të jetë një skemë që t'i lërë njerëzit përjetësisht pa punuar, ne duhet të kemi një skemë, e cila t'i nxjerrë njerëzit nga varfëria, por edhe nga mënyra e të jetuarit me ndihmë ekonomike dhe për t'i bërë ata të interesuar për të punuar, kështu që të gjitha këto elemente do të duhet të merren parasysh. Në vlerësimin që ne kemi, ka pasur një komitet që është ngritur në Ministrinë e Shëndetësisë prej më shumë se 8 vjetësh, i cili do të duhej të hartonte formulën. Ne kemi bërë një propozim si e mendojmë ne se duhet të jetë formula, por sigurisht që shteti shqiptar, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale ka ekspertët e vet, të cilët mund të paraqesin një formulë që t'i adresojë të gjitha këto lloj problematikash dhe mbi bazën e kësaj formule, vit pas viti të përcaktohet edhe vlera e minimumit jetik për qytetarët shqiptarë.

Avokati i Popullit mund ta mbështesë çfarëdolloj iniciative dhe reforme të tillë dhe besoj se kemi bërë detyrën tonë ndaj qytetarëve duke e adresuar këtë problem. Nga ana tjetër, masa e ndihmës ekonomike gjatë dy vjetëve të fundit ka pësuar rritje; gjithsesi, rritja nuk është ajo që të adresojë nevojat e qytetarëve, mbetet ende larg nevojave të qytetarëve. Vlera maksimale e ndihmës ekonomike për vitin e kaluar ka qenë në vlerën 22 mijë lekë të rinj për familje, kur e them për familje, është maksimalja, sepse kuptohet që ka shumë fëmijë dhe elemente të tjera që lidhen me këtë vlerë, por ajo është ende larg asaj që duhet të ishte për të adresuar problematikat e të gjithë familjes. Gjithsesi, është për t'u lavdëruar fakti që ka pasur adresime, si 3-fishimi i ndihmës ekonomike për ato familje që kanë më shumë se 2 fëmijë, pra 3 fëmijë e më tepër, por prapë se prapë masa mbetet e vogël.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ballanca!

A ka pyetje të tjera për Avokaten e Popullit? Në rregull.

Kalojmë te diskutimet.

Fjalën e ka zonja Bushka.

Të përgatitet zonja Zhupa.

Erinda Ballanca – Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zonja Ballanca, mund të na dëgjoni nëpërmjet sallës.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Falënderoj zonjën Ballanca për raportimin vjetor!

Fillimisht, kolegë, më lejoni të theksoj se raportimi vjetor i institucioneve për aktivitetin e vitit përkatës nuk është thjesht një raportim për të kuptuar si ka punuar institucioni, si i ka zbatuar ato që janë kompetencat funksionale të punës së institucionit, por është për të kuptuar nga rezultatet e asaj pune se si është gjendja në lidhje me fushën që mbulon ai institucion. Avokati i Popullit është institucioni më i rëndësishëm për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, një institucion me një jetëgjatësi, i cili e ka tashmë të konsoliduar veprimtarinë e vet dhe nga viti në vit ne presim rezultate nga ky institucion për të arritur atë që është objektiv në çdo shoqëri demokratike, që qytetarët të gëzojnë lirshëm të drejtat e tyre themelore të parashikuara nga aktet ndërkombëtare ku Shqipëria merr pjesë;

një prej më të rëndësishmeve është Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila mishërohet edhe në tekstin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Zonja Ballanca na bëri një raport të plotë të veprimtarisë dhe të rezultateve. Ju tashmë keni edhe një raport të Komisionit të Ligjeve dhe një draftrezolutë për këtë institucion, por unë do të ndalem tek ato çështje që kanë interes për publikun. Siç jua thashë, na duhet që në aktivitetin e mbikëqyrjes parlamentare të ngremë çështje, për të cilat shoqëria ka nevojë të diskutojë dhe të japë zgjidhje për situata problematike.

Ne në raportimet e institucioneve të pavarura kemi vënë re që raportimi vetëm në formën e statistikave nuk e ndihmon këtë qasje, ndaj vitin e kaluar, kur kemi miratuar rezolutën për Avokatin e Popullin dhe për të gjitha institucionet e tjera, në fushën e përgjegjësisë së komisionit kemi vendosur edhe disa indikatorë plus, në mënyrë që çështjet të trajtohen më në themel dhe të kemi zgjidhje dhe rezultate konkrete, të cilat do të duhet edhe të provohen sa i kanë shërbyer shoqërisë sonë. Një nga këto rekomandime ka qenë që të gjitha raportet e Avokatit të Popullit për fusha të caktuara, të jenë publike në faqen e internetit së bashku me rekomandimet përkatëse dhe të ketë një progresraport të zbatimit të rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse. Kjo gjë, nëse e shohim në raportin e këtij viti, ka përmirësuar jo vetëm zbatimin e rekomandimeve, pra rritjen e numrit të rekomandimeve të zbatuara, por në të njëjtën kohë shohim se ka një rritje të numrit të ankesave që trajtohen nga viti i mëparshëm në vitin për të cilin raportohet, pra nga viti 2021 në vitin 2022.

Çështjet kryesore që kanë qenë objekt i inspektimeve janë: situata në institucionet e paraburgimit në burgjet shqiptare apo në institucionet e organeve të rendit; respektimi i të drejtave të njeriut në këto institucione; çështje që lidhen me ndërgjegjësimin e publikut kryesisht në bashkëpunim me Komisionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi për t'i bashkërenduar të gjitha përpjekjet, që në shkollat tona të ketë një edukim thelbësor që në fëmijëri për të rinjtë, se si do të duhet të brumosen me koncepte të rëndësishme në demokraci, siç është garantimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe t'i njohin se cilat janë realisht këto të drejta.

Nga ana tjetër, një çështje e rëndësishme që do të duhet ta theksojmë, ka të bëjë me mbrojtjen e grupeve në nevojë. Ne kemi grupe, të cilat sot ende kanë nevojë të ndihmohen që të marrin shërbime dhe t'u respektohen të drejtat në institucionet publike. Shpeshherë mungesa e informacionit dhe e aksesit ul mundësinë e këtyre grupeve për të përfituar nga shërbimet, ndaj roli i Avokatit të Popullit apo edhe i institucioneve të tjera të barazisë duhet të intensifikohet në drejtim të ndihmesës që u bëhet qytetarëve të këtyre grupeve për të përfituar nga këto shërbime, për të mos i lënë mënjandë dhe që askush të mos ngelet mbrapa.

Një çështje tjetër e rëndësishme ka të bëjë me të drejtat e qytetarëve për të marrë përgjigje në kohë nga institucionet. Kemi një raport të Avokatit të Popullit, i cili jep detaje për numrin e çështjeve të trajtuara, për rezultatet e marra dhe se ku ka ende nevojë për një plan masash të konsoliduara që kërkojnë objektiva të qartë dhe rezultate konkrete në këtë drejtim. Nisur nga gjithçka që ju thashë, puna e Avokatit të Popullit konsiderohet e kënaqshme për vitin e kaluar, veçanërisht vlerësohet pozitiv forcimi i rolit në veprimtaritë ndërkombëtare, si pjesëmarrës me rol aktiv në institucionet globale dhe europiane të të drejtave të njeriut, jo vetëm sa i takon të treguarit se Shqipëria ka kapacitete njësoj si vendet e tjera, por më së shumti për të marrë eksperiencën e vendeve avangardë në këtë drejtim dhe për ta përkthyer në një eksperiencë të brendshme në vendin tonë.

Është shumë e rëndësishme që institucione si Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të jenë pjesë aktive në procesin integruar në Bashkimin Europian. Ne shohim që Bashkimi Europian në raportprogresin e vet ka dhënë vlerësimet apo komentet në lidhje me punën e institucionit, sepse vërtet këto janë momente ku ne i bëjmë edhe një lloj *screening* vendit tonë se ku jemi me situatën e të drejtave të njeriut, çfarë duhet të përmirësojmë, cilat janë rastet e suksesit dhe cilat janë ato ku ne duhet të fokusohemi më shumë dhe sigurisht kjo nuk mund të bëhet pa një ndërveprim të institucioneve si Kuvendi, Avokati i Popullit apo institucione të tjera të barazisë. Në këtë drejtim puna konsiderohet se ka ecur me hapa të mirë dhe sigurisht do të duhet të konsolidohet në drejtim të rezultateve.

Për vitin 2023 rekomandimet e komisionit, nisur nga thelbi i çështjeve që duhet të trajtojmë, jo më i statistikave, bazohet në disa pika të rëndësishme. Ne kërkojmë që Avokati i Popullit të ketë një rol më aktiv në inspektimet tek organet e pushtetit vendor, sa respektohen të drejtat e njeriut, sa përgjigje marrin qytetarët dhe se çfarë duhet bërë në atë drejtim; e njëjta gjë do të duhet të ndodhë edhe me vijimin e inspektimeve në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe respektimin e të drejtave të shtetasve këtu.

Një çështje që del sot si nevojë e shoqërisë shqiptare, është si trajtohen qytetarët tanë në shërbimet e kadastrës shqiptare. E drejta e pronës është një e drejtë shumë e rëndësishme. Ne kemi tashmë të realizuar një reformë prone me akte ligjore të miratuara në Kuvend dhe me reforma institucionale, por qytetarët do të duhet të përfitojnë realisht nga këto reforma, ndaj edhe kujdesi i të gjithëve, përfshirë edhe Avokatin e Popullit, duhet të jetë se sa garantohen të drejtat e njeriut në ofrimin e shërbimeve që ata marrin në kuadër të respektimit të së drejtës të pronës. Gjithashtu, i rëndësishëm për ne është vijimi i mbrojtjes së grupeve të marginalizuara nëpërmjet garantimit të plotë të të drejtave të këtij grupi në shërbimet që marrin në administratën publike.

Avokati do të duhet të vijojë t'i nxjerrë rekomandimet, t'i bëjë publike dhe të raportojë në Kuvend se cilat janë ato institucione që nuk i zbatojnë rekomandimet apo me cilin institucion do të duhet Kuvendi të krijojë një raport institucional nëpërmjet mjeteve që kemi ne në dispozicion, siç janë dëgjesat apo këmbimi i informacioneve zyrtare për të kuptuar se si mund të zgjidhet më mirë një situatë.

Është shumë e rëndësishme që bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me institucionet e tjera si në nivelin brenda apo jashtë vendit, të vijojë, në mënyrë që ne të kemi një hartë të plotë të të gjithë aktorëve që punojnë në këtë drejtim, një hartë të plotë të çështjeve, të cilat mund të tregojnë që ecin mirë dhe të atyre që konsiderohen problematike, sepse mbrojtja dhe garantimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut nuk është një çështje që arrihet dhe përfundon atje, por është një luftë e përditshme e kujtdo, sepse shumë shpejt një e drejtë e arritur mund të kthehet mbrapa nga veprime, të cilat mund të kalojnë nga vëmendja e atyre autoriteteve publike që e kanë për detyrë t'i garantojnë e t'i

mbrojnë ato, ndaj është një sfidë e çdo shoqërie demokratike, ashtu si edhe e vendit tonë, aq më tepër që tashmë edhe në procesin e integritimit në BE ne monitorohemi në këtë aspekt, në një sërë kapitujsh, të cilët, nëse i zërthejmë, bazë kanë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Flasim për shumë nga të drejtat që kanë edhe aktet ndërkombëtare, ku unë përmenda më parë të drejtën e pronës, por është edhe e drejta për proces të rregullt ligjor, e drejta e jetës...

(Bie gongu.)

Duhet ta përdor kohën në mënyrë efektive.

Thënë këto, rekomandimet e Komisionit të Ligjeve janë rimbledhur dhe janë miratuar në një draftrezolutë, për të cilën, kolegë, ju ftoj të votoni pro.

Sigurisht, ne jemi të hapur, nëse do të keni ndonjë propozim tjetër për rekomandim, i cili i shërben qëllimit final për të garantuar dhe për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut në Shqipëri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bushka!

Fjala për zonjën Zhupa. Koha në dispozicion është 10 minuta.

Ina Zhupa – Faleminderit, e nderuar kryesuese e seancës!

Në fakt, sot shqyrtojmë një raport me rëndësi të veprimtarisë së Avokatit të Popullit, e cila, duhet thënë se, për hir të së vërtetës, ka qenë një punë e jashtëzakonshme, që ka ardhur në përmirësim nga viti në vit, ashtu siç reflektohet edhe në raportet e Avokatit të Popullit, por edhe në diskutimet dhe në rezolutat e nxjerra nga Komisioni i Ligjeve dhe nga vetë parlamenti.

Avokati i Popullit ka arritur që nëpërmjet rekomandimeve të tij dhe mendimeve të shprehura në procese gjyqësore të vendosë disa standarde të rëndësishme, të cilat unë do të doja t'i ndaja fillimisht me ju.

E para, Avokati i Popullit ka qenë një promotor dhe ka dhënë mendime për padinë në Gjykatën Kushtetuese për të drejtën e emigrantëve për të votuar në zgjedhjet e përgjithshme. Ju e mbani mend se si me një urdhër arbitrar, Ministria e Shëndetësisë në zgjedhjet e vitit 2021 i ndaloi emigrantët për të ardhur dhe për të ushtruar të drejtën e votës. Unë, si deputete e një zone kufitare, e kam vuajtur kur qytetarët shqiptarë emigrantë nuk lejoheshin të vinin dhe të ushtronin të drejtën e votës në vitin 2021. Kur

padia shkoi në Gjykatën Kushtetuese, në opinionet më bazike dhe më të mira në mbrojtje të të drejtës së emigrantëve për të ushtruar të drejtën e votës, ka qenë opinionin *amicus curiae* i Avokatit të Popullit, e cila, në fakt, ishte edhe një padi e fituar për të garantuar që asnjëherë tjetër shteti shqiptar, qeveria shqiptare të mos mohojë të drejtën e emigrantëve për të votuar, pavarësisht rrethanave të ndryshme që ata mund t'i gjejnë si të justifikueshme ose jo.

Pasi bashkohem me atë që tha kryetarja e Komisionit të Ligjeve që të drejtat e njeriut janë një sfidë, që sot i ke, por nesër mund t'i humbasësh nga veprimet ose nga mosveprimet e qeverisë, në këtë aspekt ashtu ishte edhe e drejta e emigrantëve për të ardhur dhe për të votuar, të cilën e humbën gjatë zgjedhjeve të vitit 2021, por i takon këtij parlamenti që jo vetëm të garantojë që ata të kenë mundësinë e lëvizjes dhe të ardhjes në zgjedhje sa herë e mendojnë të arsyeshme, por mundësisht të garantojë të drejtën e emigrantëve për të votuar edhe në shtetet ku ndodhen.

Nga ana tjetër, një raport, i cili ka përcaktuar edhe formulën e minimumit jetik, është bazik për të garantuar të drejtat e qytetarëve dhe për të garantuar mbrojtjen e lirive të tyre. Ne sot si parlament do të duhet që këtë raport të Avokatit të Popullit, i cili ka ardhur nga viti në vit duke ushtuar dhe duke u përmirësuar, të mund ta vëmë në punë si dokument pune për të kaluar ndryshime ligjore dhe për të përcaktuar me ligj detyrimin që t'u garantojmë qytetarëve tanë minimumin jetik. Nuk ka më asnjë kuptim që të kemi asistencë sociale, ndihmë ekonomike apo pensione poshtë minimumit jetik, duke i pamundësuar kështu qytetarët që të kenë një jetë dinjitoze dhe më tej sesa thjesht në kushtet e mbijetesës, që buka e përditshme të mos jetë shqetësimi kryesor i qytetarëve. Përderisa ne e kemi këtë material të prodhuar nga Avokati i Popullit, do të duhet që, realisht, të reflektojmë dhe të marrim vendimmarrje, për aq kohë sa Avokati i Popullit është në tagrat e tij rekomandues për këtë proces.

Ajo që është interesante dhe të cilën unë si nënkryetare e Grupit të Deputetëve "Miqte e fëmijëve" do të doja edhe ta përcillja për publikun, është raporti i veçantë që ka bërë Avokati i Popullit për pensionin ushqimor për fëmijët, për të cilët gjatë procesit të divorcit të prindërve shteti duhet të ofrojë një garanci, kur ende nuk janë ndarë, se kush do ta paguajë

pensionin ushqimor, babai apo nëna, apo edhe kur prindërit nuk kanë të ardhura të mjaftueshme ekonomike, në mënyrë të tillë që fëmijës t'i garantohet një pension ushqimor i plotë dhe i mjaftueshëm për ushqim, shkollim dhe veshje për të mos cenuar të drejtat e tij. Në këtë drejtim, duhet të jetë pikërisht shteti ai që duhet të marrë barrën për të garantuar interesin e fëmijës. Ne e kemi edhe në Kodin e Familjes që interesi i fëmijës duhet të jetë interes parësor dhe duhet të jetë një nga detyrat themelore që duhet të ketë shteti, për arsye se ata vetë nuk mund të ngrihen për të mbrojtur të drejtat e tyre dhe nuk mund të jenë palë në ankesat e Avokatit të Popullit, nuk mund të jenë palë në procese gjyqësore, pra duhet të jetë shteti ai që kujdeset për interesin e fëmijës. Në fakt, duhet të jetë edhe detyra e Grupit të Deputetëve "Miqte e fëmijëve" që këtë raport ta kemi si një dokument pune, për ta përkthyer në politika shtetërore, në garanci për fëmijët, ashtu siç ka edhe raporte të tjera të Avokatit të Popullit pikërisht në këtë drejtim.

Ajo që vlen për t'u nënvizuar sërish, është rritja në mënyrë eksponenciale e njohjes së Avokatit të Popullit si institucion me standarde nga organizmat e huaj. Është e rëndësishme të thuhet se Avokati i Popullit është zgjedhur nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur nga institucioni i BE-së, *Fundamental Rights Agency*, pra ka aplikuar dhe është zgjedhur nëpërmjet një konkursi për të qenë ai institucioni i cili do të hartojë raportin vjetor të zbatueshmërisë të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut për Shqipërinë për llogari të Bashkimit Europian. Pra, që një institucion shqiptar të zgjidhet nga institucionet e BE-së që të kryejë punë, është një arritje shtetërore. Edhe ne duhet të jemi pjesë e kësaj krenarie kur institucionet tona, të zgjedhura nga Kuvendi, me vota nga Kuvendi, përfaqësohen, marrin tagra dhe fitojnë të tilla të drejta për të përpiluar një raport në emër të Shqipërisë.

Po ashtu, Komiteti i Parandalimit të Torturave i ka besuar Avokatit të Popullit kërkesën dhe detyrën për të hartuar një raport të veçantë në emër dhe për llogari të tij. Ky raport, po ashtu, është shumë profesional dhe me standarde.

I thashë këto, sepse është e rëndësishme që të kuptohet që institucioni ka arritur një nivel të besueshëm profesionalizmi dhe krahasohet me

organizma të tjerë, të ngjashëm në vendet e BE-së, ku ne kemi dëshirë dhe perspektivë për të aderuar.

Dua të ndalem te fakti që ne si Kuvend kemi bërë një zgjedhje para 6 vjetësh, pra kemi zgjedhur një juriste/avokate si zonja Erinda Ballanca në krye të këtij institucioni, dhe unë besoj se ka qenë zgjedhja e duhur, pavarësisht se në atë kohë nuk kam pasur mandat apo të drejtë vote. Zonja Ballanca nuk e ka hedhur kandidaturën për një mandat të dytë, pavarësisht se po vazhdon të punojë në krye të institucionit të Avokatit të Popullit, duke arritur edhe këto standarde, por është detyra jonë si Kuvend që të garantojmë vazhdueshmërinë e këtij procesi, pra zgjedhjen e njeriut të duhur, për të vazhduar me të tilla standarde profesionalizmi në krye të Avokatit të Popullit. Është përgjegjësia jonë, si propozues, pra e deputetëve të opozitës, por edhe e deputetëve të mazhorancës të arrijmë dakordësinë që të votojmë njerëz profesionistë, të cilët mund ta përfaqësojnë në mënyrë të denjë institucionin e Avokatit të Popullit në rritjen dhe në konsolidimin e këtyre standardeve që janë vendosur tashmë për të. Personalisht mendoj se institucionit i bën mirë zgjedhja e njerëzve me formim juridik, sepse, duke u nisur nga fakti që janë përballë betejave ligjore dhe çuarjes së opinionëve në Gjykatën Kushtetuese, janë pjesë aktive e proceseve të organeve të drejtësisë dhe, po ashtu, janë pjesë aktive e hetimeve administrative që kanë të bëjnë thelbësisht me gjykimet për ligjshmërinë e institucioneve, patjetër që një formim i tillë do ta forconte kryetarin apo kryetaren e ardhshme të Avokatit të Popullit, të cilët do të kenë mekanizmat e duhur për të ushtruar edhe presionin, por për të dhënë edhe rekomandimet e duhura për institucionet në drejtim të tablosë ligjvënëse dhe institucionale.

Për ta mbyllur, Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut duhet të jetë edhe sfida jonë në vazhdim, sepse është e rëndësishme që, kur bëhet fjalë për arritjen e standardeve të BE-së, pse jo, të jemi proaktivë dhe të kërkojmë që të arrijmë t'i përshpejtojmë hapat, dhe detyrimet që do të na vijnë më pas me anëtarësimin të mund t'i vëmë në vijë që tani, gjatë proceseve tona legjislative, siç është edhe Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Shumë faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zhupa!

Fjalën e ka zoti Dule. Koha në dispozicion është 5 minuta.

Të përgatiten zoti Shehu dhe zoti Vasili.

Vangjel Dule – E nderuar kryesuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Në çdo demokraci të mirëqenë, në shtetin e së drejtës, Avokati i Popullit, si institucion, është diamanti i kurorës. Në vendin tonë, me përjashtim të punës së përkushtuar të këtij institucioni prej vitesh, aq më tepër në drejtimin aktual, nuk ka pasur atë mbështetje që të paktën ne si Kuvend duhej t'ia kishim garantuar në aspektin ligjor, të burimeve njerëzore, por edhe financiare.

Përse ndodh kjo? Kjo ndodh për një fakt të thjeshtë, por edhe domethënës: Avokati i Popullit, që në destinacionin e vet kushtetues është një destinacion opozitar ndaj qeverisjes, por ne nuk kemi tolerancë për mendimin opozitar, qoftë institucional, qoftë politik, qoftë partiak. Ne jemi në një fazë shumë të arrirë të njësimi të pushteteve. Ne kemi një parti, një qeveri, një Kuvend, një shtet dhe, mbi të gjitha, qëndron Ludoviku ynë, i cili na proklamoi përditë: “Shteti jam unë”, por në një kohë që Ludoviku, ose Luigji XIV ishte krenaria e Francës së atëhershme, kreu i qeverisë është turpi i Shqipërisë së sotme.

Zonja dhe zotërinj të nderuar,

Duke folur për të drejtat e njeriut, nuk mund të mos përmend sot se një qytetari, Dhionisius Alfred Beleri, i dhunohet në mënyrë arbitrare dhe nga çdo këndvështrim i jashtëligjshëm, liria; një kryetari të zgjedhur me mandat të ratifikuar në një prej 61 bashkive të vendit, i privohet e drejta kushtetuese për të ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë që i kanë ngarkuar bashkëqytetarët e tij. Një komuniteti, atij të Bashkisë së Himarës, i nëpërkëmbet e drejta klasike e sovranit. Pse të gjitha këto?! Thjesht dhe vetëm se nuk i pëlqen Ludovikut të parë të Shqipërisë.

Mund të ketë dhe ka shumë aspekte të drejtësisë, të cilat e mbajnë në mënyrë të paligjshme të ndaluar zotin Beleri, por motivuesi dhe dirigjuesi i rrëmbimit dhe i pengmarrjes së zotit Beleri është Kryeministri i vendit. Pse e them këtë?! Shikoni kronikën e ngjarjeve më 6 maj, 1 javë e 2 ditë përpara zgjedhjeve të majit, ishte ai që dha sinjalin nga tubimi me banorët e supozuar të Himarës (të importuar ishin të gjithë ata) se nuk

do të toleronte që himarjotët të shprehnin vullnetin e tyre, sepse duhej ta shikonin atë në sy dhe të vendosnin se kë do të zgjidhnin të parin e tyre. Ky motiv, i cili ishte denigrues, intimidues dhe nga çdo këndvështrim ishte abuziv dhe autarkik, vazhdoi për ditë të tëra kudo që u gjend, në Fier, në Lushnjë, në Kamzë, në Tiranë. Motivi ishte Fredi Beleri, stigmatizimi i tij, demonizimi i tij, me qëllim final rrëmbimin e Bashkisë së Himarës. Kjo vazhdoi deri në misionin e fundit, ku gjysmë ore përpara rrëmbimit të zotit Beleri, Kryeministri i vendit, Ludoviku I i Shqipërisë dha urdhrin: “Të rrëmbehet, të mbahet peng, të drejtat të nëpërkëmben!”. Të drejtat e komunitetit të Himarës, duke filluar nga ajo e zgjedhjes, e pronës, e identitetit shkelen dhe nëpërkëmben në mënyrë flagrante e të papranueshme dhe çuditërisht shoqërohen me një heshtje, një heshtje që do ta gjejmë të gjithë përpara në ecurinë e demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe të integritetit tonë europian.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Dule!

Fjala për zotin Shehu. Keni 10 minuta në dispozicion.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Kolegë të nderuar,

Zonja Avokate e Popullit, së pari, unë ju përgëzoj për punën që keni bërë në këtë periudhë, edhe për materialin dhe raportin që keni paraqitur, i cili ka elemente pozitive, ka probleme që ngrihen, ka çështje që diskutohen! Në tërësi ky është një raport i mirë dhe, realisht, gjykoj se duhet votuar pozitivisht. Megjithatë, mirësia dhe përsosmëria nuk kanë fund, sepse ndonjëherë, pavarësisht nga materialet e mira që paraqesim, ne harrojmë dhe lëmë mënjanë disa çështje thelbësore për jetën e qytetarëve, për sigurinë e qytetarëve, për shëndetin e qytetarëve, veçanërisht të brezit të ri, të të rinjve, për të sotmen dhe të nesërmen e Shqipërisë.

Fatkeqësisht, në këtë parlament shpeshherë kolegët deputetë të mazhorancës nuk i marrin seriozisht ato që thuhet, nuk reagojnë, por ngrenë kartonët dhe kaq, pa u menduar dhe pa u thelluar në përmbajtjen e çdo ligji apo dokumenti që vjen këtu, i cili duhet miratuar me shumë seriozitet dhe me gjykim shumë të thellë në shumë këndvështrime nga ne si deputetë.

Prandaj, unë përfitoj nga rasti që Avokatja e Popullit është sot këtu dhe dua t'i drejtohem asaj,

nëpërmjet saj, pa dyshim edhe opinionit publik shqiptar, për një çështje shumë të rëndë që po kalon vendi, për një problem të madh social, ekonomik, shëndetësor të së ardhmes, veçanërisht të të rinjve, për drogën, e cila realisht është bërë një sëmundje gërryese, shkatërruese për të rinjtë tanë, për Shqipërinë në disa drejtime: në drejtim të kriminalitetit, trafiqeve, kultivimit të kanabisit dhe kanabizimit të Shqipërisë në të gjithë vendin që prej vitit 2014-2015; në drejtim të krijimit dhe forcimit në këtë mënyrë të kriminit në Shqipëri, jo të mirëqenies së njerëzve; në drejtim të asaj që shumë qytetarë të rinj janë fatkeqë, duke rënë pre e kthetrave të drogës, të kësaj të keqeje të madhe të shoqërisë njerëzore. Sipas Bankës Botërore fillojnë me tymosjen e kanabisit që në moshën 13, 14 apo 15 vjeç dhe rreth 70% e këtyre fëmijëve, veçanërisht në qytetet e vogla, fillojnë të bëhen përdorues të drogave të forta, të cilat shkaktojnë shkatërrim moral, shkatërrim fizik dhe të shëndetit mendor. Fatkeqësisht pak flitet për këtë gjë; nuk shoh të bëhet propagandë kundër drogës në Shqipëri; nuk shoh të flitet apo të ngulet këmbë; nuk shoh t'u vihet në ndihmë këtyre fatkeqëve, përkundrazi, zonja Avokate e Popullit, qeveria sjell një ligj për legalizimin e kanabisit mjekësor. Unë mendoj dhe gjykoj se e keqja po thellohet.

Së pari, dua të them dy fjalë: kanabisi mjekësor në këtë rast është një koperturë; është thjesht etiketa e sheqerosur e kanabizimit të vendit; është thjesht etiketa e sheqerosur e shkatërrimit të të rinjve, e rritjes së kriminalitetit; është licencimi dhe legalizimi i grupeve kriminale. Kjo është vërteta. Kanabisi mjekësor ka një përdorim shumë të kufizuar, vetëm eksperimental dhe për kërkime shkencore; ai përdoret në pak patologji, siç janë tumoret e avancuara, HIV-i i avancuar apo skleroza multiple, kaq, të jemi realistë. Ende kanabisi mjekësor nuk është një produkt farmaceutik, siç janë për shembull, opiatet, apo kokaina, të cilat janë produkte farmaceutike.

Eksperimentet me të: për shembull, në Itali, sasia e vogël që duhet për kërkime shkencore prodhohet nën kujdesin e ushtrisë dhe jo të Ministrisë së Shëndetësisë, siç duam ne t'ia lëmë në qafë Ministrisë së Shëndetësisë, e cila nuk kontrollon dot as medikamentet në treg; në Maqedoni ky eksperiment dështoi dhe u kthye në përdorim për trafiqe drogash, sepse kanabisi në

thelb është drogë, aq më shumë produktet e reja të kanabisit, të cilat e kanë substancën aktive jo më 8% dhe 9%, por mbi 15%, dhe e kthejnë në këtë mënyrë edhe në drogë të fortë. Kanabisi është një drogë, e cila krijon deformime intelektuale, mund të shpërthejë skizofreninë dhe është një prekursor i drogave të forta. Unë e kam thënë edhe herë të tjera që rreth 85% e të sëmurëve, që janë shtruar në QSUT me mbidozë nga drogat e forta, e kanë filluar me kanabis. Në këtë mënyrë ne u bëjmë propagandë kanabisit dhe drogave, në vend që të bëjmë të kundërtën.

Kanabisi mjekësor ka një përdorim shumë të kufizuar. Kanadaja, që është vendi eksportues kryesor i mirëfilltë për kanabisin mjekësor për shkencë, eksporton në vit jo më shumë se 50 tonelatë. Pra, tregu botëror është shumë i vogël. Shqipëria nuk ka asnjë mundësi dhe kapacitetet në këtë drejtim; vendet e tjera e përdorin në sasi shumë të vogla. Nëse ju doni të thoni: "Liberalizojmë drogën në tërësi", atëherë diskutoheni të gjithë, hapeni këtë histori dhe thoni: "Duam që të drogohen shqiptarët. Duam që Shqipëria të mbushet me tym, duam që të shtohen rastet e të droguarve". Dakord, thojeni këtë hapur: "Të liberalizojmë drogën", por mos u fshihni pas kanabisit mjekësor, që është thjesht kopertura e vërtetë e çështjes. Në vend që të mendojmë dhe të gjykojmë se çfarë do të bëjmë për ta luftuar drogën, ne i bëjmë promovimin drogës duke nxjerrë ligjin dhe duke sjellë vendime për kanabisin mjekësor. Kjo është një gënjeshtëri. Pse nuk ka propagandë kundër drogës në Shqipëri; cili është qëllimi? Ka një qëllim të madh. Pse në Shqipëri nuk ka asnjë institucion mjekësor për rehabilitimin e atyre që janë nën varësinë e drogës? Nuk ka asnjë; ishte një institucion në Kombinat, qendra "Emanuel", me 12 vende, nuk është më. Ekziston vetëm qendra toksikologjike në QSUT, që merret me rastet akute të mbidozës, por rehabilitimin nuk mund ta bëjë ajo. Në Shqipëri nuk ka asnjë qendër mjekësore, sociale që të kujdeset për këta fatkeqë, sepse këta janë fatkeqë, janë produkt i deformimit të shoqërisë dhe nuk është faji i tyre apo i familjeve të tyre, se edhe ato janë fatkeqe. Ky është produkt i deformimit të shoqërisë, pikërisht duke u influencuar edhe nga ky projektligj që vjen për legalizimin e kanabisit, cili nuk është gjë tjetër vetëm, e theksoj, një propagandë për drogën, sepse nuk do të sjellë asnjë të mirë ekonomike,

por vetë të këqija ekonomike, sepse fshatarët do të lënë bujqësinë konvencionale, siç e lanë që në vitin 2015, do të shkatërrojnë bagëtinë dhe pastaj do të dështojnë totalisht.

Kjo është të krijosh në Shqipëri “republikën e kanabisit”, të nderuar kolegë dhe e nderuar zonja Avokate e Popullit, kështu që unë mendoj se ju duhet t’i ngrini këto çështje, pasi ato bien në kurriz të popullit, në kurriz të njerëzve. Pra, këtu po shkojmë drejt një shkatërrimi të vendit; po shkojmë drejt modeleve më të rrezikshme të shoqërisë. Jam dakord që i kanë disa vende, por shikojeni si është gjendja tek ato, edhe pse mund të kenë forcë të madhe kontrolluese apo institucione të fuqishme në nivelin shëndetësor e social, përsëri kanë pasoja të mëdha. Edhe në Kolorado, po të doni, mund t’i shikoni pasojat sociale të këtij problemi. Pra, çfarë modeli do të zgjedhim ne? Ne nuk kemi asgjë, jemi një shtet i inkriminuar, me grupe kriminale që kontrollojnë, me institucione fare të dobëta. Edhe kjo na duhet pastaj, “t’i varim mëlçitë ujkut në qafë”. Prandaj unë mendoj se kjo është një çështje shumë serioze. Fatkeqësisht, shpeshherë në këtë parlament gjërat serioze merren me shumë mendjehetësi, merren me shumë suflencialitet. Fatkeqësisht, këtu kërkohet vetëm e vetëm që t’i bëhet qejfi qeverisë. Këtu nuk pranohet të bëhet asnjë ndryshim në ligjet që sjell qeveria, jo më të rrëzohen. Ky ligj që vjen, kërkon ndryshime në Kodin Penal, kërkon votim të cilësuar, të mos kërkojë njeri të bëjë akrobaci ligjore, pra kërkon një votë të gjerë që nuk besoj kurrë të arrihet në parlamentin shqiptar, e cila propagandon, promovon, forcon, shton përdorimin e drogës, forcon kontrollin e grupeve kriminale, shkatërrojnë moralin, shëndetin fizik dhe mendor, veçanërisht të rinjve në një vend, i cili realisht nuk ka asnjë strukturë që të kujdeset për ata që fatkeqësisht janë të varur nga droga. Kjo është e vërteta e hidhur e këtij vendi; kjo është ajo rrugë ku ne po shkojmë përsëri me këtë ligj, të cilin unë e konsideroj një ligj kriminal, një provokacion të rëndë për ta çuar vendin drejt asaj që quhet republika e kanabisit dhe për t’u dhënë goditjen e fundit të rinjve shqiptarë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Shehu!

Fjalën e ka zoti Vasili. Keni 5 minuta në dispozicion.

Të përgatitet zoti Balla.

Petrit Vasili – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa as më të voglin diskutim, mund të themi se jemi në ditën e raportimit të një institucioni të pavarur që i vendos këtë institucion dhe Kuvendin e Shqipërisë në një nga raportet më qesharake dhe më dramatike që mund të ekzistojë. Mandati i Avokatit të Popullit ka përfunduar më 20 qershor të vitit 2022. Sot jemi më 22 qershor të vitit 2023 dhe për një vit rresht për shkak të tregut, pazarit politik, vendosjani emrin si të doni, sepse nuk ka shpjegim tjetër, ky mandat nuk është rifreskuar, ashtu sikurse e kërkon Kushtetuta. Pra, është e drejtë e qytetarëve që të kenë një Avokat Populli të zgjedhur në mënyrë korrekte, ashtu siç e kërkon Kushtetuta, por ne nuk e kemi. Çfarë buron nga kjo, thjesht një vonesë e zakonshme?! Jo, nuk është një vonesë e zakonshme, por, siç e thashë, është për shkak të pazareve. Pikërisht për këtë gjë në kohën kur bëhej reforma në drejtësi, të paktën ta kujtojmë pak si diskutim, sepse vetë reforma në drejtësi është në një përshpirtje të plotë, Komisioni i Venecies thoshte shumë qartë që tejzgjatja e mandateve të organeve kushtetuese, krijon shteg për thyerjen e pavarësisë së tyre. Pra, krijon atë që është varësi politike, e ashtuquajtura varësi dhe mirënjohje politike, sepse “jemi ne që të zgjodhëm dhe jo ata”, për pasojë edhe objektiviteti i institucionit merr fund. Këtu nuk është në gjendje asnjëri të japë më shumë shpjegime dhe ta shpëllajë Kuvendin e Shqipërisë nga ky turp kushtetues dhe procedural. Dikush do të thotë me qetësinë më të madhe se ky Kuvend u mësua të bashkëjetojë më turpet, pra është për atë pjesë që është autore e tyre, jo për ne.

Për sa i përket veprimtarisë së Avokatit të Popullit, pa asnjë diskutim, përgjithësisht të gjitha raportet e Avokatit të Popullit, formalisht, siç thotë populli, në letra, pak kanë pasur për të kritikuar. Problemi është që, në raport me një sfond të përbindshëm të shkeljeve të drejtave të qytetarëve, të gjitha llojeve të formave, të lirisë së pronës, të lirisë së shprehjes, të së drejtës për të marrë drejtësi e të tjera, diferenca është një humnerë e vërtetë. Ajo që duhet të kishim në terren, do të ishte një Avokat i Popullit, që donte apo nuk donte, do të ishte ndryshe, nuk do të ishte si një vend tjetër, ku Kushtetuta dhe ligji mbretërojnë, por do të ishte i imponuar të kishte një protagonizëm shumë më të fortë, sepse nuk ka

kush ta mbrojë më. Ne kemi parë e shikojmë se si në institucionet e parburgimit nuk është 1, por janë 1, 2, 3 e me radhë të rinj që humbin jetën. Kjo është një situatë skandaloze që nuk ka ku të shkojë më, pra ka hyrë në kufijtë e krimit. Kemi parë se si sa hap e mbyll sytë ndryshohen kodet në Shqipëri, por kemi parë projektligje, siç thotë kolegu Shehu, për drogën (ende nuk kanë ardhur), që është akoma më dramatike, një tragjedi e vërtetë shëndetësore dhe sociale. Njëherazi ka edhe shumë çështje të tjera të mëdha, për shkak të kapjes së Gjykatës Kushtetuese, për fat të keq. Duhej të ishte detyrë e Avokatit të Popullit që të merrte misionin për të çuar atje ligje tmerrësisht antikushtetuese, sepse kjo gjykatë e kapur, sigurisht, i ka nxjerrë bojën moslegjitimitetit të palëve, pra marrjes përsipër që as të mos i lejojë palët të ankohen, qofshin parti politike, organizata joqeveritare, subjekte private, subjekte biznesi e të tjera. Pra, normalisht është e qartë që duhet dhe është e imponuar që të kishim një rol të ri të Avokatit të Popullit, ku fizibiliteti i tij duhej të ishte dukshëm shumë më i madh, sepse qytetarët kanë shumë nevojë për të. Asnjë nuk do ta kritikonte Avokatin e Popullit, kurrën e kurrës, për një protagonizëm të shtuar, përkundrazi, të gjithë do ta kërkonim dhe do të ishim solidarë me të kushdo që ta sulmonte, sepse dihej që pala që do ta sulmonte, do të ishte qeveria. Pra, ne jetojmë në ditët më të këqija dhe më të zeza të shkeljes së të drejtave të njeriut. Mjafton të mendojmë hartën e re gjyqësore, e cila e bëri të pamundur edhe marrjen formale të drejtësisë dhe jo më elemente të tjera.

Në këtë pikëpamje, duke qenë i ftohtë dhe indiferent ndaj raportimit të radhës, sërish them se duhet të heqim turpin e një viti vonesë dhe njëherazi t'i japim Avokatit të Popullit atë protagonizëm për të cilin qytetarët kanë nevojë dhe askush tjetër nuk mund t'ua japë dot.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Vasili! Fjalën e ka zoti Balla.

Zoti Balla, keni 10 minuta në dispozicion dhe me diskutimin tuaj do të mbyllet debati për raportimin vjetor të Avokatit të Popullit.

Taulant Balla – Këtë moment do ta përdor për të kërkuar mundësinë që drejtuesit e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, si grupi parlamentar më i madh i opozitës, të fillojnë të dialogojnë për t'i dhënë fund ngërçit të krijuar në

procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Që nga viti 1998, tashmë kanë kaluar 25 vjet dhe kemi krijuar një standard në procesin e zgjedhjes së Avokatit të Popullit. Në fakt, është një nga ato institucione, për të cilat Kushtetuta ka përcaktuar zgjedhjen me një shumicë të cilësuar me 3/5-tat. Në rast se në vitin 2008 për zgjedhjen e Presidentit të Republikës u fut një mekanizëm zhblllokues, pra pas raundit të tretë, në raundin e katërt dhe të pestë Presidenti i Republikës, si kryetar i shtetit, mund të zgjidhet me një shumicë të thjeshtë, për Avokatin e Popullit kjo gjë nuk është e parashikuar. Krahu i majtë i kësaj salle nuk i ka 84 vota për të zgjedhur Avokatin e Popullit, madje ne e kemi thënë shumë qartë: duam që Avokatin e Popullit ta propozojë opozita dhe asnjë deputet i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste nuk do të përfshihet në mbështetjen me firma të një kandidati, sikurse e përcaktojnë ligji dhe Rregullorja. Ne duam që, pa humbur kohë, pasi Komisioni i Çështjeve Ligjore e ka përmbyllur procesin e verifikimit të përputhshmërisë me ligjin të kandidatëve që kanë shfaqur interes, (sikurse jam njoftuar me një shkresë nga ana e kryetares së komisionit dhe nga ana e shërbimeve të Kuvendit, besoj se edhe zoti Bardhi, zonja Doda dhe zoti Mediu e kanë marrë të njëjtën shkresë, ku tashmë përpara nesh kemi 15 kandidatë, të cilët, sipas Komisionit të Ligjeve, i plotësojnë kriteret ligjore), brenda asaj liste të kemi mundësinë të gjejmë njërin prej atyre që do të jetë Avokati i Popullit të Shqipërisë për mandatin për të cilin flasim. Në këtë frymë, për 4 seancat e Kuvendit që kanë mbetur, mendoj se i kemi të gjitha mundësitë të zgjedhim Avokatin e Popullit. E them dhe e theksoj atë që kam thënë këtu, në mos gaboj, në dhjetor të vitit të kaluar: Avokati i Popullit nuk mund të jetë avokati i Partisë Demokratike, nuk mund të jetë një figurë e spikatur e Partisë Demokratike brenda viteve të fundit. Në këtë kontekst, një baraslargim politik i Avokatit të Popullit do të ishte ajo që ka parashikuar Kushtetuta për këtë pozicion.

Mendoj dhe i propozoj kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zotit Bardhi, si grupi parlamentar më i madh i opozitës, të ulemi gjatë javës së ardhshme bashkë me drejtueset e Komisionit të Ligjeve, me zonjën Bushka dhe me zonjën Çupi, në mënyrë që të bëjmë një verifikim të kandidatëve që kemi përpara nesh dhe të fillojmë të shkojmë drejt një

grupi me 3-4 kandidatura, të cilat mund të jenë kandidaturat që marrin më shumë konsensus, më pas secili prej nesh në grupet parlamentare të kërkojë mbështetjen, për të shkuar te kandidatura që mund të jetë për Avokat Populli. Unë mendoj se ky është një model që duhet konsoliduar. Ne jemi konsekuentë në atë që kemi thënë; edhe para 7-8 muajve kemi thënë të njëjtën gjë: të fillojmë që nga 15, të shkojmë në 4, në 2 dhe në 1. Ky është një model që funksionon në shumë parlamente, si ky yni, ku Kushtetuta ka parashikuar shumicë të cilësuar. Dua të shtoj një argument tjetër këtu, që është po aq i rëndësishëm, të cilin e thashë që në fillim, duhet të respektojmë një traditë parlamentare 25-vjeçare, që nga Kushtetuta e vendit, në mënyrë që ne të shkojmë drejt një kandidature, ku, e theksoj dhe nguliteni mirë në mend: ju mund të keni të drejtën për të propozuar, por as tradita parlamentare dhe as Kushtetuta nuk jua ka thënë në frymë dhe në gërmë se ju keni të drejtën të emëroni Avokatin e Popullit. Avokatin e Popullit nuk keni të drejtë ju...

(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)

Me ty nuk flasim. Ti nuk hyn fare, ti je bishti i *non grata*-s dhe me ty as nuk flasim, as nuk diskutojmë. Po flas me këta që kanë zgjedhur orientimin proeuroatlantik, me ty nuk diskutoj.

(Ndërrhyrje nga salla)

Me ty jo e jo, fare.

(Ndërrhyrje nga salla)

Ti nuk ekziston.

(Ndërrhyrje nga salla)

Dakord, dakord.

(Ndërrhyrje nga salla)

Po nuk ekzistove për mua, kot je në këtë sallë, se ti nuk bën dot asgjë.

Për t'u fokusuar, sepse zhurmuesit të prishin punë në këto raste, duke qenë se javën e ardhshme e kemi pa angazhime të mëdha pune për shkak se është java dedikuar zgjedhësve, mendoj që ta shfrytëzojmë kohën në dispozicion. Kemi edhe një sërë çështjesh të tjera për të dialoguar.

Unë mendoj se ka kaluar një kohë e gjatë që nga ngritja e grupit të punës, në fillim për t'u konsultuar dhe më pas për të hartuar një sërë ndryshimesh ligjore në disa ligje, që kanë të bëjnë me paketën e ligjeve të reformës në drejtësi. Në fakt, në këtë aspekt dua t'i falënderoj kolegët e këtij grupi pune, sepse kanë bërë një punë të shkëlqyer në konsultimin me institucionet e vendeve partnere, në konsultimin me institucionet

e drejtësisë shqiptare për të marrë prej tyre të gjithë *feedback*-un e nevojshëm, sepse pas gjashtë apo shtatë vjetësh, që nga momenti i hartimit dhe miratimit të këtyre ligjeve, është kohë e mjaftueshme, pra ka kaluar një 5-vjeçar implementimi, për të parë ndryshimet, të cilat përmirësojnë punën e këtyre institucioneve apo, le të themi, procesin e zbatimit të këtyre ligjeve. Së bashku me këto të kemi mundësi t'i depozitojmë zyrtarisht ndryshimet, në frymën e një konsensusi të nevojshëm dhe të pazëvendësueshëm, që e ka traditë tashmë parlamenti, sepse ndryshimet në ligjet që kanë të bëjnë me reformën në drejtësi, duan konsensus. Këtu e kam fjalën për konsensus mes palëve, që drejtësinë e shohin si instrument të rëndësishëm të forcimit të demokracisë në vend, jo për "bishta", që e shohin drejtësinë si armik (flas për grupet parlamentare, të cilat kanë një orientim euroatlantik).

Kështu që të dyja këto çështje së bashku, përfshirë këtu edhe komisionerët e Avokatit të Popullit, duhet t'i diskutojmë me kolegët e opozitës, me shpresën që edhe këtu të kemi sa më shumë konsensus, në mënyrë që ta mbyllim sesionin IV të Kuvendit të Shqipërisë, në mos gaboj, duke përmbyllur disa detyrime dhe të mos dëgjojmë pretendime apo ankesa të ndonjë deputeti këtu, që vjen e thotë: "turpi i parlamentit". Parlamenti ka parashikuar që, kur ndodhin bllokime të tilla, Avokati i Popullit në detyrë e vazhdon detyrën, pra nuk krijohen deficite në punën e tyre. Ndërkohë, ftesa ime është që rezoluta përkatëse, e cila ka ardhur nga Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të votohet sipas rekomandimeve.

Faleminderit!

Shpresoj të ketë një përgjigje edhe nga zoti Bardhi për këtë çështje!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla!

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës: raportimi i veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2022.

Në bazë të nenit 103, pika 2, të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 32 të ligjit organik të këtij institucioni, ligjit "Për prokurimin publik", këtë raport vjetor do ta paraqesë kryetari i këtij institucioni, zoti Jonaid Myzyri, të cilin e ftoj në sallë.

Zoti Myzyri, keni 20 minuta kohë në dispozicion, sipas nenit 103, pika 7, të Rregullores së Kuvendit.

Fjala për ju.

Jonaïd Myzyri – Faleminderit!

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar përfaqësues të Këshillit të Ministrave,

Të nderuar deputetë,

Raportimi vjetor para Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe grupeve të interesit është një moment i rëndësishëm për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik. Më shumë se një detyrim ligjor, është një mundësi për të analizuar në detaje punën e bërë gjatë një viti, çfarë është bërë mirë dhe çfarë ka vend për përmirësim, së pari, për vetë institucionin, por edhe për sistemin e prokurimit në përgjithësi.

Viti 2022 ishte një vit sfidues për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, në disa drejtime.

Së pari, viti që lamë pas ishte një vit i rëndësishëm për të matur impaktin e progresit të reformës më të rëndësishme që ka kaluar institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, atë të digjitalizimit të shërbimeve. Kjo reformë nisi në mes të pandemisë, në korrik të vitit 2020, dhe përfundoi në tetor të vitit 2021. Ndaj, viti 2022 ishte një vit vendimtar për të matur indikatorët e saj. Vetëm gjatë një viti, mbi 39% e operatorëve ekonomikë zgjodhën vullnetarisht t'i dorëzojnë ankesat vetëm në rrugë elektronike pranë autoriteteve kontraktore dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kështu, përmes digjitalizimit të shërbimeve, arritëm t'u kursejmë 52 390 kilometra rrugë operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesa dhe mbi 50 000 dollarë kosto për paraqitjen e ankesave në rrugë shkresore. Përmes dorëzimit të ankesave elektronike, arritëm të shmangim printimin e mbi 14 662 fletëve dhe të rrisim aksesin e operatorëve ekonomikë në sistemin e rishikimit. Falë digjitalizimit të shërbimeve, mbi 26 operatorë ekonomikë ankimues të rinj kanë paraqitur ankesa pranë KPP-së, duke pasur në total 300 operatorë ekonomikë ankimues për 201 nga 400 autoritete kontraktore, që kanë publikuar procedurat e prokurimit mbi kufirin e blerjeve të vogla.

Digjitalizimi i shërbimeve në tërësi ka ndryshuar jo vetëm aksesin e operatorëve

ekonomikë në drejtim të sistemit të rishikimit, por edhe sjelljen e grupeve të interesit, përfshirë edhe të vetë Komisionit të Prokurimit Publik. Digjitalizimi i shërbimeve ka rritur shpejtësinë e vendimmarrjes, ku vetëm 10,1% e ankesave janë trajtuar jashtë afatit, krahasuar me 22,8% në vitin 2020 dhe 10,8% në vitin 2021, gjithashtu, është shkurtuar koha e shqyrtimit të ankesave nga 17 në 12 ditë.

Gjatë vitit 2022 është vënë re se autoritetet kontraktore kanë shmangur përsëritjen e gabimeve dhe problematikave.

Për ne transparenca është e rëndësishme, pasi kemi bindjen e thellë se, nëse nuk sigurohet kjo e fundit, konkurrenca e hapur nuk mund të realizohet dhe dështimet e tjera në procesin e prokurimit mund të mbulohen, duke pasur një dobësim të nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies. Ndaj edhe në vitin që lamë pas kemi vijuar përpjekjet tona për përmirësimin e standardit të publikimit të të dhënave, ku në bashkëpunim me *Open Contracting Partnership*, një organizatë jofitimprurëse me bazë në Uashington, kemi ndërtuar një seksion të posaçëm të publikimit të të dhënave dhe statistikave në kohë reale, aksesuar edhe nga personat me aftësi të kufizuara, si dhe për herë të parë në 10 vjetët e fundit KPP-ja e publikon veprimtarinë e saj bazuar në parimet e OECD-së, një standard dedikuar organeve të shqyrtimit të ankesave, pilotuar për herë të parë nga KPP-ja. Gjithashtu, vijon puna për digjitalizimin e arkivës së 10 vjetëve të fundit në bashkëpunim me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Viti i kaluar ishte sfidues edhe në drejtim të ofrimit të shërbimeve *online* për shkak të sulmit të paparashikuar dhe të paprecedentë kibernetik që goditi Shqipërinë. Kjo ngjarje e paprecedentë e vuri Komisionin e Prokurimit Publik përballë një sfide jashtëzakonisht të vështirë, atë të sigurimit të vijueshmërisë së shërbimit të shqyrtimit të ankesave.

Të ndërgjegjshëm për rolin e rëndësishëm në sistemin e prokurimit dhe përgjegjësi të dhëna nga ligji, falë organizimit të mirë, puna në asnjë moment nuk u ndal. Gjatë gjithë kohës kur shërbimet elektronike ishin të paaksesueshme, shërbimi i regjistrimit të ankesave dhe i informimit të publikut u transferua në medien e shkruar dhe elektronike, në këndin e njoftimeve publike të KPP-së. Ndaj, i shprehim mirënjohje

çdo medie të shkruar dhe elektronike, që mundësoi vijimin e publikimit të veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, si një shembull i bashkëpunimit të frytshëm mes institucioneve publike dhe medias.

Për ditët kur shërbimi i dorëzimit të ankesave elektronike u ndërpre, puna nuk u ndërpre, por u regjistruan 77 ankesa dhe u morën 89 vendime. Me rikthimin e shërbimeve *online* u arrit të vërtetohej se, falë sistemeve të sigurta, të ndërtuara, nuk pati asnjë dëmtim apo shpërndarje të paautorizuar të të dhënave të sistemit të ankesave elektronike dhe se të dhënat janë të sigurta.

Në rrugëtimin e ndryshimit të ofrimit të shërbimit kemi vijuar të jemi sa më pranë me asistencë për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, duke miratuar dhe dërguar në adresë të dedikuar të gjitha manualët e nevojshme për secilin përdorues të sistemit të ankesave, si dhe duke ofruar asistencë me mbi 2720 minuta asistencë telefonike, mbi 340 e-mail-e zyrtare dhe komunikim me anë të një sistemi mesazhesh falas, të vëna në dispozicion në faqen tonë zyrtare.

Falë mbështetjes së Kuvendit u përfundua edhe faza e dytë e digjitalizimit të shërbimit, duke mundësuar ndërtimin e infrastrukturës për regjistrimin audio të seancave dëgjimore të KPP-së, duke ofruar më shumë transparencë ndaj publikut për proceset gjyqësore, në ndërveprim me sistemet e treta, si dhe një sistem të avancuar të menaxhimit të brendshëm.

Reforma e digjitalizimit, e ndjekur nga institucioni i Komisionit të Prokurimit Publik, ka gjetur, gjithashtu, edhe mbështetjen e duhur ndërkombëtare, si dhe është vlerësuar nga organizma të BE-së, po ashtu edhe nga organizata ndërkombëtare me fokus transparencën në prokurime.

Në shtator të vitit të kaluar, në ditën ndërkombëtare të demokracisë, në Maqedoninë e Veriut u mbajt “Ministeriali i Ballkanit Perëndimor mbi reformat në administratën publike”. Në këtë takim u ndanë edhe disa çmime për performancën e institucioneve publike për disa nga vendet e rajonit, përfshirë dhe Shqipërinë. Komisioni i Prokurimit Publik ishte institucioni i vetëm nga Republika e Shqipërisë, që u vlerësua me çmimin “Besueshmëria në administratën publike”, ndërkohë që sistemi i

ankesave u përzgjedh ndër 15 projektet më të mira në nivel botëror në samitin *GovTech*, i zhvilluar në Hagë.

Vlerësim për punën e KPP-së është bërë edhe nga Komisioni European, ndërkohë organizata joqeveritare me fokus transparencën në prokurime, *Open Contracting Partnership*, i ka dedikuar një artikull të posaçëm historisë së progresit të Komisionit të Prokurimit Publik.

Së dyti, viti që lamë pas ishte një vit i rëndësishëm edhe për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik me ligjin e ri të prokurimit publik, i cili jo vetëm është përafuar me katër direktiva, por, gjithashtu, ka sjellë ndryshime të qenësishme materiale dhe procedurale. Kësisoj, përgjegjësia e Komisionit të Prokurimit Publik ka qenë më e lartë në trajtimin e çështjeve të reja, si dhe në konsolidimin e praktikës vendimmarrëse. Nga 6494 procedura të publikuara për t'u zhvilluar në sistemin e prokurimeve elektronike, për 532 procedura unike janë paraqitur 794 ankesa, nga të cilat 782 ankesa janë paraqitur për procedurat e prokurimit publik, 8 ankesa për procedurat e ankandit publik dhe 4 ankesa në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ankesat janë paraqitur nga 300 operatorë ekonomikë për 201 autoritete kontraktore.

Gjatë vitit 2022, 39% e ankesave janë paraqitur për fazën e dokumenteve të tenderit dhe 61% e tyre për fazën e vlerësimit të ofertave.

Numrin më të lartë të ankesave për procedurat unike e zënë ato për kontratat e mallrave, me 486 ankesa për 308 procedura unike, më pas vijon ato të shërbimeve, me 235 ankesa për 166 procedura unike, dhe së fundi punët publike, me 73 ankesa për 58 procedura unike. 33% e ankesave për fazën e shqyrtimit të ofertave janë pranuar nga KPP-ja dhe 55% e ankesave për fazën e dokumenteve të garës janë pranuar nga KPP-ja.

Krahasuar me vitin 2020, në vitin 2021 vihet re një ndërgjegjësim i operatorëve ekonomikë për rritjen e ankesave dhe kontrollin e shmangies së problematikave që në fazën e hershme të procedurave të prokurimit, atë të dokumenteve të garës. Në krahasim me vitin 2021 vihet re një ulje e numrit të ankesave në raport me numrin e procedurave unike të publikuara në SPE, nga 15,1% në 8,19%.

Ulja e numrit të ankesave lidhet, gjithashtu, edhe me forcimin e qëndrueshmërisë në vendimmarrje të Komisionit të Prokurimit Publik,

rritjen e numrit të vendimeve interpretuese me 19 të tilla, si dhe rritjen e komunikimit me grupet e interesit. Kështu, rezulton se falë punës së bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik, autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë po shmangin përsëritjen e gabimeve të njëjta dy herë.

Gjatë vitit 2022, Komisioni është shprehur me 815 vendime, nga të cilat 614 vendime themeli, 64 vendime deklarative përfundimtare, 100 vendime të ndërmjetme dhe 37 vendime për tërheqjen nga ankesa individuale, me një kohë mesatare të shqyrtimit të ankesave prej 12 ditësh, me treguesit më të mirë në dhjetëvjeçarin e funksionimit të tij.

Gjatë vitit 2022, Komisioni ka shqyrtuar 809 ankesa, prej të cilave 794 ankesa për vitin 2022 dhe 70 ankesa të mbartura nga viti 2021. Në total janë pranuar 305 ankesa dhe nuk janë pranuar 307 ankesa.

Pas vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, pas ushtrimit të mjeteve të rishikimit, ankimit administrativ nga operatorët ekonomikë, me anë të dorëzimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP-ja pas shqyrtimit të ankesave, nga vendimmarrja e kësaj të fundit, i ka kursyer buxhetit të shtetit vlerën prej rreth 115 milionë e 967 mijë e 650 lekësh pa TVSH, llogaritur si diferencë e ofertës së kualifikuar nga vendimmarrja e autoriteteve kontraktore dhe e operatorëve ekonomikë të ankuar, ankesa e të cilëve është pranuar nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Gjatë vitit 2022 ka vijuar bashkëpunimi me Agjencinë e Prokurimit Publik në drejtim të dërgimit për hetim të thelluar të çështjeve, në të cilat nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik janë konstatuar shkelje administrative. Janë dërguar për hetim 10 çështje pranë Agjencisë së Prokurimit Publik, njëra prej të cilave i është referuar për hetim Rrjetit të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit, Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022 është vendosur masa administrative “gjobë” për dy titullarë të autoriteteve kontraktore për mosbashkëpunim me Komisionin e Prokurimit Publik.

Edhe në vitin që lamë pas, ka vijuar puna e institucionit në drejtim të monitorimit të zbatimit të vendimeve nga ana e autoriteteve kontraktore, ku falë punës së bërë, vihet re rritja e shpejtësisë

në kohë e zbatimit të vendimeve të Komisionit nga ana e tyre.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas tejkalimit të afatit ligjor të përcaktuar, për zbatimin e vendimeve nga ana e autoritetit kontraktor, ka dërguar 43 kërkesa drejtuar autoriteteve kontraktore, krahasuar me 60 në vitin 2021. Shpejtësia mesatare e zbatimit të vendimit, pas dërgimit të kërkesës për zbatimin e tyre, është 7 ditë nga marrja e saj.

Ndër problematikat e konstatuara nga ana e autoriteteve kontraktore rezultojnë si më poshtë vijon: hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore i kriterëve të paqarta; hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore i specifikimeve teknike jo në përputhje me ligjin; shkelje procedurale të kryera në fazën e vlerësimit të ofertave; kryerja e procesit të administrimit dhe trajtimit të mostrave jo në përputhje me procedurën e përcaktuar në ligj; gabime në përlogaritjen e fondit limit; problematika të mosnjohjes së mirë të ndryshimeve të ligjit “Për prokurimet publike”; problematika të moskryerjes së veprimeve procedurale, për komunikimin ndërmjet autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë për korrigjimin e të metave të ankesës; problematika të moskryerjes së veprimeve procedurale të parashikuara nga neni 114 i ligjit, për njoftimin e vendimmarrjes mbi trajtimin e ankesës; problematika lidhur me veprimet procedurale të autoriteteve kontraktore, të kryerjes së verifikimeve të deklarimeve të operatorëve ekonomikë të deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Problematikë ka shfaqur edhe mungesa në disa raste e dhënies së sqarimeve të plota, ndaj kërkesave për sqarim të operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, Komisioni ka konstatuar edhe problematika në dorëzimin e ankesave nga ana e operatorëve ekonomikë.

Në një numër të konsiderueshëm rastesh është konstatuar se operatorët ekonomikë nuk janë mjaftueshëm të informuar për formën, afatet dhe procedurat e përcaktuara nga ligji; operatorët ekonomikë kanë paraqitur ankimin e tyre, pa paraqitur formularin e pagesës; operatorët ekonomikë, në cilësinë e subjektit të interesuar të prekur nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos ezauruar shkallën e paraqitjes së argumenteve; operatorët ekonomikë

në dorëzimin e ankesave nuk kanë identifikuar qartësisht objektin e ankesës; operatorët nuk janë të qartë mbi ndryshimet mes kërkesave për sqarim të dokumenteve të procedurës së prokurimit; në rastin e konstatimit të ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë kanë dështuar të dorëzojnë argumente të plota; operatorët ekonomikë në disa raste, pas shqyrtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor dhe në fazën procedurale të shqyrtimit të ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik, riparaqesin ankesë mbi vendimmarrjen e autoritetit kontraktor; operatorët ekonomikë nuk janë mjaftueshëm të njohur me ndryshimet e ligjit të prokurimit publik për afatet e paraqitjes së ankesave; operatorët kanë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ankesa në lidhje me procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, për të cilat, referuar ligjit “Për prokurimin publik”, nuk janë në kompetencën lëndore të Komisionit të Prokurimit Publik; operatorët ekonomikë kanë gabime materiale në drejtim të dhënies së informacionit të kërkuar për secilin seksion të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit.

Nga numri total i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2022, rezulton se për 61 prej tyre ose për 50 procedura unike, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur për anulimin e procedurave të prokurimit publik.

Ndër arsyet kryesore të konstatuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, që kanë çuar në anulimin e procedurës janë: hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore i kritereve të veçanta të paqarta dhe konfuze; hartimi nga ana e autoriteteve kontraktore i specifikimeve teknike, në kundërshtim me nenin 36, të ligjit “Për prokurimin publik”; shkelje procedurale të kryera nga autoriteti kontraktor në fazën e rivlerësimit të ofertave; kryerja e procesit të administrimit jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, si dhe gabime në përlllogaritjen e fondit limit.

Qëndrueshmëria e vendimmarrjes së Komisionit është konfirmuar edhe nga Gjykata Administrative, si në drejtim të numrit më të ulët të padive me vetëm 5,5% të vendimeve të Komisionit të ankimuar, në krahasim me 7,8% në vitin 2021, por edhe në raport me vendimmarrjen e gjykatës në lidhje me këto vendime. Në përfundim të procesit gjyqësor në shkallën e parë dhe në apel, gjykata ka vendosur pranimin e plotë për 2 padi dhe praninë të

pjesëshëm për 3 padi, dhe ka vendosur rrëzimin e 10 kërkesëpadive.

Me synim shmangien e përsëritjes së problematikave të konstatuara, si edhe në zbatim të detyrave të lëna në rezolutën e Kuvendit, ka vijuar bashkëpunimi me të gjitha grupet e interesit, përmes organizimit, në bashkëpunim me SIGMA-OECD-në, të dy *workshop*-ve të rëndësishme, një me mbi 300 pjesëmarrës të autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë dhe një *workshop* me sistemin gjyqësor, në bashkëpunim edhe me Këshillin e Lartë Gjyqësor. Komisioni ka vijuar të shprehet edhe me vendime interpretuese, duke publikuar njëherazi në faqen zyrtare dhe buletinet periodike për të gjithë operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, njoftime mbi praktikën vendimmarrëse në çështje specifike, me rëndësi për sistemin, si dhe me publikimin e buletineve mujore informuese për të gjitha grupet e interesit.

Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve ka qenë kryefjala e vitit 2022 për institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, si me institucionet publike, ku ka vijuar trajnimi me Universitetin e Tiranës dhe ka nisur puna për hartimin e një manuali për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore.

Në nivel ndërkombëtar, Komisioni, gjatë vitit që lamë pas, lidhi marrëveshjen e posaçme me Autoritetin Kombëtar Antikorrupsion të Republikës së Italisë (ANAC), me synim ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve.

Gjithashtu, modestisht, falë mbështetjes së Kuvendit të Shqipërisë, është themeluar edhe biblioteka e parë me mbi 30 libra të huaj falas, dedikuar për të gjithë praktikantët e prokurimit dhe kërkuesit shkencorë, pranë mjediseve të Komisionit të Prokurimit Publik.

Forcimi i kapaciteteve të zyrtarëve të prokurimit në nivel kombëtar mbetet sfida kryesore edhe për vitin aktual, pasi çdo reformë institucionale apo politike publike nuk mund të zbatohet e veçuar, pa një trupë zyrtarësh prokurimi të kualifikuar.

Së fundi, por jo me më pak rëndësi, ka qenë në nderin e institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik të përfaqësojë Republikën e Shqipërisë, si shtet themelues dhe drejtues i të parit rrjet të organeve shqyrtuese të prokurimit të Europës Juglindore, me anëtarësinë e organeve shqyrtuese të prokurimit të Republikës së

Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Sllovenisë, Rumanisë dhe të Republikës së Turqisë. Më shumë se një ëndërr e kahershme e shumë shteteve, në Tiranë u vendos një gur themeli shumë i rëndësishëm i një misioni edhe më të madh se hapësira e një ëndrre: të bashkuar, me një gjuhë të vetme komunikimi dhe të angazhuar plotësisht në luftën kundër korrupsionit.

Prokurimi publik, ndër shekuj, është parë si një instrument i rëndësishëm për të përmbushur kërkesat publike dhe hartimi i procedurave për garat ka një ndikim të drejtpërdrejtë në arritjen e qëllimeve. Përmirësimi i sistemit të prokurimit mund të nisë pikërisht nga mësimet që mund të nxirren nga vendimmarrja e organeve shqyrtuese të prokurimit, nga problematikat në zbatimin e ligjit, si dhe nga risqet e ndryshme për përsëritjen e gabimeve procedurale.

Sfidat, por edhe arritjet që lamë pas, na bëjnë sa krenarë, aq edhe të përlulur në vijimin e kryerjes së detyrave, duke dhënë garanci për të gjitha grupet e interesit se do të vijnë me lartësinë e kërkuar nga ligji dhe të besuar nga Kuvendi për të mbrojtur interesat e ligjshëm si një organ që qëndron mbi palët dhe me emërues të përbashkët pasionin për të punuar me paanshmëri, ligjshmëri, shpejtësi dhe eficientë.

Faleminderit!

Jam informuar nga shërbimet e Kuvendit për...

Ermonela Felaj – Ju lutem, në qoftë se e keni përfunduar fjalën, më duhet të pyes kolegët nëse kanë pyetje.

Ndërkohë, nga shënimet e Kuvendit më është vënë në dispozicion pyetja e zoti Xhafa. Ndaj, e ftoj zotin Xhafa që të parashtojë pyetjen.
(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Me radhë, ju lutem!

Qani Xhafa – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Faleminderit edhe kryetarit të Komisionit të Prokurimit Publik!

Në raportin e Komisionit të Prokurimit Publik thuhet se 39% e operatorëve ekonomikë, për vitin 2022, kanë bërë ankesë pranë komisionit tuaj për kualifikimin e tyre në tenderët publikë. Nisur nga fakti se shumica e tenderëve publikë fitohen me ofertën më të lartë, unë kam një pyetje: sa për qind e këtyre operatorëve, të cilët kanë bërë ankesë pranë institucionit tuaj, kanë marrë

zgjidhje? Pra, sa për qind e këtyre operatorëve kanë fituar të drejtën e tyre pas ankimit?

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Fjala për ju, zoti Myzyri!

Jonaid Myzyri – Faleminderit!

Dua të bëj një saktësim: 39% e ankesave të depozituara pranë institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik lidhen me fazën e dorëzimit të dokumenteve të garës, ndërkohë që 61% e totalit të ankesave të depozituara lidhen me fazën e vlerësimit të ofertave. Nga analizimi i vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik rezultoi se në fazën e vlerësimit të ofertave janë pranuar 33% e ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë, për të cilat efekti vendimmarrës i Komisionit të Prokurimit Publik në llogaritjen e kursimit që i ka bërë buxhetit të shtetit është në vlerën 115 967 650 lekë. Pra, kjo është si diferencë e ofertës së kualifikuar nga ana e autoriteteve kontraktore dhe e efektit të vendimmarrjes nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Në rast se kalojmë tek ofertat e paraqitura për fazën e dokumenteve të garës, rezultoi se ka një rritje të numrit të ankesave dhe ndërgjegjësim të operatorëve ekonomikë për paraqitjen e ankesave për fazën e dokumenteve të tenderit. Për vitin e kaluar rezultoi se 55% e ankesave të paraqitura për fazën e dokumenteve të garës janë pranuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, duke rritur, nga njëra anë, konkurrencën dhe, nga ana tjetër, duke ulur numrin e ankesave të paraqitura për fazën e vlerësimit të ofertave.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Myzyri!

Zoti Leskaj ka kërkuar fjalën për pyetje.

Bujar Leskaj – Unë kam dy pyetje.

Sipas të dhënave të raportit tuaj, ju keni rivlerësuar 492 procedura prokurimi, të cilat kanë një vlerë afërsisht 17 miliardë lekë. Sikurse e theksuat dhe në fjalën tuaj në Kuvend dhe në përgjigjen ndaj pyetjes së kolegut, ju thoni se i keni kursyer buxhetit të shtetit 115 milionë lekë. Deri këtu jemi në rregull. Tani, ju me punën tuaj i keni kursyer buxhetit të shtetit 115 milionë lekë ose 1 milion euro, dhe keni rivlerësuar 180 milionë euro, në një kohë kur e gjithë shuma që prokurohet në Shqipëri është 1,7 miliardë euro. Pra, shuma që ju, si institucion, i kurseni buxhetit të shtetit nga ato që auditoni është 0,5 ose 0,6 për

qind, nga ato që ju rivlerësoni. Vërtet mendoni ju se me 1 milion euro zbulimet tuaja, kursimet tuaja në buxhetin e shtetit, ju keni qenë institucion eficient dhe shqiptarët duhet të besojnë Komisionin e Prokurimit Publik? Vërtet mendoni se në vitin 2023, me 1 milion euro që ju i kurseni buxhetit të shtetit, kur, në mos gaboj, buxheti për institucionin tuaj është 700-800 mijë euro, pra me një indikator të dobisë së punës tuaj, që shkon te 0,7, ju, si institucion, që vini këtu në Kuvend, flisni 20 minuta, bëni një raport shumë të mirë e me të dhëna statistikore, do t'ua shisni shqiptarëve sapunin për djathë?!

E dyta, ju theksuat edhe në fjalën tuaj, sikurse është edhe në raport, uljen e numrit të ankesave nga 15,1% në vitin 2021, në 8,19%, që ju e quani si rrjedhojë e punës suaj të mirë, forcimin e qëndrueshmërisë së vendimmarrjes së institucionit, rritjen e numrit të vendimeve interpretative të KPP-së, si dhe rritjen e komunikimit me grupet e interesit. Me cilat grupe interesi kontaktoni ju? Ju kontaktoni me grupet e interesit që marrin pjesë në tenderë me këto autoritete kontraktore, ku keni kufizuar konkurrueshmërinë? Ju veproni si shtojcë e qeverisë apo si institucion i pavarur?

E theksoj që dy pyetjet e mia nuk kanë qëllim të zhvlerësojnë punën tuaj, arritjet, formatimin modern të raportit apo vlerësimet që keni marrë në botë, por gjithmonë, në institucione të tilla si KPP-ja, apo edhe në institucionet e auditimit, treguesi kryesor është indikator i dobisë së vlerësimit. Për një lek që ju u keni marrë taksapaguesve shqiptarë, ju paskeni zbuluar një lek. Ky është një nga treguesit më të ulët.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Leskaj!

Zoti Myzyri, jeni gati për t'u përgjigjur?

Jonaid Myzyri – Po.

Faleminderit!

Për sa i përket pyetjes së parë për efektet e vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, do të doja të sqaroja se kursimet e bëra në buxhetin e shtetit, falë vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik, lidhen vetëm me fazën e ankesave të paraqitura për dokumentet e procedurës së prokurimit publik. Është e vërtetë që nga 6494 procedura unike të publikuara mbi kufirin e blerjeve të vogla në sistemin e prokurimeve elektronike, pranë Komisionit të

Prokurimeve Publike janë paraqitur ankesa për 532 procedura prokurimi. Dua të theksoj se jo të gjitha ankesat e paraqitura pranë Komisionit të Prokurimit Publik janë për fazën e vlerësimit të ofertave, ku mund të matet edhe indikator i kursimit në buxhetin e shtetit. Një pjesë e ankesave të depozituara, pra 39% e tyre, janë për fazën e dokumenteve të garës.

Cili është efekti i vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik në dokumentet e garës së procedurës së prokurimit publik? Nga analiza e kryer rezultojnë se, pas vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik për ndryshimin në rastet e pranimit të ankesave për dokumentet e procedurës së prokurimit, vihet re një rritje e konkurrueshmërisë në ofertat publike, referuar nivelit të konkurrueshmërisë së dorëzimit të ofertave për procedurë prokurimi, në krahasim me sistemin kombëtar në tërësi. Nga ajo që ne kemi realizuar rezultojnë se, në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik ka rishikuar kushtet e garës së vendosur nga autoriteti kontraktor, falë ankesave të depozituara nga ana e operatorëve ekonomikë, ka një rritje 1,14 herë më shumë të konkurrueshmërisë dhe numrit të ofertave të dorëzuara për procedurën e prokurimit.

Ndërkohë, pyetja e dytë lidhej me...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem, mos ndërhyini nga vendi!

Ju i bëtë pyetjet dhe besoj se zoti Myzyri është i qartë.

Jonaid Myzyri – Edhe një herë, për ta sqaruar, 180 milionë euro është i gjithë fondi limit i publikuar në procedurat e prokurimit publik. Janë ankimuar 8,19% e procedurave të prokurimit, por jo të gjitha janë ankimuar për fazën e vlerësimit të ofertave, vetëm 39% e procedurave janë ankimuar në fazën e vlerësimit të ofertave. Për fazën e vlerësimit të ofertave është ky indikator, falë vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik.

Ju pyesni se përse është ulur numri i ankesave për procedura unike të depozituara pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe se me cilat grupe interesi bashkëpunon Komisioni i Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik është paraparë nga ligji si një organ i pavarur, *quasi* gjyqësor, dhe sigurisht që ne jemi të ndërgjegjshëm për rolin e dhënë nga ligji. Për këtë arsye, duke nisur që nga viti 2021, edhe sipas një

tradite në vijim, komisioni organizon çdo vit 2 takime të rëndësishme, një me sistemin gjyqësor, dhe vitin e kaluar, falë detyrave të lëna edhe nga Kuvendi i Shqipërisë, kemi realizuar një marrëveshje me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe një marrëveshje me operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore.

Workshop-i i bisedimit të problematikave në sistemin e prokurimit publik u organizua gjatë vitit të kaluar në bashkëpunim me SIGMA-OECD-në. Komisioni i Prokurimit Publik ka pasur të ftuar në prezencë, si dhe *online*, mbi 300 operatorë ekonomikë dhe autoritetet kontraktore, të cilat zhvillojnë procedurat e prokurimit. Më pas komisioni i ka diskutuar në detaje gjetjet e raportit të vitit të kaluar dhe problematikat, duke diskutuar me të gjitha autoritetet dhe operatorët ekonomikë, që realizojnë procedura prokurimi ose kryejnë ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik, pa dallim midis autoriteteve dhe operatorëve ekonomikë.

Gjithashtu, për përforsimin e kapaciteteve, si të vetë institucionit, por edhe për diskutimin e çështjeve, sepse kemi një ligj të ri në fuqi, komisioni ka zhvilluar edhe një *workshop* të posaçëm me sistemin gjyqësor, me përfaqësues nga gjykatat e të gjitha niveleve.

Ulja e numrit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik është edhe falë qëndrueshmërisë së vendimmarrjeve të Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik tashmë ka implementuar një sistem tërësisht të hapur të publikimit të të dhënave, që do të thotë se është më e lehtë për autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë të gjurmojnë vendimmarrjen e Komisionit të Prokurimit Publik, ta analizojnë atë dhe të shmangin përsëritjen e gabimeve procedurale nga ana e tyre dy herë, pra atë që mund të jetë bërë edhe më parë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, përmes digjitalizimit të shërbimeve, nuk ka kufizuar në asnjë rast ankesat e operatorëve ekonomikë. Përkundrazi, vetëm gjatë vitit të kaluar, falë digjitalizimit të shërbimeve, kemi 300 operatorë ekonomikë ankimues unikë nga 289 në vitin 2021, ku 26 prej tyre janë tërësisht operatorë ekonomikë ankimues të rinj në sistemin e ankimit, pavarësisht se kanë qenë aktivë në tregun e prokurimeve, dhe 2 prej tyre janë kategorizuar si biznese të mesme dhe të vogla. Pra, në asnjë rast

nuk ka një barrierë për operatorët ekonomikë për paraqitjen e ankesave pranë institucionit të prokurimit publik.

Nga ana tjetër, qëndrueshmëria në vendimmarrje dhe puna e bërë nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik me të gjitha grupet e interesit, përfshirë strukturën e prokurimit, ka sjellë edhe numrin e uljes së ankesave për procedurat unike.

Ermonela Felaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Kalojmë te diskutimet.

Zoti Xhoxhi e ka fjalën.

Të përgatitet zonja Tabaku.

Keni 10 minuta kohë në dispozicion, zoti Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë,

Para se të flas për projektrezolutën e Komisionit të Prokurimit Publik, më lejoni të them shkurtimisht disa fjalë, që i mendoj të rëndësishme.

Partia Socialiste, qeveria jonë dhe Kryeministri Rama, duke i vlerësuar si shumë të rëndësishme këto aspekte, kanë ofruar mbështetje dhe kanë nxitur bashkëpunimin me Komisionin e Prokurimit Publik për të rritur efektivitetin e sistemit shqiptar të prokurimeve, për krijimin e mundësive të barabarta dhe trajtimin e barabartë për secilin operator ekonomik, duke mundësuar që sot sistemi i prokurimit publik në Shqipëri të garantojë parimet më të larta të zhvillimit të garave publike.

Sistemi i prokurimit publik në Shqipëri, që në krye të herës, është parë si një instrument i rëndësishëm i ndërtimit të një të ardhmeje të qëndrueshme. Një transformim të rëndësishëm ka pasur edhe instrumenti i rishikimit administrativ dhe mbrojtja e interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë vendas dhe të huaj.

Shqipëria, si një vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian, po ndërmerr hapa të rëndësishëm për transformimin e infrastrukturës, për zhvillimin urban, për shëndetësinë, për teknologjinë e informacionit dhe për aksesin në një qeverisje elektronike, përmes një prokurimi të hapur, transparent dhe të qëndrueshëm.

Rimëkëmbja pas tërmetit dhe pandemisë nuk ishte një sfidë e lehtë, por u zgjidh përmes një

prokurimi të shpejtë, eficient dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë të gjitha hallkat e tij edhe në procesin e shqyrtimit të ankesave.

Ligji “Për prokurimin publik” u është nënshtruar ndryshimeve thelbësore, në përputhje me 4 direktivat e Bashkimit Europian, ndërkohë që digjitalizimi, si një mjet i rëndësishëm i luftës kundër korrupsionit dhe i aksesit në garat publike, ka dhënë edhe impaktin e rëndësishëm në sistem.

Komisioni i Prokurimit Publik po formon pavarësinë funksionale dhe, përmes digjitalizimit të shërbimeve, ka krijuar mekanizmin e parë të ankesave *online*, si dhe sistemin unik të menaxhimit të ankesave elektronike, ndër më të avancuarit në Ballkanin Perëndimor, i cili redukton ndjeshëm burokracitë për furnizuesit publikë, zeron kostot, rrit eficiencën, efikasitetin dhe ka fokus kryesor transparencën. Së bashku me *Open Contracting Partnership* dhe BERZH-in po ndërtohet standardi i parë për publikimin e vendimmarrjeve të organeve shqyrtuese të prokurimit publik.

Të nderuar kolegë,

Tani do të kaloj te projektrezoluta për veprimtarinë e prokurimit publik.

Në projektrezolutën që ju dispononi janë evidentuar arritjet, realizimet dhe përmbushja e rekomandimeve të lëna nga Kuvendi dhe janë përcaktuar disa objektiva strategjike për të ardhmen. Përgjithësisht, për periudhën e analizuar, puna e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2022 është vlerësuar objektivisht me një performancë shumë të mirë.

Në rekomandimet e progresraportit të Bashkimit Europian në tetor të vitit 2022 u vlerësua se Shqipëria është e përgatitur në mënyrë të moderuar për prokurimin publik dhe, gjithashtu, siç e theksova edhe më lart, rekomandimet për komisionin janë zbatuar plotësisht. Kësisoj, përmbushja me sukses e objektivave dhe e rekomandimeve të rezolutës dëshmojnë edhe një herë, në mënyrë të qartë, jo vetëm progresin institucional të komisionit, fakt ky që u vlerësua edhe në konferencën ndërkombëtare për forcimin, për prokurimin e hapur dhe të qëndrueshëm në Europë, e zhvilluar para disa ditësh në Tiranë, por edhe angazhimin e Komisionit të Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga nënshkrimi i marrëveshjes së themelimit të Rrjetit të Organeve Shqyrtuese të Prokurimit të Europës Juglindore,

përkatësisht për përmirësimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e përvojave, të eksperiencave, të mendimeve dhe njohurive për çështje të veçanta ligjore dhe me rëndësi për punën, si dhe për zbatimin me cilësi dhe efektivitet të kompetencave statutove.

Në fund të fjalës, më lejoni t’ju kërkoj të miratoni projektrezolutën e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Fjalën e ka zonja Tabaku. Koha në dispozicion është 5 minuta.

Të përgatitet zoti Dogjani.

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Unë nuk besoj se ka pasur çështje tjetër më të debatuar dhe më të diskutuar se prokurimi publik.

Në raportin e Autoritetit të Konkurrencës, unë kërkova në mënyrë specifike që ne të vendosnim një çështje, një temë të veçantë, që i dedikohet dhe lidhet me prokurimin publik, për faktin e vetëm që sot prokurimi publik është një nga fushat ku niveli dhe norma e korrupsionit është më e lartë. Pse e them këtë?

Së pari, sipas të dhënave që publikon vetë Autoriteti, 1 në 3 tenderë sot jepet praktikisht pa garë, pra nuk ekziston një garë dhe një konkurrencë reale.

Së dyti, 1 në 3 tenderë të tjerë jepet me 99% të vlerës, ndërkohë që pjesa e mbetur shkon tek i njëjti grup kompanish.

Besoj se Shqipëria sot e ka pjekurinë për të kuptuar që ne duhet të kemi një treg konkurrues në prokurime publike. Përqendrimi i prokurimeve publike në një grup kompanish, në 10-11 të tilla, të cilat kanë marrë mbi 10 kontrata publike, që nuk po i zbatojnë, ndërkohë që vazhdojnë të paguhen pa përfunduar kontrata paraardhëse të prokurimeve publike, është një nga temat kryesore. Sot Agjencia e Prokurimit Publik nuk bën një analizë risku për kompanitë kontraktore për të parë se ku janë problemet. Sot Agjencia e Prokurimit Publik, dhe këtë jua them edhe si një përdoruese të dhënash, nuk ka transparencë për deputetët dhe për kompanitë që operojnë, nga ana tjetër nuk ka transparencë as për qytetarët. Ligji “Për prokurimet publike” është një nga pesë ligjet që unë kam kërkuar të ndryshojë bashkë me ligjin e koncesioneve për sa i përket mënyrës se si

funksionojnë prokurimet publike, aksesit që kanë në të dhëna kompanitë dhe se cilat kompani sot marrin punë publike. Në Republikën e Shqipërisë nuk mund të marrin punë publike kompani, të cilat i kanë pronarët e tyre të dënuar; kompani që janë në hetim për korrupsion, kompani që, megjithëse janë pjesë të hetimeve për pastrim parash, vazhdojnë të paguhen nga buxheti i shtetit; kompani të cilat kanë marrë punë publike dhe nuk i kanë përfunduar ato; kompani, kontratat e të cilave janë ndërprerë; kompani, për të cilat edhe ndërkohë që flasim, ka akuza të qarta (kur them akuza, nuk u referohem vetëm akuzave politike, por hetimeve të kryera nga organet ligjzbatuese për sa i përket rregullsisë së këtyre kontratave, një nga këto është çështja e inceneratorëve, por ka çështje të pafundme të kontratave korruptive që vazhdojnë, dhe këto lidhen me autoritet kontraktore, jo gjithmonë vetëm me punën e autoritetit publik).

Për këtë arsye, në emër të Partisë Demokratike, kam bërë disa propozime për ta ndryshuar mënyrën e funksionimit të këtij sistemi. Së pari, për të funksionuar në bazë të parimit të “open data”. E dëgjova zotin Xhoxhi që përmendi këtu parimin e transparencës, por, zoti Xhoxhi, unë si deputete e parlamentit të Shqipërisë, në qoftë se dua të marr një kontratë, shpenzoj mbi 3 muaj për të marrë informacione për tenderin për një punë publike të caktuar. Kam kërkuar nga institucionet, të gjitha informacionet dhe hapat e ndryshëm, që nga momenti kur shpallet tenderi, minutat e takimeve të grupeve që marrin vendimin, kërkesën dhe komunikimin ndërmjet institucioneve deri te vendimmarrja për një punë publike ose për një tender të caktuar. Sot këto informacione nuk janë publike. Në qoftë se këto do të ishin publike, të siguroj që edhe aksesit i kompanive do të ishte më i lartë, edhe zyrtarët e shtetit do të frikësoheshin më shumë me këto dokumente publike dhe do të kishte më shumë konkurrencë në këtë sektor. Përqendrimi i prokurimeve publike në një institucion të vetëm; zbatimi i parimit “open data” dhe kufizimi i kontratave publike me ato kompani që unë përmenda, sipas legjislacionit dhe kritereve të BE-së, besoj se do ta rrisnin konkurrencën në këtë sektor. Ndërkohë që flasim, prokurimet publike janë një drejtori dispeçeri, e cila shpërndan tenderë; kjo drejtori mund të konsiderohet si një drejtori varësie e Kryeministrit, por asnjëherë,

në asnjë rast si një drejtori që zbaton standardet e BE-së për prokurimet publike. Këto standarde dhe krijimi i një drejtorie ku ka qendëzim të prokurimeve publike, njëkohësisht edhe zbatim të parimeve më të mira jo vetëm të OSBE-së, por edhe të legjislacionit të BE-së për prokurimet publike, besoj se mund ta çlirojnë sektorin.

Në 20 sekondat e fundit dua të ndalem te rastet e pafundme të prokurimeve publike, që i kemi dëgjuar rëndom ditët e fundit, ku zyrtarë shteti i shpërndajnë prokurimet publike sikur i kanë pronat dhe plaçkat e tyre. Kjo shfaqje e shëmtuar me fondet publike, njëkohësisht, edhe mentaliteti për të futur duart në çdo tender publik, është për mua shenja e banalizimit të sistemit, nga ana tjetër edhe e degradimit të administratës publike.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Zoti Balla, dëshironi të flisni tani?

Atëherë, fjala për zotin Dogjani.

Asllan Dogjani – Faleminderit, e nderuar zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kur dëgjohen fjalët “prokurim publik”, “koncesion”, “partneritet publik-privat”, “tender”, në perceptimin e opinionit publik do të thotë vjedhje dhe korrupsion, ndërsa për autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik është një përfitim që u duket i drejtë. Ata mendojnë se cili do të përfitojë më shumë, cili do të ofrojë më shumë dhe çfarë kritere ndaluese të vendosin që tenderin ta marrë kompania që ata duan dhe me të cilën kanë marrëveshje. Korrupsioni në prokurimet publike ka shkaktuar dëm të dukshëm në proceset e zhvillimit të vendit, ka eliminuar konkurrencën, meritokracinë, ka rritur pabarazinë, ka goditur drejtësinë dhe i ka detyruar të rinjtë, dhe jo vetëm, të largohen masivisht nga Shqipëria.

Çfarë ndodh në jetën e përditshme?! Nuk ka transparencë; nuk ka barazi; përpara se të fitohet tenderi, operatori që përcaktohet si fitues i tenderit, duhet të paguajë paradhënie 25-30 për qind të vlerës së tenderit, kjo nëse nuk ankimohet, se, po u ankimua, duhet të paguajnë përsëri ose për ta lënë në fuqi vendimin, ose për ta rikthyer duhet paguar edhe më shumë. Kjo shumë i jepet drejtorit të autoritetit kontraktor, ndahet hapur me anëtarët e komisionit dhe shkon deri te ministri e

shumë e shumë të tjerë, por nuk mjafton me kaq. Pasi fillon puna për zbatimin e tenderit, fillojnë edhe vuajtjet e mëtejshme të kompanisë, fillojnë presionet, kontrollet (vjen supervizorja që mbikëqyr punimet, e cila për çdo faturë që kalon, do përqindjen e saj). Vazhdojmë më tej: gjatë zbatimit të punimeve bashkia bën kontrolle dhe, duke thënë se mbeturinat janë hedhur në vende të papërshtatshme, të vendos një gjobë në vlerën 100 milionë lekë. Meqenëse gjoba është shumë e madhe, operatori duhet të bëjë gati edhe 20-30 mijë euro për t'ia dhënë bashkisë. Kalvari nuk ka përfunduar akoma, duhet të paguash edhe gjatë kolaudimit, por më e keqja është se, pasi mbyllen punimet dhe dorëzohen, ata duan të marrin edhe lekët që i takojnë operatorit. Pa i paguar ata nuk t'i japin ato para, por i shtyjnë 6 muaj dhe pas 6 muajve u thonë se duhet të paguajnë 5 për qind për të marrë lekët që i takojnë për punën e kryer, sepse nuk ka para. Kjo është ajo që ndodh çdo ditë në praktikë, pa marrë parasysh kur në tenderë futen disa operatorë, të cilët nuk marrin asnjë tender, meqenëse fituesi është paracaktuar duke vendosur kritere ndaluëse.

Raportet e bukura bëhen shumë mirë këtu, por çfarë ndodh në terren, është një tjetër realitet. Situata e korrupsionit në prokurimet publike është kjo. Prandaj, Shqipëria është në këtë gjendje që qytetarët largohen masivisht. Ne jemi një ndër vendet më të korruptuara në Ballkan, në Europë dhe arsyeja kryesore pse dalim në të gjitha raportet si një vend i korruptuar janë pikërisht prokurimet publike. Si ka mundësi që një komision i përbërë me 2, 3 veta përcakton se cili do ta marrë tenderin? E dini se kush e zgjedh këtë komision?! Titullari i institucionit është ai që e zgjedh komisionin dhe përcakton se kujt do t'i jepet tenderi. Sigurisht që për shkak të këtij korrupsioni dhe të parave që shkojnë në xhepat e këtyre institucioneve që përmenda, edhe punimet, janë pa cilësi, sepse operatori nuk ka çfarë të bëjë me aq para sa i mbeten, ndoshta as 40 apo 50 për qind, megjithëse tenderët i marrin me vlerë të caktuar. Çfarë do të ndodhë me këto punë publike? Punimet do të prishen dhe duhen ribërë pas një viti. Zotërinj kolegë deputetë, kjo është gjendja. Prandaj unë mendoj se ka ardhur koha që në Shqipëri të bëhen të gjithë bashkë dhe të mendohen mirë për të bërë një ligj për prokurimet publike, i cili të mos mbetet në letër, që zhdruk korrupsionin, që garanton barazinë, drejtësinë dhe

transparencën, me qëllim që taksat e qytetarëve shqiptarë të përdoren ashtu siç duhet (pra, kur të bëhet një rrugë, të ndërtohet tamam, pa u vjedhur siç po i vjedhin). Ky është realiteti dhe situata ku ndodhemi, por po të bëhemi bashkë, e ndryshojmë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zonja Zhupa, fjala për ju. Koha në dispozicion edhe për ju është 5 minuta.

Ju lutem, të përgatiten zoti Leskaj dhe zoti Dashnor Sula!

Ina Zhupa – Faleminderit, e nderuar kryesuese e seancës!

Dua ta nis me habinë time se si Komisioni i Prokurimeve Publike paska marrë një çmim! Nëse ky komision duhej të merrte një çmim, duhej ta merrte si “certifikuesi i vjedhjeve dhe i abuzimeve në prokurimet publike”. Në fakt, korrupsioni në Shqipëri, i nxjerrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, por edhe nga vetë raportimet e Ministrisë së Financave, të paktën për 129 njësi që janë audituar, në dekadën e fundit prokurimet publike i kanë sjellë një dëm buxhetit në shumën 120 milionë dollarë. Vetëm në periudhën janar-prill të vitit 2023, KLSH-ja ka bërë 20 procedura auditimi dhe në 20 procedura auditimi të 55 institucioneve, kemi një dëm prej 21 milionë eurosh. Vetëm kryetari i bashkisë që e përdorte bashkinë edhe si një dhomë moteli, ka marrë 110 milionë euro tenderë. Për këta tenderë nuk foli njeri, derisa i plasi skandali publikisht.

Në fakt, kjo qeveri ka bërë një përmirësim, nga 1 në 3 procedura tenderimi me shkelje ka kaluar 1 në 2 procedura me shkelje. Sipas raporteve, 54 për qind e procedurave të prokurimit publik janë me shkelje. 54 për qind e procedurave janë ose pa garë, ose duke shpikur kritere me porosi, si “kostum me porosi” për atë që do të marrë tenderin, ku vihen elemente si, sa punonjës duhet të ketë, çfarë ngjyre duhet të ketë traktori, mundësisht edhe sa vjeç duhet të jetë administratori i kompanisë që do ta marrë tenderin, në mënyrë të tillë që këto kritere të shpikura me porosi të përmbushen posaçërisht vetëm nga ai që është paracaktuar si fitues dhe që në fund do të marrë tenderin.

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit flet të vërtetën për klimën e investimeve në Shqipëri dhe për atë që ndodh në sektorin e prokurimeve publike, ku thotë se karakterizohet nga mungesa e transparencës (dhe institucioni juaj

është pjesë e kësaj mungese të transparencës), nga kushtet e shpikura në funksion të fituesit të paracaktuar; flet për ekonominë shqiptare që karakterizohet nga ekonomia informale. Në fakt, Komisioni i Prokurimeve Publike shkel parimin e të drejtës administrative në vonesën që ka në dhënien e gjykimit për ankimimet.

Ju vetë në raportin tuaj thoni se janë 768 ankesa dhe nga këto 768 vetëm 21 kanë marrë përgjigje dhe ka përfunduar procesi. Ka procese që zgjasin 7 vjet, duke e bërë të pamundur ta marrin të drejtën, për arsye se ai që e ka fituar, ka mbaruar punë, ka marrë edhe paratë, është kryer gjithçka dhe vazhdon e vazhdon ankimimi te ju. Ndërkohë që shpejtësia dhe transparenca janë dy parimet bazë, me të cilat ju mund të garantoni që, të paktën këta 768 ankimes, të merrnin të drejtën nga Komisioni i Prokurimit Publik. Absolutisht që keni të drejtë që, kur janë tenderët pa garë, nuk ka as ankimim, se nuk ka pasur garues të tjerë, është paracaktuar fituesi, por të paktën këto 768 subjekte që besuan ende se ju mund të ishit një institucion i pavarur, duhej të kishin marrë përgjigje nga ju dhe duhej të kishte përfunduar procesi i ankimimit brenda kuadrit që parashikon e drejta administrative. E kanë më kollaj të shkojnë në gjykatë dhe ta marrin të drejtën te kjo e fundit, ku proceset edhe për nga natyra duhet të jenë më të gjata dhe më të komplikuar, sesa të marrin të drejtën te Komisioni i Prokurimeve Publike.

Koha sot është shumë e limituar për shkak të 5-minutëshit. Për ta konkluduar, do të desha të them që, nëse ka një sektor ku ka dështuar dhe është vjedhur në mënyrën më skandaloze, është pikërisht sektori i prokurimeve publike, i tenderëve, ku qeveria ia jep një grupi klientelistësh, i paracakton dhe pasurohen vetëm këta mbrapa nesh, dhe asgjë nuk shkon për biznesin e ndershëm, për ata që mund të bëjnë punë që të mbrohen paratë e taksapaguesve shqiptarë.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla.)

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Bujar Leskaj. Koha në dispozicion 5 minuta.

Bujar Leskaj – Zonja Kryetare, 5 minuta mund të jenë fjalët tuaja për të lavdëruar Komisionin e Prokurimit Publik, por në rast se një deputet normal...

Lindita Nikolla – Mos e shpenzoni kohën, ju lutem, filloni!

Bujar Leskaj – Nuk ka problem, jua kam falur 30 sekonda.

Si do të flasim ne 5 minuta?!

Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik, një nga institucionet më të rëndësishme në vend, vjen me një raport vjetor për vitin 2022 dhe me tregues sasiore të kënaqshëm në pamje të parë, por, po ta analizosh me vëmendje raportin, mendoj se KPP-ja, pavarësisht përpjekjeve të anëtarëve të saj dhe të kryetarit, ka dështuar për 3 arsye kryesore:

1. KPP-ja nuk ka mundur të parandalojë me vendimmarrjen e saj efektivisht marrëveshjet e fshehta të operatorëve ekonomikë në prokurimet publike. Për këtë mjafton të ballafaqojmë punën e KPP-së me specialistët e Institutit Shqiptar të Shkencave, një OJF, që menaxhon portalin e njohur dhe profesional “*Open Data Albania*”. Aty gjejmë pasqyrim defektet më të mëdha të sistemit të prokurimit publik sot tek ne. Këto defekte nuk i gjejmë te raporti vjetor i KPP-së. Problem nuk janë vetëm tenderimet me një operator në garë, por problemi themelor qëndron te kontratat që miratohen me ligje të posaçme që e shmangin qëllimisht, pa e nxitur fare, konkurrencën për shkak të marrëveshjeve të fshehta: titullar publik-kompani biznesi e interesuar. Në asnjë rast të veprimtarisë së saj vjetore KPP-ja nuk e konstaton këtë fenomen. Këto kontrata me vlera qindra milionë euro, para të buxhetit të shtetit (janë 1 miliardë kontrata të prokuruar, sipas Komisionit të Prokurimit Publik), në të vërtetë përfaqësojnë procedura tenderimi të trukuara, gara të trukuara, me fitues të paracaktuar, që deformojnë konkurrencën e lirë të operatorëve ekonomikë në treg dhe janë bërë shkak që në kontratat tona publike për punime në infrastrukturën rrugore, portuale e të tjera të realizohet gati me 100 % të fondit limit, si dhe të ketë më shumë se një dekadë që mungojnë kompanitë e huaja me emër, që janë të pranishme në rajon me kontrata të ngjashme, si në Kosovë, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut e të tjera.

Nuk kemi parë asnjë rast të vetëm që KPP-ja të ketë reaguuar për këto shkelje të qarta, shpeshherë edhe flagrante, të ligjit “Për prokurimin publik” në këto kontrata.

Dy institucionet tipike, që edhe gjatë vitit 2022 kanë kryer shkeljet më serioze dhe me dëm

të ndjeshëm ekonomik për buxhetin e shtetit, janë: Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Kisha 2-3 shembuj, por për efekt kohe nuk po i jap, të cilët janë sinjifikativë për këto 2 autoritete.

2. Flamujt e kuq në tenderët problematikë të bashkive nuk shihen vetëm nga KPP-ja. Sipas një sistemi vlerësimi për tenderët publikë, mbështetur edhe nga projekte të USAID-it në Shqipëri, marrin flamuj të kuq tenderët e dyshimtë, ku evidentohet mungesa e konkurrencës ose skualifikimi i qëllimshëm i konkurrentëve, duke lënë në garë vetëm fituesin. Tenderi që merr flamur të kuq, ka dy karakteristika: fituesi nuk është operatori me ofertën më të ulët ekonomike; më parë janë skualifikuar të gjithë operatorët e tjerë konkurrues në garë. Tipike janë Bashkia e Tiranës, si dhe Bashkia e Durrësit, por për efekt kohe nuk po i përmend.

3. KPP-ja nuk i shikon arsyet e vërteta pas uljes së ankesave dhe indikatorit shumë të ulët të dobisë së vendimmarrjes së tij. Për pyetjen që i bëra kryetarit, pavarësisht përpjekjeve të tij, ai nuk ktheu dot përgjigje pse KPP-ja është një institucion, i cili si rrjedhojë të veprimtarisë së tij ka një indikator shumë të ulët të dobisë ekonomike. Për 1 lek të shpenzuar nga taksapaguesit shqiptarë, KPP-ja i ka kursyer shtetit shqiptar afërsisht 0,8 lekë ose edhe 1 lek.

Zonja Kryetare, dua 40 sekonda për të shprehur një gjë pozitive, që unë mendoj për veprimtarinë e këtij institucioni. Pavarësisht se i ka munguar kuraja publike për ta parë në sy problematikën e vërtetë në prokurimet tona publike dhe në hetimin e shumë rasteve të dyshuara si abuzive dhe të denoncuara nga media, përgjatë vitit 2022, në vijim të përpjekjeve, KPP-ja ka realizuar një konferencë shkencore shumë të suksesshme me temë “Sfidat e sistemit të prokurimit publik në Republikën e Shqipërisë” në maj të po këtij viti me mbështetjen e SIGMA-s dhe OECD-së. Unë gjykoj, duke i falënderuar drejtuesit e komisionit, pavarësisht se nuk heq dorë nga vërejtjet apo akuzat e mëparshme, se rekomandimet e kësaj konference për krijimin e trupës së zyrtarëve të certifikuar të prokurimit publik për hartimin e standardeve kombëtare për grup-mallrat me përdorim të përgjithshëm dhe për hartimin në bashkëpunim me Autoritetin e Konkurrencës të një manuali të sinjaleve të marrëveshjeve të ndaluara në prokurimet publike

do ta ndihmonin KPP-në të punonte më me efektivitet dhe pavarësi për realizimin e misionit të saj në të ardhmen. Këto duhej të ishin bërë pjesë e rekomandimeve tona në rezolutë, por për këto KPP-ja për vitin 2023 duhet të bëjë avokatinë e saj kryesore.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zotin Dashnor Sula. Keni 5 minuta në dispozicion.

Dashnor Sula – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në këtë seancë po debatohet për Komisionin e Prokurimit Publik. Do të thosha që në fillim se ky institucion është thjesht një noter asgjë më tepër, që certifikon, vulos tenderët e kompanive, që merren në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Do të jem i qartë në ato që do të them. A e shikoni çfarë ndodh me pushtetin lokal nëpër bashki; çfarë ndodh me institucionet qendrore; çfarë ndodh nëpër ministri? I marrim gjërat me radhë. Po e nis nga fundi. Respekt për një koleg të mazhorancës, i cili tha: “Mos u ankoni ju të opozitës, sepse e shikoni sa transparencë kemi ne si mazhorancë?!” E kishte fjalën për Bashkinë e Kukësit. Me të drejtë, sepse transparencë si kjo që jepni ju për tenderë dhe për gjithçka, nuk gjendet. Kot ankohet opozita. Mos u ankoni ju të opozitës, sepse mazhoranca jua nxjerr si dritën e diellit gjithçka dhe duhet të jeni të kënaqur për këtë. E kuptoni që arrihet deri atje, sa vaksinimi i një qeni vlen 60 mijë lekë, ndërsa ndihma ekonomike për një familje, për një që merr ndihmë ekonomike, është 40 mijë lekë të vjetër. Këto ndodhin përditë.

Po ajo tjetra ju kujtohet, 400-500 mijë euro tek tubi i aspiratorit, ajo e famshmja që bënte të gjithë tenderët e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave? E mori antikorrupsioni. Po ajo tjetra që i kishte poshtë dyshekut? Po kjo e fundit e Ministrisë së Shëndetësisë, e cila nuk lë të bjerë në tokë asgjë, edhe 3- milionëshin e fundit e ruan për vete? Këto janë të vërtetat. Ju mund të thoni çfarëdolloj gjeje dhe mund të justifikoheni si të doni, por të vërtetat janë këto që ndodhin përditë. Dilni këtu sot e thoni ju, përfaqësues të mazhorancës, madje edhe Kryeministri: “Po mirë, pse kapni vetëm nga krahu ynë, nuk kapni edhe nga krahu tjetër?” Po çfarë do të kapin te ne? Ne morrat kemi! Paratë, pushtetin, gjithçka e keni ju, njerëzit tuaj. Ju i merrni, ju i pasuroni, ju vidhni! Jo të gjithë, që të jemi të qartë, e kam thënë edhe

herë të tjetra, nuk e them për diversion, por ata që i kanë në dorë.

Edhe për ngjarjen e fundit që ndodhi, u thashë një gjë miqve të mi: nuk është problemi i gjestit që ndodhi aty, por problemi më i madh është se ju që keni pushtet dhe para, jeni aq arrogantë, saqë nuk u bën syri tërr për asgjë më dhe e ktheni edhe zyrën e shtetit në bordello.

Ky është realiteti. Për këtë duhet të na vijë turp të gjithëve, nga i pari deri tek i fundit. Pa diskutim, ka pasur gjithmonë problematika me zyrat e shtetit; të gjithë e dimë që nuk reagohej, të gjithë e dimë se çfarë nuk ndodh nëpër zyrat e shtetit, intimidohen, bëhen presione, edhe për tenderët kjo gjë ndodh. Të gjithë e dimë që në Ministrinë e Shëndetësisë vetëm 5 operatorë qarkullojnë të gjithë tenderët. Të gjithë e dimë që janë kushërinjtë, të afërmit e tyre, që i ndërrojnë, vendosin emrat, firmat dhe tenderët i marrin ata.

Po nëpër bashki? Të dalin t'i bëjnë transparente pse i kanë kushërinjtë, kunetërit, dhëndrit, njerëzit e afërt të ministrave, të drejtorëve të drejtorisë apo të drejtuesve të tjerë të mazhorancës! Në një kohë që, nëse nga opozita ka njerëz të caktuar, të cilët kanë të afërm të tyre që kanë përfituar nga fonde publike, kanë marrë tenderë, bëjini publikë. T'i nxjerrim letra sheshit këtu, sepse ndryshe i bëjmë të gjithë pis, pra edhe këtë nga mazhoranca bëhen pis disa që nuk janë të tillë, e njëjta gjë edhe nga ana jonë.

Miqtë e mi, ka ardhur një moment tani që duhet t'i themi të gjitha gjërat në sy. Unë nuk kam turp ta them, pavarësisht se jam përfaqësues i kësaj opozite, që ky vend po shkon drejt greminës. Në çfarë kuptimi?! Në kuptimin që këtu po ngel vetëm një regjim, vetëm një parti, vetëm një qeveri dhe ju nuk keni faj, sepse edhe opozita nuk bën opozitën ashtu siç duhet ta bëjë atë, nuk denoncon, sepse ka elementë të caktuar, ka drejtues të caktuar të opozitës apo njerëz të caktuar të opozitës që janë me fije të lidhura me biznese, sepse të gjithë e dimë se ata pesë a dhjetë individë, që quhen oligarkë, janë njerëz që kanë lidhje edhe me opozitën, edhe me mazhorancën, sepse bëjnë biznes me njerëzit e tyre të afërm. Opozita duhet të dalë këtu çdo ditë, çdo orë dhe të denoncojë me emra konkretë, me fakte konkrete, me firma konkrete, se cilët janë personat e lidhur qoftë me njerëz nga opozita, qoftë nga mazhoranca, duke bërë biznes e duke marrë tendera.

Si ka mundësi që ish-kryetari i bashkisë së Kukësit, për katër vjet merr 100 milionë euro? Si ka mundësi që të afërm kryetarësh të tjerë bashkie marrin nga 50 milionë euro, 200 milionë euro brenda tre-katër vjetëve. Ku i gjejnë këto? Pra, fondet e shtetit janë të kanalizuar vetëm në duart e disa personave, të cilët ne i dimë, se këtu jetojmë.

(Bie gongu.)

Tani, të dalin e të flasin për Qani Xhafën, për vëllain, për motrën apo për njeriun e tij, që është deputeti më i ri këtu. Dilni e thoni! Flisni për mua, që kam krushqitë, dhëndërit, kunetërit, që kanë marrë tenderë. Ju do thoni: pse flet me këtë gjuhë? Unë kam vendosur që për sa të jem këtu, në këtë parlament, të flas me gjuhë të thjeshtë e të drejtpërdrejtë. Unë mendoj se do të ishte e ndershme për çdo deputet të mazhorancës e të opozitës, të cilët nuk janë të përzier në afera, që nuk janë të implikuar në këto lloj aferash, të dalin e t'i thonë gjërat në sy, sepse nuk shtyhet më kështu. Është e turpshme që në opozitë apo në mazhorancë, njeriu t'i lëpihet pushtetit, t'i bëhet patericë pushtetit për një mandat deputeti, vetëm e vetëm për të marrë një rrogë. Edhe atë rritje rroge e bënë për t'ju bërë të heshtni ju dhe ne.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Monika Kryemadhi!

Nuk është?

Këtu mbyllet kjo pikë e rendit të ditës.

Po, zoti Balla, fjala për ju!

Taulant Balla – Dua të sqaroj se Kuvendi i Shqipërisë e kryen këtë procedurë parlamentare në respekt të autoritetit dhe rolit që Kushtetuta i ka dhënë Kuvendit, si organi më i lartë në piramidën shtetërore. Pra, ne i zgjedhim, ne i votojmë në ato pozicione, dhe në mënyrë të natyrshme ata raportojnë tek ne.

Keqardhje shumë e madhe, pasi që i dëgjova me shumë vëmendje të gjithë deputetët e opozitës. Natyrshëm që zonja Zhupa, një deputete e re, edhe pse u bënë dy vjet, nuk ka haber nga kjo punë, sepse tha: sektori i Prokurimeve Publike është më i... E para njëherë, Prokurimet Publike nuk janë sektor. Sektor është bujqësia, sektor është industria, sektor është arsimit, sektor është shëndetësia. Prokurimet Publike janë procedurë. Minimalisht, kur vini këtu dhe flisni, merreni e lexojeni dokumentin që ju ka sjellë institucioni. Nëse nuk keni kohë, pasi ju keni punë të mëdha,

të paktën lexoni relacionin e komisionit përkatës. Nëse nuk keni kohë, pasi ju keni punë të mëdha, merreni raport-progresin e Komisionit Europian. Të paktën aty do të lexoni se për këtë procedurë, për këtë institucion, Shqipëria ka marrë jo notë kaluese, jo notë të mirë, por ka marrë notën maksimale. Madje, rekomandohet që eksperiencia e fituar nga Shqipëria, institucioni që ka zgjedhur Kuvendi si gjykatë e prokurimeve...

Se ju nuk e dini, por kjo është një kuazigjykatë, është niveli i parë i një gjykate, vendimet e së cilës shqyrtohen si nivel i dytë nga Gjykata Administrative e Apelit. Për të kuptuar se me çfarë institucioni kemi të bëjmë, për të vënë notën në fund, sepse në fund të fundit ne do të bëjmë vlerësimin për 2022-in, dhe do të themi: ky institucion, çfarë note ka?

E vërteta është se nga gjithë ato procedura, vetëm pesë vendime ka nga Gjykata e Apelit, për të cilat është pranuar shqyrtimi i ankesës në gjykatë. Pra, mes atyre qindra procedurave. Në fakt, edhe vetë ankimesit, operatorët, kanë nivelin më të ulët. Vetëm 5, 5 % e të gjitha ankesave kanë zgjedhur të shkojnë në Gjykatën Administrative të Apelit.

E pra, është e natyrshme që ne jemi të ndarë. Ne jemi shumica, ju jeni pakica, por të paktën gjithë këto vite kemi pranuar që raportet e progresit nga ana e Komisionit Europian t'i lexojmë të gjithë njëllonj. Dhe kur Bashkimi Europian na thotë se ky institucion e ka bërë punën si duhet, kur Bashkimi Europian e merr Komisionin shqiptar të Prokurimeve Publike për t'ia rekomanduar... Dhe unë e përsëris, sepse t'ju them të drejtën, e kam nxitur bashkëpunimin mes Komisionit tonë të Prokurimeve Publike dhe atij të Kosovës, duke dhënë një asistencë të vyer.

Në fakt, e kemi kthyer Tiranën në një qendër rajonale të eksperiencave. Po shkoj përtej kësaj, për të mbështetur atë që ka thënë Kryeministri Edi Rama, i cili ka rekomanduar, gjë në të cilën edhe unë besoj, se duhet të shkojmë drejt një institucioni rajonal të Prokurimeve Publike. Është një shembull ose një destinacion, ku duhet të përqasemi, sepse e vërteta është se prokurimet publike janë dhe mbeten një sfidë në të gjitha vendet. Nuk flas këtu për vendet që synojnë të anëtarësohen në Bashkimin Europian, po për vende që janë anëtarë të Bashkimit Europian.

Këtu po marr një shembull: në vitin 2012, në Rumani arrihej të përmbylej në procesin e

tenderimit vetëm 10 % e fondit publik, sepse 90 % e procedurave nuk përmbylleshin dot, kjo edhe për shkak të luftës kundër korrupsionit dhe hezitimit të anëtarëve të KVO-ve, komisioneve të vlerësimit të ofertave, për të marrë pjesë në to. Prandaj, ndoshta një model tjetër i KVO-ve me *outsourcing* mund të ishte një zgjidhje, që do t'i dilte para këtij momenti.

Tani duhen thënë katër gjëra, dhe shumica këndeje do ta votojmë vlerësimin e raportit. E para, ligji i ri "Për prokurimet publike"... Dëgjoje ti, zonja Zhupa, meqë e ke si shkollë nate këtë punë, që vjen, ikën e vjen. Gjëja e parë... Jo, ta dish, se nuk ishte këtu: Prokurimi Publik nuk është sektor, por është shërbim. Po pra, po. Sektor është industria, sektor është bujqësia. Ky është shërbim publik. Dhe te ky shërbim publik ne kemi bërë një reformë, me asistencën e vyer të Komisionit Europian. E në fakt, për ata që flasin këtu, jemi i vetmi vend që kemi vendosur kritere përjashtuese – për këta profesorët e të drejtës kushtetuese – ndoshta në kundërshtim me të drejtat themelore të njeriut dhe me ato që burojnë nga Kushtetuta, që personat e dënuar për korrupsion, të cilët janë ortakë në shoqëri tregtare, ata nuk mund të përfitojnë, nuk mund të kualifikohen, ose thënë ndryshe, skualifikohen automatikisht.

Po ashtu veprohet edhe për krime të tjera, për krime të rënda. Jemi një vend që kemi shkuar përtej asaj që quhet *acquis communautaire*, në lidhje me pjesën e prokurimeve publike. Në fakt, dhe këtu po nënvizoj përsëri, në raportet e BE-së Shqipëria rekomandohet si një vend që ka bërë një përparim të dukshëm.

Sa i përket pjesës tjetër, digjitalizimit të ankesave, e kemi arritur dhe jemi pothuaj 100 % në destinacion, duke shpëtuar kohë, por dhe duke rritur transparencën. Dhe në këtë proces transparenca vlerësohet maksimalisht nga raport-progresi i Bashkimit Europian. Prandaj, Shqipëria ka ndërlidhur procesin administrativ të shqyrtimit të ankesave përmes një institucioni, që është kuazigjykatë, Komisioni i Prokurimit Publik, në nivelet e gjyqësorit. Duke përjashtuar këtu gjatë, të cilat shkojnë në shkallën e parë të Gjykatës Administrative, të gjitha ankesat e tjera shkojnë në shkallën e dytë, pra në Apelin Administrativ.

Dashi foli për çështje nga më të ndryshmet, dikush tjetër këtu nuk u kënaq me përgjigjen, prandaj, do t'ju lutesha shumë, që kur

vihet në Kuvend, kur është për t'u vlerësuar një institucion, vlerësimi bëhet për vitin paraardhës: pra vitin 2022-2023 do ta vlerësojmë në 2024-ën. Në rast se doni që këto raportime t'i kryejmë siç duhet, mirë do të ishte të flisni me laps, me letër, me mend në kokë, duke iu referuar dokumenteve, duke iu referuar fakteve.

Ftoj Kuvendin ta votojmë raportin, ta votojmë rezolutën e Kuvendit, dhe natyrshëm u drejtohem institucioneve: Kuvendi i miraton këto rezoluta, me qëllim që rekomandimet që vijnë nga Kuvendi të merren parasysh. Fakti është se Komisioni i Prokurimit Publik i ka marrë të gjitha rekomandimet e bëra nga Kuvendi vitin e kaluar. Në fakt, edhe në raportim, u raportua mbi bazën e detyrave që kishte vendosur Kuvendi.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Zhupa, dy minuta replikë.

Ina Zhupa – Faleminderit, Kryetare!

Kur gishti tregon hënën, budallai tregon gishtin. Kur unë flas për korrupsionin në Shqipëri dhe për prokurimet publike, që kanë shkaktuar 120 milionë dollarë dëm në dekadën e fundit, sipas KLSH-së, kryetari i grupit parlamentar thotë: sektor a jo sektor. Në çdo administratë prokurimet publike kanë një drejtori, kanë një sektor, quaje si të duash ti, që merret me prokurimet publike. Më e rëndësishmja është se ju mund të arrini një rekord: brenda burgjeve mund të krijoni – pikërisht për këto dëme e vjedhje që keni bërë me tendera e me prokurime publike – qoftë një grup parlamentar, qoftë shoqatën e bashkive. Për grupin parlamentar, sugjeroj që zoti Balla të kërkojë edhe drejtimin e atij grupi parlamentar.

Ndërkohë, dua t'ju kujtoj që në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, meqenëse e citoni për standardet amerikane dhe jeni të gjithë proeuroatlantikë, flitet për mungesën e transparencës në prokurimet publike, flitet për ekonomi informale, për kushte të shpikura sipas...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, raporti i fundit i DASH-it për klimën e investimeve. Merre, lexoje, se ke kohë dhe eja ta diskutojmë këtu! Madje, meqë ke të drejtë, si kryetar grupi, të kërkojsh debat, bëjmë një debat të posaçëm në seancën e ardhshme vetëm për raportet e DASH-it.

Faleminderit, Kryetare!

Lindita Nikolla – Këtu mbyllet diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për “Përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit GovTech””.

Fillojmë diskutimin me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja.

Fjala për zonjën Ekonomi, pa kufizim kohe.

Milva Ekonomi – Mirëdita të gjithëve!

Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, dua t'ju parashtoj arsyen pse vijmë në këtë moment për të kërkuar ratifikimin e kësaj marrëveshjeje huaje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për të mundësuar një kredi që vjen nga programi i mbështetjes i Bankës Botërore.

Sipas të dhënave të INSTAT-it, 98,4% e ndërmarrjeve të mesme dhe të mëdha në Shqipëri përdorin internetin. Në këto ndërmarrje, rreth 33% e punonjësve janë të zotë të përdorin shërbimet elektronike. Ndërkohë, siç ka bërë matjet për ndërmarrjet, INSTAT-i, duke ndjekur modelin e Eurostat-it, për të kuptuar se si përdoret interneti në Republikën e Shqipërisë, tregon se në vitin 2022, 13,8% e ndërmarrjeve i kanë shitur produktet e tyre nëpërmjet platformave të “e-Commerce”, nga 5,8% që ishte kjo shifër në vitin 2019.

Në anketën pranë familjeve tregohet se në Shqipëri popullsia e moshës 16-74 vjeç në vitin 2022 është e aftë të përdorë internetin në masën 82,6%, dhe të gjithë dinë ta përdorin internetin nëpërmjet telefonave *mobile*. Një pjesë tjetër përdor edhe forma alternative, siç janë: *laptop*-ët, *desktop*-ët apo tabletat. Përqindja e dhënë nga INSTAT-i, por edhe nga AKEP-i, e familjeve që kanë akses në internet në vitin 2022 është rreth 97%, krahasuar me 83% që ishte një vit më parë. Familjet shqiptare i përdorin të gjitha shërbimet e “e-Qeverisjes”, dhe në vitin 2022 numri i aplikimeve që janë shkarkuar dhe printuar është rritur me 37,6 pikë përqindje në krahasim me vitin 2021.

Të gjitha këto, në momentin kur ne hartuam strategjinë e qeverisjes digjitale për periudhën 2022-2026, tregojnë se ishim bërë gati për të kuptuar që Shqipëria e kishte përqafuar siç duhet revolucionin digjital. Këtë e kanë treguar edhe të dhënat e tjera, sikurse matjet që bëjnë institucionet e UN-it në të gjithë globin. Në institucionet e UN-it Shqipëria renditet si një nga vendet në Europë që kishte bërë kapërcimin më të madh, duke u renditur e 8-ta për nga progresi, dhe në nivel global UN-ja e klasifikonte Shqipërinë në vendin e 18-të nga 181 shtete.

Herën e kaluar ne diskutuam këtu, në parlament, projektligjin “Për qeverisjen elektronike”, ku vendosëm një kornizë legjislativë për të gjitha zhvillimet e mëtejshme që do të shoqërojnë “e-Shërbimet” dhe kuptuam që është e rëndësishme që këtë strategji ta mbështesim edhe me strategjinë globale 2030 të Kombeve të Bashkuara, që e kemi përqafuar të gjithë. Ky akses në shërbimet digjitale është një nga objektivat e zhvillimit të mijëvjeçarit, që ne e matim në pikën 9 të strategjive.

Ndaj, në këtë marrëveshje me Bankën Botërore, kërkojmë pikërisht rritjen e barazisë në përdorimin e shërbimeve publike me standard të lartë, nëpërmjet teknologjive të qeverisjes GovTech, duke vënë kështu në jetë një sërë objektivash që kemi marrë në strategjinë digjitale për Republikën e Shqipërisë.

Në fakt, kjo kredi, që hartohet nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Bankës Botërore, vjen si rezultat i negociatave që ka bërë stafi i Ministrisë së Financave, por ka edhe një element tjetër të rëndësishëm, që duhet konsideruar në këtë marrëveshje huaje, i cili lidhet me faktin se Shqipëria, duke bërë këtë progres, si një nga vendet ku Banka Botërore përdor këto lloj marrëveshjesh, ka mundësi të përdorë për herë të parë disbursimin e kredisë sipas rezultateve. Pra, përveç guidave që ajo përdor në të gjithë botën, ku punon si organizatë partnere zhvillimi, të përdorë në Shqipëri edhe disbursimin sipas rezultateve.

Shuma e huas që do të marrim është 60 milionë euro, e bazuar në normën e referencës të interesit euribor, plus marzhin e pandryshueshëm, që është 1,17% dhe ka një tarifë në *front end* 0,25% të shumës së huas. Komisioni i angazhimit është 0,25% dhe llogaritet mbi shumën e padisbursuar të huas. Maturimi i kësaj kredie

është për 18 vjet. Fakti që do të ndjekë rigorozisht të gjithë rezultatit e AKSHI-t kërkon, nga ana tjetër, që të kemi përballë një institucion i cili i ka shumë të qarta detyrat që do të kryejë për angazhimin e kësaj kredie që merr.

Prandaj, e kemi shumë të qartë që produkti që do të vijë nga kjo kredi bën pjesë në listën e produkteve të strategjive prioritare të qeverisë, që lidhet me qeverisjen 2,0, me krijimin e *smart lab-ëve* në të gjithë Republikën e Shqipërisë dhe me nevojën për të pasur qendra rinore, që nxisin aftësimin digjital të popullsisë së re dhe jo vetëm.

Ndaj, kur flasim për arrijtjen e kësaj kredie, kemi parasysh edhe detyrat, dhe në këto detyra ajo që ka të bëjë me “e-Qeverisjen” 2,0 është përmirësimi në aksesin e shërbimeve elektronike për të gjithë përdoruesit.

Në këtë fushë shërbimet tona janë aty për përdoruesit dhe ju duhet të dini që sot ne kemi 1227 shërbime *online*. Duhet të keni parasysh që shumë nga shërbimet e kanë ulur në mënyrë të konsiderueshme numrin e dokumenteve që duhet të marrin qytetarët, madje disa janë bërë pa dokumente fare.

Ndërkohë, ne duam të vazhdojmë t'i përmirësojmë këto shërbime, duke krijuar ato elemente në shërbime, që quhen *life events*, të cilat kanë si qëllim kryesor automatizimin e shërbimeve për përdoruesin. “Shërbime të automatizuara” do të thotë që ato shërbime që përdoren më shumë të merren vetëm me një klikim. Matja e shërbimeve që përdoren më shumë në Republikën e Shqipërisë nuk bëhet vetëm nga AKSHI, por edhe nga Kombet e Bashkuara, nëpërmjet një anketimi vjetor në të gjitha vendet.

Nga ana tjetër, ne kërkojmë të rinxhinierizojmë portalin “e-Albania”, duke i bërë edhe më të lehta shërbimet dhe duke kaluar në mikrosërbime për qytetarët, si dhe duam të krijojmë mënyrën e zgjidhjes së problemeve nëpërmjet inteligjencës së biznesit, për të analizuar dhe vizualizuar se ku janë problemet, por edhe për të pasur parasysh ecurinë, dhe parashikimin ta bëjmë mbi bazën e të dhënave.

E dyta, që është shumë e rëndësishme në këtë hua, është krijimi i *smart lab-ëve*. Ju e dini, sepse këtu kemi miratuar buxhetin e shtetit për vitin në ushtrim dhe kemi ndërtuar 100 laboratorë *smart lab* në shkollat e vendit. Nëpërmjet kësaj huaje mundësohet ndërtimi i 200 laboratorëve të

tjerë dhe nëpërmjet fondeve IPA mundësohen dhe 684 laboratorë të tjerë. Kështu që rreth 1000 shkolla të vendit do të kenë *smart labs*, ku të gjithë fëmijët do të mësojnë procedurat e kodimit apo të përdorimit të teknologjive inovative.

Sot, në klasat e para ka filluar procesi i kodimit, duke i bërë fëmijët shqiptarë në këta 100 *smart labs* të barabartë me 25 milionë fëmijët e tjerë në mbarë botën, ku *smart labs* nuk përdoren vetëm për t'u aftësuar digjitalisht, por edhe për të aftësuar mënyrën e qasjes kritike ndaj informacioneve që ato marrin.

Në lidhje me shërbimet që do t'u jepen qytetarëve, gjithashtu, është shumë e rëndësishme të themi që ne i kemi pasur qendrat me një ndalesë, të cilat ishin qendrat e ADISA-s dhe do të tjetërsojnë rolin e tyre: nga qendra me një ndalesë ato do të kthehen në qendra që aftësojnë rininë nga pikëpamja digjitale, duke u kthyer në qendra kreative të digjitalizimit.

Gjithashtu, ne do të nxisim edhe krijimin e TOM-it (një bashkësi *startup*-esh) me të rinj, me iniciativa shkollash dhe biznesesh private, që kërkojnë të krijojnë një mjedis inovacioni në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Do të përmirësohet ndjeshëm dhe shërbimi ndaj qytetarëve. Ne do të hartojmë për herë të parë një "Siri" për të gjitha shërbimet që u jepen qytetarëve, pra do të kemi atë që quhet *omnichannel contact center* për personat që kanë nevojë. Natyrisht, sot ne e përdorim këtë nëpërmjet një "numri të gjelbër", por me avancimin e teknologjisë duam ta bëjmë edhe më moderne. Rastet e personave që kanë probleme do të vazhdojnë të ndiqen me shumë kujdes nga të gjithë punonjësit që janë *back office* e shërbimeve.

Në fushën e tretë ne kërkojmë të forcojmë mundësitë parësorë të GovTech-ut, prandaj është shumë e rëndësishme të kemi parasysh që në Shqipëri ne kemi vendosur standarde për shërbimet digjitale, sepse, kur secili nga ne merr një shërbim ka një lloj pritshmërie, dhe e rëndësishme është të matim pritshmërinë karshi standardeve. Nëse diferenca e pritshmërisë karshi standardeve është e largët, puna që bëhet, së pari, është autokorrigtimi, i cili është një proces i vazhdueshëm në "e-Shërbime". Kështu që, nëpërmjet kësaj, do të përplojmë të përditësojmë teknologjinë për ta lejuar këtë gjë dhe për të krijuar mekanizma vlerësimi, që janë shumë të

rëndësishëm në çuarjen përpara të sistemit "e-Shërbime" në vendin tonë.

Nga ana tjetër, shërbimet merren duke i vënë në përdorim të gjithë regjistrat. E kemi thënë disa herë këtu, që, nëse në vitin 2014 ne kishim vetëm 5 regjistra që komunikojnë me njëri-tjetrin, sot kemi 58 regjistra që komunikojnë me njëri-tjetrin, të cilët kanë nevojë të shkëmbejnë në mënyrë unike informacionin dhe kontrolli për këtë shkëmbim të jetë i ndjekur dhe i qendëruar. Prandaj nënshkrimi elektronik i dokumenteve bëhet shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë vazhdimisht në kontroll, por, gjithashtu, edhe i lehtë në përdorim. Prandaj, shërbimet që do të dalin në mënyrë automatike do ta kenë të gjeneruar, më së pari, komunikimin midis regjistrave.

Ndërkohë, sa më shumë hapim lidhjen midis regjistrave, kërkojmë që të dhënat që hartojmë në vend, që janë të dhëna administrative dhe bazë shumë e rëndësishme studimi për të gjithë studiuesit dhe politikëbërësit, të kenë mundësi të jenë në portalin "Open data" apo, siç quhet ndryshe, të të dhënave të hapura. Edhe ky portal do të marrë një siguri, që do të kalojë në dy hapa: së pari, do të shikohet gatishmëria e të dhënave për të qenë të dhëna të hapura, sepse kjo është shumë e rëndësishme dhe, së dyti, do të nxitet përdorimi i të dhënave të hapura për analizimin dhe shtrirjen më tej në cilësinë e shërbimeve.

E ardhmja e "e-Albania" është shumë sfiduese dhe kërkon të kemi mbështetje nga ekspertiza ndërkombëtare, pasi këto gjëra bëhen duke u konsultuar me vende të përparuar, të cilat kanë hasur vështirësi dhe i kanë zgjidhur problemet, por, gjithashtu, kërkon të kemi gjithmonë e më shumë një motivim për të ndjekur trendet e reja që ndodhin në botë. Nuk mund t'i shpëtojmë dot revolucionit teknologjik dhe është fat, në fakt, se nga viti 2007, 2008, 2011, 2014 dhe që nga 2014-a gjithmonë e më shpejt, ne kemi përqaftuar teknologji të reja. Të mos harrojmë që edhe për shumë vende të tjera në Europë dhe më gjerë, situata pas pandemisë ishte e domosdoshme për të kaluar në e-shërbime më cilësore dhe më të garantuara për qytetarët.

Prandaj, thënë këto gjëra, unë besoj se kjo marrëveshje huaje që kemi sot përpara për diskutim dhe për të parë se si do të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve digjitale në

Shqipëri do të jetë një element që do të na bëjë të mendojmë drejt dhe ta votojmë atë.

Ndaj, kolegë, ju ftoj ta votojmë.
Faleminderit!

Lindita Nikolla – Hapim diskutimet.

Zoti Braçe, fjala për ju.

Të përgatitet zoti Çollaku.

Erion Braçe – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,
Zonja Ministre,

Patjetër, unë besoj se nuk ka njeri në këtë sallë të mendojë që paratë që përdoren për të përmirësuar shërbimet dhe, veçanërisht, për të investuar në e-shërbime, janë para që shkojnë atje ku duhet.

Është gjë e mirë që ne prej vitesh kemi nisur atë që ju e konsideroni revolucion digjital, veçanërisht në fushën e shërbimeve dhe që duhet të jetë i tillë, duhet të shkojë deri në fund si i tillë.

Është një mundësi shumë e mirë që u jepet qytetarëve, që të mos kenë kontakt me ofruesin e shërbimeve dhe natyrisht të minimizojnë në maksimum korrupsionin, atë korrupsionin që është i vogël, por, për shkak se bëhet i gjerë, kthehet i gjerë, është aq bezdisës sa që u merr shpirtin njerëzve, një herë si burokraci dhe një herë si korrupsion.

Kështu që, unë mendoj se gjithçka kemi bërë deri tani apo që duam të bëjmë, duke filluar me klasat digjitale, me *smart lab*-et, me e-shërbimet dhe gjithçka tjetër në këtë fushë, është gjë e duhur, është gjë e mirë dhe, natyrisht, në qoftë se ka një detyrë për ne është që të nxitojmë. Të nxitojmë sa më shumë të jetë e mundur, sepse zhvillimet në këtë fushë janë shumë të mëdha.

Mjafton t'ju them që sot flitet për inteligjencën artificiale dhe për rregullimin e inteligjencës artificiale, ndërkohë që ne jemi akoma tek e-shërbimet dhe duhet t'i shtyjme akoma edhe më tutje.

Natyrisht, duke thënë këtë dhe duke nxitur për të vijuar për të bërë akoma më mirë në këtë fushë, kam edhe disa probleme, që, natyrisht, lidhen me mënyrën se si po funksionojnë sot shërbimet e, në krahun tjetër, edhe me atë që duhet të shtyjme me forcë përpara.

Dhe në qoftë se ka një gjë, për të cilën unë bie shumë dakord në këtë marrëveshje dhe që është një element shumë i rëndësishëm jo vetëm teknologjik, jo vetëm teknik, jo vetëm digjital, por

është një element shumë i rëndësishëm për demokracinë, është barazia e aksesit në këtë vend.

Kjo është themelore, në qoftë se ne duam që demokracinë ta çojmë në një nivel tjetër.

Kjo është themelore, në qoftë se ne duam t'u ofrojmë qytetarëve tanë akses të barabartë në të dhënat dhe mundësinë që gjithsecili prej tyre të përfitojë nga baza e të dhënave.

Në qoftë se ka një çështje, për të cilën diskutohet sot dhe që duhet ta bëjmë pjesë edhe të diskutimeve tona, është pikërisht kjo, barazia në të dhëna, që, natyrisht, sjell si pasojë pastaj, në rast se cenohet, pabarazi në shumë drejtime të tjera dhe e bën pabarazinë, që ne kemi sot në aksesin sa i takon ekonomisë, edhe më të qenësishme, edhe më dëmbërëse në këtë aspekt.

Imagjinoni: ju thatë se kemi 1720 shërbime sot që i ofrojmë *online* dhe, natyrisht, aksesin në të dhënat që lidhen me këto shërbime bëhet jetik, në qoftë se ne duam të kemi barazi midis njerëzve.

E dyta që kam si shqetësim lidhet me atë që ju e përmendët, por që unë shikoj se jemi ende mbrapa, me digjitalizimin e *back office*. Ne mund t'i bëjmë të gjitha shërbimet *online* në raport me qytetarin. Mund t'i kemi ofruar mundësi qytetarit, siç edhe po ndodh sot, që të aksesojë shërbimet *online* përmes e-shërbimeve. Por në qoftë se nuk funksionon nga pikëpamja digjitale *back office*-i, gjithmonë e më tepër do të kemi vështirësi për të marrë maksimumin e mundshëm nga i gjithë ky proces që po zhvillojmë, nga procesi i e-shërbimeve.

Mjafton t'ju sjell shembuj që janë sinjifikativë.

Sot që flasim, po ju marr atë që është problemi më i madh i qytetarëve dhe do të ndalem edhe më pas, pjesa dërrmuese e Kadastrës funksionon në *back office* manualisht. Dhe është një shqetësim shumë i madh, sepse ne kemi vendosur edhe afate për dhënien e shërbimit dhe qytetari është gjithmonë e më tepër i bezdisur sa kohë që di edhe afatin pas ditës së tij të aplikimit *online* dhe nuk e merr këtë shërbim.

Po siç është ky shërbim, janë edhe shërbime të tjera. Mjafton t'ju them që sot pensionisti, po, patjetër, e ka mundësinë të aplikojë *online* për të marrë apo për të lidhur pensionin e tij, por i gjithë *back office*-i i pensioneve i merr shpirtin një njeriu që mund të ketë edhe dy vjet, edhe tre vjet pa marrë ende lidhjen e pensionit të tij.

Imagjinoni, ka mbushur moshën e daljes në pension para dy vjetësh dhe sot, pas dy vjetësh, përsëri ai nuk ka një lidhje pensioni. Pse? Sepse *back office*-i funksionon manualisht dhe funksionon manualisht aq keq, edhe për shkak të asaj që ka qenë para viteve '90, saqë nuk gjen dot vitet e punës. I duhet të shkojë nëpër procese gjyqësore me dëshmitarë, me të cilët ka punuar e të tjera me radhë, dhe i merr vite të tëra për të lidhur pensionin e tij. Mund t'i ndodhë diçka e papritur, se në atë moshë vuajnë edhe nga sëmundje kronike dhe nuk ka marrë qoftë edhe një pagesë të vetme pensioni.

Kështu që, ka shumë rëndësi që *back office*-i të hyjë në procesin e digjitalizimit sa më shpejt të jetë e mundur, qoftë edhe të automatizimit, pra edhe në këtë segment të shërbimit, me qëllim që njerëzit të marrin shërbimet e duhura.

Problemi i tretë që kam, unë e ngrita edhe në komision dhe, natyrisht, këtë duhet ta shohim, kur fola për barazinë e aksesit, lidhet edhe me infrastrukturën bazë, që është infrastruktura e internetit. Sot zonat rurale në pjesën më të madhe të tyre nuk mbulohen me internet. Po lë mënjanë faktin se atje ka një pjesë të madhe të popullsisë që nuk është e mësuar me internetin, me mënyrën se si përdoret, me mënyrën se si vihet në shërbim të çdo qytetari atje, por patjetër që ne duhet të ndikojmë fort.

Infrastruktura bazike në këtë sektor ka shkuar te privati, është liberalizuar, dhe natyrisht ata janë të lidhur me interesin e tyre, sa para fitojnë, në qoftë se do të investojnë edhe atje. Ama, ne duhet të kemi të paktën një masë bazike, me qëllim që ky shërbim të ofrohet edhe atje, që këto investime të shtrihen edhe në fshat. Dhe nuk po flas për shërbime të standardet që po bëhen sot. Ngulin shtylla dhe i kalojnë rrjetet e tyre atje sipër.

Nuk mundet që fshati të jetë ndryshe nga qyteti. Në qoftë se këtu po shkojmë te fibra optike, kjo e fundit duhet të mbërrijë edhe atje. Prandaj flas për barazi. Se në qoftë se ata njerëz atje në një pjesë të madhe nuk e kanë, në një pjesë e kanë me një standard që ka qenë në qytet para 10 vjetësh dhe nuk shkon tek ajo që është themelore e që është zhvillim sot, që është fibra optike, atëherë çfarë? Çfarë?

Sa kohë do të mungojë kjo, do të lulëzojë tregu i ndërmjetësve.

Për të gjitha shërbimet *online* janë krijuar zyra ndërmjetësish, të cilët e ofrojnë aksesin në e-shërbime përmes pagesës. Deri dje ishin fotokopjet që e bënin këtë gjë. Duhej të shkoje atje matanë për të bërë një fotokopje dokumentesh për t'i paraqitur atje. Ka ikur kjo histori. Tani, kanë një kompjuter përpara dhe ofrojnë shërbimin në akses. Atje ndodh kështu. Po jua them unë: kam ndjekur me shumë vëmendje aplikimet e bujqve, veçanërisht për naftën. Në zyrat e bujqësisë ka pasur radhë, radhë, radhë pa fund, sepse janë njerëz që nuk e kanë këtë akses, nuk e kanë këtë mundësi atje në fshat dhe detyrohen të shkojnë nëpër Zyrat e Bujqësisë, ku bëhet falas edhe aplikimi.

Pra, infrastruktura, një, dhe eliminimi i këtyre ndërmjetësve do t'u japë mundësinë njerëzve që t'i marrin këto shërbime ashtu siç ne po i ofrojmë. Teknologjia ul edhe kostot dhe, sa kohë teknologjia i ka çuar kostot në fund, këta mund t'i marrin këto shërbime me zero lek, me zero pagesë.

E fundit që kam, është Kadastra.

Patjetër që numrat aty janë. Mund të jetë bërë mirë në procesin e legalizimit dhe nuk e mohon kurrkush, sepse janë legalizuar mijëra banesa. Ama, jemi shumë mbrapa te këto, tek toka bujqësore që ka frenuar totalisht të gjitha zhvillimet sa i takon kapitalit në fshat.

Sot që flasim, fshati mbahet me investime të vetat, të vetë bujqve, me paratë që grumbullojnë nga aktiviteti i tyre...

(*Bie gongu.*)

...apo në krahun tjetër, me paratë e emigrimit.

Sot kapital privat, injektim, veçanërisht të investimeve të huaja në fshat nuk ka, dhe thelbi është një copë letër, certifikata e pronësisë. Sa kohë që ne kemi një problem shumë të madh në këtë shërbim, patjetër që numrat ato do të jenë, një shifër minimale me të cilën ne sot kemi trajtuar bujqit.

(*Bie gongu.*)

Ama, kjo shifër minimale në një dokument pronësie ka frenuar totalisht të gjitha zhvillimet e tjera ekonomike sa i takon investimit. Madje, edhe këtë që ne duam të bëjmë sot. Në qoftë se sot në fshat bujqësia po zhvillohet në tokat me qira, nuk ka një akt noterial që të shoqërojë një kontratë qiraje. Pse? Sepse nuk ka një dokument pronësie. Ka vetëm një AMTP dhe kaq.

Po ju them edhe një gjë: duhet të nxitojmë të ky proces.

Sot ata që kanë emrin në një akt të marrjes së tokës në përdorim apo në pronësi në fshat, janë në moshën 70, 75, 80 vjeç dhe që ta kalojnë te fëmijët e tyre, duhet të nxitojmë ne, sepse në atë moshë, për shkak edhe të sëmundjeve kronike, pjesa më e madhe po krijon një problem shumë të madh, që nuk po trashëgon tokën tek trangu familjar. Ky është një hall akoma edhe më i madh. Fëmijët janë në emigrim.

Ata që duan ta marrin me qira atë tokë që ngelet djerrë, sepse ata bujq, që janë nga 70-75 vjeç, 80 vjeç, nuk e punojnë dot më atë tokë, nuk e marrin dot, sepse duhet miratimi i çdo fëmije që e ka emrin në aktin e marrjes së tokës në përdorim apo në pronësi. Dhe ky është një problem shumë i madh.

Unë e bëra propozimin në Komisionin e Ekonomisë dhe mendoj se, përtej faktit, reformës që duhet bërë me patjetër në zyrat e Kadastrës, duhet bërë edhe një gjë më shumë: tokat bujqësore, të ndara sipas ligjit nr. 7501, e për të cilat nuk ka konflikt pronësor as me kufitarët, as fshati me fshatin, por as bujku me bujkun, të certifikohen njëherë e mirë. Nuk kanë pse të presin në radha apo nuk kanë pse të presin as aplikimet *online*...

Lindita Nikolla – Përfundoni, ju lutem.

Erion Braçe – ...por të certifikohet dhe t'i hapë rrugë pikërisht kësaj gjëje, certifikimit të tokës bujqësore dhe hapjes së të gjitha zhvillimeve të tjera ekonomike në fshat.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Faleminderit!

Fjala për zotin Kreshnik Çollaku. Nuk është.

Viojmë me zotin Toni Gogu.

Të përgatitet zonja Ina Zhupa.

Toni Gogu – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa i hequr asnjë presje fjalës së kolegut Braçe, i cili bëri një skaner të zhvillimeve teknologjike, por edhe në mbështetje të ministres Ekonomike, dua të them se sot, vetëm një javë më pas, ne kemi përpara një akt tjetër jashtëzakonisht të rëndësishëm për qeverisjen elektronike në vendin tonë. Ky akt mundëson vazhdimësinë e rrugës që kjo qeveri ka nisur për të revolucionarizuar shërbimet publike, të cilat, e ritheksoj, janë fytyra e një qeverisjeje. Pa diskutim, këto shërbime sot janë më moderne, më

të shpejta, më të lira dhe në shërbim të plotë të qytetarëve. Natyrisht, t'u shërbesh 2,8 milionë përdoruesve, që janë sot në sistem apo 220 mijë bizneseve, nuk është e lehtë, ndaj dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim i ka dhënë një vulë aprovimi të gjithë udhëtimit që ka bërë qeveria shqiptare në revolucionarizimin e shërbimeve publike.

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë, që na ndiqni,

Kredia që ne do të miratojmë sot për investimin më strategjik që ne bëjmë në shërbimet publike, në fakt, tregon qartë se udhëtimi i Shqipërisë në këtë revolucion teknologjik ka qëllime të qarta dhe ndjesi të thella të pasjes së këtyre qëllimeve. Pra, ne jemi të qartë dhe e dimë shumë mirë se ku po shkojmë. Nga ana tjetër, ashtu siç e diskutoi gjatë kolegu Braçe, jemi të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për përkushtimin ndaj drejtësisë që duhet të ketë ky revolucion teknologjik, që askush të mos lihet pas. Pra, barazia e të dhënave është një nga shtyllat kryesore të qëllimeve të qeverisjes tonë.

Sidoqoftë, për sfidat që u përmendën me detaje, po them për rastet konkrete që përmendi kolegu Braçe, qoftë në shërbimet që u ofrohen fermerëve, qoftë në shërbimet që u ofrohen qytetarëve, që banojnë në zonat rurale, qoftë edhe në shërbimet që ofrohen në mes të qytetit, për sa i përket të drejtës kryesore, të drejtës së pronësisë, ne jemi të vetëdijshëm që duhet të gjejmë ekuilibrin. Ky është një ekuilibër delikat ndaj mbirregullimit të fushës së teknologjisë, por edhe të mirëqenies së njerëzve që u shërbejmë. Për ta bërë këtë punë, absolutisht që na duhet urtësi për të drejtpeshuar, nga njëra anë rregullimin, pra revolucionin teknologjik, shërbimet, modernizimet e tyre, digjitalizimi i këtyre shërbimeve duhet të kenë rregullimin e duhur, siç bëmë javën e kaluar me ligjin për qeverisjen elektronike, por, nga ana tjetër, duhet të ketë hapësirë për eksperimentimin, siç tregoi ministrja me detaje, si dhe për eksplorimin e teknologjive të reja.

Kolegu Braçe bëri thirrje për të parë se si inteligjenca artificiale tashmë është vendosur në shërbim të qytetarëve. Kështu pra, ne duhet të lëmë hapësirë për të eksperimentuar dhe për të eksploruar me të. Të gjithë aktorët privatë, që janë kyç në përshtetimin e këtij udhëtimi, duhet të kenë hapësirë të duhur. Kjo gjë, të nderuar kolegë (sepse dëgjova edhe diskutimin mëparshëm),

bëhet patjetër duke prokuruar shërbime. Po nuk prokurove shërbime, nuk mund të investosh në teknologji. Kjo gjë nuk bëhet vetëm duke shpërndarë paga, dhe të mos bëjmë asnjë prokurim, sepse prokurimet patjetër që bëjnë korrupsion. Jo, prokurimet e drejta, prokurimet transparente, prokurimet e bëra sipas ligjit të prokurimeve, patjetër që mundësojnë që udhëtimi ynë të bëhet edhe më i shpejtë. Ndaj, i bindur tërësisht që qeveria nuk është vetëm një kujdestare e rregullimit, por në këtë moment që ne flasim, është edhe një arkitekthe e mundësive për të gjithë *start-up*-et e reja të teknologjisë së informacionit, unë besoj se ne jemi në rrugën e duhur, patjetër edhe në zgjidhjen e të gjitha atyre problematikave që kolegu Braçe i përshkroi me detaje.

Kolegë, ky udhëtim nuk bëhet vetëm, unë jam i bindur si shumica prej jush për këtë, por jam edhe i lumtur që sot ne kemi marrë një pëlqim nga një prej aktorëve më të mëdhenj të kreditimit të zhvillimit, që është Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, pra Banka Botërore. Nga ana tjetër, ne duhet të biem të gjithë dakord që ky udhëtim bëhet bashkë. Nuk mund të ndahemi në përdorimin e teknologjisë. Jo, ne duhet të jemi bashkë, që ta mbështesim këtë udhëtim dhe që ta fuqizojmë me të dhëna. Sa më shumë të dhëna që ne grumbullojmë, aq më mirë është për këtë udhëtim që ne bëjmë, por, nga ana tjetër, na duhet të përdorim edhe ato prova, të cilat kolegët i përshkuan këtu me detaje. Pra, në momentin kur ne shikojmë se si teknologji të caktuara funksionojnë, atëherë le t'i përdorim edhe më mirë. Ndërsa, për ato teknologji, që tashmë kanë treguar qartë se nuk funksionojnë, nuk është nevoja më që të vazhdojmë të shpenzojmë.

Kështu që, pa humbur kohë, duke ju bërë thirrje që ta miratojmë të gjithë së bashku këtë marrëveshje, për shkak se mbështesim një nga programet më të rëndësishme në përfundimin e modernizimit të shërbimeve publike, ju ftoj që të votojmë atë!

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Faleminderit!

Fjala për zonjën Ina Zhupa.

Të përgatitet zonja Antoneta Dhima.

Ina Zhupa – Faleminderit, kryetare!

Përpara se t'i kushtoj një vëmendje të veçantë digjitalizimit dhe shërbimeve publike *online*, dua pak minuta vëmendjen tuaj për një

çështje që lidhet me studentët shqiptarët, që lidhet me arsimin, që lidhet me të drejtën për të lëvizur dhe me të drejtën për t'u arsimuar. Si anëtare e Komisionit të Edukimit i kam kërkuar shpjegime edhe ministres Evis Kushi, por me sa shoh ky është një projekt i përbashkët edhe me ministrin e Shëndetësisë, për t'u hequr të drejtën e lëvizjes dhe të drejtën e profesionit studentëve të mjekësisë, ku dhe si e dëshirojnë ata. Ky është një plan antilogjik, antikushtetues dhe nuk ka të bëjë fare me politika, që gjoja merren në suaza patriotike, sepse nuk është aspak patriotike të vjedhësh; nuk është aspak patriotike të mos e bësh buxhetin e arsimit 5% të GDP-së, siç e ke premtuar; nuk është aspak patriotike të mos mbash asnjë nga pikat e paktit të universitetit, për t'u krijuar kushte dhe standarde studentëve; nuk është aspak patriotike varfëria e pagave; nuk është aspak patriotike varfëria dhe skandaloziteti i kushteve me të cilat duhet të studiojnë dhe duhet të punojnë më pas dhe nuk është aspak patriotik niveli i jetesës dhe pamundësia që kanë për karrierë këta mjekë që formohen në Shqipëri.

Është e paimagjinueshme se si në vitin 2023 një qeveri demokratike pretendon se bën politikë patriotike duke u pamundësuar studentëve që me mundin e tyre, me djersën e tyre kanë arritur të marrin një diplomë, të mos e ushtrojnë të drejtën e tyre të lëvizjes, të mos e ushtrojnë profesionin e tyre atje ku duan dhe si duan, për shkak se kjo quhet "politikë patriotike". Meqenëse neve po na ikin shqiptarët, me këtë logjikë, i bie që ne të mbyllim kufijtë dhe të shkojmë drejt një qeverie komuniste. Pra, të mbyllim kufijtë, që të mos na ikin shqiptarët, të mos na ikin noterët, të mos na ikin policët, të mos na ikin njerëzit e nderuar të këtij vendi, ashtu siç na ikin edhe mjekët. Por besoj se e dini, që nuk është as politika ligjore, as kushtetuese dhe as morale, por është politika shtetërore ajo që duhet t'i nxisë të qëndrojnë këtu, është ulja e nivelit të korrupsionit, ku ato 120 milionë eurot, që vidhen nga prokurimet publike, mund të shkojnë në investime për mjekët, për pagat e tyre, për dinjitetin tyre, meqenëse bëhet fjalë për Universitetin e Mjekësisë. Është e paimagjinueshme se si vendoset një pagesë në shifra europiane prej 5200 eurosh ose përndryshe studentëve u mbahet diploma, kur këtu s'ke asgjë europiane. Nuk ka asnjë arsye pse studenti duhet të paguajë një tarifë, e cila nuk u përshtatet kushteve, me anë të të cilave merr mësimdhënien.

Në qoftë se ka edhe një hapësirë ku mund të shtrihen shërbimet digjitale, ku mund të shtrihet digjitalizimi në të gjitha format, është pikërisht sistemi arsimor. Kjo është një arsye më shumë pse ne e mbështesim digjitalizimin.

Detyrimi që ju mendoni t'u bëni studentëve të mjekësisë, jua them me bindje të plotë, jo vetëm që tregon mungesën totale të një vizioni qeverisjeje, por tregon edhe mentalitetin me të cilin ju qeverisni, i cili është tërësisht si i pararendësve tuaj, si i partisë mëmë nga e cila keni ndryshuar vetëm emrin, por jo metodat.

Ndërkohë, mjafton t'ju kujtoj Kosovën që mbulon shumicën e shpenzimeve universitare. Kosova ofron mensë. Kosova ofron konvikt me vetëm 35 euro në muaj. Kosova u jep bursa dhe bonuse me 100 euro studentëve, ndërkohë, e vetmja politikë që ju doni të ndiqni, është politika e shtrëngimit, politika e moslejimit e lëvizjes së lirë, politika e tarifave të mbivendosura prej 5200 eurosh më shumë edhe se privati. Në qoftë se merak juaj është që t'i çoni ata të studiojnë në universitet private, po ia arrini shumë mirë. Në qoftë se keni merak të fuqizoni sektorin privat të ndonjë klienti, po ia arrini shumë mirë. Në qoftë se doni t'i hiqni, që të mos studiojnë këtu dhe të jenë më të gatsëm për të ikur nga Shqipëria që para studimeve universitare, po ia arrini shumë mirë. Hiqni dorë nga këto metoda! Kthejuni shërbimit të qytetarëve! Ka metoda të tjera me anë të të cilave ju mund t'i shtyni studentët, që të qëndrojnë me vullnet të lirë, që të punojnë me vullnet të lirë në Shqipëri në shërbim të profesionit të tyre.

Nga ana tjetër, ne sot diskutojmë për digjitalizimin, për shërbimet publike *online* dhe për marrjen përsëri të një huaje tjetër, të një borxhi tjetër, për të përmirësuar këto shërbime. Në fakt, fatkeqësisht, kur ne të gjithë jemi dakord se era e digjitalizimit, e ecjes përpara është moderne, të vetmet gjëra që kanë prodhuar realisht kanë qenë tenderat e majmë të AKSHI-t, me qëllim digjitalizimin, por, në fakt, me qëllim final ose destinacion final, pasurimin e atyre që i marrin këto tendera dhe klientëve të pushtetit. Platforma më e mirë e digjitalizimit të kësaj qeverisjeje dhe platforma më efikase *online* e kësaj qeverie, ka qenë platforma "Aktivisti". Në fakt, kjo platformë është një platformë shumë e mirë digjitale, në të cilën, në mënyrë *online* gjithsecili nga aktivistët mund të bëjë *share*, *like*, *comment* qeverinë. Nuk

e di nëse ekspertizën për këtë platformë e keni marrë nga AKSHI apo edhe paratë nga tenderat e qeverisë, por e rëndësishme është që kjo platformë është e vetmja gjë funksionale që ka bërë kjo qeverisje. Ndërkohë, në të gjitha dimensionet e tjera të digjitalizimit janë ato probleme që me të drejtë i tha, për herë të parë ndoshta, një anëtar i mazhorancës si zoti Braçe, duke filluar nga kadastra, plaga e shoqërisë shqiptare dhe duke vazhduar me radhë te bujqit dhe te pensionet, gjithçka që është e pamundur për shkak të zhvillimit të shoqërisë, për shkak të aksesit të dobët që kanë në internet, për shkak të njohurive të pakta që ka brezi i prindërve tanë për të aksesuar dhe për t'i kryer në mënyrë personale këto shërbime. Për këtë pamundësi janë krijuar ato zyrat e ndërmjetësimit, ato zyrat e tjera që ofrojnë shërbime private për të kryer shërbimet publike që, në fakt, bëjnë të kundërtën e asaj që duhet të ishte. Pra, në qoftë se digjitalizimin e shërbimeve e krijuam për të ulur kostot, për të mos paguar, për të mos mbajtur radhë, në fakt, këto kostot po paguhen, po paguhen te privati, po mbahet radhë për të kryer këto shërbime, pasi njerëzit e kanë të pamundur që këto shërbime t'i kryejnë në mënyrë individuale.

Ndërkohë, ne mund të fillojmë me aksesimin e internetit, me futjen e metodave të digjitalizimit pikërisht në sistemin arsimor. Ne mund të kërkojmë, do të doja të ishte edhe ministrja e Arsimit prezente, për shembull, për një nga problematikat më të mëdha që ne kemi janë provimet e maturës, kur 10 minuta mbasi shpërndahet teza, ajo është në rrjet, që ndoshta do të ishte më efikase që ne të fusim tableta "e-matura", që provimet të jepen *online* të digjitalizuara dhe kështu krijohet mundësia që studentët të marrim përgjigje në kohë rekord, apo edhe në universitet shqiptare. Pra, t'i fusim për atë brez që ka mundësi ta përthithë njohurinë teknologjike, ta përdorë teknologjinë dhe jo t'i fusim si shërbime për pensionistët, për një brez që mund ta kishte opsionale teknologjinë, pasi nuk ka as njohuritë e mjaftueshme dhe as aksesin e mjaftueshëm në internet, i cili sot, ju e dini shumë mirë që paguhet dhe paguhet dhe me tarifa të shtrenjta.

Do të vijë momenti këtu kur ne do të flasim edhe për raportin e AKEP-it, edhe për konkurrencën, në mënyrë të tillë që të kuptojmë tarifimet e internetit dhe tarifat e kompanive

celulare, të cilat e vështirësojnë dyfish aksesin në shërbimet publike *online*. Patjetër, ata e heqin atë që ne themi “pa kosto”, sepse qytetarët kanë një kosto nga marrja e këtyre shërbimeve nga autoritetet private, të cilat jo rrallëherë veprojnë si oligopole në Shqipëri.

Shumë faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Antoneta Dhima.

Të përgatitet zoti Bujar Leskaj.

Antoneta Dhima - E nderuar zonja kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji që po diskutojmë sot bën fjalë për një hua të Bankës Botërore në shumën 60 milionë euro, e cila synon përmirësimin e portalit “*e-Albania*” për më shumë shërbime publike dhe një aksesim më të thjeshtë dhe më të gjerë nga çdo qytetar, që meriton të shërbehet dhe të mbështetet.

Jam më se e bindur se shumëkush prej jush do të na e bëjë prezent në këtë foltore rastin e rëndë të sulmit kibernetik ndaj këtij portali, që solli dhe çoi në bllokimin e shumë shërbimeve, si dhe në rrjedhjen e të dhënave të qytetarëve, që ishte një rast i paprecedentë, një sulm i organizuar kibernetik, një sulm ndaj sistemeve tona të informacionit dhe njëkohësisht, një sulm ndaj shtetit shqiptar.

Por më lejoni, të nderuar kolegë, të kthejmë kokën pas, në kohën e sporteleve, në kohën e radhëve të gjata, të pritjeve të pafundme përpara banakëve, e në mos më keq, të dritareve me hekura të zyrave të gjendjeve civile, të kadastrave, të institucioneve ku njerëzit ishin të detyruar të kalonin orë të tëra për të marrë një dokument zyrtar, një certifikatë familjare apo personale, apo certifikatë martesore, një dëshmi penaliteti, një vërtetim çfarëdolloj, për të mos folur për aplikime të ndryshme, për të cilat dorëzoheshin dosje me dokumente dhe letra pa fund, vetëm letra dhe pritje të gjata dhe ndonjëherë edhe të stërzgjatura, herë në diell dhe herë në shi, në kushte jodinjitoze, ku rrallëherë gjeje ndonjë stol apo ndonjë karrige, ku mund të ulej një person i moshës së tretë. Sot, jo vetëm që nuk ekzistojnë më zyra shteti që u ngjajnë qelive, por besoj se të gjithë biem dakord se revolucionin digjital nuk ka qenë thjesht një utopi për vendin tonë, por ka qenë një proces i rëndësishëm, i cili përmirësohet dhe revolucionarizohet çdo ditë e më shumë.

Janë me qindra shërbimet që ofrohen përmes portalit “*e-Albania*”, ku kushdo nga ne ka “sirtarin” e vet të dokumenteve, të cilat mund t’i shkarkojë kurdoherë *online*, si dhe mund t’i ketë në postën e vet elektronike brenda një kohe fare të shkurtër, pa pasur nevojë të dalë fare nga shtëpia apo të humbasë kohën dhe orarin e punës. Sot 95% e shërbimeve publike ofrohen *online*. Ky revolucion ka ndryshuar edhe jetët tona, pasi vetëm me një klikim ne mund të shërbehem, por patjetër që të gjithë jemi të ndërgjegjshëm dhe biem dakord që ka nevojë edhe për një përmirësim të mëtejshëm të sistemeve dhe të shtimit të shërbimeve të ofruara.

Ndryshe nga shumë vende të tjera, Shqipëria ka hyrë më vonë në fushën e shërbimeve *online*, çka do të thotë se kërkohet më shumë kohë për fuqizimin e kësaj infrastrukture, për ta shtrirë atë në kohë dhe kudo, si dhe për ta bërë më të sigurt. Që prej vënies në funksion të këtij portali numri i shërbimeve të ofruara është rritur dita-ditës dhe të gjitha institucionet janë bërë pjesë e këtij revolucionin digjital, por, nga ana tjetër, janë hasur edhe problematika. Jo çdo shërbim ofrohet përmes këtij portali, jo gjithmonë përgjigja vjen në kohën e duhur, ku problem kryesor është aksesueshmëria e tij nga kushdo.

Brezi i tretë është ai që has probleme të mëdha në qasjen ndaj teknologjisë, ndërkohë që kemi edhe kategori në nevojë, që nuk mund ta aksesojnë teknologjinë. Jo kushdo e ka mundësinë e aksesit në kompjuter dhe në aparate celulare *smart*. Huaja që propozohet do të mundësojë përmirësimin e shërbimit të “*e-Albania*”, përmirësimin e infrastrukturave mbështetëse të tij, shtimin e funksionaliteteve të reja për qytetarët dhe bizneset, por edhe rritjen e aftësive bazë dhe atyre të avancuara digjitale për popullatën. Programi, i cili mbështet agjendën digjitale 2022-2026 të Shqipërisë, është në përputhje me strategjinë ndërsektorale “Agjenda digjitale e Shqipërisë 2022–2026” dhe projektet që do të implementohen nëpërmjet këtij programi janë pjesë e listës kombëtare të projekteve strategjike. Është shumë e rëndësishme të theksohet se ky program është në përputhje me agjendën 2030 “Për zhvillimin e qëndrueshëm”, si pjesë e një prej 17 objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 2015 dhe se do t’ua lehtësojë jetën qytetarëve dhe jo t’ua vështirësojë atë, çka do të

thotë se të gjitha ndërhyrjet për riorganizimin e portalit do ta bëjnë atë lehtësisht të aksesueshëm, më efikas dhe më të shpejtë.

Është e mirëpritur dhe e domosdoshme rritja e aftësive dhe e gjithëpërfshirjes digjitale, çka kërkon ngritjen e laboratorëve të edukimit informatik në sistemin arsimor. Është parashikuar që këta laboratorë të ngrihen në 200 shkolla të vendit, ku do të marrin pjesë 200 drejtorë shkollash dhe 600 mësues të trajnuar, si dhe qendrat rinore TIK në dhjetë qytete të vendit, ku do të bëhet transformimi i dhjetë qendrave të integruara ADISA në qendra rinore kreative. Nga ana tjetër, nëpërmjet modernizimit të strukturës së shërbimeve për klientin do të lehtësohet aksesimi në shërbimet digjitale, përfshirë këtu edhe grupet në nevojë të synuara, duke çuar në përmirësimin e njohurive digjitale të popullatës së përgjithshme dhe të të rinjve.

Është e vërtetë se kategoria që shfaq më shumë problematika në aksesimin e shërbimeve *online* është mosha e tretë, por hapja e këtyre laboratorëve do të krijojë një zinxhir të shëndoshë, pasi, nga njëra anë, krijojmë një brez të aftë për të nesërmen dhe, nga ana tjetër, rrisim nivelin e asistencës dhe numrin e atyre që mund të ofrojnë ndihmë.

Në cilësinë e relatores e kam shqyrtuar me vëmendje projektligjin dhe më vjen mirë që është parashikuar ngritja e një kanali të integruar të asistencës ndaj qytetarit, që përfshin një asistent virtual me zë për shërbimet elektronike, dhe e sistemit elektronik të dedikuar të asistencës ndaj qytetarit për menaxhimin dhe ndjekjen e problematikave deri në zgjidhjen e tyre.

Të nderuar kolegë,

Projektligji që po diskutojmë sot është një hap i domosdoshëm për ngritjen e standardeve të shërbimeve publike të domosdoshme *online* në të gjithë Shqipërinë, sipas kërkesave dhe standardeve të Bashkimit Europian, për rritjen e sigurisë së të dhënave personale, por edhe për rritjen e transparencës përmes përmirësimit të portalit kombëtar të të dhënave të hapura, për monitorimin më të mirë të shërbimit ndaj qytetarëve, për ndërveprimin mes institucioneve, që do të na çojnë shumë shpejt drejt një qeverisjeje pa letra, që është projekt i qeverisë shqiptare dhe i Kryeministrit Rama.

Të nderuar kolegë,

Duke vlerësuar rëndësinë e këtij projektligji si një mundësi që vjen në të mirë të qytetarëve, të cilët na kanë besuar dhe votuar për një shërbim sa më të mirë dhe të barabartë për të gjithë, ju kërkoj ta miratojmë së bashku këtë projektligji!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Bujar Leskaj.

Bujar Leskaj - Faleminderit, zonja Kryetare!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BERZH-it për “Përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit *Govtech*”, i cili do të zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Shkëmbimit të Informacionit, AKSHI, përmes një kredie të butë nga BERZH-i prej 60 milionë eurosh, pavarësisht qëllimit të mirë për përmirësimin e portalit “*e-Albania*” dhe infrastrukturave mbështetëse të tij, si dhe investimit në rritjen e aftësive bazë dhe atyre të avancuara digjitale për popullatën, pavarësisht shpjegimeve profesionale dhe korrekte që bëri ministria, zonja Milva Ekonomi, përmban mangësi dhe paqartësi të konsiderueshme në masat dhe veprimet e veta.

AKSHI angazhohet në lumë tenderësh të pakoordinuar mirë për përmirësimin e mirëmbajtjes së portalit “*e-Albania*” dhe rritjen e elementeve të sigurisë. Vetëm në muajt prill dhe maj 2023, AKSHI kishte të paktën 4-5 tendera të hapur për mirëmbajtjen e veprimtarisë së saj lidhur me dokumentet elektronike dhe rinovimin e kontratave për elemente të sigurisë. Për realizimin e këtyre tenderave po shpenzohen miliarda lekë të taksapaguesve shqiptarë, që harrohet nga deputetët e mazhorancës, me kritere jo të qarta dhe të papublikuara tërësisht për qytetarin. Siç e thashë edhe në Komisionin e Ekonomisë, për mendimin tim këto fonde po shpenzohen nga AKSHI jo me efektivitetin, eficiencën dhe ekonomicitetin e duhur, sepse sistemi ynë i sigurisë vazhdon të jetë i dobët dhe i penetrueshëm lehtësisht dhe masivisht, pra, i dëmtueshëm në shkallë të gjerë dhe në çdo kohë. AKSHI kishte informacione të mjaftueshme për rrezikun që i kanosej mbrojtjes kibernetike të sistemeve qeveritare *online* 6 vjet më parë, sepse në një raport të tij në vitin 2017 deklaronte se portali “*e-Albania*” ishte sulmuar jo pak, por 2,57 milionë herë nga hakerat.

Pse në këta 5 vjet Agjencia nuk ishte aktive? Pse kjo Agjenci fjeti gjumë ndërkohë që prej 5 vjetësh ishte në djepi të këtij shqetësimi? Pse nuk i mori masat urgjente dhe të plota në këta 5 vjet për të mos arritur në cenimin e rëndë të sigurisë kibernetike me sulmet e korrikut dhe shtatorit 2022? Është mungesë profesionalizmi, mungesë përqendrimi e vëmendjes në sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve shqiptarë apo indiferentizëm ekstrem i politikës qeveritare në këtë drejtim? Cilat janë arsyet, apo të gjitha bashkë? Ende sot qytetarët shqiptarë nuk kanë marrë përgjigje për këto pyetje? Sa garanci jep AKSHI sot që sistemi i shërbimeve qeveritare *online*, në të cilin realizohen 95% e miliona shërbimeve ndaj qytetarëve, nuk është dhe nuk do të jetë më i dobët, i thyeshëm dhe i dëmtueshëm në çdo kohë? Gjykoj se sot është i domosdoshëm një rikonceptim tërësor i sistemit të shërbimeve qeveritare *online* për qytetarin, me prioritet absolut sigurinë kibernetike dhe transparencën e plotë për qytetarin dhe jo shtrirjen e përshpejtuar artificialisht të shërbimeve të pasigurta dhe me rrezik të lartë mbivendosjeje, të tipit operacioni “*Govtech*”, siç po ndodh me këtë program.

Gjithashtu, kemi një risk të lartë të mbivendosjes në masat dhe ndërhyrjet e këtij operacioni. Një pjesë e rëndësishme e programit të financuar nga kredia e BERZH-it është investimi për rritjen e aftësive bazë dhe të avancuara digjitale për 200 laboratorë të zgjuar në shkollat e vendit. Ky program ka qenë edhe pjesë e programit buxhetor të Ministrisë së Arsimit për vitin 2023. Relacioni shpjegues i programit që po diskutojmë nuk e përmend programin përkatës të Ministrisë së Arsimit dhe nuk i jep përgjigje pyetjes: si do të ndërthuren të dyja programet dhe a kemi mbivendosje mes tyre? A ka kryer AKSHI një analizë të kostos dhe përfitimit, duke pasur parasysh edhe riskun që kanë shërbime të tilla? Sërish nuk përmendet asgjë në dokumentet e programit.

Një problem tjetër është mungesa problematike e manualit operacional në dokumentet e prezantuara të operacionit “*Govtech*”. Në tekstin e marrëveshjes së huas, në skedulën nr. 2, germa c, faqja nr. 8, manuali operacional, edhe pse i parashikuar në tekstin e marrëveshjes, ky material nuk është i disponueshëm në dosjen e të gjitha materialeve që aksesohen në faqen tonë të Kuvendit për

projektligjin në fjalë, gjë e cila e bën jo të plotë analizën e efektshmërisë së këtij projektligji nisur nga objektivat e parashtruara.

Për më tepër, sipas pikës 3 të këtij seksioni, në marrëveshjen e huas theksohet se pavarësisht nga sa më sipër, nëse ndonjë dispozitë e manualit operacional nuk pajtohet me dispozitat e kësaj marrëveshjeje, dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të kenë përparësi.

Të njëjtën gjë mund të themi edhe për theksimin e veprimtarive të përjashtuara në skedulën nr. 2 të seksionit nr. 2, të cilat unë i përmenda edhe në Komisionin e Ekonomisë, por që për efekt kohe nuk po vazhdoj me shpjegime. Në rast se do të kem kohë në dispozicion, do ta bëj.

Nisur nga rezultati i pikës 2, rritja e aftësive dhe gjithëpërfshirjes digjitale, pretendohet se do të mundësohet krijimi i *smartlab*-eve për 200 shkolla, nga ku do të realizohet edhe trajnimi i 200 drejtorëve dhe 600 mësuesve. Si do të përfitojnë një numër i konsiderueshëm i patargetuar fëmijësh të shkollave të sistemit parauniversitar? Kjo nënkupton krijimin e laboratorëve të IT-së nëpër shkollat vendit apo krijimin e laboratorëve të kodimit, që është një domosdoshmëri për kohën që po kalojmë?

E katërta, huadhënësi ndërkombëtar, në fakt, shfaq një mungesë të theksuar besimi ndaj huamarrësit, ndaj qeverisë shqiptare, AKSHI-t, dhe mbron veten duke theksuar në seksionin 2 të skedulit 2, se kërkon të sigurohet që programi do të përjashtojë çdo veprimtari që për mendimin e bankës mund të ketë ndikime negative të konsiderueshme, të cilat janë sensitive, të shumëllojshme ose të paprecendta për mjedisin ose personat e prekur, si: prokurime me vlerë 115 milionë dollarë, mallra me vlerë 75 milionë dollarë, shërbime jokëshillimi me vlerë 75 milionë dollarë ose shërbime këshillimi me vlerë 30 milionë dollarë.

Pra, me këto përjashtime me vlerë totale 295 milionë dollarë, që huadhënësi i vendos si kritere, i kërkon BERZH-it të sigurohet për një kredi në vlerën 60 milionë dollarë. Unë mendoj se mangësitë dhe paqartësitë e kësaj huaje dhe këtij programi janë shumë herë më të mëdha se këto që unë përmenda më sipër.

E nderuar zonja Kryetare,

Në fund të fjalës sime dua t’ju tërheq vëmendjen edhe si mazhorancë për faktin se vitet

e fundit ne kemi marrë borxhe në formën e kredive të buta në nivele disa dhjetëra milionë euro, të cilat e kanë rritur borxhin publik të vendit. Vetëm huat e buta të marra në 3 vjet, 2021-2023, për sektorin energjetik shkojnë në vlerën 375 milionë euro. Vetëm gjatë muajit prill 2023 kemi miratuar në Kuvend dy kredi të buta: një me vlerë 20 milionë euro nga KfW-ja për projektin “Zhvillimi i integruar rajonal” dhe një me vlerë 35 milionë euro nga qeveria italiane për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Njëloj si qindra milionat e viteve të fundit, edhe këta 8 milionë euro të BERZH-it janë detyrime financiare të shtrira nga sot apo pas 4 vjetësh në 17 vjet të tjera, të cilat do t'i paguajnë fëmijët tanë nga taksat e tyre, nuk janë dhuratë, rrjedhojë e kursimeve apo e politikave të drejta qeveritare që ka ndjekur apo po ndjek kjo qeveri. Ne si parlamentarë, pavarësisht kaheve politike, opozitë apo pozitë, duhet të tregohemi shumë të kujdesshëm kur miratojmë këto detyrime financiare, qoftë edhe në formën e huave të buta, të lidhura pazgjydhshëmrisht dhe të harmonizuara si duhet me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit për sot dhe për vitet në vijim. Për mendimin tim edhe kjo hua nuk është e qartë dhe do t'i rëndojë fëmijët tanë dhe taksapaguesit shqiptarë në 17 vjetet e ardhshme.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Fjala për zotin Xhelal Mziu. Të përgatitet zoti Sali Berisha!

Xhelal Mziu – Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Është bërë e udhës që në çdo seancë plenare duhet të miratojmë një projektligj për marrjen e një kredie, që e thellon akoma më tej borxhin publik, për më tepër kur jemi në një periudhë që interesi bankar është dyfishuar krahasuar me 2 vjet më parë. Kjo do të thotë se do të rëndojë akoma më tej në xhepin e qytetarëve.

Qeverisja elektronike nisi 15 vjet më parë me Regjistrin Kombëtar Elektronik, me pasaportat dhe me kartat biometrike, të cilat ishin vërtet sukses, me prokurimet publike elektronike, për të vazhduar me platformën “e-Albania” apo akoma më tej në 10 vjetet e fundit, por progresi ka qenë shumë i vogël dhe i pajustificuar krahasuar me çfarë është investuar në këtë sektor, për të vazhduar akoma më tej me standardin më të fundit të operacionit “Govtech”, i cili nuk e justifikon

kredinë, përkundrazi, e ka bërë të pabesueshme “e-Albania”-n, madje, ka krijuar edhe kosto për qytetarët.

Në këta 8 vjet AKSHI ka marrë jo pak, por më shumë se 300 milionë euro. Në fakt, për sa i përket produktit të tij, mjafton të shikojmë se si një vit më parë u hakërua i gjithë sistemi elektronik në Shqipëri, duke e çorientuar të gjithë tregun elektronik, por edhe duke rritur pasigurinë e qytetarëve dhe të biznesmenëve. Në fakt, “e-Albania” është një strukturë politike, sepse bashkë me AKSHI-n janë kthyer në një hambar punësimesh, patronazhistë dhe aktivistët janë pararoja e këtyre institucioneve, dhe për pasojë produkti është shumë i vogël në raport me investimin në këto institucione.

Edhe pse janë dhënë miliona euro, vazhdojmë të kemi të dhënat e vitit 2019 të paazhurnuara. Kjo është vërtet absurde. Edhe pse më përpara janë dhënë miliona euro të tjera kredi, përsëri e pamë sa i pasigurt ishte sistemi *online* në Shqipëri. Pavarësisht se jepen 60 milionë euro kredi, në fakt, janë planifikuar 295 milionë dollarë që do të investohen për përmirësimin e standardeve, edhe pse nuk shikojmë një produkt konkret ku do të orientohen këto lloj investimesh që do të realizohen.

Në morinë e këtyre shpenzimeve shikojmë që një pjesë e konsiderueshme do të shkojë për riinxhinierizimin e portalit, një pjesë do të shkojë për ridizenjimin e portalit, një pjesë do të shkojë për integrimin e portalit, një pjesë do të shkojë për organizimin e portalit, por në asnjë vend nuk thuhet se cili do të jetë produkti që do të përfitohet. Madje, po ta shikosh, agjenda e disbursimit të kësaj kredie, bashkë me financimet e tjera që do të jepen me vlerë 295 milionë dollarë, do të ishte pjesë e implementimit për vitet 2022-2026. Në fakt, viti 2022 ka kaluar dhe nuk janë planifikuar as për këtë vit, pra për vitin 2023. Kjo do të thotë që planet jo vetëm që nuk realizohen, por duhet kohë për të shkuar tek implementimi i tyre.

Produkti i 295 milionë dollarëve do të jetë krijimi i 200 laboratorëve, si dhe trajnimi i 200 drejtorëve dhe 600 mësuesve të shkollave. Është absurde se si mund të rritet akoma më tej hendeku në Shqipëri midis qyteteve të ndryshme dhe midis shkollave të ndryshme, sepse i gjithë ky projekt do të bëhet për 200 laboratorë dhe 10 zyra të ADISA-s. Kjo do të thotë se do të kemi një

diskriminim sa politik, aq edhe krahinor. Pra, pavarësisht shumë marramendëse që do të investohet, do të kemi një situatë të pabarabartë të produktit, që do të merret, dhe për pasojë do të kemi krijimin e hotspotëve, sidomos në zonat periferike dhe rurale, të cilat do ta kenë të pamundur marrjen e shërbimit. Edhe sot që flasim një pjesë e konsiderueshme e zonave rurale apo e ish-komunave e kanë të pamundur ta marrin shërbimin. Madje, informatizimi i tyre, gjoja në të gjithë Shqipërinë, e ka rritur koston, sepse një banor i Lurës, i Kalasë së Dodës, i Ostrenit, i komunave të tjera në zonat e thella apo kudo qofshin, jo vetëm që nuk e merr shërbimin elektronikisht për shkak të mungesës së infrastrukturës së internetit, por është i detyruar të ecë me orë të tëra në këmbë apo me makinë për të marrë një shërbim simbolik, që mund ta merrte manualisht edhe në njësinë e tij vendore.

Kjo kredi ka krijuar edhe mjaft probleme të tjera, sepse po ta shikosh, jo vetëm që nuk jep informacionin e detajuar se ku do të përdoren, por thuhet se, nga 295 milionë dollarë, 115 milionë dollarë do të përdoren për prokurime, por pa përmendur se çfarë do të prokurohet. Thuhet se do të blihen mallra me vlerë 75 milionë dollarë, por nuk thuhet konkretisht se çfarë mallrash do të blihen. Në projekt thuhet se do të ketë shërbime jokëshillimore, që kushtojnë jo pak, por sa 1/4 - ta e shumë, 75 milionë dollarë. Ky është një absurditet i jashtëzakonshëm. Për të vazhduar më tej, janë edhe 30 milionë dollarë që do të shpenzohen për shërbime. Kjo është një tjetër mënyrë abuzimi me qytetarët. Pra, do të jepen 300 milionë dollarë të tjera plus 300 milionë eurove të shpenzuara vite më parë, por, në fakt, produkti është pothuajse edhe më keq në një pjesë të konsiderueshme të zonave të vendit.

Si mund të konsiderohet një revolucion elektronik në Shqipëri, ndërkohë që për 8 apo 10 vjet është thënë që do të kemi informatizimin e kadastrës urbane, por ende sot, jo vetëm elektronikisht, por është e pamundur edhe manualisht që dikush të marrë një dokument te zyra e hipotekës apo zyra e legalizimeve?

Si mundet që një qytetari, qoftë edhe deputet, kur shkon në një universitet i kërkohet të paraqesë në mënyrë manuale vërtetimin e pagës, sepse institucioni universitar e ka të pamundur ta marrë në mënyrë elektronike? Edhe kur Ministria e Bujqësisë i jep ato pak litra karburant si

subvencion në rast zgjedhjesh, fermerët duhet t'i dorëzojnë vetë dokumentet, sepse institucionet e kanë të mundur t'i marrin nëpërmjet sistemit *online*.

Pra, kemi një situatë vërtet kaotike, e cila jo vetëm që nuk e justifikon këtë kredi, por ndërkohë krijon një disproporcion të jashtëzakonshëm edhe për shkak të financimit të njëanshëm që bëhet me 300 milionë dollarë për 200 laboratorë apo 10 qytete. Imagjinoni çfarë do të ndodhë me qytetet e tjera!

Thirrja ime është që as këto para të marra me kredi dhe as para të tjera të buxhetit të shtetit nuk mund të përdoren në mënyrë selektive, por duhet të shkojnë në drejtim të çdo qytetari. Ndërkohë, duhet të rritet transparencja dhe duhet që qeveria të heqë dorë nga monopolet e saj, qoftë te kadastra urbane, qoftë te hipotekat apo për mjaft shërbime të tjera, të cilat u mungojnë sot qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Fjala për zotin Sali Berisha!

Sali Berisha - Zonja dhe zotërinj deputetë, Zonja drejtuese e seancës dhe Kryetare e Kuvendit,

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Sot kam një lajm të hidhur për krahun këtej, i cili do të mërzhitet shumë, sepse sot, për herë të dytë në historinë e SHBA-ve, në një akt shumë të rrallë dhe historik Kryeministri i Indisë, Narendra Modi, një burrë shteti i sanksionuar pak vite më parë, i është drejtuar Kongresit të SHBA-ve me një fjalim të veçantë. Këtë shans e ka pasur tri herë me radhë gjeniu i politikës botërore, Winston Churchill, për së dyti kanë qenë të rrallë, të jashtëzakonshëm.

Nuk e solla këtë këtu për të bërë ndonjë paralelizëm mes Narendra Modit dhe Sali Berishës, ndonëse e vërteta është si diamanti, i cili, i madh ose i vogël, shkëlqen pandalshëm, dhe triumfon në çdo lloj rrethane, por e solla për të bërë një kërkesë ndaj guvernatores Yuri Kim, e cila po largohet nga Shqipëria. T'u kërkojë falje shqiptarëve, sepse, në mënyrë të përsëritur, u ka deklaruar atyre se ky vendim, sanksionimi, nuk hiqet kurrë. Ftesa ime nuk ka lidhje me ndonjë rivendikim timin, por ka lidhje thjesht për t'i thënë asaj, të nderuarës, të kthehet tek e vërteta para se të largohet nga Shqipëria.

Meqë jam në këtë temë, të më falni, por në prag të largimit nga Shqipëria, duhet t'i them zonjës guvernatore se në historinë e pluralizmit dhe lirisë së këtij kombi, emri i saj do të mbetet i gdhendur si i një personi që abuzoi me pushtetin e përfaqësimit të vendit të vet dhe që, së bashku me Edi Ramën, bëri gjithçka për të shkatërruar opozitën e vërtetë shqiptare. Natyrisht, e dëmtove, por dështove.

Nga ana tjetër, me qëndrimet tuaja dhe bashkërendimin me qeverinë e narkotrafikantëve të Edi Ramës, je e vetmja ambasadore në 32 vjet, që largohesh nga ky vend, e cilësuar gjerësisht si sekretare e Partisë Socialiste të Shqipërisë; jo nga unë.

Së treti, mendoj se në këto pak ditë apo orë që ju kanë mbetur, kërkoni ndjesë shqiptarëve për McGonigal-in, jo vetëm për sintoninë e veprimeve tuaja kundër opozitës shqiptare, por se në njërin nga skandalet më të mëdha të kohërave, nuk shqiptove, nuk u the atyre, një fjalë të vetme për këtë skandal, duke i shumëzuar kështu, në mënyrën më të pamerituar, me zero, si shoqëri dhe si komb.

Së fundi, si një admirues i palëkundur i vendit të madh të lirisë, SHBA-ve, më duhet të shpreh keqardhje të thellë se ju, të vetmin "sukses" që merrni me vete, është dëmtimi thelbësor me qëndrimet tuaja i reputacionit të shkëlqyer që ka pasur dhe përsëri do të ketë, kombi dhe vendi i madh i lirisë në Shqipëri.

Tani të kalojmë pak te raporti i zonjës "Erisa Fero", apo drejtoreshës reale të AKSH-it. Në qoftë se ka një gropë të zezë të vërtetë të korrupsionit në Shqipëri, është kjo zonjë dhe kjo agjenci.

Të dashur qytetare dhe qytetarë shqiptarë, në kundërshtim me ligjin, në kundërshtim flagrant me moralin, "Erisa Fero" (ka një emër tjetër, por ajo është ish-ndihmësja e saj trafikante, e dini vetë ju, u kap me 60 kilogram heroinë apo kanabis në makinë) ka bërë 942 transaksione sekrete të parave të shqiptarëve, në një kohë kur ligji asaj nuk i njeh asnjë të drejtë; 942 transaksione sekrete. Kjo është një njeri që vjedh në errësirë, çdo natë, çdo ditë, sikur i ka paratë e veta, dhe i ka ndarë këto para me Armando Frangun e Edi Ramës, i ka ndarë këto para me mafian rajonale të Edi Ramës, sikur t'i kishte të vetat.

Në një vend që nuk ka drejtësi dhe drejtësia komandohet nga një njeri, mund të bësh si të

duash, siç bën kjo zonja, por në çdo vend tjetër, kjo për këto do të ishte e dënuar me dhjetëra vite në burgjet e vendit.

Mirëpo këtu kemi një "SKAP" që i ka mbyllur sytë me shaminë e partisë. I dëgjoj shpeshherë gazetarët të më pyesin: pse nuk i çoni në "SPAK" ju këto? Po ju pyes unë ju, të dashur qytetarë, a janë të dhëna sekrete këto? Jo, jo, i lexojmë të gjitha në dokumentet zyrtare, por "SKAP"-i nuk ka sy për të lexuar, sepse ia kanë verbuar sytë e mendjes, pasi mjafton të ngarkojnë një sekretare të lexojë publikimet e Agjencisë Kombëtare të Prokurimeve Publike, mjafton të lexojë gazetën zyrtare dhe të procedojë. Po "SKAP"-i preferon shaminë me të cilën ka lidhur sytë dhe gjoja u shërben shqiptarëve. A ka gjë me qesharake, më të turpshme? 942 transaksione sekrete, me ligj nuk i takon asnjë i vetëm. Kujt? Kësaj zonjës që depoziton në selinë e PS-së të dhënat personale të 1 milion shqiptarëve, kësaj zonje që nxori në treg të gjitha targarat për bandat dhe kriminelët.

(Bie gongu)

Kaloi koha, ja një minutë dhe mbarova.

Kësaj zonje, e cila nga mëngjesi deri në darkë luan bixhoz, jo bixhoz, se nuk e di nëse luan me letra ajo, por pasurohet me paratë e qytetarëve shqiptarë dhe e ka shndërruar Shqipërinë, sistemin në një sistem kashte.

Ajatollahët ndërmorën një sulm, por sulmet më të egra i ndërmorët ju. Ju nxorët targarat, ju nxorët rrogat, ju nxorët të dhënat personale, ju dhe askush tjetër, nxorët targarat dhe të dhënat e punonjësve të SHISH-it, të Shërbimit Informativ.

Ku e ke vendin ti zonjë, që vjen këtu në parlament? Vend në parlament nuk mund të kesh normalisht ti, sepse ti do ta kesh vendin atje ku e meriton. Ndaj dhe, çfarë raporti paraqet këtu? Shko te Erisa më mirë, se je me Erisën. Edhe ti, në llojin tënd, je një Erisë Fero!

Kaq kisha.

Lindita Nikolla - Fjala për zotën Taulant Balla.

Taulant Balla - Je bërë si TikTok-u i Ilir Vrenozit për nga gjuha që përdor për përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri.

Dua t'i them të gjithë opinionit publik që ky është i vetmi që ka pasur pothuajse të njëjtën marrëdhënie konflikuale; ka sharë, ka fyer, ka denigruar pothuajse të gjitha ambasadorët

amerikanë që nga Mariza Lino, tek, i ndjeri, zoti Limprecht, te Xhejms Xhefri, pastaj te Marsi Ris, te Xhon Uidhërsi, Aleksandër Arvizu, Donald Lu-ja, dhe natyrshëm në fund dhe me zonjën e nderuar, Juri Kim.

Pra, në rast se një person ka konflikt me të gjithë ambasadorët amerikanë, po përjashtoj këtu zotin Rajerson, tregon se nuk janë gabim ambasadorët, gabimi është te ky. E meqë u rropat këtu të shohë si dritë në fund të tunelit, pritjen e dytë zyrtare të Kryeministrit Narendra Modi, dhe, në mos gaboj, them e dytë, sepse e para ka qenë diku nga viti 2014 apo 2015, ka një dallim të madh Sali, mes teje dhe Narendra Modit. Së pari, kur është shpallur zoti Modi, me një mekanizëm krejtësisht tjetër si ky i pas vitit 2017, “*non grata*” për të shkelur Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bëhej fjalë për disa protesta të dhunshme, ku mbetën të vdekur një numër i madh besimtarësh myslimanë, në një prej provincave të Indisë, dhe ku kishte një akuzë ndaj zotit Modi për nxitjen e atyre përplasjeve që çuan në humbje jetësh. Ndërkohë që ti je shpallur “*non grata*” nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për korrupsion të nivelit të lartë dhe minim të demokracisë. Pra, ka një dallim të madh këtu.

Në fakt, SHBA-të, pa dashur të bëj unë zëdhënësin e tyre këtu, pasi u hetua tërësisht zoti Modi për atë që kishte ndodhur në vitin e largët 2002, natyrshëm që kanë vendimmarrjet e tyre. Pra, shpresa jote, Sali, që ti do ta shkelësh ndonjëherë tokën amerikane, është zero. Ta kam thënë, të erdhën me radhë, në fillim Amerika, pastaj Britania e madhe, por ti kujdesu mos të të duhet vizë të shkosh deri në Gjirin e Lalëz, sepse, siç po shkojnë bathët, edhe në Gjirin e Lalëz do të të duhet të shkosh me vizë.

Pastaj kjo marrja e fjalës se gjoja ke një lajm të keq, është, në fakt, fundi më i keq që ti mund ta kishe imagjinuar ndonjëherë. Teksa pjesa më e madhe e kësaj sale sot janë ftuar për të festuar, së bashku me miqtë amerikanë, ditën e pavarësisë së SHBA-ve dhe ti je i përjashtuar nga prezenca, tregon shumë. E këtu pastaj le ta kalojmë diskutimin në një kontekst më rajonal, që ne shqiptarëve tashmë në 101-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike me SHBA-të, duhet të na ndriçojë sadopak dhe duhet ta themi sa herë kemi mundësi që, pa mbështetjen dhe kontributin e SHBA-ve, të Presidentit Uillson dhe me radhë, nuk do të ishim sot Shqipëria që ne njohim me

kufijtë e vet. Pa mbështetjen e SHBA-ve, të cilët na mundësuan që në vitin 1999 të marrë udhë zgjidhja e një padrejtësie të madhe historike dhe krijimi në vitin 2008 i shtetit të pavarur të Kosovës, me kontributin e pazëvendësueshëm, unik të SHBA-ve, ne nuk do të ishim sot dy shtete shqiptare, me shumicë shqiptare në rajonin tonë.

E vërteta është që (unë do të vazhdoj ta them sa herë të më jepet mundësia në këtë foltore, sikurse e thonë të gjithë përfaqësuesit e Partisë Socialiste) e kemi nisur këtë rrugë me SHBA-të dhe duhet ta kryejmë me ta në krah, me SHBA-të, me Britaninë e Madhe dhe NATO-n. Prandaj, kjo prirje e ndonjë politikani në këtë sallë, i cili është shpallur nga SHBA-të si person “*non grata*” dhe prirja e ndonjë politikani tjetër për të mos u renditur në të njëjtin krah me SHBA-të, nuk i bën mirë çështjeve tona kombëtare. Doni apo nuk doni ju, të gjitha çështjet tona kombëtare janë zgjidhur duke pasur në krah aleatin tonë të madh strategjik, SHBA-të. Pastaj, përdorimi i kësaj foltoreje, që nëse do të shkonim dhe të pyesnim qytetarët shqiptarë, në shumicë na kërkojnë dhe duhet ne të gjejmë një mekanizëm, që persona të cilët i kanë shpallur luftë SHBA-ve, si ky që sapo la sallën, mendoj se nuk i bëjnë nder Kuvendit të Shqipërisë dhe duhet të gjejmë një mekanizëm që këto lloje të mos zgjidhen më në Kuvendin e Shqipërisë. Kjo sallë nuk mund të mbajë brenda vetes një person si Sali Berisha, i cili është shpallur zyrtarisht nga dy vende aleate, SHBA-të dhe Britania e Madhe, “*non grata*” për korrupsion të nivelit të lartë dhe për minimin e demokracisë dhe shpresoj që përdorimi i kësaj foltoreje për të sulmuar Prokurorinë Speciale Antikorrupsion me fjalën “SKAP”, ndërsa ne ende besojmë që SPAK-u do të hetojë krimet për të cilat akuzohet...

Meqenëse e hapi me Modin, po e mbyll po me Kryeministrin indian. Zoti Modi u hetua për protestat në një prej provincave indiane në vitin 2002, ku mbetën të vdekur një numër i madh personash të besimit mysliman. Po Sali Berisha, pse nuk hetohet ende? Jo nga Prokuroria e Tiranës, sepse ne e kemi ndryshuar ligjin, të gjithë ne këtu në këtë sallë jemi subjekt të Prokurorisë së Posaçme. Sali Berisha duhet të hetohet për shpërdorim të detyrës me pasojë vdekjen e 4 qytetarëve shqiptarë dhe plagosjen e 26 të tjerëve. Meqenëse vepra penale e shpërdorimit të detyrës kërkon pasojë, unë mendoj se nuk ka pasojë më të rëndë se të vrasësh ditën për diell, mu në qendër

të Tiranës, mu para zyrës tënde, dhe më pas edhe të dalësh e të hakërrehesh nëpër studio televizive, muaj pas muaji dhe vit pas viti, se do të kishe qëlluar edhe kryetarin e opozitës.

Meqenëse zotëria në gjuhë popullore erdhi dhe provokoi vetë me një krahasim, unë mendoj se krahasimi duhet çuar deri në fund. Meqenëse Kryeministri Modi është hetuar për këtë ngjarje, le të hetohet dhe Saliu, le të vijë e të thotë këtu që është i gatshëm të hetohet. Por një gjë duhet ta dini, ky bën këtu si..., por nuk ka këllqe dhe fund shpine të shkojë dhe të përballet atje me prokurorët për t'u hetuar për të gjitha të zezat që i ka bërë këtij vendi në 32 vjet.

Faleminderit!

Lindita Nikolla - Fjala për zonjën Albana Vokshi, të përgatitet zoti Oerd Bylykbashi.

Albana Vokshi - Faleminderit!

Zoti Balla, i dhatë përsëri urdhër SPAK-ut që ta hetojë, por ka qaq vite që e kanë hetuar, stërhetuar atë dhe familjen, prapë e kanë hetuar dhe stërhetuar, dhe nuk ka pasur asnjë fakt.

Nuk folët asnjë fjalë për AKSH-in, nuk folët asnjë fjalë për shqetësimin e daljes së të dhënave personale, që janë bërë shqetësimi më i madh dhe krimi më i madh elektoral në vend, por u morët me Sali Berishën, sepse as e blini dot, as e korruptoni dot, dhe është i vetmi që ju rri përballë, që e keni frikë, ndaj merreni me atë. Në çdo fjalim vetëm me Sali Berishën merreni, nuk merreni me çështjet, jeni këtu për të diskutuar për ligje. Ishe këtu dhe duhej të flisje për AKSH-in, por nuk folët asnjë fjalë; folët për marrëdhëniet me ambasadorin amerikanë, por ai i ka marrëdhëniet me presidentët amerikanë. Është i vetmi që ka qenë në një vizitë zyrtare në Shtëpinë e Bardhë dhe që ka pritur disa presidentë amerikanë, që i ka ngritur marrëdhëniet me Amerikën në shkallën më të lartë, dhe për këtë është vlerësuar në mënyrë të përsëritur.

Por unë do t'ju ftoja, zoti Balla, që sot të flisni për krimin më të madh elektoral, të flisni për institucionin që është bërë kriminel më i madh elektoral: AKSH-in.

Do të doja t'ju përmendja që në raportin final të OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet e vitit 2021, rekomandimi i 4-t prioritar është se: "Shqipëria duhet të garantojë sigurinë e të dhënave personale të qytetarëve. Institucionet përkatëse duhet të hetojnë tërësisht dhe të

sanksionojnë çdo shkelje që ndikon në besimin e publikut dhe procesin zgjedhor".

Misioni i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, po për zgjedhjet e vitit 2021, thotë që "rrjedhja e të dhënave të ndjeshme personale përfshirë preferencat politike të qytetarëve, është shqetësim serioz dhe i bën votuesit vulnerabël".

Raporti paraprak i OSBE-ODIHR-it në zgjedhjet lokale të vitit 2023, thotë që një numër rekomandimesh, përfshirë dhe rekomandimin numër 4 të raportit final për zgjedhjet e vitit 2021, nuk janë zbatuar.

Kapja nga Edi Rama i të gjitha pushteteve, institucioneve dhe atyre përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve, nuk siguroi asnjë barazi në garë, nuk mbrojti të dhënat personale të votuesve. Edi Rama madje përdori edhe fatkeqësitë, edhe Covid-in, edhe mbylljen nga Covid-i, për të mbledhur të dhënat personale dhe përmes shërbimeve *online* që u përdorën më tej nga AKSH-i për të ndërtuar skemat monstruoze të patronazhimit, që u përdorën gjatë zgjedhjeve të vitit 2021 dhe të vitit 2023.

Dështimi për të marrë masa, për të përmbushur pra rekomandimet e OSBE-ODIHR-it, për të siguruar që të dhënat personale të votuesve të mos keqpërdoren nga partitë politike, po gërryen dhe më tej të drejtat e njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracinë në Shqipëri. Shfrytëzimi i të dhënave personale të mbledhura nga qeveria shqiptare dhe të përdorura në fushata politike është në kundërshtim me Kushtetutën, me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale, me rregulloret e BE-së për mbrojtjen e të dhënave dhe ligje të tjera të BE-së.

Të dashur qytetarë,

Zgjedhjet e 14 majit nuk ishin as të lira dhe as të ndershme. Vota u patronazhua, u ble, u shantazhua, u vodh, u kërcënua, u zbulua dhe u dhunua. Kjo u bë nëpërmjet sistemit të patronazhimit, i ngritur me urdhër të Edi Ramës dhe i implementuar me shumë zell nga Mirlinda Karçanaj, drejtuesja e AKSHI-t, e cila na patronazhon të gjithëve, madje edhe juve, të nderuar deputetë të Partisë Socialiste. Në këtë sistem, në këtë *database* është çdo informacion për ju dhe për familjet tuaja, ashtu sikurse është për mua, për familjen time dhe për të gjithë deputetët, ashtu sikurse është për çdo votues në Republikën e Shqipërisë. Ndaj unë sot akuzoj

Mirlinda Karçanaj, për nxjerrjen e të dhënave të mia personale, të babait tim, të motrave të mia, të vëllait tim dhe të gjithë rrethit tim familjar, nuk po kaloj tek të tjerët, e akuzoj për këtë krim elektoral që ajo ka bërë, duke nxjerrë të dhënat e mia personale. Të dhënat personale duhet të mbrohen me ligj dhe institucionet shtetërore e kanë detyrim ligjor për t'i mbrojtur ato. Po çfarë ndodh? Çdo e dhënë vihet në *database* dhe u shpërndahet të gjithë shtabeve elektorale të Partisë Socialiste. Kështu më ka rënë në dorë edhe mua çdo gjë, nga një shtab elektoral i Partisë Socialiste. Aty gjeni çdo gjë për mësuesit, për gjykatësit, edhe *afilacionin* politik të tyre, për prokurorët, për të gjithë.

Kushdo që i ka nxjerrë, nisur nga Edi Rama, Karçanaj, kryetari i Bashkisë, Erion Veliaj, kryetarët e tjerë të bashkive, ministrat, të cilëve u ka siguruar AKSHI të gjithë të dhënat personale të qytetarëve, duhet të shkojnë në burg. Është krimi më i rëndë elektoral, e përsëris, dhe SPAK-u duhet të nisë hetimet menjëherë pa u vonuar. Kam depozituar tri kallëzime në vitin 2021 dhe asgjë nuk ka ndodhur, SPAK-u ka heshtur. Epo nuk duhet të presë më asnjë ditë, unë vetë do ta çoj dhe do ta ndjek deri në fund.

Duhet të hetohet Mirlinda Karçanaj për dy çështje.

Së pari, sepse AKSHI është shndërruar në dhunuesin më të madh të të drejtave të çdo qytetari. Sot nuk ka asnjë të dhënë personale të mbrojtur, sepse të gjitha janë në shesh, në duart e patronazhistëve dhe të aktivistëve. Ja kjo është tabela e *database-s* së familjes sime, po merrem vetëm me familjen time, për të mos përdorur të dhënat tuaja personale. Në këtë tabelë, ka edhe të tjera që mund ta furnizojnë këtë tabelë, është numri i kartës së identitetit, emri, mbiemri, atësia, patronazhisti, adresa, gjinia, vendlindja, datëlindja, Kodi Zgjedhor, gjendja civile, rrethi, qendra ku votojmë, vendi i punës, preferenca politike, NIPT-i i vendit të punës, numri i telefonit, por, siç jua thashë edhe më parë, ka edhe shumë të dhëna të tjera, të cilat i përdorin shtabet elektorale të Partisë Socialiste. Patronazhisti është rilindja e së keqes, që ne mendonim se e zhdukëm bashkë me komunizmin.

Së dyti, Mirlinda Karçanaj duhet të hetohet për tenderat abuzivë, tenderat sekretë dhe josekretë, denoncimet e të cilëve janë bërë në mënyrë të përditshme dhe të përsëritur.

Miliona euro për AKSHI-n, miliona euro për sigurinë e sistemeve, por asgjë nuk mbrohet. AKSHI është institucioni që nuk i jep llogari askujt, për asnjë fond. Në pamje të parë edhe projektligji që ju keni sjellë sot do të ishte një gjë e mirë, të tjera shërbime *online*, modernizim, por, duke pasur parasysh mamuthin e madh të abuzimit me të dhënat personale, por edhe të korrupsionit të AKSHI-t, sigurisht që unë do të votoj kundër. Nuk i kanë mjaftuar këto para dhe këto fonde që kanë marrë deri më sot, 942 transaksione sekrete, i përmendi edhe zoti Berisha, 42 milionë euro për tendera sekretë që askush nuk i di. Për çfarë? Pikërisht për të na vjedhur të dhënat personale, për të na bërë vulnerabël ndaj bandave të patronazhistëve, ndaj bandave kriminaleve dhe ndaj shtabeve elektorale të Partisë Socialiste.

Patronazhistët i kemi kudo, na kanë hyrë në shtëpi dhe nuk u shpëton dot. Patronazhisti në shumicën e rasteve nuk është ai militanti që falënderon në çdo rast Edi Rama, jo, patronazhisti në pjesën më të madhe është drejtuesi lart i administratës publike, është punonjës apo specialist në administratën publike dhe paguhet nga taksat tona, është punonjës në bashki, në ministri, në agjenci apo edhe punonjës i kompanive klienteliste të Partisë Socialiste. Patronazhisti mund të jetë i çdo moshe, e ke aty te cepi duke të ruajtur, duke survejuar dhe spiunuar nga 10 deri në 100 votues.

Këto që shihni këtu janë tabelat me *database-n* e të dhënave personale që është përdorur në zgjedhjet e vitit 2021. E kanë ngritur zërin të gjitha organizatat ndërkombëtare, edhe Parlamenti Europian, edhe *Transparency International*, edhe DASH-i, të gjithë e kanë ngritur zërin për mbrojtjen e të dhënave personale. Çfarë është bërë? Është perfeksionuar, ja ku e keni vitin 2023, të gjitha të dhënat personale, edhe tuajat janë këtu. Asgjë nuk ka ndodhur. Pse? Sepse drejtësia ende nuk funksionon.

Unë kam një thirrje të fundit për AKSHI-n: të nisë urgjentisht dhe menjëherë hetim të thelluar ndaj këtij mekanizmi të rrezikshëm spiunimi, ndëshkimi dhe dënimit e fajtorëve dhe ky duhet të jetë edhe prioritet absolut i të gjithëve ne. Nëse nuk shkatërrohet kjo skemë, nëse nuk dënohen personat e përfshirë në këtë krim të rëndë elektoral, nuk do të mund të ketë zgjedhje të lira në Shqipëri. Ky sistem duhet të shkatërrohet dhe

qytetarëve t'u kthehet liria dhe e drejta, që të mendojnë dhe të votojnë për kë të duan politikisht.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Bylykbashi.

Të përgatitet zonja Kryemadhi.

Oerd Bylykbashi – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot ju kërkojnë që të votoni borxhin për AKSHI-n. Për periudhën 2019-2023, e thanë edhe zoti Berisha dhe zonja Vokshi, janë gati 42 milionë euro të përdorura nga AKSHI në 942 transaksione për kontrata, ku shumica e tyre kanë qenë kontrata sekrete. Unë kujtoj që kur është krijuar AKSHI, në kohën e qeverisjes sonë, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ishte agjenci, një institucion i rëndësishëm për atë ku ne po përpiqeshim ta fusnim Shqipërinë, pra në periudhën e qeverisjes digjitale, por kurrë nuk ishte menduar që AKSHI do të ishte një organ prokurimi kaq i rëndësishëm, që shpenzon dhjetëra e miliona para të taksapaguesve, madje me kontrata sekrete.

Për ata që nuk e dinë, kontratat sekrete janë për çështje të një interesi shumë të lartë shtetëror, kryesisht për çështje ushtarake ose për çështje të sigurisë së lartë, por çfarë ka për siguri të lartë bërja e platformave publike qeveritare për qeverisjen elektronike, çfarë ka sekrete këtu dhe se çfarë nuk duhet të marrin vesh qytetarët, si, qysh e tek bëhet ai prokurimi publik dhe pse duhet ta marrë iksi apo ipsiloni, që dihet se cilët janë?! Kjo është vetëm përpjekja për t'ia mbyllur derën publikut për të kuptuar se çfarë po ndodh me këtë institucion.

Nga ana tjetër, vlera prej 42 milionë eurosh për një periudhë 4-vjeçare tregon rëndësinë e madhe që i është dhënë këtij institucioni. Pse mendoni se është për “e-Albania”, sa herë futen dhe dalin shqiptarët për të marrë një certifikatë apo një shërbim tjetër?! Në fakt, nëse bëjmë një analizë të kësaj që ka ndodhur tani në fund fare, pra në zgjedhjet e 14 majit, por, po të shohim edhe ato të vitit 2021, do ta kuptojmë pse AKSHI është kthyer në një institucion kaq të rëndësishëm për Edi Ramën, si një institucion qendror në mekanizmin e kontrollit të zgjedhësve, jo të votës.

Sigurisht që do të përsëritim veten këtu, por ndonjëherë përsëritja na bën të mundur që t'i

ngulitim gjërat në kokë: ore, me çfarë po përballen shqiptarët në fillim, dhe pastaj partitë e opozitës? Po përballen me shtetin, në zgjedhje bëhet garë kundër shtetit.

Për ata që e kuptojnë gjuhën, me të cilën do të flas tani, dua të them se paragrafi 5,4 i dokumentit të Kopenhagenit i vitit 1990 i OSBE-së, kur vendosi rregullat për të gjithë OSBE-në se si duhet të jenë zgjedhjet demokratike, thotë një gjë shumë të rëndësishme: “Shteti duhet të ndahet nga partia në pushtet; partia në pushtet nuk duhet të shkrihet me shtetin”. Kjo do të thotë se të gjitha institucionet e shtetit duhet të funksionojnë mbi bazën e asaj që kërkon po ashtu paragrafi 3 i këtij dokumenti të rëndësishëm që vë bazat e qeverisjes demokratike. Në paragrafin 3 thuhet: “Shteti i së drejtës ka rëndësi themelore për demokracinë”, pra që do të thotë përdorimi i institucioneve mbi bazën e asaj që thotë ligji.

Çfarë kemi ne sot me AKSHI-n? Edhe një herë, ai volumi i parave nuk është vetëm një histori korrupsioni, sepse edhe ajo është shumë e rëndësishme, ai volum i parave tregon se çfarë investimi po bëhet; një instrument, i cili i shërben Edi Ramës për kontrollin e zgjedhësve nëpërmjet profilizimit të zgjedhësve. T'i profilizosh zgjedhësit, jo në kategorinë e pensionistëve, të punonjësve, të administratës apo ku e di unë, gjejeni ju kategorinë, pra një grup i madh që ka nevojë për politika, për rritje page, për subvencione në bujqësi, për çfarëdo gjëje, mendoni ju se është një program politik? Jo! Për çfarë ka nevojë zgjedhësi specifik? Ka nevojë për legalizim, ka nevojë t'i nxirret certifikata e pronës, të cilën nuk po e merr, ka nevojë për punësim ose ka gjoba tek tatimet e të tjera me radhë. Pse? Në mënyrë që më pas të dish me precizion se çfarë do t'i ofrosh atij: do t'i ofrosh para për t'i blerë votën; do t'i ofrosh para që ai të qëndrojë në shtëpi, që është më keq akoma; do t'i ofrosh një vend pune, që ai të ndërrojë mendjen; do t'i rrisësh pensionin, se ai ka nevojë (pra është edhe grupi, hajdeni t'ua rrisim të gjithëve pensionet përpara zgjedhjeve); do t'i japësh atë shërbim që ai ka nevojë në mënyrë që ai të ndërrojë mendje dhe eventualisht të votojë për partinë në pushtet ose, po të jetë e nevojshme, t'i kërkohej të qëndrojë në shtëpi.

Të ngresh një sistem patronazhimi që arrin ta bëjë këtë, e vetmja mundësi është që t'i japësh informacion. Sistemi i patronazhimit, për të cilin

keni dëgjuar Edi Ramën ta përgëzojë në tentativën e tij për të legalizuar diçka që është e paligjshme, për t'i thënë prokurorisë: mos guxo të hetosh, pavarësisht se këtë ta kërkojnë institucionet ndërkombëtare, sepse në këtë mes jam unë; këtë e kam kërkuar unë; këtë e kërkoj me domosdoshmëri, madje të jetë sa më perfekt sistemi i patronazhimit si instrument, është si një makineri pa energji nëse nuk merr të dhëna dhe informacion dhe të vetmet databaza, të cilat bëjnë punë për këtë, janë ato shtetërore. AKSHI është guri i themelit në të gjithë këtë mekanizëm kontrolli të zgjedhësve, pra jo të votës me numëruesin tek tavolina, por i kontrollit të votës paraprakisht dhe, nëse nuk ka siguri që zgjedhësi do të votojë për Partinë Socialiste, duhet të qëndrojë në shtëpi dhe të paguhet me para. E ngriti dikush këtë në një debat, se nuk e kishte dëgjuar që kishte edhe të këtillë, pra që paguheshin para që të qëndronin dhe të mos votonin, por kur iu shtrua pyetja: “Ore, po që blihen apo merren kartat e identitetit, e ke dëgjuar? Po, - tha e kam dëgjuar.” Është e njëjta gjë.

Pra, mekanizmi kriminal që Partia Socialiste, me Edi Ramën në krye, kanë vendosur në një funksion në të gjithë territorin, duke përdorur shtetin, është i furnizuar me informacion nga AKSHI, me të dhënat që qytetarët shqiptarë janë të detyruar t'i japin, sepse ju po u ndërprisni mundësinë t'i marrin në mënyrë tjetër, dhe të dhënat që ata fusin përdoren. Për sa kohë prokuroria nuk do të ndërhyjë, për aq kohë do të jeni edhe ju të qetë, për aq kohë do të vini këtu e do të thoni lloj-lloj dënglash për ç'ka ndodhur në të shkuarën e të tjera, e gjitha kjo është përpjekje për të mbuluar njërin nga arkitekturat më kriminale, që mund të ekzistojnë në lidhje me zgjedhjet. Këto po dalin, ne do t'i përsëritim këtu, sigurisht që ka edhe diskutime të tjera që duhen bërë, por këto do të thuhën në këtë sallë dhe kudo tjetër.

Sot ishte një tryezë shumë interesante, ku përfaqësuesi i Partisë Socialiste tha: “Zgjedhjet ishin me standarde të shkëlqyera, nuk thyen asnjë standard, nuk u përdorën fare burimet shtetërore, nuk u përdorën të dhënat, patronazhistët nuk janë asnjë lloj problemi, është një mënyrë organizimi e Partisë Socialiste dhe “Aktivistit” është një program përdorimi i brendshëm i Partisë Socialiste”. Do të ishte mirë të kishit qenë aty,

sepse nuk mbeti asnjë organizatë e shoqërisë civile, që nuk e shpartalloi përfaqësuesin e Partisë Socialiste në sy të organizatorëve të huaj.

Kjo ka një impakt të vogël në lidhje me këtë që po diskutojmë dhe me problemin e madh që është, por fakti është se nuk ka njeri që nuk është i ndërgjegjshëm për arkitekturën kriminale që keni ngritur, duke përdorur të dhënat shtetërore në funksion të marrjes dhe të mbajtjes së pushtetit dhe më pas t'i përdorni zgjedhjet si një vello që justifikon përdorimin kriminal të shtetit për korrupsion, për lidhje me krimin dhe për çdo gjë tjetër. Pra, zgjedhjet nuk kanë më konceptin e legjitimitetit të pushtetit, mundësisht të rotacionit, jo, është justifikimi që keni bërë një palë zgjedhje, në mënyrë që të vazhdoni ta përdorni pushtetin në mënyrën edhe më të degraduar, siç e kemi parë para pak ditësh. Vini këtu e flisni. Kam qenë aty kur ka thënë ambasadori amerikan: “Jemi të shqetësuar që prokuroria nuk po heton organizatorët e “21 janarit””, por kjo është histori e vjetër. Ajo që provuan shqiptarët atje është se shumë nga këto dënglat që dëgjuan sot në sallë, nuk i kanë besuar, ata të opozitës nuk i besojnë, por nga ana tjetër çfarëdo që të themi ne këtu, ky problem është shumë i madh dhe, në qoftë se ne nuk do të merremi seriozisht për ta çmontuar, është detyra jonë, e opozitës, juaja, sepse ajo që u kuptua sot nga reagimi i përfaqësuesit të Partisë Socialiste (është i rëndësishëm në atë fushë), është që nuk keni ndër mend ta ndryshoni këtë sistem kriminal dhe do të vazhdoni ta mbani, ndërsa detyra jonë është ta bëjmë të qartë për shqiptarët, për të huajt dhe për këdo dhe të fillojmë ta çmontojmë, sepse çfarëdo që të ndodhë, po nuk u çmontua shteti në zgjedhje, do të thotë se zgjedhjet kanë vdekur më parë.

Të na kërkonin ne sot të miratojmë një borxh, që të vazhdoni të financoni një strukturë, e cila, në fakt, po kthehet në një strukturë kriminale, nuk ka cipë fare, por ju praktikisht këtë po bëni: po kërkonin të financoni me paratë e një institucioni financiar të huaj një institucion, i cili po i shërben çdo ditë e më shumë partisë në pushtet, që në mënyrë kriminale po dërrmon dhe po asfaltton rezultatet e zgjedhjeve, që ju të trasheni në pushtet dhe të vazhdojnë ato gjërat e shëmtuara nëpër zyra që i kanë parë të gjithë shqiptarët.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zonja Kryemadhi nuk është.

Këtu mbyllet diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla-Pulaj për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar”.

Fillojmë diskutimin me paraqitjen e projektligjit nga nismëtari.

Ministri Çuçi, fjala për ju.

Koha është e pakufizuar.

Bledar Çuçi – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Marrëveshja që kemi paraqitur sot në Kuvend për miratim, për hapjen e një pike të përbashkët të kalimit kufitar midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, ka një rëndësi të veçantë për lehtësimin dhe intensifikimin e shërbimeve dhe të shkëmbimeve midis dy vendeve tona, por edhe më gjerë, në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit rajonal dhe të kohezionit në Ballkanin Perëndimor, që, siç dihet, Shqipëria e ka prioritet. Për të ngritur në një nivel tjetër zhvillimin e sektorëve me interes strategjik midis dy vendeve tona, veçanërisht zhvillimin e turizmit, kemi punuar bashkërisht si një ekip me palën malazeze për marrëveshjen, e cila u firmos në mbledhjen e fundit midis dy qeverive.

Konkretisht, kjo marrëveshje përcakton hapjen e një pike të re kufitare të përbashkët, atë të kalimit kufitar Shën Nikolla-Pulaj. Pulaj është një fshat i Bashkisë së Shkodrës, që do të jetë një pikë kufitare për qarkullimin ndërkombëtar si të njerëzve, ashtu edhe të mjeteve. Hapja e kësaj pike të përbashkët të kalimit kufitar do të japë një frymëmarrje të re dhe përfitime jo vetëm për banorët e zonave përreth lumit Buna, por edhe një impuls alternativ për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe zhvillimin e një ekosistemi turistik më koheziv në të dyja anët e kufirit.

Më konkretisht:

Së pari, do të lehtësohet lëvizja e banorëve të zonave të Nënshkodrës, pjesë përbërëse e Bashkisë së Shkodrës, dhe të zonave të Ulqinit nga ana e Malit të Zi, përkatësisht në malësinë e Krajës.

Së dyti, do të shkurtohet në mënyrë të ndjeshme distanca dhe do të ulet fluksi i hyrjedaljeve në pikën e përbashkët të kalimit kufitar në Murriqan, veçanërisht për mbarëvajtjen e punës gjatë sezonit turistik. Sigurisht, do të shkurtohet në mënyrë drastike distanca ndërmjet Velipojës dhe Ulqinit. Sot kjo distancë është 70 kilometra dhe me investimin në infrastrukturë dhe bërjen e urës së re (marrëveshje, të cilën e kemi kaluar këtu në parlament) kjo distancë do të jetë vetëm 310 metra, duke besuar se do ta shndërrojë të gjithë zonën në një destinacion turistik nga më të preferuarit jo vetëm për pushuesit shqiptarë dhe malazezë, por edhe për të gjithë pushuesit e huaj që i frekuentojnë këto dy brigje kaq të kërkuara.

Së treti, do të stimulohet dhe do të rritet shumë shkëmbimi i aktiviteteve dhe i paketave turistike si rezultat i shkurtimeve të distancës.

Të nderuar kolegë,

Mendoj se nga një pikëpamje më gjithëpërfshirëse ky impuls i ri i zhvillimit për sektorin e turizmit do të japë edhe një kontribut të drejtpërdrejtë në ekonominë vendore të të dyja anëve të kufirit dhe besoj se do të stimulojë edhe sipërmarrje të reja që i ushtrojnë aktivitetet e tyre në këto zona.

Ky projekt, si dhe pika e re ndërlidhëse, do të impaktojë edhe reputacionin ndërkombëtar të turizmit në rajonin tonë, pa përjashtuar këtu edhe stimulimin e ofertës së agjencive apo të operatorëve turistikë të të dyja vendeve. Shqipëria është një vend ku turizmi tashmë ka marrë një zhvillim të jashtëzakonshëm dhe po rritet vit pas viti, prandaj çdo investim në infrastrukturë që e ndihmon këtë sektor është gjithmonë më shumë se i mirëpritur.

Ngritja e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ku aplikohet parimi “one stop shop”, siç do të aplikohet në këtë pikë, të cilën e kemi parashikuar, konsiderohet një nga nivelet më të larta të bashkëpunimit ndërkufitar mes dy vendeve, ku aplikimi i standardeve *mot a mot* të vendeve Shengen, na sjell më afër familjes europiane.

Nga kjo pikëpamje, çelja e kësaj pike të re, së pari, do të ndikojë në rritjen e efektivitetit të kontrollit të vijës së kufirit përgjatë lumit Buna dhe, së dyti, do të vendosë më në pah vlerat turistike të ekosistemit të lumit Buna, të liqenit të Shkodrës dhe traditat e banorëve të Ulqinit, të

Velipojës, të malësisë së Tivarit apo edhe të zonave përreth.

Në vlerësimin tonë, të gjitha pikat e kalimit kufitar në kufirin shtetëror ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi duhet të jenë të tilla, pra pika të përbashkëta të kalimit kufitar. Eksperiencia e deritanishme ka treguar përparësitë dhe përfitimet direkte të kryerjes së procedurave të përbashkëta të kalimit kufitar. Ne po punojmë me palën malazeze për të ndryshuar edhe statusin e pikave të tjera kufitare që kemi, për t'i kthyer ato në pika të përbashkëta.

Në interesin tonë, por sigurisht edhe të malazezëve, është edhe hapja e pikës tjetër të përbashkët, të kalimit kufitar në fshatin Zogaj.

Në përfundim, shpreh bindjen se mbarimi i projektit të ndërtimit të urës mbi lumin Buna, si dhe hapja e kësaj pike kufitare të përbashkët me Malin e Zi, e cila do të jetë efektive menjëherë me inaugurimin e urës së re, do të kenë një impakt domethënës për ndërlidhjen mes dy vendeve tona në këtë pjesë të kufirit, si dhe do të çlirojnë potenciale të jashtëzakonshme të zhvillimit të turizmit.

Ndaj, të nderuar kolegë, ju ftoj ta votojmë së bashku, dhe besoj se do ta votojmë, pa parë ndasitë politike majtas apo djathtas.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për ministren Bilali.

Të përgatitet zoti Petro Koçi.

Edona Bilali – Si ministre Shteti për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, por edhe si deputete e qarkut të Shkodrës, jam shumë e lumtur për këtë fazë në të cilën arritëm sot.

Në seancën e muajit prill bashkërisht miratuam marrëveshjen për ndërtimin e urës, e cila në më pak se një vit, kur ishte vetëm një diskutim midis dy kryeministrave dhe qeverive të vendit, po sheh gjithnjë e më shumë dritën e realizimit.

Si shkodranë nxitemi nga padurimi, por sigurisht që kemi edhe arsye për të pritur gjëra të mëdha në qark, por kryesisht në Bashkinë e Shkodrës. Sezoni turistik ka filluar dhe, në fakt, ky sezon turistik duket si më i mbari nga çdo vit, por paralelisht me sezonin vijnë edhe sfidat, dhe sfidat fillimisht lidhen edhe me trafikun që krijohet në pikat kufitare, që na lidhin kryesisht me Malin e Zi.

Veçantia e kësaj marrëveshjeje që do të miratojmë sot, është pikërisht fakti që kjo pikë kufitare do të jetë e përbashkët. Kjo do të thotë se radha do të ulet në mënyrë të ndjeshme dhe nuk do të kryhen procedurat dy herë, do të optimizohet jo vetëm koha, por edhe motivi për të shkuar në njërin anë të kufirit apo në anën tjetër.

Nuk është pak që një hapësirë e urës të kthehet në 300 metra, ndërkohë që aktualisht sot janë 37 kilometra nga njëra anë e kufirit tek tjetra, apo një reduktim nga 90 minuta në 5 minuta. Kjo praktikisht heq në mënyrë domethënëse ekzistencën e kufirit.

Si përkthehet kjo në ekonominë lokale? Po të shikojmë sot tregun e pasurive të patundshme në zonën e Velipojës, çmimet variojnë nga 800 në 1300 euro për metër katror. Kjo nuk është e rastësishme, rritja domethënëse ka ardhur nga vëmendja e shtuar që qeveria ka dhënë dhe premtion edhe për vitet e ardhshme; nuk është as e shprehur, pasi është një investim paralel që duhet të ndodhë, që pritet të rritë akoma më shumë vlerën e pronave në këtë zonë dhe bëhet fjalë për lidhjen nga ana tjetër me Shëngjinin, pra rrugën Shëngjin-Velipojë, e cila, gjithashtu, është në fazë të avancuar.

Përveç përfitimeve direkte në tregun e pasurive të patundshme, pritshmëritë e tjera për përmirësimin ekonomik lidhen me ambientet e akomodimit, me restaurimet, në të cilat jo vetëm që ka fluks të shtuar pune, por ka nxitje edhe për të përmirësuar cilësinë, meqenëse tashmë do të jenë në garë për të gjithë fluksin e turistëve nga të dyja anët e kufirit.

Përveç elementit ekonomik, ka edhe një element tjetër social. Zona e Nënshkodrës është e lidhur dhe me pjesën matanë kufirit, kryesisht me zonën e Krajës, edhe për shkak të marrëdhënieve historike, familjare e fafaisnore midis tyre. Kjo pikë kufitare do të ndihmojë, gjithashtu, edhe në shkëmbimin dhe në vijimin e intensivimit të marrëdhënieve, por edhe të eventeve nga të dyja anët e kufirit. Këto evente patjetër që do të ndihmojnë në ekonominë lokale të të dyja vendeve në mënyrë të njëjtë.

Shohim një ofertë konkurruese midis një plazhi në Malin e Zi dhe plazhit nga krahu ynë i kufirit, Velipojës, pasi më duhet t'ju them, si frekuentuese prej 34 vjetësh e këtij plazhi, që situata me mbetjet ishte gati dëshpëruese, do të thosha, sepse jo vetëm kishte mbetje ushqimore

urbane nga konsumatorët, por, për shkak të një mungese totale të planifikimit, kishte edhe mbetje inertesh. U desh ndërhyrja e disa palëve, e ushtrisë, e emergjencave në koordinim me bashkinë që të hiqeshin javën e kaluar, jo pak, por 398 metra kub inerte. Po t'i përfytyrojmë këto në një zonë bregdetare, e kuptoni se sa i vështirë dhe sfidues bëhet turizmi i qëndrueshëm apo turizmi cilësor në një zonë, që, praktikisht, është e mbushur me mbetje.

Sot Bashkia e Shkodrës ka filluar të marrë një fytyrë të re. Ne jemi shumë të lumtur dhe krenarë që Shkodra e votëbesoi këtë ndryshim dhe është pjesë e të gjithë paketës që tashmë të kemi një plazh cilësor, që nis nga "A"-ja, që është pastërtia, dhe vazhdon me pikën e dytë që ne votojmë sot, që është infrastruktura, për të prodhuar atë që jo vetëm bashkia, por edhe qarku dhe ekonomia e të gjithë Shqipërisë e përfiton, që është rritja ekonomike.

Ashtu sikurse votuam marrëveshjen për urën, ju ftoj të votojmë bashkërisht edhe për hapjen e pikës së re kufitare.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zotin Petro Koçi.

Të përgatitet zoti Isuf Çelaj.

Petro Koçi – Zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

I mbështes fort të dy anëtarët e kabinetit të qeverisë "Rama", të cilët kërkuan që këtë projekt-marrëveshje ta votojmë të gjithë në mënyrë konsensuale. Hapja e një pike të kalimit të kufirit, në shërbim të urës dhe pastaj të qarkullimit mes të dyja vendeve, por kryesisht në shërbim të rajoneve afër kësaj pike të kalimit të kufirit, sigurisht që është një lajm shumë i mirë, që besoj se nuk gëzon vetëm shkodranët, por gëzon edhe shumë shtetas të Shqipërisë, që preferojnë t'i kalojnë ditët turistike në atë zonë.

Sigurisht që kjo dëshmon edhe një herë thellimin e marrëdhënieve që ne kemi me Malin e Zi, këtij fqinji të rëndësishëm për ne; nga ana tjetër, tregon se edhe qeveria jonë, por edhe qeveria e Malit të Zi janë duke investuar për të lehtësuar jo vetëm qarkullimin, por sidomos ekonominë dhe turizmin në të dyja vendet.

Besoj se ky është një projekt, i cili i shërben Shkodrës së re, Shkodrës që tani do ta drejtojë Benet Beci, dhe është një nga ato lajmet optimiste që nxit edhe më shumë energji për të vepruar

gjithnjë e më shumë në të mirë jo vetëm të ekonomisë në përgjithësi, por edhe të ekonomisë familjare dhe të atyre që merren posaçërisht me biznesin e turizmit.

Sigurisht që pika e re e kalimit të kufirit nuk do të fillojë të ndërtohet qysh tani, por duke i paraprirë qysh sot, me miratimin e kësaj marrëveshjeje, ndoshta është një nga herët e rralla që ne, si të thuash, i bëjmë gjërat parapritë për të qenë gjithnjë të gatshëm në momentin e duhur.

Nga ana tjetër, nuk besoj se do të kishte kuptim ura, nëse nuk do të bëhej edhe pika e kalimit të kufirit, dhe këtu i bashkohem logjikës së ministrit, që e shpjegoi qartazi këtë marrëdhënie të domosdoshme, se, përndryshe, edhe ura do të ishte jofunksionale në përmasën e vet. Kjo tregon se Ballkani, në fund të fundit, po bëhet gjithnjë e më i hapur, një Ballkan, i cili lëviz më mirë, më lirshëm, jo vetëm nga pikëpamja e qarkullimit njerëzor, por edhe e vlerave financiare të ekonomisë dhe sidomos të turizmit. Sigurisht që në këtë Ballkan të hapur marrëdhënia jonë me Kosovën është tjetër gjë, është komplet një projekt i përbashkuar, por ne me të gjitha vendet e tjera duhet të jemi shumë të hapur, dhe ky është Ballkani i sotëm, por besoj se do të jetë edhe më i hapur në të ardhmen.

Meqenëse jemi duke folur për një çështje, e cila prek politikën tonë ndërkombëtare dhe jo rastësisht kaloi kjo marrëveshje edhe në Komisionin e Politikës së Jashtme, si komision përgjegjës, sigurisht më jepet mundësia për të folur për këtë temë, edhe për disa nga çështjet që u prekën paraditen e sotme.

Unë gjykoj se përdorimi i territorit të Republikës së Shqipërisë për sulme kibernetike ndaj një vendi tjetër, nuk është vetëm një shkelje e rëndë e një marrëveshjeje, por është një krim i shëmtuar, që i sjell dëme të jashtëzakonshme interesave tanë kombëtarë. Rreshtimi në krah të atij krimi është tradhti dhe pabesi ndaj interesave të Shqipërisë.

Unë besoj se ajo që ka ndodhur në Manzë, nuk është thjesht një aksion që ka ardhur si një iniciativë thjesht e nxitur nga agjencitë tona ligjzbatuese, sigurisht, ato janë përgjegjëse dhe në gjithnjë e më shumë kemi ekspertë në radhët e tyre, me siguri është një bashkëpunim me agjencitë e tjera të inteligjencës, që besoj se e kanë verifikuar se nga ai territor ka pasur sulme me natyrë kibernetike ndaj vendeve të tjera.

Kështu që mendoj se politikanët e Shqipërisë, sidomos ata që janë në këtë sallë, nuk duhet të guxojnë të rreshtohen në krahun e gabuar dhe kundër Shqipërisë në këtë rast. Të qëllosh mbi agjencitë tona, në fakt, në këtë rast është të rreshtohet kundër Shqipërisë. Kështu që do të kërkoja menjëherë një refleksim urgjent të atyre politikanëve që guxojnë dhe kanë guxuar deri tani ta bëjnë këtë gjë.

Të mos harrojmë se kjo që ka ndodhur sot, nuk është një gjë e rastit, sepse është pak a shumë nga të njëjtit zëdhënës që sulmojnë ambasadorët e SHBA-ve, që sulmojnë Sekretarin Blinken, që sulmojnë të dërguarit e posaçëm të SHBA-ve në rajon. Bashkimi i këtyre zërave me qëndrime të shteteve të tjera, që janë kundër SHBA-ve, mendoj se jo vetëm është një akt i papranueshëm, i pamoralshëm dhe i pabesë, por është edhe qëndrim i ndëshkueshëm.

Agjencitë tona, sidomos SPAK-u, duhet ta shohin me vëmendje këtë gjë, sepse shumë mirë që po veprojnë ndaj çdo personi të dyshuar për korrupsion, por duhet parë me kujdes çdo qëndrim, edhe në sallën e këtij parlamenti, që përbën tradhti kombëtare, sepse janë të njëjtët njerëz që sulmuan marrëveshjen e Rambujesë, janë të njëjtët njerëz që bënë “14 shtatorin”, “21 janarin”, “‘97-n” dhe shumë akte të tjera, të cilat kanë dëmtuar rëndë shtetin shqiptar dhe interesat tanë kombëtarë.

Jemi në një moment, i cili, në fund të fundit, provon edhe një herë në krah të kujt jemi: jemi në krahun e Shqipërisë, apo në krahun e armiqve të Shqipërisë?!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Isuf Çelaj.

Të përgatitet zoti Tritan Shehu.

Isuf Çelaj – E nderuar Kryetare,

Të nderuar qytetarë të Kukësit, të Tropojës dhe të Hasit,

Të nderuar kolegë,

Sot nga qeveria është paraqitur për miratim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla-Pulaj për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar”.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe

qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar është propozuar nga pala malazeze. Objekt i kësaj marrëveshjeje do të jetë hapja e pikës së përbashkët Shën Nikolla-Pulaj për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe për kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar.

Parimisht jam dakord me këtë marrëveshje, e cila është në shërbim të qytetarëve shqiptarë që janë banorë në zonat ndërkufitare midis dy shteteve, por sado pika kontrolli të kalimit kufitar të hapim, në Shkodër mbetet emergjente që të investohet në rrugën nacionale Shkodër-Milot, pasi situata me trafikun, sidomos gjatë stinës së verës, është një tmerr jo vetëm për qytetarët e Veriut, por edhe për vizitorët e huaj.

Unë uroj që kjo marrëveshje të mos mbetet thjesht si shumica e marrëveshjeve në letër dhe të firmosura vetëm për fasadë propagandistike të stilit tuaj të të bërit të gjërave.

Unë do ta ripërsëris sot shqetësimin tim, si përfaqësues i qytetarëve të Tropojës, i cili ka të bëjë me moszbatimin e një marrëveshjeje ndërmjet qeverisë së Malit të Zi dhe qeverisë shqiptare, e miratuar në vitin 2013, për hapjen e pikës së kontroll-kalimit me Malin e Zi, në vendin e quajtur Qafa e Vranicës, në fshatin Çerem të rrethit të Tropojës, e ndodhur në trekëndëshin që lidh tri shtete: Shqipëri – Mali i Zi – Kosovë.

Për marrëveshjen e miratuar para 10 vjetësh nga qeveria e Partisë Demokratike, edhe pse kanë kaluar 10 vjet që ju drejtoni vendin si mazhorancë, nuk keni ndërmarrë asnjë hap për realizimin dhe zbatimin e saj. Sa u takon arsyeve për moszbatimin dhe mosrealizimin e kësaj marrëveshjeje, unë dhe qytetarët e Malësisë së Gjakovës i kemi të qarta, pasi Tropoja, Hasi dhe Kukësi nga ju, si mazhorancë, gjatë këtyre 10 vjetëve janë trajtuar si qytete të dorës së tretë, si dhe me një urrejtje, deri në hakmarrje politike ndaj qytetarëve.

Shqetësimi im lidhur me moshapjen e kësaj pike të kontroll-kalimit në Qafën e Vranicës, në Çerem, ka të bëjë me faktin që kjo pikë ka qenë historikisht e hapur edhe në periudhën e mbretit Zog, deri në vitin 1948, kohë kur u mbyll kufiri me ish-Jugosllavinë. Kjo pikë u shërben 15 mijë banorëve të rrethit të Tropojës, sidomos gjatë periudhës së verës, pasi lidhjet e këtyre zonave janë të forta me zonat e shqiptarëve të Plavës e Gucisë, një prej trevave dhe luginave më të

bukura natyrore, por edhe një prej zonave më patriotike dhe qëndrestare, sa u takon çështjeve të shqiptarisë dhe çështjeve madhore kombëtare. Lidhjet e gjakut e ato familjare, me martesat e shtuara ndërmjet banorëve të këtyre zonave, janë shekullore, dhe në 30 vjetët e rënies së regjimit diktatorial ato janë shtuar edhe më shumë. Këto zona kanë qenë pjesë e bukurive përrallore të Alpeve Shqiptare dhe vizitohen nga një numër i madh banorësh nga e gjithë bota, si nga brenda, ashtu dhe përtej kufirit. Kështu që hapja e kësaj pike kontrolli do t'u shërbente shumë banorëve të zonave: Plavë, Guci, Martinaj, Vuthaj, Zabel, Hot e të tjera. Këtyre banorëve, në raste vizitash familjare apo turistike, do t'u duhet të bëjnë 200 e ca kilometra rrugë dhe të kalojnë në dy dogana, në atë të Kosovës dhe të Malit të Zi, dhe po aq në kthim, kjo për vetë pozicionin gjeografik që kanë në këto zona. Po të hapej edhe pika në Qafën e Vranicës, do të bëhej i mundur shkurtimi i distancës vajtje-ardhje në jo më pak se 67 kilometra, duke qenë një lehtësim për këta banorë, gjithnjë nëse qeveria do të kishte menduar për hallet dhe problematikat e këtyre zonave.

Kërkesa ime për Kryeministrin, për ministrat Çuci dhe Xhaçka është që të angazhohen në riaktivizimin dhe në zbatimin e kësaj marrëveshjeje me qeverinë e Malit të Zi, pasi do të jetë në të mirë të qytetarëve të të dyja shteteve.

Po ashtu, të bëhen të vlefshme edhe marrëveshjet me Republikën e Kosovës për hapjen e pikave të kontrollit të kalimit në zonat ndërkufitare, në vijën kufitare me Hasin, Tropojën dhe Kukësin dhe të mos lihen në kuadrin e llafeve dhe të letrave, që shkruhen për fasadë e propagandë nga ana juaj, pasi këto pika u shërbejnë banorëve të këtyre zonave për të lëvizur në territoret respektive, duke u shkurtuar distancat e lëvizjes, pasi atyre do t'u duhet të bëjnë kilometra të tëra që të shkojnë në pikat ekzistuese të kontrollit kufitar.

Shpresa se ju do të angazhoheni për këto është pothuajse zero, pasi u bë e disata herë që e kam ngritur këtë shqetësim të këtyre banorëve nga kjo foltore, por, siç e thashë edhe më sipër, për ju këto zona nuk ekzistojnë, sepse nuk mendojnë dhe nuk veprojnë politikisht si ju.

Përgjegjësia për harresën, për varfërinë dhe për shpopullimin e Tropojës, të Hasit dhe të Kukësit është vetëm juaja si mazhorancë me modelin e të emëruarve tuaj, që ju përfaqësojnë në

këto bashki, siç ishte edhe rasti flagrant i skandalit të turpshëm në zyrën e shtetit, në Bashkinë e Kukësit, produkt ky i arrogancës suaj si mazhorancë dhe i pushtetit të vjedhur me veprime abuzive dhe korruptive, ashtu siç është komplet modeli juaj qeverisës.

Gjatë 10 vjetëve të qeverisjes suaj zhvillimi në këto zona ka mbetur në vend. Infrastruktura rrugore rurale është e shkatërruar, mungojnë investimet në infrastrukturën e furnizimit me energji elektrike, që në pjesën më të madhe janë të viteve '70-të, ndërkohë që arritja juaj më e madhe si mazhorancë është se e keni renditur qarkun e Kukësit në qarkun më të varfër në vend dhe në rajon.

Do të vijë dita kur qytetarët e qarkut të Kukësit do t'ju ndëshkojnë për të gjitha ato që i keni shkaktuar vendit, nga korrupsioni galopant, varfëria e shtuar e deri te shpopullimi në përmasa biblike, kryesisht i zonave të Veriut, por edhe i të gjithë Shqipërisë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Tritan Shehu.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja Kryetare!

Pa dyshim që kjo projekt marrëveshje që vjen sot, është pozitive dhe influencën në lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve dhe të mallrave shqiptare me Malin e Zi. Është një marrëveshje e cila duhet miratuar, sepse shkon paralel me qëllimin që kemi, me mundësinë e qytetarëve shqiptarë që të udhëtojnë të lirë, pa pengesa, jo vetëm në rajonin tonë, por edhe në të gjithë hapësirën europiane qoftë për aktivitetet ekonomike, qoftë për turizëm, qoftë për aktivitete shkencore, profesionale, shkollim, passhollim e të tjera me radhë.

Pa dyshim që kjo marrëveshje shkon edhe në linjën e liberalizimit të vizave të shqiptarëve në hapësirën Shengen që është realizuar prej vitesh, duke krijuar mundësi më të prekshme për qytetarët shqiptarë. Mendoj se problemi qëndron diku tjetër dhe duhet parë diku tjetër. Problemi qëndron te pengesat që krijojmë në këtu në Shqipëri, që krijojnë qeveria shqiptare për lëvizjen normale dhe të lirë të specialistëve dhe të qytetarëve në hapësirën ku ata duan të punojnë, duan të aftësohen dhe të specializohen, duke u shkelur në këtë mënyrë një të drejtë universale qytetarëve shqiptarë: atë të lëvizjes së lirë, të

drejtën e zgjedhjes së vendit të punës, të drejtën e specializimit, të drejtën e kualifikimit, të drejtën e rritjes profesionale. Pse e them këtë gjë?! E them këtë, sepse ajo që po ndodh sot me studentët e Fakultetit të Mjekësisë, pa dyshim që është diçka e paimagjinueshme, është një gjë mund të ndodhë vetëm në regjimet autokratike, është një gjë, e cila u shkon për shtat ish-vendeve të tjera komuniste, pasi Shqipëria në atë kohë i kishte pothuajse të mbyllura fare rrugët. Këto vende vinin norma të tilla dhe kërkesa bllokimi për ata që mbaronin studimet, duke u penguar të drejtën e udhëtimit, të daljes jashtë dhe të marrjes së diplomës. Ti thuash sot studentit të mjekësisë që nuk do t'i japësh diplomën për 3-5 vjet dhe ta detyrosh të punojë ku do ti dhe jo ku do ai, është pa dyshim një formë skllavërie moderne, është pa dyshim një formë e punës së detyruar të përdorur dikur. Dikur përdornin kampet, dikur përdornin forma të tjera administrative për t'i çuar ku donin ata, ku deshën edhe regjimet. Sot po shpikin elemente të tjera. Kjo, pa dyshim, është e palejueshme dhe e patolerueshme, dhe unë i mbështes plotësisht kërkesat e protestat e studentëve. Ata janë në të drejtën e tyre të padiskutueshme në atë që kërkojnë, sepse e drejta e zgjedhjes së vendit të punës, e drejta e specializimit është një e drejtë universale që nuk mund të shkelet. Çfarë ndodh?! Ju e dini që, kur studentët tanë mbarojnë Fakultetin e Mjekësisë, paguajnë 450 mijë lekë të vjetër çdo vit. Kjo është absurde, pasi shteti duhet t'i sigurojë, dhe i siguron në të gjithë botën demokratike *gratis* studimet në universitetet publike, ndërsa studentët tani i detyrojnë të paguajnë 450 mijë lekë të vjetër çdo vit. Kjo është një shkelje e madhe e të drejtës universale për studim. Studentëve tanë nuk u krijojnë lehtësira të tjera, siç krijohen kudo. Shikoni Kosovën, e cila siguron qoftë nivelin e banimit, qoftë lehtësira të tjera. Përveç kësaj, u thonë studentëve që, kur të mbarojnë studimet, duhet të rrinë 3-5 vjet ku duan ata dhe nuk do të shkojnë diku tjetër. A e kuptoni se çfarë është?! Ky është kulmi i arbitraritetit, i padrejtësisë dhe i shkeljes së të drejtave të njeriut.

Së pari, shkolla publike duhet të jetë *gratis*, sepse nuk mund të paguajë studenti; është shkelja më e rëndë në botë. Shkoni e shikoni si është! *Gratis* është shkolla, madje, përkundrazi, krijojnë edhe lehtësira të tjera. Ju mund të shikoni Kosovën si e keni.

Së dyti, u thonë që nuk do të specializohen. Një student që mbaron Fakultetin e Mjekësisë, ka nevojë të specializohet. Ai nuk mund të punojë si mjek normalisht, sipas normave europiane, pa bërë specializimin së paku 3 vjet për mjek familjeje. Çfarë ndodh këtu te ne?! Ai do të specializohet në Gjermani, në Francë apo kudo, por i themi që nuk mund të shkosh, por do të punosh mjek i përgjithshëm në Shqipëri për 3 vjet. Pra, ai do të humbë 3 vjet dhe do të bëjë një punë të pakualifikuar, sepse nuk është specializuar për ta bërë atë punë. Në qoftë se studenti fiton për t'u specializuar në Shqipëri, çfarë ndodh?! A e dini ju se sa paguan një specializant në vendin tonë gjatë specializimit?! 1 milion e 200 mijë lekë të vjetër në vit. Ku ndodh kjo?! Nuk ndodh gjëkund, megjithëse specializanti kryen një punë aktive në spital dhe duhet paguar për këtë punë. Në Gjermani një specializant fillestar që ditën e parë, kur fillon specializimin, merr 2900 euro në muaj në xhep; në Itali një specializant fillestar që ditën e parë merr 1900 euro në muaj, ndërsa te ne specializanti duhet të paguajë 1 milion e 200 mijë lekë, pra rreth 1200 euro me kursin e ri, që të bëjë specializimin. Ky detyrim e pengon studentin të aplikojë në Gjermani, në Francë apo në Itali për specializim, sepse i thuhet që nuk i jepet diploma për 3-5 vjet. A e kuptoni se çfarë marrëzie dhe çfarë shkelje të drejtash është kjo?! Këtu shkatërrojmë edhe anën profesionale të mjekëve, këtu nuk i lejojmë mjekët të kualifikohen dhe të specializohen, përveçse mjekët e rinj i trajtojmë si skllavër apo si bujkrobër. A ka gjë më të keqe se kjo?! Kjo shkatërron shumë elemente, jo vetëm të drejtat e njeriut, jo vetëm të drejtën e punësimit dhe specializimit, por shkatërrohet rihvillimi i sistemit shëndetësor, sepse sikur 30% nga ata mjekë, të cilët do të shkojnë jashtë për specializim, të kthehen në Shqipëri, është fitore e madhe për vendin tonë, por që të kthehen në Shqipëri, duhet t'u krijojnë kushte, nuk mbahen me urdhra administrativë, sepse vetëm Kim Jong Un mund të mbajë sot me urdhra administrativë. Një mjek ka nevojë për kushte. Duhet të kuptojmë diçka: mjekët janë ndër nivelet më të larta intelektuale dhe sociale të shoqërisë sonë. Mjeku ka nevojë për kushtet e tij të punës, të zhvillimit shkencor, të zhvillimit profesional, të specializimit në nivelet europiane, të dinjitetit, të ambientit ku punon, të prestigjit të tij dhe, pa dyshim edhe të anës financiare, e cila duhet të jetë

e përputhshme me këto. Çfarë bëjmë sot?! Nuk ka asgjë. Ju e dini që sot nuk ka asnjë fond që jepet në mjekësi për kualifikimet dhe, e thashë, për specializimet paguhen 1 milion e 200 mijë lekë të vjetër në vit. Asnjë kongres nuk ka buxhet; asnjë konferencë shkencore nuk financohet; asnjë libër nuk vjen i financuar; asnjë revistë nuk vjen e financuar në Shqipëri; nuk ka asnjë fond për kërkimin shkencor. Këto janë qesharake. Çfarë kërkojmë?! Çfarë janë mjekët?! Si mund të rrinë mjekët këtu po nuk u krijuan këto kushte?! Mjeku është mjek dhe duhet ta kuptojmë mirë këtë gjë. Mjeku është mjek dhe ka nevojë për këto elemente, në mënyrë që të japë dhe të prodhojë duke i shërbyer sistemit shëndetësor shqiptar, duke u shërbyer qytetarëve shqiptarë, pra duke u shërbyer njerëzve, ndërsa ne i trajtojmë si bujkrobër, si skllevërit e dikurshëm dhe u themi: “Jo, nuk ta japim as diplomën kur mbaron studimet, megjithëse ti ke paguar 450 mijë lekë çdo vit”. Kjo është arbitrare, e pandershme dhe antikushtetuese. Ka nga ata që thonë: “Sa mirë”, por ta dini që ky është kulmi i së keqes; është kulmi i persekutimit të intelektualëve; është kulmi i persekutimit të mjekëve të rinj, të cilët aspirojnë të specializohen në Gjermani, Francë, Itali apo ku të duan ata, ku të kenë qejf. Bllokimi i tyre është në kundërshtim me çdo parim të zhvillimit, me çdo parim të shkencës dhe profesionalizmit, me çdo parim të të drejtave.

Prandaj, unë u bëj thirrje mjekëve, kolegëve, studentëve që të protestojnë fort, të ngrihen fort dhe të kërkojnë të drejtën e tyre, sepse janë në të drejtën e tyre. Nuk mund të lejohet që e drejta e tyre të shkelet në këtë mënyrë nga një regjim anadollak, i cili është antiintelektual, antishkencë, antizhvillim, antiprogres.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Këtu mbyllem diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër: projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit””.

Fillojmë diskutimin me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja.

Zonja Ibrahimaj, keni fjalën me kohë të pakufizuar.

Delina Ibrahimaj – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”” që sjellim sot përpara jush, vjen si një nismë ligjore, e cila synon të adresojë disa sfida në lidhje me integrimin në vendin e punës të disa kategorive të veçanta, siç janë të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara apo edhe grupe të tjera të veçanta.

Përpara se të kaloj në detajimin e përmbajtjes së projektligjit që vjen për miratim, dua të theksoj se vitet e fundit Shqipëria ka pasur një ecuri mjaft pozitive të tregut të punës. Ne kemi reduktuar normën e papunësisë, kemi rritur shkallën e pjesëmarrjes në forcat e punës, dhe e gjithë kjo ka ardhur falë zbatimit të politikave të suksesshme që kemi ndërmarrë ndër vite, falë krijimit të vendeve të reja të punës, por edhe zhvillimit ekonomik dhe zhvillimit të sektorit privat, që gjithmonë e më shumë ka nevojë për punë të denjë dhe të kualifikuar. Që nga fillimi i qeverisjes sonë ne jemi munduar që t’i përmirësojmë kushtet dhe standardet e zyrave të punës. E kemi ngritur arsimin profesional në një tjetër nivel. Tashmë ne kemi filluar një reformë të madhe dhe gjithëpërfshirëse të rritjes së pagave, me qëllim që të shkojmë një shkallë më tutje në përmirësimin e kushteve të punës, me qëllim nxitjen e punësimit dhe adresimin e të gjitha sfidave të kohës që lidhen me migracionin, qoftë emigrimin, qoftë imigrimin.

Sot është detyra jonë që të vijojmë të hartojmë politika për të adresuar ato sfida të mbetura, dhe projektligji që paraqesim, synon të ndikojë në punësimin e të rinjve. Prej disa vjetësh ne jemi duke punuar me Bashkimin Europian, me qëllim që të zbatojmë skemën e garancisë rinore, e cila synon që të rritë punësimin e të rinjve, të rritë arsimin profesional të të rinjve, duke i ofruar çdo të riu nga mosha 19 vjeç deri në 25 vjeç në më pak se 4 muaj të paktën një punë, një trajnim apo një kurs të formimit profesional.

Ne si qeveri kemi ndërmarrë disa angazhime edhe në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, me qëllim rritjen e punësimit dhe garantimin e një pjesëmarrjeje aktive dhe gjithëpërfshirës në tregun e punës. Hartimi i këtij projektligji synon pikërisht të përmirësojë disa aspekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me integrimin në vendin e punës.

Sot në zyrat e punësimit janë të regjistruar 78 024 punëkërkues të papunë, ku 23% e tyre janë

të rinj që nuk janë në punësim, arsimim apo formim profesional dhe në synojmë që nëpërmjet një plani konkret pune, në zbatim të Strategjisë Kombëtare të Punësimit, ta përgjysmojmë këtë numër deri në vitin 2027. Për ta trajtuar këtë kategori, siç thashë, është parashikuar përfshirja e skemës së garancisë rinore, e cila është iniciativë e BE-së e përfshirë dhe e shtrirë në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Në këtë kuadër, gjatë tremujorit të parë të vitit 2023, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim ka filluar të evidentojë një grup punëkërkesish dhe ka mbështetur me shërbime punësimi dhe aftësimi 2498 të rinj, duke i punësuar ata; ka mbështetur 675 të rinj nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit dhe 1327 të rinj nëpërmjet programeve të formimit profesional

Një tjetër ndryshim që ju paraqitet sot për miratim, ka të bëjë me funksionimin e Fondit Social të Punësimit, duke qenë një nga përparësitë e qeverisë shqiptare. Aktualisht numri i të regjistruarve të kategoria e personave me aftësi të kufizuara si punëkërkes të punë nga 237 persona në vitin 2022, ka shkuar në 720 persona në vitin 2023, kjo vetëm në katërmujorin e parë. Arsyeja është pasi zyrtarë të punësimit po përgatiten t'i asistojnë punëdhënësit me listat e punëkërkesve të papunë.

Në projektligjin që ju paraqitet, ne kemi menduar disa ndryshime ligjore, ku çdo punëdhënës duhet të punësojë të paktën një person me aftësi të kufizuara, kur numri i të punësuarve të punëdhënësit është mbi 25 person, ndërkohë duhet të punësojë nga një person shtesë për çdo 50 punonjës të tjerë të ndërmarrjes. Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e caktuar të personave me aftësi të kufizuara, sipas ligjit duhet të derdhë një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit në masën 100% të pagës minimale në shkallë vendi për çdo muaj për çdo person me aftësi të kufizuara që ai duhej ta punësonte.

Qëllimi i Fondit Social të Punësimit është sigurimi dhe administrimi i mekanizmeve financiarë për nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara.

Projektligji që paraqesim sot, përcakton qartë institucionin që do të mbledhë kontributet nga punëdhënësit, duke reflektuar ndryshimin përkatës për vënien në funksion të Fondit Social

të Punësimit, i cili do të shkojë i gjithi për të mbështetur personat me aftësi të kufizuara në drejtim të punësimit të tyre.

Ndryshimet e prezantuara janë të lidhura drejtpërdrejt me operacionalizimin e Fondit Social të Punësimit, duke përcaktuar se kontributi derdhet nga punëdhënësi dhe pasqyrohet në listëpagesën mujore të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Në ligj është parashikuar se të ardhurat nga kontributet për llogari të fondit derdhen tek institucioni përgjegjës për punësimin e aftësitë dhe janë një zë më vete në buxhetin e tij, i cili do të administrohet nga bordi i administrimit të fondit. Fondi Social i Punësimit do të përdoret për programe të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, të cilat synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, rikonstruksion dhe përshtatje të vendit të punës, por edhe programe riintegrimi social, si dhe mbështetje për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuara.

Përmes zbatimit të këtij kuadri ligjor ne synojmë të punësojmë 9030 persona me aftësi të kufizuara, nga të cilët rreth 3618 do të punësohen në institucione publike dhe 5412 në sektorin privat. Nëse nuk do të punësohen, siç e thashë, kontributet do të derdhen nga punëdhënësi dhe vlera totale, nëse askush nuk do të punësohej, do të ishte 309 milionë lekë.

Më lejoni të nënvizoj edhe një ndryshim të rëndësishëm që propozojmë, i cili ka të bëjë me dy programe të reja të nxitjes së punësimit, në përputhje me skemën e garancisë rinore. Bëhet fjalë pikërisht për këshillimin për punësimin e grupeve e veçanta, duke garantuar shërbime të cilësisë së lartë nga organizata të specializuara, me qëllim ndërmjetësimin dhe integrimin në tregun e punës të grupeve më vulnerabël. Kjo për arsye se grupet e veçanta kërkojnë një trajtim të veçantë dhe shumë të specializuar. Nga ana tjetër, ne propozojmë skemën e kuponit për financimin e formimit profesional, e cila përdoret për mbështetjen e formimit profesional nëpërmjet skemës së kuponit, *voucher*, për financimin e formimit profesional, duke mbuluar plotësisht, ose pjesërisht kostot e një trajnimit të zgjedhur nga punëkërkesi i papunë. Kjo është një skemë që përdoret gjerësisht në BE për të diversifikuar

ofertën publike, me qëllim formimin profesional të punëkërkuësve të papunë në kurse e profesionet e ofruara dhe më të kërkuarat në tregun e punës.

Nëpërmjet këtij ndryshimi ligjor ne synojmë një punësim më të sigurt dhe produktiv për popullsinë; synojmë një nxitje më të madhe dhe produktive të krijimit të vendeve të punës dhe sigurimin e integritit në tregun e punës së grupeve vulnerabel, sidomos të varfërve, grave dhe të rinjve. Ne do të vijojmë të ofrojmë mbështetje buxhetore për të siguruar që asnjë kategori të mos ndihet e lënë mbrapa.

Më lejoni t'ju kujtoj se vetëm në 4 vjetët e fundit buxheti për mbështetjen e programeve të nxitjes së punësimit është rritur me 46%, kjo si një mënyrë për t'iu përgjigjur sfidave, me të cilat jemi përballur kryesisht gjatë periudhës së pandemisë.

Ne sot flasim për forma të tjera mbështetjeje, për forma të reja mbështetjeje, siç është programi i kodimit, për punët komunitare dhe mbështetje për punët komunitare, gjë që tregon vizionin tonë për t'iu përgjigjur drejt dhe në kohë reale kërkesave të tregut të punës.

Ne sot flasim për kurset e formimi profesional, të cilat ofrohen falas për punëkërkuësit e papunë në të gjitha qendrat e formimit profesional në të gjithë Shqipërinë. Në vitin 2022 kanë marrë pjesë në këto kurse 9398 punëkërkuës të papunë, ndërsa është dyfishuar numri i personave përfitues të ndihmës ekonomike që kanë ndjekur këto kurse, duke synuar që të integrojmë pikërisht ato kategori që kanë më shumë nevojë në tregun e punës.

Ne sot kemi një plan 7-vjeçar veprimi, i cili ka në qendër rritjen e mundësive për një punë të denjë nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, nëpërmjet reduktimit të mospërputhjes së aftësive për të gjitha profesionet dhe rritjes së nivelit të aftësive të grave dhe burrave në moshë pune dhe funksionimit më të mirë të tregut të punës për të gjithë.

Përmes ndryshimeve ligjore ne do të mundësojmë gjithpërfshirje në tregun e punës, përmirësim të njohurive, koordinim dhe menaxhim më efikas të shërbimeve publike.

Të nderuar deputetë,

Ne besojmë se nxitja e punësimit kontribuon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike dhe kjo lidhet me disa prioritetet strategjike të vendit, ndaj ju ftoj ta votoni projektligjin!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fillojmë diskutimet.

Fjala për zotin Ilir Metaj.

Ilir Metaj – Ka shumë tregues, me të cilët mund ta matim punën e mirë të qeverisë socialiste, mund të matim kilometrat e rrugëve të reja, mund të matim kilometrat e tuneleve të hapura, mund të matim investimet e reja në energjetikë, mund të matim numrin e dyfishuar të turistëve gjithëvjetorë, mund të flasim patjetër edhe për uljen e deficitit buxhetor apo të përdorim argumente të tjera të këtij lloji, por treguesi më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë te qytetarët shqiptarë është ai i punësimit dhe i të ardhurave familjare, sepse të gjithë treguesit e tjerë që përmenda më lart konvergojnë në fund të fundit pikërisht te ky tregues. Për këtë arsye punësimi ka qenë kryefjala jonë në fushatat elektorale dhe vazhdon të jetë kryefjala jonë në analizat e punës.

A kemi arritur mjaftueshëm rezultate?! Treguesit matin suksese në disa dimensione, sepse norma e papunësisë në 8 vjetët e fundit është ulur në 6%, ndërkohë që paralelisht norma e pjesëmarrjes është rritur me 9%.

Rritja ekonomike me burim veçanërisht investimet, konsumin, eksportin dhe turizmin ka rritur ndjeshëm kërkesën për punë, si pasojë edhe pagën mesatare. Kjo rritje në punësim ka pasur një bazë të gjerë në industri, ndërtim dhe shërbime, duke shënuar një rritje prej 12% të normës së punësimit në 8 vjetët e fundit dhe duke e çuar shifrën në 65%. Jo keq, por nuk është mjaftueshëm, sepse ka ardhur koha që të synojmë një sukses afatgjatë dhe cilësor; ka ardhur koha që forca jonë e punës të rritet jo vetëm në numër, por edhe në cilësi, sepse konkurrenca dhe sfidat që na presin fillojnë, në radhë të parë, me produktivitetin, i cili fillon me rritjen e aftësive të burimeve njerëzore.

Ne nuk duhet të flasim më për punë, por duhet të flasim për kapital human. Kapitali human matet me rritjen e aftësive menaxhuese të burimeve njerëzore.

Rinia jonë duhet të bëhet gati për tregun europian dhe kjo nuk nënkupton vetëm mobilitet fizik të punës drejt Europës, përkundrazi, kjo duhet të kuptojë së pari e mbi të gjitha përfshirje qysh sot në zinxhirët globalë të vlerës së shtuar nga Shqipëria. Ne duhet të synojmë pjesëmarrje pa u larguar nga vendi ynë; ne duhet të marrim pjesën tonë në këtë zinxhir global, i cili nuk njeh

më gjeografi, por i jep akses atij që është gati për këtë dhe ne patjetër që duhet të jemi gati për këtë pjesëmarrje, sepse pjesëmarrja, përveçse sjell të ardhura, përkthehet edhe në njohuri të reja dhe njohuritë e reja përkthehen në novacion e zhvillim të industrive të reja në vend.

Është qeveria, e cila përmes eksperteve të dedikuar për tregjet globale, duhet t'i identifikojë kërkesat e së ardhmes dhe detyrat e sotme në funksion të kësaj të ardhmeje. Këtë detyrë të saj kjo qeveri nuk e ka lenë vetëm me fjalë, por e ka sanksionuar në objektivat që i ka vënë vetes në drejtim të aftësisimit profesional, të përfshirjes së segmenteve të mbetura jashtë këtij procesi dhe, mbi këtë bazë, të draftit të strategjisë 2030.

Natyrisht, puna bëhet me ligje të mira dhe projektligji që kemi sot për shqyrtim, është një ligj i mirë, sepse u përgjigjet këtyre nevojave. Ai nxit punësimin, sepse lehtëson kushtet për hapjen e vendeve të reja të punës, pra mbështet kërkesën për punë; promovon hapjen e vendeve të reja të punës përmes inovacionit, pasi inovacioni është parakusht për rritjen e produktivitetit përmes aftësive teknike që i rezistojnë kohës; mundëson disa përmirësime ligjore në kuadrin e projekteve integruese të BE-së në Ballkanin Perëndimor; mundëson krijimin e Fondit Social të Punësimi që do të thotë se synimet kanë tashmë edhe një mbështetje financiare.

Por rëndësia specifike e këtij projektligji është vëmendja që ai u jep segmenteve të rinisë të përjashtuara nga kategoritë e punësimi dhe aftësisimit për punë. Kjo kategori zë 27,8% të të rinjve. Kjo do të thotë ta njohësh plagën e shoqërisë dhe të përpiqesh ta kurosh atë.

Për të trajtuar këtë kategori është parashikuar, përveç të tjerave, edhe futja e skemës së garancisë rinore në një nen të veçantë të këtij projektligji.

Vëmendja ndaj këtyre të rinjve, deri tani, ndoshta, pa asnjë plan dhe pritshmëri për një jetë më të mire, është një shërbim që i bëhet kombit. Minimizimi i këtij segmenti duhet të jetë një objektivi themelor i institucioneve përkatëse. Kjo do të thotë jo vetëm aktivizim i të gjitha energjive të vendit në funksion të zhvillimit, por, mbi të gjitha, nxjerrja e këtij segmenti nga apatia mbyltese e mungesës së qëllimit në jetë. Trajnimi dhe aftësimi për punë cilësore do të përkthehet në një jetë më të mirë për ata vetë dhe për familjet e tyre.

Ndaj e mbështes plotësisht këtë projekt dhe ju inkurajoj që në ardhmen të kemi projekte të tjera për nxitjen dhe për promovimin e punësimi Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zonja Ilda Dhori.

Të përgatitet zoti Erion Braçe.

Ju lutem, teknika, do të flasë nga vendi!

Ilda Dhori – Faleminderit!

Në fakt, çështjet e punësimi janë shumë të mprehta, aktuale, të përhershme dhe të vazhdueshme në Shqipëri, veçanërisht kur ato prekin të rinjtë, grupet vulnerabël, siç janë personat me aftësi ndryshe.

Në fakt, ligjet aty kanë qenë, por ne çedojmë në faktin se nuk i zbatojmë ligjet dhe herë pas here i përshtatim, i bëjmë më të mira në letra, por sërish vazhdojmë të mos i zbatojmë.

Për sa u përket personave me aftësi ndryshe, në 4 vjet, qëkur është miratuar ligji, sepse ligji është i vitit '95, janë punësuar vetëm 18 persona me aftësi ndryshe. Sa janë sot pritshmëritë pas miratimit të këtij ligji?! Unë shpresoj të jenë shumë, por jam skeptike dhe besoj se sërish do të ngelemi në vazhden e letrave dhe do të qëndrojmë aty, pa pasur një rezultat konkret për sa i përket punësimi.

Sa funksionojnë sot zyrat e punësimi në Shqipëri?! Edhe kjo vlen për t'u diskutuar, sepse nuk e di që të ketë shqiptar që të shkojë të regjistrohesh aty dhe të ketë përfituar punë, pra të jetë integruar në tregun e punës. Për më tepër, ne kërkojmë të cenojmë edhe të drejtën e punësimi të lirë të profesionistëve, të atyre që i kërkon tregu brenda në Shqipëri, edhe tregu jashtë. Pikërisht këtë kategori që e kërkon tregu i punës (këtu flas edhe për pjesën jashtë Shqipërisë), ne duam ta mbajmë aty ku na duhet, pra ta çojmë me orë të tëra larg familjes, larg vendbanimit, për aq kohë sa i intereson propagandës qeveritare për të përmbushur ato qëllime që, në fakt, po shkojnë gjithnjë edhe më tepër larg pritshmërive dhe asaj që na shpalolet në propagandën e përditshme të qeverisë. U referohem mjekëve, të cilët janë tema e ditës, pasi studentët e mjekësisë janë në protestë, edhe nesër do të jenë në protestë për një plan që ka Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit për të kushtëzuar me anë të kontratave arsimimin e kësaj kategorie studentësh, pra ata që duan të vazhdojnë mjekësinë e përgjithshme, më pas edhe punësimin

e tyre, duke i detyruar ata të punojnë për 3 vjet sipas nevojave të vendit dhe për 3 vjet u privohet marrja e diplomës pas arsimit 6-vjeçar, pra ciklit 6-vjeçar normal të arsimit të mjekësisë së përgjithshme. Nuk e di se ku mund të shikohet një gjë e tillë, ku mund të ndodhë një gjë e tillë, përveçse në sistemet totalitare, nga të cilat edhe ne kemi një eksperiencë të para 30 vjetëve, por që sot tentohet të rikthehen sërish nga kjo qeveri. Mua më duket realisht absurde që t'i detyrojmë këta studentë, të cilët janë edhe ekselentët e këtij vendi, dhe të kushtëzojmë arsimin e tyre. Cili do të jetë rezultati? Rezultati do të jetë tashmë jo vetëm zbrazja e Shqipërisë nga mjekët, gjë që jemi duke e jetuar me mungesë shërbimi të specializuar, veçanërisht në zonat e thella larg Tiranës, por edhe zbrazja e Fakultetit të Mjekësisë nga studentët, sepse kam bindjen që asnjë nga kjo kategori studentësh nuk do të pranojë të kushtëzohet në arsimim, aq më tepër në qëllimet që i kanë vendosur vetes për një kualifikim sa më të mirë për të qenë ata shërbyesit mrekullibërës nesër të pacientëve të tyre dhe për të qenë gjithmonë më të mirët në fushën ku kualifikohen, sepse janë njerëz që i shërbejnë këtij vendi.

Në fakt, ajo që ne kemi zgjedhur deri tani, absolutisht nuk është ajo që zgjedhin vendet demokratike, pra t'i nxitim, t'i përkrahim dhe t'i mirëpaguajmë këta profesionistë, të mbrojmë dinjitetin këtyre njerëzve, që shërbejnë nga mëngjesi deri në darkë dhe që i kanë dhënë kaq shumë shoqërisë shqiptare, gjë që u dëshmuar në kohën e pandemisë kur ishin në vijën e parë të luftës me COVID-19. Për këtë arsye edhe në ligjin "Për strehimin social" ne si komision kemi propozuar që, krahas shtresave të tjera në nevojë, të përfshihen familjarët, fëmijët e mjekëve që kanë humbur jetën në krye të detyrës gjatë pandemisë, si një kategori që duhet të përkrahet me kredi të lehtësuara për çështjen e strehimit.

Ajo që kemi zgjedhur që në krye të herës, dhe vazhdojmë sot sërish edhe me këtë akt, me këtë planprojekt, është ta denigrojmë figurën e mjekut, sepse në hyrjen e QSUT-së shikojmë banderola të mëdha "Stop korrupsionit", "Denonco korrupsionit", sepse thua se këtu në QSUT dhe në spitalet e mëdha të vendit fshihet korrupsioni; thua se në atë bakshishin e pacientit ndaj mjekut, ndaj infermierit e të tjerë fshihet korrupsioni; thua se këta njerëz janë problemi i kësaj shoqërie, prandaj ky vend nuk ecën përpara.

Në fakt, mendoj dhe kam bindjen që këto banderola duhet të jenë tjetërkund, në hyrjet dhe në hollet e ministrive, duhet të jenë në hyrje të Kryeministrisë, të institucioneve të tjera të këtij vendi, aty ku bëhen tenderët, aty ku merren taksat e shqiptarëve dhe tjetërsohet destinacioni i tyre, aty ku vidhen çdo ditë shqiptarët për të çuar qindra mijëra euro, madje edhe në shtëpitë e sanitareve të zyrtarëve të lartë të ministrive, jo më të mendosh te vetë zyrtarët e lartë.

Kështu që aty duhet të jenë këto banderola dhe jo në hyrje të spitaleve, jo t'i përdorim mjekët për shou mediatik publik për të tërhequr vëmendjen nga skandali i radhës qeveritar. Kështu që në kushtet e një sistemi të tillë, që i përdor, që nuk i vlerëson, që i denigron, që i zhvesh totalisht edhe në punën e tyre të përditshme, që përfshin edhe gabimet njerëzore të profesionit, patjetër që mjekët do të zgjedhin të largohen, të ikin në vende të tjera që i mbështesin, në vende të tjera që i vlerësojnë, që u japin pozicionin që meritojnë, dinjitetin e tyre dhe të vazhdojnë jetën të qetë, pa pasur mendjen se dikush do t'i kapë mbrapa nga përparësja dhe do t'i nxjerrë në kamerat e medieeve.

Nga ana tjetër, unë jam e sigurt që ky planprojekt i ministrive nuk do të ketë asnjë sukses, sepse ne e pamë dhe po i shikojmë kontratat e detyruara në specializime, ku në vitet e para pati një lloj interesi dhe tashmë që tregu është i mbushur, sidomos në qendrat më të mëdha, ku mungojnë vendet e punës për këta specialistë, shikojmë se kemi shumë pak interes, madje nuk plotësohen as kuotat e specializimeve. Domethënë, ka rënë ndjeshëm niveli i specialistëve që ne sot prodhojmë në shëndetësi, sepse interesi i mjekëve të rinj për ta vazhduar këtë proces në Shqipëri ka rënë, duke qenë se sot ka mjekë specialistë që punojnë, në rastin më të mirë, si mjekë familjeje dhe në raste të tjera janë të papunë. Pra, 10 vjet për formim profesional, për të shërbyer, të shkuara dëm në këtë vend!

Unë dua t'u bëj thirrje të dyja ministrive që të tërhiqen nga ky absurditet, i cili nuk do t'i çojë askund, i cili thjesht do të boshatisë edhe universitetet, konkretisht të mjekësisë, nga një shtresë elitë, nga një shtresë nxënësish që vërtet mund t'i japin shumë kësaj Shqipërie, nëse nesër do të trajtoheshin jo me masa shtrënguese, jo me këtë formë diktatoriale për t'i mbajtur këtu kundër vullnetit të tyre, por do të trajtoheshin me dinjitet,

do të përkraheshin, do të mbështeteshin, t'u ofroreshin kushtet dhe infrastruktura e duhur për të punuar dhe për të bërë detyrën e tyre, atë që më së shumti është dëshira dhe qëllimi i tyre.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zoti Braçe.

Të përgatitet zonja Zheni Gjergji.

Erion Braçe – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Ligji që kemi përpara apo ndryshimi në ligjin bazë përmes këtij projektakti, është një përpjekje shumë e mirë. Të gjitha të rejtat, si politika, si programe, si instrumente dhe në fund fare si rezultate janë të mirëpritura në çdo kohë që ato vijnë, natyrisht, në çdo formë që ato paraqiten para nesh. Puna po ndryshon, por tregu i punës te ne jo, informaliteti mbetet i lartë dhe problem serioz; pagat e padrejta vazhdojnë të jenë prezente dhe, pa diskutim, që janë një problem shumë i madh; gjysma i merr lekët në dorë, gjysma tjetër i merr në bankë; pushimet arbitrare nga puna në tregun tonë natyrisht që janë bërë normalitet; jemi mbrapa, shumë mbrapa.

Në Europë po provohet java 4-ditëshe e punës, si një instrument i rëndësishëm për të rritur produktivitetin në punë dhe për t'u dhënë mundësi punëtorëve që të jenë gjithnjë edhe më shumë pranë familjeve të tyre dhe tek aktivitetet e tjera që plotësojnë ditën e tyre. Ndërkohë, puna në distancë po bëhet gjithnjë edhe më e gjerë në funksion të përmirësimit të ditës, pra dhënies kohë çdo punonjësi, punëtori apo nëpunësi që të përmirësohet për sa i takon aftësisë së tij profesionale, natyrisht edhe për t'iu përkushtuar, veçanërisht gratë dhe vajzat, pjesës tjetër të familjes.

Inteligjenca artificiale ka nisur të sfidojë akoma edhe më fort. Lajmet që vijnë nga bota për shkurtim të vendeve të punës dhe për përshtatje në përdorimin e inteligjencës artificiale, natyrisht që do të jetë një sfidë shumë e madhe, do të mbërrijë edhe këtu te ne, sidomos këtu te ne. Nga ana tjetër, kjo sfidë nuk është asgjë para atij që po e vuajmë të gjithë në këtë vend: agresionit të ekonomive të mëdha për të marrë punëtorë, veçanërisht nga vende si ne, ku paga ngelet ende e ulët në sektorin privat dhe ku 5 euro më shumë i detyrojnë njerëzit të largohen nga ky vend.

Shifrat në statistika natyrisht që janë inkurajuese. Vitin që shkoi ne e mbyllëm punësimin me 3,9% më shumë, pra punësimi u rrit

gjatë vitit 2022 me 3,9%, ndërkohë që 3-mujori i parë i këtij viti shënon shifrën 4,4% dhe i referohet numrit të të punësuarve. Po t'i shikosh, duken numra shumë të mirë, pa më të voglin diskutim. Ajo që mua më shqetëson, ka të bëjë me konstatimin që vjen më pas: ne po humbin punëtorë dhe po humbin punëtorë në sektorë jetikë. Krahasuar me 3-mujorin e mëparshëm, në 3-mujorin e parë të vitit 2023 punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart u rrit me 0,4%. Punësimi u ul me 3,2% në sektorin e bujqësisë dhe me 1,8% në sektorin e industrisë. Janë dy sektorët më të gjerë dhe më prodhues të ekonomisë kombëtare.

Nga ana tjetër, statistika e pagave për këta 3 muaj na bën me dije se paga mesatare në këtë vend arriti në 64 mijë e 706 lekë dhe u rrit me 9,2%. Por shikoni nga vjen rritja! Vjen nga sektorët ku ne po humbin punëtorë, dhe ky është një problem shumë i madh. Paga mesatare bruto për aktivitetin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, si ndër aktivitetet me pagë mesatare më të ulët se paga mesatare në nivel kombëtar, ka pasur një rritje të lartë prej 14,2%.

Dua të ndalem këtu për të thënë disa gjëra: paga mesatare sot, referuar pikërisht këtyre statistikave, në sektorin e bujqësisë ka arritur në nivelin 43 mijë e 900 lekë. Natyrisht, kjo është rroga që i referohet sektorit të agropërpunimit, i cili në pjesën më të madhe të tij është formal dhe deklaron në organet fiskale, por edhe në ato të sigurimeve shoqërore. Në bujqësi tregu i punës thuhet është informal, natyrisht paga është më e lartë sesa kjo. Për shkak se po humbin punëtorë në bujqësi dhe, për fatin tonë të keq, po humbin punëtorë në bujqësi të cilët bëjnë të njëjtën punë, punën e bujkut, në vendet përreth, qoftë në Greqi, nga Veria deri poshtë në Kretë, qoftë në Itali, nga Piemonte lart e deri në Siçili, natyrisht që dita e punës në bujqësi është bërë e shtrenjtë, është 20 mijë dhe 25 mijë lekë, por, mbi të gjitha, në periudha piku, si kjo në të cilën jemi, ku prodhimi është në fazën e pjekjes së tij dhe të vjeljes dita e punës është më e lartë, por e gjitha paguhet në të zezë, është informale.

Ajo që mua më shqetëson përsëri në këtë sektor, pra në sektorin e bujqësisë, ka të bëjë me një element tjetër akoma më të rëndësishëm, që është puna e papaguar, e pamatur kurrë, e bujqve që punojnë në ekonominë e tyre familjare, qoftë kjo blegtorale, qoftë edhe bujqësore, qoftë kjo në fushë të hapur, qoftë edhe në serrë. Kjo u mungon

statistikave. Natyrisht, puna e papaguar e bujkut është problemi më i madh që ne kemi dhe elementi kyç pse të rinjtë që merren me bujqësi janë gjithnjë edhe më pak në fshat dhe janë gjithnjë edhe më shumë në fshatrat e Greqisë apo të Italisë, si shqiptarë, si bujq të rinj shqiptarë.

Atëherë, në këtë pikë mendoj se na duhen disa gjëra, që janë shumë të rëndësishme. Pra, ligji që ne kemi sot është shumë i mirë, por kam përshtypjen se e ka lënë jashtë vëmendjes totalisht sektorin më të gjerë të ekonomisë kombëtare të vendit, sektorin e bujqësisë. Ne kemi bërë një përpjekje shumë të madhe për të stimuluar, për të nxitur, për të subvencionuar bujqësinë, por ende, pavarësisht masave mbështetëse që kemi pasur, nuk i kemi bindur të rinjtë që të rrinë këtu, të bëjnë punën e bujkut këtu, dhe ka një arsye: është rroga, është dita e punës e paguar dhe e garantuar, por që të arrijmë në këtë pikë, duhet bëjmë komplet të kundërtën e asaj që po bëjmë sot, jo me këtë ligj, por të asaj që po bëjmë atje matanë, në fshat e prodhimit bujqësor dhe në çdo objekt tjetër të përpunimit të prodhimit bujqësor, të prodhimit nga blegtoria dhe të përpunimit nga blegtoria.

Po ju marr vetëm grurin. Shikoni, ka filluar korrja. Kjo është java e parë e korrjes së grurit në të gjithë territorin e vendit. Pjekja, për shkak edhe të temperaturave shumë të larta, sot është e mjaftueshme dhe, natyrisht, të gjithë janë turrur nëpër fusha për të marrë prodhimin dhe gruri është një produkt 9-mujor, nuk është një produkt që e ka ciklin e shkurtër 3-4 muaj, si ai i serrave, por është një produkt që ka 9 muaj një cikël. Çmimi që po u ofrohet sot bujqve, natyrisht i bën ata që ta quajnë veten të humbur, jo thjesht për shkak të punës së papaguar, por edhe për shkak të ardhurave që do të marrin. Që t'ua mbledhësh sot bujqve grurin me 28 lekë për kilogram, nuk ka më monedha që të justifikojnë punën e 9 muajve kur himet që dalin nga gruri këta po na i shesin me 37 lekë për kilogram dhe kur miellin që del nga gruri këta po e shesin me 70 lekë për kilogram dhe kur çmimi i bukës nuk ndryshon, edhe pse këta na thonë që po sjellin grurë nga Serbia, nga Ukraina, nga Serbia, nga Rusia me 28 lekë, kur buka sot duhej të ishte me 600-700 lekë. Kjo, natyrisht, e bën bujkun të mos punojë, të mos mbjellë dhe ta lërë punën me tokën, e cila, në gjykimin tim, është puna më fisnike që bëhet në këtë vend.

Të thuash që sot çmimet i vendos tregu, kur e di fare mirë që kostoja e atij produkti, me të

gjithë subvencionin që pagoi qeveria për hektar, është më e lartë se sa 28 lekë, natyrisht është të dorëzohesh dhe ta lësh fushën e hapur për tregtarët abuzues, për ata që grabisin dy herë, edhe bujkun për prodhimin e tij, por edhe për qytetarin me produktin final të cilin i shesin. Këtu duhet ndërhyrë dhe duhet të ndërhyjë shteti. Në qoftë se ka një arsye apo një produkt për të cilin, natyrisht, duhet një bord, ky është drithi, është produkti më strategjik që ka një vend dhe duhet mbrojtur. Nuk po i kërkoj qeverisë të bëjë ndonjë gjë që të bjerë ndesh me çdo ligj kombëtar dhe ndërkombëtar, por të bëjë atë që Komisioni Europian bëri për Poloninë, për Hungarinë, për Sllovakinë, për Slloveninë dhe për Bullgarinë: të mos lejojë që në ato territore të tregtohet grurë importi me çmim më të lirë sesa kostoja e grurit të prodhuar në vend. Kaq, asgjë më shumë, pjesën tjetër dinë ta bëjnë bujqit fare mirë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zonja Zheni Gjergji.

Zheni Gjergji – E nderuar zonja Kryetare,
Të nderuar qytetarë,

Shtesat në dy projektligjet që do të shkojnë sot për votim, atë të nxitjes së punësimit dhe atë për strehimin social, aq të rëndësishme për të gjithë shoqërinë shqiptare, në fakt, nuk sjellin asgjë të re për adresimin e nevojshëm të çështjeve dhe problematikave që kanë të bëjnë me strehimin social dhe me nxitjen e punësimit në tërësi, në veçanti për të rinjtë, si dhe për integrimin në tregun e punës të personave me aftësi të kufizuara. Rinia shqiptare sot nga dita në ditë po beson më pak te politikat e kësaj qeverie, por edhe tek opozita si alternativë politike. Këtë e tregoi numri i ulët i të rinjve që morën pjesë në zgjedhjet e 14 majit. Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në këtë proces ishin regjistruar 122 mijë e 545 votues për herë të parë, por vetëm 16 mijë e 628 prej tyre ushtruan të drejtën e votës, pra 90% e të rinjve votues për herë të parë na braktisën.

Të dashur kolegë,

Ky fakt duhet të na shqetësojë të gjithëve. Të rinjtë shqiptarë, ata të arsimuar, por edhe ata pa profesion, po largohen masivisht nga Shqipëria dhe kjo çështje për ne duhet të jetë një kampion alarmi, pasi prej një dekade jemi në kushtet e një emergjence kombëtare. 55 mijë vota largohen çdo vit nga vendi, 90% e të cilëve nuk kthehen as për një periudhë afatshkurtër, as për një periudhë

afatmesme dhe 35% e tyre janë rreth 25 vjeç. Një nga arsyt kryesore të këtij largimi masiv është papunësia dhe përmirësimi i kushteve ekonomike familjare.

Më 2013-ën premtuat 300 mijë vende pune, por, edhe pse kanë kaluar 10 vjet, jeni ende shumë larg premtimit tuaj elektoral. Të rinjtë në Shqipëri hasin vështirësi në gjetjen e punëve të kualifikuara dhe të mirëpaguara, duke mos garantuar dot një të ardhme të sigurt për veten dhe familjen. Kjo bën që të rinjtë, sidomos ata të zonave periferike të Shqipërisë, të emigrojnë. Gati 570 mijë shqiptarë kanë emigruar në 10 vjetët e fundit.

Shkopullimi i vendit nga rinia, po, ky është objektivi që keni realizuar. Sipas INSTAT-it shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç është rritur në 22,5% nga 21,5%, që ishte në tremujorin e parë të 2023-shit. Në krahasim me mesataren europiane, prej 6,3%, shkalla e papunësisë tek të rinjtë shqiptarë është 3 herë më e lartë. Edhe në raport me shtetet e tjera të rajonit treguesi është shumë negativ. Sipas Eurostat-it në Serbi papunësia tek të rinjtë e grupmohës 15-29 vjeç ishte 8,6%; në Maqedoninë e Veriut 14%. Pra, Shqipëria, si një vend që pret anëtarësimin në BE, është vetmja që e ka ende shkallën e papunësisë tek të rinjtë mbi 20%.

Përqindjen më të lartë të të papunëve e përbëjnë të rinjtë as në punësim, as në arsim dhe trajnim, NEET, me 26,1%, edhe ky tregues është më shumë se dyfishi i BE-së, që e ka 13,1%. Nga ky grup gjatë vitit 2021, 37% e tij ishin të papunë, 15,4% ishin punëtorë të dekurajuar; 17,5% ishin duke përmbyshur detyrat familjare; ajo që është bie në sy është se vetëm 10% e të rinjve, NEET, janë të regjistruar në zyrat e shërbimit publik të punësimit. Çka dëshmon edhe njëherë mosbesimin e tyre te funksionimi e institucioneve dhe politikat e kësaj qeverie.

Fatkeqësisht, edhe pse që nga viti 2019 kemi pasur një ligj për nxitjen e punësimin, sot mund të themi se ky ligj përgjatë këtyre 4 vjetëve ka dështuar në hartimin e politikave për punësimin e të rinjve në përgjithësi dhe grupeve të individëve me aftësi të kufizuara në veçanti. Vetëm 18 individë me aftësi të kufizuara kanë përfunduar nga ky ligj deri më sot, ndërkohë 9030 duhet të ishte numri i individëve të punësuar nëse ky ligj do të ishte zbatuar. Kjo jo vetëm që nuk ka ndodhur, pra që ligji nuk është zbatuar prej 4 vjetësh, dhe për

këtë nuk mban përgjegjësi asnjëri, por personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre janë në vështirësi të mëdha ekonomike, duke pasur parasysh edhe periudhën e vështirë të pandemisë, ku u ndien të papërkrahur.

Ndaj ne, si opozitë, mendojmë se ligji nuk ka pasur mangësi, siç po thuhet sot, por ai thjesht nuk është zbatuar dhe do të vazhdojë sërish të mos zbatohet, sepse kjo qeveri zyrtarë i ka për burokratët, horrat, batakçinjtë e qejflinjtë, sepse vendet e punës shiten në këmbim të votave, sepse i paafiti drejton dhe për të aftin nuk ka punë.

Korrupsioni qeveritar po i zbeh çdo ditë e më shumë shpresat që vendi ynë mund të ndryshojë, ndaj, edhe pse miratojmë shtesa ligjore, asgjë e re nuk pritet të ndodhë. Gjithsesi, duke falënderuar ministrinë përgjegjëse, që disa propozime të miat dhe të opozitës i bëri pjesë të ndryshimeve ligjore, mendoj se ne, si ligjvënës, kemi detyrimin të jemi në pritshmëritë e qytetarëve që na kanë votëbesuar. Sigurisht, për të ushtruar këtë detyrë duhet të jemi seriozë dhe t'i kërkojmë qeverisë të jetë llogaridhënëse jo vetëm në kuadër të mënyrës sesi formëson politikat e saj, si e propozon përmbajtjen e kuadrit ligjor, që rregullon fusha të caktuara, siç është edhe nxitja për punësim, por ne duhet t'i kërkojmë të japë llogari për mungesën e vullnetit ndaj miratimit të kuadrit ligjor mbështetës, nëpërmjet të cilit këto ligje marrin efekte konkrete implementimi.

Ndaj, sot, duke mbështetur ndryshimet e ligjit nr. 15/2019, kërkoj që monitorimi i këtij ligji të jetë në fokusin tonë, kolegë, në përputhje me detyrën tonë dhe domosdoshmërinë e kohës për nxitjen e punësimin në vend.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për ministren Manastirliu.

Të përgatitet zonja Tabaku.

Ogerta Manastirliu – E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Përpara se të flas për ndryshimet që janë propozuar në ligjin “Për nxitjen e punësimin”, ndryshime të cilat shkojnë në të njëjtën linjë me strategjitë tona, me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me prioritetet tona strategjike në kuadër të mbështetjes së të rinjve, në kuadër të mbështetjes së kategorive në nevojë, veçanërisht personave me aftësi të kufizuara, më lejoni të bëj

një sqarim për një çështje, e cila u ngrit nga kolegët e opozitës lidhur me një cikël diskutimesh, që së bashku me ministren e Arsimit dhe rektorin e Universitetit të Mjekësisë së Tiranës kemi nisur me studentët e Fakultetit të Mjekësisë, për të vlerësuar mekanizma dhe instrumente, të cilat do të nxitin akoma më shumë mundësinë për të kontribuar në vend të të gjithë studentëve që studiojnë në mjekësi dhe më pas licencohen për të ushtruar profesionin si mjekë; për të parë dhe për të vlerësuar mekanizma, mundësi të ndryshme, alternativa, që do të mundësojnë që mjekët e ardhshëm ta ushtrojnë profesionin e tyre në Shqipëri, të mbështeten nëpërmjet incentivave, ashtu sikurse kemi bërë deri më sot, duke i mbështetur mjekët për sa u përket kushteve të punës, por edhe nga ana financiare.

Në fakt, kemi nisur një cikël diskutimesh, kemi bërë edhe diskutimin e dytë, ku kemi pasur ide, që janë ngritur nga studentët, por, gjithashtu, edhe opsione apo zgjidhje, që besojmë se deri në fund të ciklit të këtyre diskutimeve do të gjenden zgjidhjet apo mekanizmat dhe do të bëhet më e mira, në mënyrë që ne të mos mendojmë vetëm për atë që mund të japim sot. Në fakt, një qeveri e përgjegjshme ndërton politika, të cilat i rezistojnë kohës dhe mendon për të sotmen, për të nesërmen, por edhe për atë që do të vijë më 2030-ën, apo edhe më tej, sepse ajo çka kemi hasur në praktikën e të kaluarës nuk ka qenë aq mbështetëse qoftë për profesionistët e shëndetësisë, qoftë për qytetarët e vendit, mbi të gjitha.

Unë besoj se të gjithë ju këtu, por edhe vetë qytetarët e mbajnë mend që specializimet nuk u hapën për katër vjet në Universitetin e Mjekësisë, gjë që shkaktoi jo katër, por vite të gjata mungese në spitalet tona rajonale dhe bashkiake të mjekëve specialistë. Nuk u hapën për katër vjet specializimet, çka do të thotë se minimumi 1 200 mjekë specialistë u privuan nga e drejta për të ofruar kujdes shëndetësor për qytetarët shqiptarë, por, nga ana tjetër, iu mohua kujdesi qytetarëve shqiptarë, duke u bërë ajo që duhej bërë në ato momente, i morën shërbimet në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, si struktura universitare që ofronte të gjitha specialitetet.

Situata ka ndryshuar. Me hapjen e specializimeve, cikle të cilat janë hapur përgjatë këtyre 9 vjetëve, janë më shumë se 2 000 specialistë, të cilët tashmë po përgatiten dhe më

shumë se gjysma e tyre tashmë kanë dalë nga cikli i specializimeve dhe po ushtrojnë profesionin e tyre. Më shumë se 500 mjekë specialistë në këta 5 vjet, 2018-2023, janë atashuar pranë spitaleve tona rajonale, bashkiake, universitare, të cilët po e ushtrojnë profesionin e tyre dhe po ofrojnë më shumë shërbime afër vendbanimit. Vetëm me përfundimin e ciklit të fundit të specializimeve, që përfundoi tani, në muajin mars 2023, janë 60 mjekë specialistë, të cilët janë atashuar pranë spitaleve tona rajonale dhe bashkiake.

Ja pra, nuk janë të vërteta ato që thonin, se nuk ka mjekë specialistë apo që specializantët i paguajnë vetë specializimet e tyre, sepse për të gjitha ato angazhime që Ministria e Shëndetësisë, qeveria shqiptare, ka marrë për ata specializantë, të cilët janë kuotë e mbuluar, pra e zënë, e Ministrisë së Shëndetësisë, paga e mjekut specialist, pra shteti investon, është sa 80% e pagës së mjekut.

E dini sa paguheshin apo investohej për specializantët përpara 10 vjetëve? As 20 mijë lekë të rinj nuk merrnin, ndërsa sot marrin 1000 euro, me rritjen e pagave që ne bëmë për mjekët specialistë, ku 80% e pagës u shkon specializantëve, të cilët janë me kontratë të lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë.

Duke qenë se sapo ka përfunduar edhe cikli i ri i specializimeve për këtë vit, janë më shumë se 120 kuota, që janë lidhur me Ministrinë e Shëndetësisë për të vijuar plotësimin e nevojave me mjekë specialistë. Sigurisht, ne do të vijojmë të mendojmë jo vetëm për të sotmen, edhe për të nesërmen, edhe për 2030-ën, sepse angazhimi ynë në strategjinë e shëndetësisë, por edhe në planin tonë të zhvillimeve të burimeve njerëzore, e kemi fokus parësor dhe absolut, është mbështetja e burimeve njerëzore, qoftë në përmirësimin e kushteve të punës, qoftë në mbështetjen financiare për ta.

Duke u kthyer tek aspektet e ligjit “Për nxitjen e punësimit” unë dua të ndalem te një instrument i rëndësishëm, i cili, në fakt, shkon në të njëjtin drejtim me reformën që ne kemi ndërmarrë sa i përket mbështetjes së personave me aftësi ndryshe, është pikërisht krijimi i fondit social të punësimit të personave me aftësi të kufizuara, një instrument më tepër, i cili do të garantojë që punësimi i personave me aftësi të kufizuara qoftë në institucionet shtetërore, qoftë në ato private të jetë mbi 9 000.

Sigurisht, ky është një ndër aspektet parësore të këtij ligji, sepse fokusi ynë, përpos reformimit të skemës së aftësisë së kufizuar, nëpërmjet ngritjes së 37 komisioneve biopsiko-sociale në strukturat e qendrave shëndetësore, ku më parë më shumë se 35 mijë qytetarë duhet të vinin në Tiranë për të bërë komisionimet dhe rikomisionimet, me reformën e re tashmë ata e kryejnë afër vendbanimit vlerësimin e ri biopsiko-social, duke e bërë më të lehtë aksesin te mjeku, por, nga ana tjetër, edhe vlerësimin, për të marrë më pas mbështetjen financiare, që parashikon skema e mbrojtjes sociale për aftësinë e kufizuar. Ajo mundëson pikërisht këtë, më shumë aksesueshmëri për shërbimet sociale, më shumë akses edhe për shërbimet e punësimit.

Ne po ngremë një mekanizëm, siç është fondi social i punësimit, ai do të garantojë që në rastet kur institucionet shtetërore, por edhe ato jopublike nuk do të realizojnë punësimin e personave me aftësi të kufizuar në masën e parashikuar në ligj, atëherë do të ketë një mbështetje financiare, e cila do të derdhet pikërisht në këtë fond social, që do të shkojë për aftësimin profesional, për më shumë nxitje për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Sigurisht, ky është një instrumentet shumë i mirëpritur, i cili do të garantojë edhe një tjetër aspekt për personat me aftësi të kufizuar, por edhe për ata me status të aftësisë së kufizuar, që aftësitë e tyre mund t'ua lejojnë punësimin, sepse ky parlament ka miratuar, gjithashtu, përpara disa vitesh ligjin për asistencën sociale, ku ndër pikat më të rëndësishme të këtij ligji ishte fakti që nëse një person me aftësi të kufizuara, me status, mund të punësohet, atëherë ai e përfiton edhe mbështetjen financiare, që merr nga paketa e mbështetjes së ndihmës ekonomike, përgjatë gjithë kohës, edhe gjatë punësimit të tij. Pra, dikur mbështetej vetëm 4 vjet, me ndryshimet ligjore që ne propozuam, tashmë mbështetja është pandalshme, pra do ta marrë edhe përpos faktit që mund të punësohet.

Një tjetër instrument i rëndësishëm është edhe garancia rinore, një instrument që vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor e kanë aplikuar, që do të vlejë pikërisht për punësimin e të rinjve të grupmoshës 15-29 vjeç. Sigurisht, do të mbështesë këtu edhe ata anëtarë të familjeve me ndihmë ekonomike, që kanë të rinj që janë pjesë e kësaj skeme dhe mbështeten nga skema e ndihmës

ekonomike, për të mundësuar që, qoftë me ndërmjetësimin për punësim nëpërmjet skemës së garancisë rinore, por, nga ana tjetër, edhe nëpërmjet instrumentit të ri, pra skemës së kuponit, të rriten aftësitë profesionale të të rinjve, të cilët janë pjesë e skemës së ndihmës ekonomike dhe kërkojnë një mbështetje të shtuar nga programet sociale.

Pra, çfarë vjen sot me ndryshimet e këtij ligji i shërben më shumë rritjes së aksesueshmërisë për grupet vulnerabël dhe, mbi të gjitha, i shërben një qasjeje të barabartë dhe shanse të barabarta për qytetarët, duke e pasur fokusin tek të rinjtë dhe te personat me aftësi të kufizuar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zonjën Tabaku.

Të përgatiten ministria Muzhaqi dhe zoti Ilirjan Pendavinji.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Besoj se nuk ka të djathtë e të majtë sot që të mos pranojë se Shqipëria po përballet me dy kriza reale, që po ndikojnë sot dhe, çfarë është më e rëndësishmja, do të ndikojnë nesër.

Së pari, është kriza e emigracionit, ku qeveria ka dështuar për të promovuar, prodhuar, por edhe për të propozuar politika, sidomos për të rinjtë, për të ndaluar emigracionin.

Së dyti, është kriza e besimit tek institucionet.

E dëgjova me shumë interes zonjën ministre, dhe besoj se edhe ajo bie dakord me mua, kur shikon ato skena të të rinjve duke protestuar me disa pankarta nëpër duar, që ikja masive e të rinjve tregon dështimin e sistemit, tregon dështimin tonë, e dashur Ogerta. Ne jemi sistemi, nuk ka sistem tjetër. Po u ndryshua, e ndryshojmë ne sistemin; kur them ne, e kam fjalën për politikën, ato që sot qeverisin, institucionet. Ky sistem ka dështuar, sepse të rinjtë sot po largohen masivisht, fatkeqësisht.

Të dyja krizat, si ajo e besimit tek institucionet, por edhe ajo e emigracionit, lidhen me korrupsionin; lidhen me sistemin, që shpeshherë i ndryshon fytyra, por jo përmbajtja; i ndryshon forma, por jo thelbi, ku disa ikin e të tjerë vijnë, por në vetvete nuk ndryshon asgjë.

Ky është problemi real që ka sot ekonomia, që ka politika, që ka sistemi, sepse nuk po

prodhohet më dhe nuk po vjen më ajo shpresë, që t'i mbajë të rinjtë të punojnë, të jetojnë dhe të kontribuojnë këtu.

Qeveria, sigurisht, është në të drejtën e saj të sjellë këtu, në parlament, ligje kozmetike. Ky është një ligj kozmetik, që nuk e ndryshon thelbin e gjësë; një ligj që merret me disa elemente dytësore të mungesës së punësimit të të rinjve, të sfidës së punësimit tek të rinjtë.

E dëgjova me shumë interes zonjën ministere, e cila tha se me ligjin e miratuar për asistencën sociale ata që janë me aftësi të kufizuar vazhdojnë ta marrin pagesën për aftësinë e kufizuar edhe pse janë të punësuar në institucione. Ndërkohë, ne debatua dy orë në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave me zëvendësministren e Financave dhe Ekonomisë, e cila thoshte të kundërtën: personat me aftësi të kufizuar nuk punësohen dot, sepse nuk duan të heqin dorë nga përfitimet që ata kanë nga burime të tjera.

Tani, kur vetë përfaqësuesit e qeverisë nuk e kuptojnë se si zbatohet ligji, kur vetë përfaqësuesit e qeverisë janë të paqartë se çfarë ndodh me legjislacionin, se cilat janë arsyet pse nuk punësohen, pse janë të kufizuara mundësitë, atëherë si mendoni se ata që e zbatojnë këtë ligj janë më të qartë për ta kuptuar dhe për ta vënë atë në praktikë?!

INSTAT-i raporton se papunësia tek të rinjtë në fund të vitit 2022 ishte 21,5%, ndërsa në Europë mesatarja është 6,3%. Megjithëse kemi numrin më të lartë të emigrimit, megjithëse kemi normën më të lartë të largimit nga Shqipëria, përsëri papunësia tek të rinjtë është më e lartë se mesatarja e vendeve të BE-së.

Fatkeqësisht, është më e lartë edhe te mjekët. Vetëm në periudhën 2020-2022 largimi i mjekëve ishte në masën 22%. A e kemi ne luksin të humbasim kaq shumë mjekë dhe profesionistë të tjerë? A e ka luksin Shqipëria t'i largohet shtresa e mesme? A mundet sot që sistemin e shëndetësisë, të arsimit, të bujqësisë dhe çdo sistem tjetër ta lëmë të vazhdojë të degradojë, pa mungesën e këtyre të rinjve?

Unë kisha menduar që kjo duhet të ishte një emergjencë kombëtare; që qeveria duhet të vinte me propozime konkrete se si mund të ndryshohet dhe se si mund të hartohet një strategji dhe një politikë kombëtare për punësimin, por jo me propozime për ndryshime kozmetike, për një bord që shpërndan disa fonde; jo me ndryshime

kozmetike, që nuk e ndryshojnë thelbin e gjësë, që nuk i vënë zyrat e punës në lëvizje, që nuk targetojnë të rinjtë, që nuk merren fare me ato nevoja që ka sot tregu.

Diskutuam edhe në komision me ministren Ikonomi, por njëkohësisht edhe sot në seancë se cilat janë sfidat e reja; a ka qeveria shqiptare një strategji për të mbështetur biznese në teknologjinë e informacionit, në agroturizëm, në arsim për tendencat e reja të inteligjencës artificiale? Ne jemi te pentium 2 kur bota ka shkuar tek *chatGPT*. Ne flasim për borde që shpërndajnë fonde, sepse na i kërkon BE-ja, ndërkohë që të rinjtë largohen; ne flasim për një situatë, që nuk lidhet fare me realitetin, sepse sot, fatkeqësisht, shqiptarët po largohen.

Në vend që të konkurrojmë me rajonin për çdo vend pune; në vend që ne të jemi në garë për çdo vend pune; në vend që të tërheqim investimet e huaja; në vend që të bëjmë paketa për bizneset që të vijjnë këtu; në vend që të bëjmë oferta reale për bujqësinë dhe turizmin, që kanë nga 20% të të ardhurave në PBB, shqetësimi i madh i këtij parlamenti është se si të krijojmë një bord, që ndan disa fonde! Unë nuk besoj se kjo është ajo çka kërkon sot rinia.

Kjo është një çështje që e kërkon të gjithë politikën që të bëhet bashkë. Largimi i të rinjve ndikon sot në ekonominë e vendit, ndikon nesër në PBB, ndikon në largimin e shtresës së mesme dhe në fund ndikon edhe te ne, sepse kur shkojmë për të trokitur në ato dyer nuk gjemë më votues. Ne do të jemi përpara një realiteti, që nuk do të ketë kush të na votojë. Ata që kandiduan për bashkitë kanë shkuar dhe kanë bërë fushatë elektorale në Londër; kanë shkuar kanë bërë fushatë elektorale në vende të tjera, sepse qytetet janë zbrazur.

Shumë mirë që i keni ndërtuar qendrat e qyteteve, po kujt i duhen ato qendra të bojatisura të qyteteve?!

Kështu që, nëse duhet ta shohim këtë problem realisht, le të marrim masa për rininë, me një strategji kombëtare, që e kthen punësimin e të rinjve në prioritet; që nuk merret me kozmetikë; që merret me thelbin përse po largohet rinia.

Disa nga kolegët nuk e kanë me qejf kur unë e përmend Europën, por, më ka rënë për hise dhe do ta përdor. Në shumë vende të tjera, zoti Braçe, ky problem ka ndodhur në prag të anëtarësimit në BE. Është normale, sepse për 10 vjet kanë pritur

që vendi të anëtarësohet dhe nuk po anëtarësohet, sepse jemi në këtë pellgun që vendi vazhdon për 10 vjet te paradhoma e anëtarësimit. Nëse ka diçka që duhet bërë, është përshpejtimi i këtij procesi. Përshpejtimi i këtij procesi, ndërmarra e reformave dhe angazhimi në masa reale mund ta ndryshojnë situatën.

Cila ka qenë reforma e fundit që kanë votuar deputetët në këtë parlament? Unë mbaj mend vetëm reformën në drejtësi që votuam më 2016, edhe kjo ka qenë e imponuar.

Çfarë reforme ka sjellë në parlament qeveria, që e ndryshon në thelb gjënë? Flasim për reforma të mëdha, por në fund të ditës vetëm ligje kozmetike vijnë këtu. Asnjë ndryshim thelbësor, asgjë se si mund ta ndryshojmë situatën qoftë për të rinjtë, për fermerët, për mjekët që po ikin dhe po e kthejnë në emergjencë sektorin shëndetësor; asgjë nuk ndryshon në thelb; asgjë nuk ndryshon në përmbajtje, vetëm forma.

Siç duket e nisën si qeveria e formës dhe do ta mbyllin si qeveria e formës.

Unë besoj se Shqipëria ka një potencial të jashtëzakonshëm tek të rinjtë dhe ne po e humbasim këtë potencial, po humbasim edhe avantazhin konkurrues. Sot, 1 në 3 të rinj është pa shkollë dhe pa punë; 13% është mesatarja e vendeve të BE. Jemi dyfish mbi mesataren e vendeve të BE-së. Mirë puna, që nuk është më një opsion për të rinjtë, por, fatkeqësisht, as arsimit nuk është më një opsion për ta.

Dëgjoj pa fund raste nga kolegët e mi, të cilët thonë se sa vështirësi ka sot në sistemin e arsimit, që një student i mirë dhe i zoti t'ia dalë. Sot klasat po zbrazen edhe në universitete dhe kjo është kambana e dytë. Ky ndryshim nuk vjen me retorikën se po investojmë në arsim, por vjen me investime reale.

Vendet që kanë përparuar dhe kanë mbështetur sot zhvillimet më të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, janë ato shtete që kanë investuar më shumë në arsim. Po dështuam ta bëjmë këtë, pra po të mos investojmë në këto fusha që janë prioritare, nesër thjesht do të detyrohemi të mbyllim dyert e institucioneve, të mbyllim dyert e bashkive dhe të presim në qoftë se vjen ndonjë nga emigracioni të na votojë.

A e dini se në shumë bashki sot, duke filluar nga Gjirokastra, Elbasani e të tjera, ka vende bosh në drejtori të rëndësishme si te planifikimi buxhetor apo edhe në drejtori të tjera të integritit

europian, pasi njerëzit e shkolluar po largohen dhe nuk ka kush të punojë? Këtë gjë duhet të shohë qeveria. Çfarë mund të bëjmë ne për të mbajtur të rinjtë këtu? Çfarë mund të bëjmë për të ndryshuar sistemin, për t'u ofruar atyre mundësi reale dhe të mos vijmë të diskutojë këtu retorikë boshe se të gjithë qenkan të kënaqur? Realiteti nuk është ky që shohim në këtë sallë, realiteti, fatkeqësisht, është tek ata të rinj që sot largohen, pasi nuk shohin shpresën dhe përgjigjen nga kjo sallë e parlamentit.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Braçe, keni 2 minuta kohë për replikë.

Erion Braçe – Meqenëse zakonisht u referohem fakteve, patjetër kjo që po na ndodh neve u ka ndodhur edhe vendeve të BE-së kur u bënë pjesë e saj.

Unë do t'ju lutesha shumë që të shikonit Italinë sot, e cila është në ciklin e dytë të ndodhjes së kësaj historie, pasi nuk ka mjekë, nuk ka infermierë, po i largohen të gjithë. A e dini ku? Në ishull, në Irlandë. Pse? Sepse rroga atje për të sapodiplomuarit është shumë herë më e lartë se në Itali. Ky është tregu.

Cila është fatkeqësia jonë? Fatkeqësia jonë është se edhe Gjermania, kur njofton për vende pune, njofton për shoferë, për muratorë, për karpentierë, për hidraulikë, për elektrikistë e kështu me radhë.

Fatkeqësia jonë e dytë më e madhe ka të bëjë me faktin se të tilla punë i bëjnë ata që janë shkolluar këtu, të cilët nuk punojnë në profesionin e tyre, por në këto profesione. A është ky një fenomen europian? Po, është një fenomen europian, sepse edhe grekët po vuajnë të njëjtën gjë, po ashtu edhe italianët. Edhe më lart po të shkosh, në Kroaci, e njëjta histori është, po ndodh kjo gjë, por problemi është sa shpejt adaptohen shoqëritë në zhvillimet e reja që ndodhin në treg dhe, veçanërisht, në tregun e punës.

Në qoftë se ka një gjë që ne duhet ta bëjmë këtu dhe duhet ta bëjmë pa imponim, siç bëmë pa imponim reformën në drejtësi, por e bëmë me iniciativën tonë, patjetër duhet të jetë përshtatja me zhvillimet e reja të të gjitha tregjeve tona. Në qoftë se ne tregjet do t'i lemë në gjendjen siç është, në fakt, tregu i bujqësisë, patjetër që njerëzit do të ikin. Cili i ri sot dëshiron që të bëjë punën e gjyshit me kokën ulur tek toka? Cila e re sot dëshiron që të bëjë punën e gjyshes, duke mjelë

lopën? Askush, sidomos kur puna është e papaguar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për ministrën Muzhaqi.

Të përgatitet zoti Ilirian Pendavinji dhe më pas zoti Luan Baçi.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Nuk ka replikë mbi replikë, e dimë këtë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Të lutem, ti e bëre replikën, të mos e prishim tani!

Ju e mbajtët fjalën tuaj dhe folët kur deshët, kështu që vijojmë me kolegët.

Bora Muzhaqi – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Është e trishtë të dëgjosh kolegët, në fakt, të cilët as nuk dëgjojnë dhe as nuk lexojnë dhe, mbi të gjitha, përmendin dhe fjalën kozmetikë për një ligj dhe për një skemë reformuese, që nuk po e bën vetëm Shqipëria, e bën i gjithë Bashkimi Europian e për më tepër ka dhe rezultate shumë të mira kur zbatohet.

Meqenëse ra fjala, edhe strategji për rininë kemi, është 2022-2029, edhe strategji për punësimin dhe aftësimin kemi, edhe kjo është e miratuar. Duhet t'i lexojmë ndonjëherë strategjitë, t'i kuptojmë edhe masat, edhe politikat që ato përcaktojnë, se ndryshe pastaj nuk dimë t'i diskutojmë. Kjo është e rëndësishme që ta bëjmë të gjithë ne, sidomos nëse jemi këtu duke bërë një debat konstruktiv.

Unë, ndryshe nga kolegët, mendoj se sot është një ditë shumë e rëndësishme, ku ne hedhim një hap shumë të rëndësishëm për të rinjtë shqiptarë, qoftë me projektligjin “Për nxitjen e punësimin”, qoftë me projektligjin “Për strehimin social”, sepse të dyja përbëjnë dy hallka shumë kyçe për mekanizmat që shteti po ngre në mbështetje të të rinjve në vend.

Së pari, kur flasim për projektligjin “Për nxitjen e punësimin”, ky siguron një bazë ligjore për ngritjen e skemës së garancisë rinore në vend.

Skema e garancisë rinore, që nuk po hartohet vetëm nga ne, por po hartohet në bashkëpunim me ekspertizën më të mirë të Bashkimit Europian, adreson drejtpërdrejtë nevojat e të rinjve shqiptarë, të cilët nuk janë as në punë, as në shkollë dhe as duke ndjekur një program trajnimi. Kjo skemë në vetvete synon që, pasi të

identifikohen të gjithë të rinjtë sipas rasteve të tyre individuale, të ketë mundësi të sigurohet nga ana e shtetit mbështetja dhe një ofertë e vlefshme punësimi, shkollimi apo formimi profesional, brenda 4 muajve të përfshirjes së një të riu në skemë. Aktualisht, janë rreth 130 000 të rinj ose 27% e numrit total të të rinjve në vend, që i përkasin kësaj kategorie, normë kjo, ndryshe nga çfarë u tha këtu, që është më u ulët se mesatarja e vendeve të Ballkanit Perëndimor; përtej kësaj, mbetet pak më e lartë se mesatarja e Bashkimit Europian, prandaj dhe është e rëndësishme që ta adresojmë sot.

Këta të rinj përbëjnë dhe pjesën më të cenueshme dhe janë në kushte më të vështira të të gjithë të rinjve në vend, prandaj dhe programi i garancisë rinore, i cili do të fillojë zbatimin vitin e ardhshëm, përbën një nga programet me ndikimin më të drejtpërdrejtë dhe më të gjerë në numër përfituesish të përgatitura ndonjëherë për të rinjtë, duke iu përgjigjur edhe nevojave kryesore të artikuluar nga vetë ata, atë të formimit dhe aftësimin, sipas nevojave të tregut të punës dhe sigurimin e punësueshmërisë së tyre.

Në këtë kuadër, meqenëse folëm më parë për inteligjencën artificiale, për kodimin, për programimin dhe për të gjitha fushat e të ardhmes, duhet t'ju them se ne kemi një tjetër program që ka nisur zbatimin në janar të vitit 2023 dhe është në linjë me parashikimet e këtij projektligji. Programi i kodimit për të rinjtë i mundëson çdo të riu mbi 16 vjeç e lart ndjekjen e kurseve intensive të formimit profesional për zhvillimin e aftësive dhe kompetencave digjitale. Me anë të këtij programi, qeveria shqiptare ofron 100% mbështetje për ndjekjen e kurseve të programimit, për punëkërkuesit e papunë, dhe një mbulim 50% të pagesës së kursit, në linjë me konceptin “Voucher” ose të kuponit të prezantuar në këtë projektligj, për të gjithë studentët apo të rinjtë në marrëdhënie pune, por që duan të thellojnë njohuritë e tyre në fushat e programimit dhe kodimit apo duan të ndryshojnë edhe drejtimin e karrierës në përputhje me zhvillimet e tregut të punës.

Ky program është mirëpritur nga të rinjtë, siç vërtetohet edhe nga shifrat, se shifrat flasin më mirë se fjalët. Në fakt, për 5 muaj ne kemi pasur mbi 3000 aplikime, prej të cilave 524 të rinj kanë filluar tashmë kurset e programimit dhe kodimit

për t'u përfshirë në fushat e së ardhmes, jo vetëm të Shqipërisë, por të të gjithë botës.

Suksesi i shpejtë i këtij programi na bën vërtet besimplotë dhe na nxit të punojmë edhe më tepër për miratimin e këtij projektligji dhe fillimin e zbatimit të garancisë rinore, ku edhe oferta e kurseve intensive të aftësisë dhe formimit profesional për të rinjtë do të thellohet dhe do të zgjerohet më tej, për të gjithë ato fusha profesionale dhe sektorësh që do të jenë shtyllat e zhvillimit të vendit për dekadën e ardhshme.

Së dyti, doja të ndalesha pak te projektligji "Për strehimin social" që adreson një nga nevojat më të mprehta për të rinjtë dhe familjet e reja, atë të sigurimit të një strehimi të përbalueshëm. Strehimi i familjeve të reja përbën në vetvete një vështirësi, por është kthyer gati e papërbalueshme dhe e pamundur gjatë dy viteve të fundit me rritjen e normave europiane të referencave të kredisë. Prandaj, nisma e qeverisë për të mbështetur një pjesë të kostos së kredisë dhe siguruar strehimin e përbalueshëm të familjeve të reja, të të rinjve dhe punonjësve të administratës publike, që kanë shpenzuar kohë e kapital për t'u shkolluar dhe që kontribuojnë çdo ditë në ekonominë e vendit dhe jo vetëm, është një mbështetje e drejtë dhe e nevojshme për këta të rinj dhe përbën në vetvete një garanci për vijimin e kontributit të tyre për të tashmen dhe të ardhmen e vendit.

Sigurisht, në linjë me çdo masë që ndërmarim, edhe kjo mundësi do të ofrohet online, duke ua bërë procesin edhe me të lehtë dhe pa andralla administrative të rinjve që duan të krijojnë familjen e tyre dhe të kenë mundësinë e një shtëpie.

Të nderuar deputetë,

Paçka se mundësitë tona nuk na lejojnë që oferta jonë për të rinjtë të jetë aq tërheqëse se ajo e vendeve si Britania e Madhe apo Gjermania, është e domosdoshme që ne së bashku ta bëjmë garancinë rinore realitet, pasi përvoja europiane ka dëshmuar dhe ka prodhuar rezultate kudo që është zbatuar. Ne duhet të sjellim në jetë këto rezultate për të mbrojtur të rinjtë tanë nga joshja e asaj çfarë rezervon emigracioni i pasigurt.

Prandaj, ju ftoj të votoni pro projektligjit "Për nxitjen e punësimit" dhe pro projektligjit "Për strehimin social". Kjo votë pro shkon në të mirë të punësimit dhe strehimit të të rinjve, në përmirësimin e kushteve të jetesës së çdo të riu

dhe mbështet të ardhmen e vendit. Le të bëjmë secili të vetën dhe punojmë të gjithë së bashku për të mbështetur të rinjtë tanë.

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Pendavinji.

Të përgatitet zoti Luan Baçi.

(Ndërrhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, zonja Tabaku, keni fjalën për replikë, 2 minuta.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zonja Kryetare!

Zoti Braçe, politika nuk është ankesë, politika është ofertë. Ata ikin nga Italia, shkojnë në Irlandën e Veriut, sepse kanë politika taksash më të mira. Bëje Shqipërinë atraktive, që të rrinë këtu dhe të mos largohen. Ky është problemi tek oferta politike që vjen sot, tek oferta që vjen për të rinjtë për të qëndruar këtu.

Me zonzën nuk kam çfarë replike të bëj, sepse ata që lexojnë mesazhe të gatshme kanë ikur dhe kanë ardhur nga ky parlament, kemi parë shumë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Pendavinji, fjala për ju.

Ilir Pendavinji – E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

I dëgjova me shumë vëmendje parafolesit dhe bie dakord edhe me zotin Braçe, edhe me zonzën Tabaku, që vërtet duhet të jemi të shqetësuar për ikjen të rinjve. Bie dakord me të dy për pjesën e punësimit, si do t'i punësojmë të rinjtë, si do t'i mbajmë këtu, si do t'i mbajmë ata në fshat, siç tha Erioni, apo si do t'i mbajmë në të gjithë Shqipërinë, siç tha zonja Tabaku. Këtë shqetësim duhet ta kemi vërtet të gjithë bashkë, pra të dyja kahet e politikës, se nuk e ka fajin as PS-ja dhe as PD-ja për ikjen e të rinjve, por konkluzioni është se ne po na ikin të rinjtë dhe pjesa më vitale e kësaj shoqërie.

Si mund t'i mbajmë këtu? Ejani të bëhemi të gjithë bashkë. "Kjo gjë po ndodh në të gjithë rajonin" - tha Erioni, dhe është e vërtetë. Ne të gjithë e dimë se në çdo vend të rajonit po ikën fuqia punëtore, duke nisur nga Greqia, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Kroacia apo Italia. Patjetër ata ikin se oferta andej ku shkojnë është më e mirë, ikin edhe për 5 dollarë më shumë në orë.

Unë u bëj një thirrje të rinjve se kudo që të shkojnë, Shqipërinë nuk do ta gjejnë askund, edhe

pse me këto kushte që kemi këtu. Mbase situata jonë politike lë për të dëshiruar dhe besoj se duhet të ndryshojë edhe mënyra se si ne e bëjmë dialogun. Unë jam nga ata deputetë, që i mëshoj dialogut shumë konstruktiv ndërmjet forcave politike në komisione, por shpeshherë edhe në parlament kam bërë thirrje.

Për t'iu referuar ligjit të fundit që po miratojmë, siç tha edhe zonja Gjergji, në komision janë bërë shumë ndryshime, ku reflektuam edhe propozimet që u bënë nga opozita. Pra, duke pasur dakordësinë e të dyja palëve dhe dashamirësinë që ta bëjmë të mirë këtë ligj, se ndoshta nuk kemi ditur ta bëjmë apo nuk e kemi bërë mirë për x arsye, menduam të bëjmë këto ndryshime që neve nuk na kanë shkuar në mendje që t'i bënim më parë. Rezultati i këtij ligji është vërtet pjesë e të dyja forcave politike, ku, pa dyshim, edhe opozita ka meritën e saj.

Gjatë kësaj dekade qeverisjeje kemi sjellë në këtë sallë për miratim projektligje të ndryshme, të cilat kanë pasur gjithmonë për qëllim efektivitetin e legjislacionit në praktikë, si dhe të shërbyerit sa më shumë dhe sa më mirë qytetarëve të këtij vendi.

Me të njëjtin qëllim kemi sjellë për miratim sot edhe ndryshimet në projektligjin "Për nxitjen e punësimit", ku, konkretisht, përmes ndryshimeve të propozuara rrisim mundësinë e punësimit të forcave të punës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit, si dhe të formimit profesional. Në mënyrë të veçantë u japim zgjidhje problematikave të dala gjatë zbatimit katërvjeçar të këtij ligji, përfshirë këtu: zbatimin në praktikë të dispozitave lidhur me Fondin Social të Punësimit; kontributin e punëdhënësve, si dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të politikave shtetërore, të cilat qëllimisht qeveria shqiptare i ka fokusuar tek të rinjtë si një kategori me një rëndësi të veçantë për vendin dhe të ardhmen.

Në këtë projektligj parashikojmë për herë të parë skemën e garancisë rinore përmes së cilës synojmë të mbështesim të rinjtë deri në 29 vjeç, duke u dhënë një ofertë punësimi, arsimim të vazhdueshëm apo praktikë profesionale brenda një periudhe 4-mujore nga momenti i regjistrimit në zyrën e punësimit. Gjithashtu, në këtë ligj shtojmë vëmendjen ndaj grupeve vulnerabël, të cilëve ky akt u garanton integrimin në tregun e

punës dhe barazinë sociale në kushtet e punësimit. Ky ligj është një nga hapat kyçe për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe planit të zbatimit të garancisë rinore.

Çështjet më kritike të punësimit që kërkojmë të përmirësojmë, janë konkretisht: zbatimi i skemës së garancisë rinore për të rinjtë, si pjesë e iniciativës të BE-së për Ballkanin Perëndimor, si dhe mbështetja e të rinjve deri në 29 vjeç, që nuk janë të punësuarit me arsim ose me formim profesional, të cilët do të përfitojnë një ofertë punësimi, formimi profesional, arsimim në vendin e punës brenda një periudhe 4-mujore, duke i identifikuar ata si një grup të veçantë që duhet të trajtohen me përparësi, sepse këta përbëjnë rreth 37,3% të këtyre të papunëve.

Pjesa tjetër është jashtë fuqisë punëtore, sepse janë punëtorë të dekurajuar, duke përbushur përgjegjësitë shtëpiake dhe familjare ose për arsye të tjera. Megjithatë, rreth 10% e të rinjve janë të regjistruar në shërbimet publike të punësimit dhe kontakti duhet shtrirë përtej këtij numri.

Programet sipas skemës së garancisë rinore dhe procedurat e zbatimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për vënien në funksion të fondit social të punësimit, ligji parashikon vendosjen e kuotave për punësim të personave me aftësi të kufizuara. Kjo është një nga ato grupmosha, që nuk kanë përfituar. Këta 4 vjet ne kemi dështuar në këtë pjesë dhe besoj se me ndryshimet e fundit ligjore, të cilat do të rrisin kontributin në këtë fond social, do të rritet edhe numri i të punësuarve të kësaj kategorie. Çdo punëdhënës për këtë kategori do të punësojë një person me aftësi të kufizuara për 25 punonjësit e parë të ndërmarrjes dhe nga një person shtesë për çdo 50 punonjësit e tjerë të ndërmarrjes mbi parashikimet e bëra në shkronjën e parë të nenit.

Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1 të këtij neni, i del kontributi i përlogarituri i fondit social të punësimit në masën 100% të pagës minimale në shkallë vendi për çdo person me aftësi të kufizuara.

Qëllimi i fondit social të punësimit është sigurimi i administrimit të mekanizmave financiare për nxitjen e punësimit. Meqenëse ky fond nuk është vënë në zbatim për arsye të problematikave, siç e theksova edhe në fillim,

kontributet nga të gjithë punëdhënësit do të mbliidhen nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke shërbyer kjo drejtori si një agjent tatimor për mbledhjen e këtij kontributi.

Fondi social i punësimit do të përdoret në programet që synojnë vetëpunësimin, rehabilitimin në punë, riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim, shërbime mbështetëse, si dhe rikonstrukcion në përshtatje të vendit të punës për personat e parashikuar në këtë ligj.

Punëdhënësit kanë të drejtë të kërkojnë subvencion nga strukturat përkatëse rajonale. Fondi social i punësimit do të administrohet nga bordi i administrimit të fondit, sipas legjislacionit në fuqi, që do të vendoset me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, me vënien në zbatim të këtij ligji duhet të punësohen rreth 9030 persona me aftësi të kufizuar, nga të cilët 3618 në institucionet publike dhe rreth 5412 në sektorin privat.

Fondi i punësimit social do të zbatohet duke filluar nga viti 2024. Realizmi i planit të zbatimit do të sjellë përfitime reale, duke rritur punësimin dhe përfitime të të papunëve të kësaj kategorie.

Gjithashtu, një pikë e rëndësishme e këtij ligji, që dua ta theksoj, janë programet për nxitjen e punësimit.

Në nenin 11 të këtij ligji flitet për dy programe të reja për nxitjen e punësimit: këshillimi për punësim për grupe të veçanta, si një garanci për shërbime me cilësi të lartë nga organizatat e specializuara në tregun e punës dhe skema e kuponit financiar për mbështetjen e formimit profesional. Ky kupon mbulon plotësisht kostot e një trajnimit të zgjedhur nga një punëkërkuar i papunë. Kjo skemë përdoret gjerësisht në vendet e Bashkimit Europian, duke ndihmuar formimin profesional dhe ngritjen profesionale të punëkërkuarëve të papunë.

Të nderuar kolegë, besoj se ky projektligj do t'i japë zgjidhje njëfarë problematike që ka hasur zbatimimi i këtij ligji. Gjithashtu, reflekton parashikime në përputhje me aktualitetin, në lidhje me punësimin e të rinjve; garanton përfshirjen në tregun e punës të grupeve vulnerabël; kontribuon në përmirësimin e situatës aktuale të punësimit të popullsisë dhe, për rrjedhojë, besoj se do të sjellë punësim më të madh për të rinjtë shqiptarë, por edhe të punësim

të grupeve vulnerabël, duke rritur mirëqenien në shoqërinë shqiptare.

Unë ju ftoj ta miratojmë këtë ligj.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Luan Baçi.

Të përgatitet zonja Desantila Tahiraj.

Luan Baçi – Zonja Kryetare,

Kolegë deputetë,

Unë do ta nis fjalën time aty ku e la zoti Braçe. Është shqetësimi i madh aktual që ka të bëjë me çështjen e atij punësimi shumë të rëndësishëm që ju po e çoni në faliment të plotë, për fermerët dhe për prodhimet e tyre në bujqësi.

Në fakt, ditët e fundit më kanë kontaktuar shumë fermerë, bujq të drithërave të shumë zonave të Lushnjës dhe Fierit, të cilët apelojnë të shqetësuar për fatin e prodhimeve të tyre në bujqësi, sidomos për grurin që po korret këto ditë. Prodhimet e tyre janë tërësisht të rrezikuara nga pushtimi i tregut nga produktet serbe që importojnë monopolet e miellit. Ky është vërtet një sabotim i pastër i punës dhe i sakrificës disavjeçare të qindra familjeve të këtyre zonave dhe të vetë bujqve, të cilët kanë investuar gjithë jetën e tyre në kultivimin e drithërave.

Drithërat shqiptare, sidomos gruri që është i bollshëm këto ditë në Fier, rrezikojnë të kalbet dhe fermerët rrezikojnë të falimentojnë. Ata do të falimentojnë nga mosshitja e grurit të fabrikat e miellit, të cilat sot po kërkojnë ta marrin grurin me 22 deri me 25 lekë kilogramin, kur kostoja e 1 kilogrami grurë dihet tashmë që fillon nga 30, 35 apo edhe 40 lekë kilogrami.

Unë nuk e di se sa e kuptoni ju situatën në të cilën ndodhen fermerët, por e vetmja gjë që më habit, madje më habit shumë, është se kur kolegu Braçe ngre një problem kaq të rëndësishëm për fermerët dhe prodhimet e tyre bujqësore, ai merr duartrokkitje nga të gjithë kolegët e tij. Atëherë mua më lind pyetja: tallen kolegët e tij me të apo tallen zoti Braçe me fermerët? Sepse të ngresh zërin kaq fuqishëm në foltoren e parlamentit, madje të bërtasësh aq fort sa të tërheqësh vëmendjen e të gjithë të pranishmëve këtu në sallë, dhe të mos arrish të bashkëpunosh me kolegët e tu të mazhorancës, me qeverinë tënde, që në këto ditë shumë të vështira të fermerëve të ndërhyri që ata të mos falimentojnë, pasi janë në një gjendje vërtet të vështirë, është një fakt konkret. Madje, fabrikat e miellit po i marrin prodhimet e tyre, duke u thënë të presin për arsye

se ata marrin miell nga jashtë, miell që futet nga importi.

Nuk ka gjë për të qeshur, zonja Ministre, ju mund të vini dhe të bisedoni direkt me fermerët. Pra, nuk është propagandë kjo që po ju them këtu. Po të keni kurajën, zbrisni poshtë në Myzeqe dhe pyesni se sa është kostoja e një kilogram grurë, sa e shet fermeri te fabrika e miellit dhe a është në gjendje fermeri të mbijetojë dhe të nxjerrë shpenzimet e tij? Absolutisht, fermerët janë të falimentuar. Për këtë ju duhet të reagoni dhe jo të qeshni, ju duhet të reflektoni dhe jo të qeshni, ju duhet të merrni përgjegjësi dhe jo t'i falimentoni fermerët. Ju nuk duhet të talleni me ta, duke nxjerrë këtu një, dy apo tre deputetë, të cilët flasin me fjalë të bukura për t'u bërë qejfin fermerëve se gjoja ju po interesoheni për ta, por, në fakt, nuk po veproni.

Nuk e kuptoj se kujt ia kërkoni gjithë këtë interesim që keni, ua kërkoni deputetëve të opozitës për ta bërë?! Jo, është detyra juaj, kushtet i keni, mundësitë i keni, votat i keni, atëherë veproni. Ulni traun e doganës, le t'u bien pak fitimet atyre pronarëve të mëdhenj dhe të fuqishëm dhe të subvencionohen, të ndihmohen fermerët e thjeshtë dhe të varfër, qytetarët e këtij vendi, se po i detyroni të largohen që të gjithë.

Kjo ishte në kuadër të këtij ligji të nxitjes së punësimit. Konkretisht sot kemi arnim të këtij ligji për nxitjen e punësimit. E quaj "arnim", sepse kështu i keni katandisur Kushtetutën dhe ligjet e këtij vendi dhe këtë e bëni për të qenë në rregull me propagandën dhe manipulimin që i bëni shpeshherë opinionit publik. Për t'u treguar njerëzve se mendoni për ta, ju flisni për punësimin dhe keni harruar se para 10 vjetësh kur erdhët në pushtet, premtuat 300 mijë vende pune. Çfarë rezultati kemi arritur sot? Ka rezultuar se nga vendi janë dëbuar 3 herë më shumë qytetarë se 300 mijë vendet e punëve që premtuat. Në 10 vjet janë larguar nga vendi ynë mbi 900 mijë qytetarë, të rinj e të reja, inxhinierë, mjekë dhe profesionistë të ndryshëm, dhe vazhdojnë të ikin, sepse nuk gjejnë punë, nuk mund të përballojnë dot shkollën dhe jetën e shtrenjtë të studentit në Tiranë. U fikët çdo shpresë dhe i larguat të gjithë.

Sot që flasim, rreth 30% e të rinjve në Shqipëri janë të papunë, pa arsim të përgjithshëm dhe pa formim profesional. Këto shifra janë përcjellë nga INSTAT-i, por jam i bindur që ka më shumë të rinj të ikur, të cilët shteti shqiptar nuk

i ka të regjistruar dhe absolutisht nuk e di se ku janë. Të dhënat në tërësi bëhen më të trishta kur mëson nga Eurostat-i se Shqipëria renditet me papunësinë më të lartë në Ballkanin Perëndimor dhe në Europë. Në krahasim me mesataren europiane prej 6,3%, shkalla e papunësisë tek të rinjtë shqiptarë është 3 herë më e lartë.

Të dhënat që i përkisnin fillimit të pandemisë tregonin se 70% e të papunëve në Shqipëri ishin me arsim të lartë, ndërkohë që Kosova, Maqedonia e Veriut dhe rajoni kishin 20% të kësaj kategorie. Për fat të keq, papunësinë, pas të rinjve, e vuajnë më shumë gratë, e theksuar më shumë veçanërisht pas pandemisë.

Ky projektligj, sikurse edhe ligji ekzistues, nuk sjell asgjë të re në politikat nxitëse reale të punësimit në tërësi. Ne jemi dëshmitarë që zyrat e punësimit, programet dhe formimi profesional janë inefficente. Zyrat tuaja të punësimit funksionojnë për militantët, për njerëzit tuaj të afërt dhe për patronazhistët, por nuk ka aspak shërbime të përgjegjshme për qytetarët e tjerë.

Në ndryshimet e këtij projektligji ju thoni: "Punëdhënësi ka të drejtë të kërkojë subvencionim financiar për punësimin e personave me aftësi ndryshe ose të shtresave të marginalizuara". Jemi dakord me këtë, por nuk është parashikuar mënyra e marrjes së kësaj mbështetjeje. Sa është afati i marrjes së kësaj mbështetjeje? Subvencionimi do të bëhet nga strukturat e pushtetit vendor apo nga strukturat e pushtetit qendror? Si gjithmonë, këto i lini në letër, që absolutisht të mos vihen në jetë.

Ne nuk kemi asnjë informacion për numrin e personave apo të kryefamiljarëve në nevojë, të punësuar në shërbimet e bashkive apo në subjektet e bizneseve private. Po ashtu, nuk kemi asnjë informacion për mbledhjen e detyrimeve ndaj punëdhënësve që nuk kanë punësuar persona të kësaj kategorie, sipas parashikimeve të ligjit të vitit 2019. Si do të funksionojë pagesa e sigurimeve shoqërore të kësaj kategorie në sistemin *online* të tatimeve? Në këtë projektligj parashikohet një pagesë për të rinjtë që zgjedhin trajnim profesional. Sa është numri i të rinjve që kanë përfituar nga programi i garancisë rinore për nxitjen e punësimit, nëse keni përgjigje? Sa funksionon dhe sa njohuri kanë të rinjtë, të cilët ndjekin një kurs formimi profesional në subjektet private, për kuponin e financimit nga shteti?

Ndër të tjera, në projektligj theksohet se për të rinjtë nën 29 vjeç jo të punësuar, pa arsim të përgjithshëm apo pa arsim profesional do të ofrohet një mundësi punësimi ose trajnim profesional brenda 4 muajve nga paraqitja e kërkesës në zyrat e punësimit. Thjesht gënjeni, bëni atë që dini të bëni më mirë.

Konsumimi i tepërt i pushtetit nga skandalet e korrupsionit, por edhe nga skandale të tjera të shumë llojeve, po e rëndojnë edhe më tepër jetën e shqiptarëve të thjeshtë e të varfër.

Dua t'ju sjell në vëmendje se turizmi, për të cilin ju propagandoni me të madhe, ka shumë mundësi të sjellë dështime këtë sezon, sepse çmimet janë të papërbalueshme, si për pushuesit nga Kosova, edhe për të huajt, ndërsa për qytetarët shqiptarë nuk bëhet fjalë fare. Biznesi i hotelerisë dhe i restoranteve po përballen me mungesën e theksuar të fuqisë punëtore, pasi nuk ka banakierë, kuzhinierë, kamerierë apo pastrues. Të rinjtë tanë zgjedhin më mirë të shërbejnë në hoteleritë italiane, greke dhe të vendeve të tjera, sepse këtu nuk gjejnë motiv për të jetuar.

Zotërinj të mazhorancës, merrni masa reale dhe sa më të shpejta për të mbështetur punëdhënësit dhe të nxisni punëkërkuessit të qëndrojnë në vend.

Të më falni, por e keni ulur dinjitetin e jetës së qytetarëve shqiptarë nën kuotën e ushqimit të një qeni! Vendosi sa më shpejt minimumin jetik, që të shpëtojnë shqiptarët!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Desantila Tahiraj.

Të përgatitet zoti Vullnet Sinaj.

Desantila Tahiraj – Të nderuar kolegë,

Ky projektligj vjen si rezultat i disa problematikave që ka paraqitur ligji nr. 15/2019 gjatë aplikimit të tij.

Qëllimi kryesor i projektligjit është rritja e mundësive të punësimit nëpërmjet skemave të ndryshme, si në punësimin në shtet, në punësimin privat, në vetëpunësimin apo në formimin profesional.

Nga ndryshimet në këtë projektligj do të përfitojnë dy kategori kryesore: e para, të rinjtë nën 24 vjeç, të cilët nuk kanë kualifikim, arsim, punë aktuale apo formim profesional nga qendrat e formimit profesional apo institucione të tjera; e dyta, kategoria e personave me aftësi të kufizuara,

për të cilët është shumë i rëndësishëm integrimi në shoqërinë tonë.

Me ligjin e deritanishëm nuk është bërë i mundur aksesimi i tyre në një vend pune. Shifrat tregojnë se gjatë një periudhe 4-vjeçare është bërë e mundur të punësohen vetëm 18 persona me aftësi të kufizuara.

Disa aspekte të politikave të punësimit duhet të shkojnë në të njëjtin drejtim me vendet e Bashkimit Europian dhe të Ballkanit Perëndimor. Kryesisht ky projektligj ka objektiv kryesor sigurimin e efikasitetit të fondit social të punësimit, i cili nuk është zbatuar me ligjin e deritanishëm.

Për sa i përket garantimit të shërbimeve të cilësisë së lartë nga organizata të specializuara në tregun e punës për punësim, sidomos për këshillim dhe ndërmjetësim të grupeve vulnerable, grupe që e kanë tejet të rëndësishëm kualifikimin, por edhe ndërmjetësimin dhe këshillimin; rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të dispozitave, të procedurave dhe programeve të nxitjes së punësimit në përgjithësi; garantimin e të drejtës së punësimit të sigurt dhe produktiv në vend; uljen e nivelit të përgjithshëm të papunësisë, pritet që nga implementimi i këtij ligji papunësia në vend të ulet në masën 9% dhe të krijohen vende të reja pune.

Kemi dy skema: skema e garancisë rinore, që është shumë e rëndësishme, dhe skema e kuponit. Nëse deri tani të rinjtë janë kualifikuar dhe trajnuar në qendrat e apo shkollat e formimit profesional, për shkak të trajnimit në disa profesione të veçanta, që nuk ofrohen në këto shkolla, është menduar të jepet një kupon që do të mbulojë në një masë të konsiderueshme trajnimin në disa profesione të veçanta, gjë që nuk është aksesuar deri tani.

Presupozohet rritje deri në masën 50% e nivelit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara; rritje e nivelit të punësimit të të rinjve në një masë të konsiderueshme; rritje e ofertës efikase të fuqisë punëtore, duke ndihmuar të papunët dhe personat ekonomikisht pasivë.

Gjithashtu, dua të them se i bashkohem mendimit të kolegut Braçe për të mundësuar incentiva ekonomike dhe më shumë subvencione për të simuluar punën në bujqësi. Si deputete e një zone bujqësore kam vënë re që jo shumë të rinj janë të incentivuar për të punuar në fshat dhe mendoj se nga kjo ministri, bashkë me Ministrinë

e Bujqësisë, duhet të ketë më shumë incentiva për fshatin dhe për punën në fshat.

Me këtë projektligj bëhet i mundur fondi social i punësimit dhe kontributi i punëdhënësve për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, për personat që nuk dëgjojnë, nuk shikojnë dhe për invalidët e punës.

Ka pasur shumë arsye të cilat sollën vendimin për marrjen e kësaj iniciative, por më kryesorja është mungesa e implementimit. Në ligjin e kaluar, 1 në 25 persona duhet të ishte i punësuar me aftësi të kufizuara, por kjo nuk realizohej, sepse nuk zbatoheshin sanksionet. Me këtë ligj do të arrihet të zbatohen sanksionet dhe shpresoj të punësohen më shumë persona me aftësi të kufizuara. Këta persona nuk do të jenë barrë për shoqërinë, por do të jenë pjesë aktive e shoqërisë. Po ashtu, ka edhe shumë ndryshime në nene.

Shpresoj të marrim miratimin e të gjithë kolegëve për këtë projektligj shumë të rëndësishëm për nxitjen e punësimit të kategorive të veçanta, sepse ndërkohë kemi edhe shumë të rinj të kualifikuar, të arsimuar në pritje të një pune, një pjesë e të cilëve, fatkeqësisht, ndjekin rrugën e emigracionit.

Gjithashtu, shpresoj që ky ligj të monitorohet shumë mirë nga Ministria e Financave dhe Ministria e Mbrojtjes Sociale, sepse do të ketë një impakt shumë të madh për grupet vulnerable apo për të rinjtë nën 29 vjeç, që kanë qenë të papunë deri në këto momente, por unë dua të vë theksin te personat me aftësi të kufizuara. Ne duhet ta kthejmë vërtet vëmendjen nga ata. Ky projektligj duhet të gjejë zbatimin e duhur dhe të sanksionohet kontrolli periodik për zbatimin e tij në ndërmarrjet shtetërore dhe private.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Vullnet Sinaj.

Të nderuar Pranvera Resulaj.

Vullnet Sinaj – E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

I dëgjova me vëmendje diskutimet e kolegëve për këtë projektligj. Kam përshtypjen se është ndryshe të flasësh i lirshëm dhe ndryshe të kesh ngarkesë në shpatulla, pasi projektligji për nxitjen e punësimit, i cili vjen me ndryshime për ligjin bazë, nr.15/2019, nga njëra anë, i vjen në

favor biznesit, por, nga ana tjetër, ka disa rregulla që e ngarkojnë biznesin me detyrime të tjera.

Për fat të mirë, Shqipëria është ende një nga vendet e Europës me popullatë të re, por sërish ka rreth 27% të të rinjve të papunë apo që nuk punojnë, nga mosha 15-24 vjeç. Duhet diskutuar çështja, nëse nuk punojnë apo janë të papunë. Qeveria ka marrë shumë masa për të nxitur punësimin e të rinjve dhe një nga masat e fundit është thirrja e tetë për programin kombëtar të praktikave të punës, duke u dhënë mundësi të gjithë të rinjve me diplomë për të aplikuar, që njohuritë e marra në teori t'i zbatojnë në praktikë dhe të jenë të gatshëm për tregun e punës.

Mendoj se projektligji që ne po diskutojmë sot nuk do t'i zgjidhë të gjitha problemet që u diskutuan nga kolegët, moslargimin e shqiptarëve apo papunësinë, sepse në përmirësimin e gjendjes së punësimit në Shqipëri dhe të moslargimit të të rinjve nga Shqipëria ndikojnë një sërë ligjesh. Megjithatë, në këtë projektligj janë 4 pika kryesore me ndryshime.

Pika e parë është garancia rinore, që do të thotë se pas 4 muajve nga regjistrimi i një të riu në zyrën e punës, atij do t'i ofrohet një vend pune, do t'i ofrohet arsimim ose një praktikë, që të ketë mundësi të punësohet. Këto skema janë mbështetur nga Bashkimi Europian në kuadër të politikës për Ballkanin Perëndimor.

Pika e dytë është funksionimi i skemës së kuponit, që parashikon t'i bëhet një pagesë në formë kuponi një personi, për të cilin tregu ka nevojë, për një profesionist të caktuar, i cili nuk përfshihet në skemat publike të arsimit apo të formimit profesional.

Pika e tretë është këshillimi dhe nxitja për punësimin e grupeve vulnerable, sidomos për personat me aftësi ndryshe, që të përfshihen në jetën normale dhe në punësim. Gjithashtu, kjo do të bëhet edhe për fëmijët që kanë përfutur statusin e jetimit.

Pika e katërt është vënia në funksion e fondit social të punësimit.

Të gjithë flasin për pagat dhe unë kam dëgjuar shpesh të diskutohet që ato nuk merren të plota në bankë, që një pjesë e tyre merret në dorë dhe që punësimi dhe punëdhënësit kanë problematika të tilla. Unë prandaj e përmenda barrën e peshës në fillim, sepse pikërisht në këtë pikë, pra në funksionimin e fondit social të punësimit, parashikohet që çdo kompani që ka

deri në 25 punonjës, duhet të marrë në punë një punonjës me aftësi ndryshe ose, nëse nuk e merr, ligji e detyron të paguajë 100% pagën minimale dhe ta derdhë në këtë fondacion social të punësimimit. Pra, është pikërisht kontributi i këtij biznesi, që ne duam t'i vijmë në ndihmë me politikat e punësimimit, që sërish mban barrën mbi shpatullat e veta.

Koleg i nderuar, duhen thënë edhe fjalë të mira për biznesin, sepse nga biznesi mbështetet buxheti i këtij vendi dhe përmirësohen edhe skemat që ne ngremë.

Në nenin 11 të këtij projektligji parashikohet të ndihmohen njerëzit që kanë nevojë për punë apo bizneset nëpërmjet subvencionimeve, por unë do të jap një sugjerim për ministren e Financave: që këto subvencionime të kenë efektin e duhur dhe të prekshëm, mendoj se duhet të krijohet një mundësi për të ndihmuar dhe subvencionuar të rinjtë që duan të zhvillojnë një biznes agroturizmi, apo që duan të aplikojnë në skemën e IPARD-it. Kemi përpara IPARD III, janë 146 milionë euro. Çfarë ndodh? Në momentin kur një i ri kërkon të bëjë një plan biznesi, të bëjë një planprojekt, është i detyruar t'i drejtohet një agjencie që e përgatit këtë dokumentacion. Me sa informacion kam nga shumë njerëz, nga shumë të rinj që kanë dashur t'i bëjnë këto projekte dhe plane biznesi, kostoja e përgatitjes së dokumenteve në këto agjenci shkon deri në 500 000 lekë të rinj ose 5 milionë lekë të vjetër.

Unë do të sugjeroj që në nenin 11 të projektligjit të shtohet edhe një pikë tjetër, për të parashikuar subvencionimin e të gjitha projekteve dhe planbizneseve të të rinjve për fushën e biznesit të tyre, të agrobiznesit, duke qenë se përmirësimet në këtë projektligj ndikojnë në punësimin e të rinjve, sidomos në moslargimin e tyre nga Shqipëria, një temë kjo që i kalon diskutimet në këtë parlament, duke folur vetëm një herë, duke dalë këtu dhe duke thënë mendimet tona.

Unë i dëgjova kolegët me vëmendje dhe bashkohem në një pikë, që ndalimi i largimit të shqiptarëve nga Shqipëria ka vetëm një zgjidhje: rritjen e pagës. Këtë problem e ka edhe Ballkani, edhe Europa. Vendet më të zhvilluara të Europës e kanë zgjidhur, sepse po marrin fuqi punëtore nga Ballkani dhe ne po kërkojmë të marrim fuqi punëtore, por asnjëherë të mos mendojmë se është e lehtë rritja e pagës, sepse gjithmonë do të

shoqërohet me një efekt dytësor, me rritjen e çmimeve. Ju, kolegë të opozitës, nëse do të ndodhë fenomeni i rritjes së çmimeve, do të filloni të ngriheni dhe të thoni: “Qeveria ngriti çmimet”.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zoti Braçe, unë jam i mendimit që rritja e pagave shoqërohet me rritje të çmimeve, por ka një efekt pozitiv në ekonomi: do të nxisë prodhimin vendas dhe, duke u bërë kjo, ne do të kemi mundësi të përmirësojmë ekonominë dhe jetën në vend.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe i uroj suksese ministres për zbatimin e projektligjit për punësimin! Shpresoj që ky projektligj, kështu siç ne e lexojmë në teori, të gjejë vërtet vend në praktikë dhe t'u vijë në ndihmë të rinjve dhe bizneseve, që sot kanë vërtet uri për punonjës!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Pranvera Resulaj.

Të përgatitet zonja Mirela Pitushi.

Pranvera Resulaj – Faleminderit, e nderuar Kryetare!

Të dashur qytetarë,

Togfjalëshi “nxitja e punësimimit” është një koncept shumë i gjerë, por që në vetvete intrigon, sepse, në fund të ditës, qytetarët në të gjithë botën presin nga qeveritë e tyre pikërisht nxitjen e punësimimit.

Tregu i punës, si çdo treg tjetër, i nënshtrohet ligjit të kërkesës dhe ofertës, por qeveria është aty pikërisht për të nxitur, orientuar, strukturuar tregun e punës nëpërmjet ndërhyrjeve të saj. Mjafton të kujtojmë se sa po vuan sot tregu i punës për fuqi punëtore dhe, nga ana tjetër, të shikojmë të gjithë të papunët, të regjistruar apo jo në zyrat e punës, për të kuptuar se roli i institucioneve në rastin konkret është shumë i madh për të shërbyer si ndërmjetës dhe rregullatorë për të përputhur kërkesën dhe ofertën për punë.

Nuk ka kaluar shumë kohë nga miratimi i ligjit ekzistues nr.15/2019 dhe sot ka ardhur për disa ndryshime dhe shtesa pikërisht për shkak të disa mosfunksionimeve, por, në fund të fundit, për t'u përmirësuar dhe për t'u bërë më funksional.

Projektligji që do të kalojmë sot për miratim ka dy qëllime kryesore: integrimin e të rinjve në tregun e punës dhe integrimin e personave me aftësi të kufizuara.

Pse vjen me ndryshime ky projektligj? Sikundër e thashë, ligji ekzistues i ka të parashikuara të dyja elementet kryesore që po diskutohen nga të gjithë kolegët tanimë: konceptin në programin e garancisë rinore dhe fondin social të punësimit, por të dyja këto kanë nevojë për disa instrumente shtesë dhe nxitëse për t'u bërë më funksionale.

Së pari, për sa i përket garancisë rinore, projektligji e zgjeron konceptin për këtë program, duke parashikuar se skema e garancisë rinore është pjesë e programeve të punësimit, që mbështet të rinjtë deri në moshën 29 vjeç, të cilët nuk janë në punë, në arsim apo në formim profesional. Këtyre të rinjve do t'u jepet një ofertë punësimi, arsimimi të vazhdueshëm ose praktikash profesionale brenda një periudhe 4-mujore nga momenti i regjistrimit në zyrën përkatëse të punësimit. Nga ky program do të përfitojnë të gjithë të rinjtë e regjistruar në zyrat e punës.

Për t'iu referuar një statistike të thjeshtë, sipas Agjencisë Kombëtare të Punësimit, për 3-mujorin e parë të vitit 2023 janë gjithsej 160 926 të papunë mbi moshën 15-vjeçare dhe vetëm 78 124 punëkërkues të papunë të regjistruar në zyrat e punës. Pra, më pak se sa gjysma e numrit të të papunëve figurojnë të regjistruar si punëkërkues pranë zyrave të punës. Pse të papunët nuk regjistrohen në këto zyra pune si punëkërkues? Kjo mund të ketë shumë arsye. Një statistikë tjetër është që rreth 30,8 për qind e të regjistruarve në zyrat e punës përfitojnë ndihmë ekonomike. Ndoshta kjo mund të jetë një nga arsyet kryesore që të papunët regjistrohen për të përfituruar ndihmën ekonomike. Meqenëse jemi këtu, pavarësisht politikave të majta dhe diskutimeve të shpeshta për të rritur pagesën e ndihmës ekonomike. Ajo që duhet të bëjmë është që këta njerëz t'i nxjerrim nga pagesat e ndihmës ekonomike dhe t'i integrojmë në tregun e punës. Të gjitha programet e qeverisë shqiptare kanë si qëllim madhor nxitjen e punësimit, integrimin e të rinjve, të grave apo të kategorive të tjera në këtë treg, por pafuqia për t'i bërë këto programe funksionale kërkon diçka më tepër. Ajo që do të sugjeroja, është që pikërisht, para se të shkojmë te zyrat e punës apo te çdo institucion tjetër shtetëror, do të duhet që të fokusohemi me urgjencë te përputhja e programeve të punësimit me tregun e punës, jo se kjo nuk është bërë deri

më tani, por mendoj se zyrat e punës duhet të kenë një bilanc të saktë të kërkesave dhe të nevojave të tregut të punës të ndara sipas kategorive dhe profesioneve.

Propozimi për rishikimin e projektligjit "Për shtesa dhe ndryshime në ligjin 15/2019 "Për nxitjen e punësimit"" vjen për faktin se nuk është bërë i mundur të realizohet fondi social i punësimit për një arsye të vetme, sepse nuk është përcaktuar në ligj organi i cili do të bëjë mbledhjen dhe grumbullimin e këtyre fondeve. Sikundër u tha edhe nga kolegët deri më tani, Fondi Special i Punësimit është përcaktuar duke iu referuar ligjit, i cili parashikon që çdo ndërmarrje publike apo private duhet të punësojë (është e rëndësishme të theksojmë që edhe shteti ka të njëjtin detyrim ligjor si sipërmarrjet private) 1 punonjës me aftësi të veçanta për çdo 25 punonjës dhe më pas 1 punonjës me aftësi të kufizuara duhet të jetë i punësuar për çdo 50 punonjës të tjerë. Punëdhënësi, i cili nuk e zbaton këtë ligj, ka penalitetin, sikundër u tha, e derdhjes së kontributit deri në 100 për qind të pagës minimale. Mospërcaktimi i organit të mbledhjes së këtij detyrimi ishte edhe arsyeja pse nuk ishte realizuar deri më sot ky fond, por me ndryshimet që propozohen në ligj, si agjent i mbledhjes së këtij detyrimi do të jetë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Në fund të vitit 2022, për t'iu referuar përsëri disa të dhëna, numri i tatimpaguesve, që kishin punësuar deri në 25 punonjës ishte 3885 sipërmarrje. Kontributi që duhet të derdhen këta tatimpagues në Fondin Social të Punësimit, në rast të mospunësimit të personave me aftësi të kufizuara, është rreth 3,7 miliardë lekë në vit. Për sa i përket faktit se pse nuk është parashikuar diçka në ligj në lidhje me dështimin e mbledhjes së 3,7 miliardë lekëve, kjo është një çështje që edhe mund të diskutohet dhe nuk përbën ndonjë shqetësim shumë të madh, por ajo që dua të theksoj është se, më tepër sesa penaliteti që vendosim për të gjitha sipërmarrjet që nuk e respektojnë këtë ligj, duhet të fokusohemi te zbatimi i këtij ligji. Pra, të gjitha institucionet, qofshin publike apo private, do të duhet ta respektojnë ligjin për t'i përfshirë në strukturat e punësimit të gjithë punonjësit me aftësi ndryshe, sepse, për hir të së vërtetës, më tepër sesa fondi dhe penaliteti, më i rëndësishëm është integrimi i tyre në shoqëri.

Dua ta ritheksoj edhe një herë, se ndoshta është në interes të gjithë personave me aftësi të veçanta, atë që ministrja Manastirliu e tha në fjalën e saj, këta persona nuk e humbasin pagesën që marrin për trajtimin për shkak të aftësisë ndryshe. Ata do të trajtohen me pagë, njëkohësisht edhe me këtë pagesë të veçantë. Duke iu referuar ligjit, përpara se të shkojmë te penaliteti, duhet të kërkojmë zbatimin e tij dhe zbatuesi i parë duhet të jetë shteti. Institucionet publike duhet ta zbatojnë këtë ligj, sepse, mbi të gjitha, bëhet fjalë për integrimin e personave me aftësi të veçanta në shoqëri.

Ju ftoj që ta miratojmë këtë projektligj.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Mirela Pitushi.

Të përgatitet Tatiana Piro.

Mirela Pitushi – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë, pjesë e diskutimeve tona në komisionet parlamentare ka qenë projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2009 “Për nxitjen e punësimit””. Ky projektligj ka si qëllim rritjen e mundësisë së punësimit të forcave të punës nëpërmjet ofrimit të shërbimit dhe programeve publike të punësimit, vetëpunësimit dhe formimit profesional. Përmes projektligjit do të përmirësohen disa problematika të dala gjatë zbatimit katërvjeçar të këtij ligji. Ka ardhur koha që përmes iniciativave tona ligjore të bëjmë të mundur identifikimin dhe projektimin e politikave që do të nxitin të rinjtë dhe grupet e veçanta, kryesisht personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar zbatimin e politikave efikase të tregut të punës, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës.

Programi i qeverisë për periudhën 2021-2025 ka vënë në fokus punësimin dhe zhvillimin cilësor të forcës së punës në përputhje me vizionin dhe direktivat e BE-së, strategjinë europiane të punësimit dhe kërkesat për integrimin e Shqipërisë në Europë. Përmirësimi i legjislacionit dhe reflektimi i tij evoluon në zhvillime të mëtejshme. Sipas analizave dhe studimeve është evidentuar se të rinjtë, të cilët nuk janë të punësuar, të arsimuar ose të formuar profesionalisht, janë një nga kategoritë më vulnerabël të të rinjve dhe përbëjnë rreth 27,8 për

qind të të gjithë të rinjve në Shqipëri. Për ta trajtuar këtë kategori është parashikuar futja e skemës së garancisë rinore në një nen të veçantë, përveç parashikimit të bërë në nenin 11, si pjesë e iniciativës së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në këtë projektligj është reflektuar ndryshimi përkatës për krijimin e Fondit Social të Punësimit, duke qenë një nga përparësitë e qeverisë shqiptare, duke qenë se nuk është zbatuar deri më tani. Në projektligj do të gjejmë një sërë ndryshimesh, të cilat janë në mbështetje të politikës së punësimit të të rinjve, duke u bërë një bazë mbështetëse për të ardhmen e tyre. Në këtë projektligj do të gjejmë edhe disa ndryshime që e vënë theksin te grupet e veçanta, duke përfshirë një nga programet aktive mbështetëse: këshillimin për punësim të grupeve të veçanta, për arsye se ato kërkojnë një trajtim të veçantë dhe shumë të specializuar në raport me grupet e tjera të punëkërkuesve. Gjithashtu, kemi shtimin e një programi të ri: skema e kuponit për financimin e formimit profesional, e cila është një skemë që përdoret për mbështetjen e formimit profesional. Skema e kuponit mbulon kostot e një trajtimi të zgjedhur nga punëkërkuesi i papunë dhe përdoret gjerësisht në vendet e BE-së për të ndihmuar formimin dhe ngritjen profesionale të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet kurseve dhe trajnimeve profesionale për të qenë gati për tregun e punës, të cilat nuk ofrohen nga sistemi publik i arsimit dhe i formimit profesional.

Nëpërmjet skemës së garancisë rinore, e cila është pjesë e programeve të punësimit, arsimit dhe formimit profesional, adresohen nevojat e të rinjve që nuk janë në punë, në arsim ose në formim profesional, si pjesë e iniciativës së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Është pozitiv fakti që, përmes skemës së garancisë rinore, të rinjve që nuk janë pjesë e programeve të punësimit, arsimit dhe formimit profesional, do t’u ofrohet një ofertë punësimi, arsimimi i vazhdueshëm dhe praktika profesionale brenda një periudhe prej katër muajsh nga momenti i regjistrimit në zyrën përkatëse të punës.

Me ndryshimet e propozuara në këtë projektligj do të gjejë më shumë hapësirë Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive që të bëjë propozimet përkatëse nënligjore edhe për programe apo çështje të tjera, jo vetëm për nxitjen e punësimit. Këtu parashikohet se Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive shërben si

sekretariat teknik i Fondit Social të Punësimit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi. Është i rëndësishëm ndryshimi për sa i përket punësimit të personave nga grupe të veçanta, të personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë personat që nuk dëgjojnë, invalidët e punës që janë vlerësuar si pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse. Sipas këtij ndryshimi, punëdhënësi publik ose privat, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave sipas ligjit, do të derdhë një kontribut, për llogari të Fondit Social të Punësimit në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi. Pra, çdo muaj, për çdo person që u përket grupeve të përcaktuara në këtë ligj dhe duhet të punësohet sipas këtij neni, punëdhënësi duhet të derdhë kontributin dhe kjo do të pasqyrohet në listëpagesën mujore të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të deklaruara në sistemin *online* të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (institucion i cili luan rolin e agjentit tatimor për mbledhjen e kontributeve).

Me këto ndryshime ne marrim në mbrojtje në mënyrë ligjore dhe u largohemi abuzimeve të bëra ndër vite me këtë kategori në nevojë të popullsisë sonë. Sipas këtij ligji, nuk do të ketë më sorollatje për këtë grup-kategori, pasi përveç komunikimit direkt me qytetarin, do të jetë edhe komunikimi elektronik përmes sistemit të administratës shqiptare për të bërë ndërlidhje dhe shkëmbim informacioni në kohë reale. Pra, pasi personat me aftësi të kufizuara të jenë regjistruar, do të kenë një databazë në Shërbimin Social Shtetëror dhe të sigurohet shoqërore për të bërë komunikimin automatik të sistemeve që në momentin kur të ketë një ndryshim të statusit të personit me aftësi të kufizuar, do të sinjalizohet automatikisht zyra e punës për t'i bërë një ofertë të menjëhershme punësimi personit që do të ketë ndryshim të statusit.

Të nderuar qytetarë, sjell në vëmendje për të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe familjarët e tyre se personat me aftësi të kufizuara, janë apo nuk janë të punësuar, nuk do ta humbasin për asnjë moment pagesën e aftësisë së kufizuar. Punësimi i tyre, falë këtyre programeve të nxitjes së punësimit, do të bëhet për integrimin e tyre ekonomik dhe social dhe në momentin që nuk do të jenë fizikisht të aftë për të punuar, pagesa e aftësisë së kufizuar do të vazhdojë normalisht.

Të nderuar kolegë deputetë, për këto dhe shumë çështje të tjera të trajtuara në këtë projektligj, me rëndësi jetike për shoqërinë tonë dhe në mënyrë të veçantë për të rinjtë shqiptarë, shpreh mendimin që ta votojmë këtë projektligj për të pasur nesër një ligj me fuqi vepruese në dobi të qytetarëve.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Tatiana Piro.

Të përgatitet zonja Erisa Xhixho.

Teknika, zonja Piro do të flasë nga vendi.

Tatiana Piro – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ky projektligj ka si qëllim rritjen e mundësive të punësimit nëpërmjet krijimit të shërbimeve, programeve dhe politikave të punësimit, si dhe përmes formimit profesional. Gjithashtu, ky projektligj synon identifikimin, skicimin e politikave të duhura dhe nxitëse për të rinjtë dhe grupet e veçanta, kryesisht për personat me aftësi të kufizuara për të siguruar politika efektive për tregun e punës.

Projektligji ka si objektiv sigurimin e integritetit në tregun e punës së grupeve vulnerable dhe të grupeve të tjera; rritjen e nivelit të punësimit për personat me aftësi të kufizuara, duke ndihmuar që të punësohen të papunët dhe personat ekonomikisht pasivë; garantimin e barazisë sociale në kushtet e punësimit, kryesisht për personat me aftësi të kufizuara. Nëpërmjet këtij projektligji realizohen disa objektiva, të cilët konsistojnë si më poshtë: mundësia e fillimit të zbatimit të ligjit për pjesën e Fondit Social të Punësimit dhe të kontributit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara; vendosja e dispozitave zbatuese të skemës së garancisë rinore dhe parashkrimi i disa programeve të reja nxitëse për punësimin.

Në vijim të diskutimit tim për programet e punësimit, mendoj se fokus të veçantë merr mbështetja e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, por a është i mundur punësimi i këtyre kategorive dhe i grupeve të tjera vulnerable? Modeli zviceran sjell një zgjidhje, e cila i vendos kompanitë private në pozicionin trajnues, pra të zhvillojnë kapacitetet e personelit të tyre për të ardhmen. Metoda që ofron ky model, është një përshtatje inovative për kategoritë në nevojë dhe

për të rinjtë që hasin vështirësi për integrimin në tregun e punës. Programet e punësimit duhet të jenë të integruara edhe me kompanitë private, që të rinjve, grupeve të marginalizuara, minoriteteve dhe grupeve të tjera t'u ofrohet edukimi profesional dhe aftësimi për punësim. Në zyrat e punësimit është rritur numri i personave të regjistruar me aftësi të kufizuara, nga 237 persona në vitin 2020, në 720 persona vetëm në katërmujorin e parë të vitit 2023. Më së shumti përmes këtyre programeve dhe strukturave, si kurset e formimit profesionale dhe praktikat aktive në punë, ulet numri i personave që përfitojnë ndihmë ekonomike. Kompanitë private duhet të angazhohen për të përfituar mbështetjen që jep qeveria në realizimin e këtyre projekteve.

Sektori privat në Shqipëri përballet me shumë nevoja, më e rëndësishmja ndër të cilat është nevoja për personel të kualifikuar. Me gjithë përpjekjet e shumë kompanive për ta zgjidhur këtë problem, duket se ekziston një hendek midis aftësive të të rinjve dhe kërkesave të biznesit. Aplikimi i këtyre metodave, të cilat i ofron modeli i mësipërm, është i rëndësishëm, sepse të rinjtë mund të sjellin përfitime për kompanitë në inovacion dhe mund të jenë shumë të përshtatshëm për shumë sektorë e shërbime. Aftësitë e fituara në vendin e punës mund të zhvillohen sipas nevojave të kompanisë, si një mënyrë e ndryshme e edukimit të të rinjve. Përmes krijimit të shërbimeve lehtësuese kompanitë mund të rritin kënaqësinë e punonjësve në punë dhe të ulin numrin e të larguarve nga stafi i tyre.

Si konkluzion, mendoj se aplikimi dhe zbatimi i projekteve të tilla do t'i shërbente integritit të personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës dhe një politike gjithëpërfshirëse punësimi. Gjithashtu, do të hapte rrugën e përgatitjes së Shqipërisë për të përfituar nga programet dhe fondet strukturore të BE-së, në kuadër të procesit të integritit.

Ju falënderoj!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Erisa Xhixho.

Erisa Xhixho – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë një projektligj të rëndësishëm “Për nxitjen e punësimit”, por faktikisht jemi shumë vonë, sepse të rinjtë tanë

kanë marrë gomonet për të shkuar drejt vendeve europiane. Kjo do të duhej të ishte tema e diskutimit për shumë nga seancat tona, por pyetja është: a e zgjidh përfundimisht dhe a mjafton ky projektligj për realitetin në të cilin ndodhet sot Shqipëria dhe tregu i punës, i cili po zbrazet me shpejtësi nga profesionistët që po emigrojnë, ndërsa të rinjtë mezi presin të mbarojnë studimet e maturës për t'u nisur drejt vendeve të Europës e më tej? Një qytet i tërë vetëm me të rinj “avullon” nga Shqipëria çdo vit. Të rinjtë ikin, sepse nuk paguhen, nuk ka meritokraci, por ka korrupsion; kanë humbur shpresën për një të ardhme në këtë vend. Rreth 50 për qind e të larguarve gjatë viteve të fundit janë të rinj të moshës 15-29 vjeç. Ata e ndërtojnë jetën e tyre në një realitet të ri ekonomik, gjë që e shuan përfundimisht shpresën e rikthimit në vend. Shqipëria plakët dhe vuan për punëtorë të rinj, aq sa kompanitë po detyrohen të importojnë krah pune për të vijuar aktivitetin. Pa dyshim, kriza e çmimeve e ka bërë më të fortë dëshirën për të ikur. Jemi vendi me pagat më të ulëta në rajon, por kemi çmime shumë të larta. Në Shqipëri çmimet janë sa 61,3 për qind e mesatares së BE-së, sipas të dhënave të raportuara nga INSTAT-i. Pjesa më e madhe e të ardhurave të shqiptarëve, gati 60 për qind, shkojnë për ushqim dhe strehim. Fuqia blerëse ka rënë; konsumi është ulur; shqiptarët të varfër dhe të pashpresë zgjedhin të largohen. Këto janë fakte dhe ky është realiteti.

Nëse kthehemi sërish te largimi, nuk mund të lë pa përmendur atë që ka zënë hapësirën në të gjitha ekranet e vendit: eksodin e mjekëve dhe protestën e studentëve. Eksodi i mjekëve nga Shqipëria është një fenomen, i cili ka marrë përmasa shumë të madha gjatë dekadës së fundit. Sipas një studimi, 22 për qind e totalit të mjekëve në Shqipëri kanë emigruar (në shifra janë rreth 1028 nga 4745 mjekë që ka Shqipëria) dhe ata që emigrojnë, janë elita e studentëve të mjekësisë. Eksodi vazhdon... Sipas studimit, rreth 62 për qind e të diplomuarve në mjekësi në periudhën 2018-2022 pritet të largohen. Qeveria shqiptare, e paafte për të garantuar pagesa, kushte pune, mundësi karriere si në vendet ku emigrojnë, ka zgjedhur ta frenojë ikjen duke i kushtëzuar me pseudokontrata detyruese. Në fakt, është fatkeqësi që në vitin 2023 ne mendojmë se si të izolojmë trurin e vendit.

E kam mbështetur protestën e studentëve, e cila u zhvillua para dy ditësh, me bindjen se ata janë në të drejtën e tyre. Është tërësisht në shkelje të Kushtetutës dhe të çdo kriteri tjetër, përveç aftësisë për të pasur akses në studimet e larta në universitetet publike. Janë me mijëra prindër që me sakrificë të shumta kanë përballuar studimet e fëmijëve të tyre dhe këtë e bëjnë pasi i kanë paguar taksat e kësaj qeverie rregullisht, por, pavarësisht kësaj, në mënyrë tërësisht arbitrare qeveria vendos të propozojë rritjen e disafishtë të tarifës së studimit për fëmijët e tyre. Kjo praktikë detyruese është shumë afër atyre praktikave të komunizmit dhe është totalisht e papranueshme. Unë dëgjova këtu edhe ministren, e cila u shpreh se kjo është në vazhden e konsultimit dhe ky nuk është një propozim apo vendim, ndërkohë fakti që studentët kanë dalë në protestë dhe e kanë kundërshtuar këtë vendimmarrje, tregon se është propozuar një draft. Pra, është propozuar një draft, duke e bërë fakt të kryer dhe nuk ka ndodhur që fillimisht të dëgjoheshin palët e interesuara dhe të zhvilloheshin konsultimet. Kjo cenon të drejtën për akses në arsim dhe penalizon një kategori të veçantë studentësh. Efektet e para do të ndihen tek të ardhurat e familjeve me të ardhura të ulëta, që financojnë me mund e sakrificë pëmbushjen e ëndrrës së fëmijëve. Kjo pseudokontratë, e cila u imponohet mjekëve të ardhshëm, do të nxitë nga ana tjetër një emigrim parauniversitar. Me një kosto të tillë studimesh shumë maturantë, që synojnë mjekësinë, do të zgjedhin ta ndjekin atë në auditoret jashtë vendit. Kjo qeveri që synon të kurojë emigrimin e mjekëve me kontrata penalizuese, duhet të dijë para së gjithash një gjë që e dinë jo vetëm mjekët, por edhe studentët e mjekësisë, pra që e dinë të gjithë: nuk mund të shërosh një trup duke kuruar simptomat. Shërimi vjen duke kuruar shkakun e kësaj sëmundjeje. Shkaku i emigrimit të mjekëve janë pagat e ulëta në raport me vendet e tjera, kushtet e papërshtatshme të punës, pamundësia e zhvillimit të karrierës dhe mungesa e meritokracisë e plot të tjera, që studentët gjatë këtyre ditëve i kanë artikulluar shumë qartë. Nëse kuron këto shkaqe, qeverisë nuk i duhet të ndërmarrë iniciativa për kontrata që mbajnë peng studentë të përgatitur të universiteteve publike, për të cilët të gjithë kontribuojmë me taksat tona. Thirrja ime sot është që ministret të dëgjojnë studentët e mjekësisë! Është e domosdoshme të dëgjojmë për alternativat

që ata japin për përballimin e kësaj problematike që nuk do të rëndojë vetëm familjet e tyre, por të gjithë Shqipërinë, për këtë ikje masive të trurit dhe të rinjve për shkak të gjendjes në të cilën ndodhet sot Shqipëria. Do të duhet të flasim për punësimin dhe të kemi një strategji të qartë afatgjatë, në mënyrë që të përballojmë dhe të pranojmë së pari faktin që kemi një problem shumë të madh me emigrimin e trurit dhe të profesionistëve, më pas të gjejmë të gjithë mekanizmat për ta luftuar atë, për t'ua kthyer Shqipërinë shqiptarëve dhe jo vetëm disave.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Mbyllet diskutimi për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër: projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”.

Fillojmë diskutimin me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja.

Zonja Ibrahimaj, keni fjalën pa kufizim minutazhi.

Delina Ibrahimaj – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Ndryshimi i ligjit që sjellim sot në Kuvend synon të përmirësojë politikën për një çështje thelbësore që ka impakt të rëndësishëm social: politikën për çështjen e strehimit social. Në qeverisjen tonë kujdesi ndaj qytetarëve ka qenë gjithmonë një prioritet i vazhdueshëm. Qeveria jonë në vitin 2016 miratoi Strategjinë Kombëtare dhe ndryshimet ligjore të nevojshme për të adresuar nevojat e grupeve më të prekura, si dhe për të përmirësuar bazën e të dhënave të banesave sociale. Në fokusin tonë janë familjet e reja, çiftet që ndoshta nuk kanë mundësi të fillojnë një jetë të pavarur ekonomike, gratë kryefamiljare, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet rome dhe egjiptiane. Deri më tani janë alokuar 5,3 miliardë lekë nga buxheti i shtetit për strehimin social. Që nga viti 2020, çdo vit mbi 18 mijë familje kanë përfituar nga programet e strehimit social. Pa diskutim ky ka qenë një ndër ato programe që ka ndihmuar një numër të konsiderueshëm familjesh me qira sociale edhe pas tërmetit të vitit 2019. Pa diskutim që ka ende shumë nevoja për strehim, po ashtu ka nevoja për korrigjimin e politikave në këtë fushë dhe për këtë, sot propozojmë ndryshime në ligjin “Për strehimin social”.

Mbështetja për strehimin social do të përforcohet dhe në vitin 2025 ne kemi parashikuar të alokojmë 2,4 miliardë lekë shtesë për strehimin e 13 mijë familjeve shqiptare.

Çfarë synojmë me këto ndryshime?!

Së pari, do të përfshijmë në skemën e programit të subvencionimit të interesave të kredive, punonjësit e administratës publike. Një muaj më parë ne miratim në Kuvend ndryshimet ligjore që do të sjellin një rritje thelbësore dhe shumë të rëndësishme të pagave në administratën publike. Ne jemi të angazhuar që ta mbështesim administratën duke synuar të rritim eficientën në çdo hallkë të saj. Në vazhdim të kësaj politike, ndryshimi ligjor që sjellim sot, u mundëson punonjësve të administratës të marrin kredi me interesa të ulëta, më të ulëta se ato të tregut bankar. Ky program ofron një zgjidhje për ata punonjës që plotësojnë kushtet e nevojshme për të përfutur kredinë, duke mundësuar blerjen e një banese me kushte të favorshme. I rëndësishëm është fakti që ne e krijojmë këtë mundësi menjëherë pas politikës së rritjes së pagave. Kombinimi i këtyre dy zhvillimeve tregon se qeveria jonë është e përkushtuar ndaj mirëqenies së të gjithë trupës së punonjësve të administratës, duke u ofruar jo vetëm një pagë më të mirë, por edhe një mundësi më të madhe për të siguruar strehim të qëndrueshëm dhe të mirë. Përmes këtij programi të kredive të lehtësuara, punonjësit e administratës publike do të mund të përfitojnë shtëpi e kredi me interes deri në 3%, ndërsa diferenca e interesit do të subvencionohet nga buxheti i shtetit. Lehtësimi i kredive me interesa të ulëta tregon se qeveria i vlerëson dhe i mbështet me përkushtim punonjësit e administratës publike.

Ky program siguron një stabilitet financiar dhe besueshmëri për punonjësit, duke i bërë ata më të motivuar për të qëndruar në administratë dhe për t'i shërbyer interesit publik. Këto përfitime ofrojnë një perspektivë afatgjatë për punonjësit, duke i ndihmuar ata të planifikojnë dhe të ndërtojnë një të ardhme të qëndrueshme në administratë e të ndihen të inkurajuar që të vazhdojnë të qëndrojnë aty dhe të japin kontribut për zhvillimin e vendit.

Miratimi i këtij ndryshimi ligjor do t'i hapë rrugë VKM-së që qeveria do të miratojë, e cila për vitin 2023 parashikon të mbështesë mjekët, policët dhe ushtarakët.

Së dyti, ndryshimet ligjore që ne paraqesim sot, synojnë digjitalizimin e plotë të shërbimit, i cili mund të zbatohet në çdo njësi të pushtetit lokal brenda vitit 2024.

Sot në seancë dëgjova shumë të flitej për AKSHI-n, të fliteshin gjëra të pavërteta; dëgjova me keqardhje se si hidhej baltë mbi një institucion, i cili ka ndikuar në digjitalizimin e shërbimeve të të gjithë popullatës. 95% e shërbimeve publike sot ofrohen *online* dhe pas kësaj qëndron puna e palodhur e AKSHI-t, i cili është një institucion që është angazhuar me qëllim ofrimin e shërbimeve sa më të mira, në kohë reale dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së çdo qytetari në vend. Ky është një progres i jashtëzakonshëm, që na bën të jemi më afër se kurrë për t'u shërbyer qytetarëve në mënyrë transparente, efikase dhe të thjeshtë.

Edhe me këtë ndryshim ligjor që paraqesim sot, është parashikuar lehtësimi i aplikimeve për programet e strehimit social. Digjitalizimi dhe modernizimi i sistemit tonë të strehimit social janë thelbësorë për të siguruar një ndihmë efektive dhe të drejtë për ata që kanë më shumë nevojë. Ndryshimet ligjore do t'i japin frymë procesit të ri të aplikimit, duke mundësuar bërjen e aplikimeve nëpërmjet portalit "*e-Albania*". Po ashtu, është ndërhyrë në përmirësimin dhe rregullimin e procesit të vlerësimit dhe të miratimit të kërkesave.

Ndryshimet ligjore e bëjnë procesin më transparent dhe më efikas, duke garantuar një përgjigje të shpejtë dhe të drejtë për kërkesat për programet e strehimit social.

Nga ana tjetër, ka lehtësime edhe për grupet vulnerabël, për grupet e minoriteteve rome dhe egjiptiane, për kategoritë e familjeve pa të ardhura, të cilat kanë hasur vështirësi në plotësimin e dokumenteve bazë për të përfutur nga subvencionimi i qirasë. Tashmë ato mund të kryejnë procedura të thjeshtuara edhe pranë njërive të vetëqeverisjes vendore. Këto nuk janë vetëm ndryshime teknike. Këto janë ndryshime, të cilat tregojnë mënyrën sesi ne si qeveri u përgjigjemi nevojave të qytetarëve në ofrimin e shërbimeve publike.

Së treti, këto ndryshime ligjore japin një mbështetje më të madhe për disa kategori specifike. Këtu mund të përmend përfshirjen e familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë dhe të grupit që përfiton statusin e

fëmijëve në përkujdesje të Republikës, të cilët, përveçse përfitojnë kredinë me interes zero për çështje të strehimit, kanë edhe një grant të menjëhershëm të barabartë me 20% të vlerës së banesës.

Po ashtu, ky projektligj lehtëson përcaktime të tjera për të rinjtë dhe rrit moshën e përfituesve të rinj në disa nga programet përkatëse, të cilat aplikohen aktualisht.

Në fund, ne parashikojmë që këto ndryshime ligjore të sjellin rreth 2 mijë përfitues më shumë me kredi me interesa të lehtësuara nga kategoritë e familjeve dhe të rinjve, të punonjësve të administratës, familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit të rënë në krye të detyrës, si dhe fëmijëve në përkujdesje të Republikës.

Të nderuar qytetarë, ne jemi këtu për të hartuar politika që vijnë në ndihmë të mirëqenies suaj. Unë inkurajoj, sidomos punonjësit e administratës publike që ta shfrytëzojnë këtë mundësi dhe të aplikojnë në të ardhmen për programet e kredive me interesa të favorshme, si një kolonë e re dhe e fortë e programit tonë të strehimit social. Në besojmë se kjo masë do të përmirësojë jetën e shumë familjeve, individëve dhe do të ndikojë në rritjen e mirëqenies sociale, por edhe në rritjen ekonomike të vendit tonë.

Me keqardhje dëgjoj herë pas here fjalë e komente për mënyrën e qeverisjes, zhvillimin ekonomik, statusin e varfërisë, statusin e mirëqenies, papunësinë, shifrat e të cilave nga viti në vit kanë ardhur duke u përmirësuar. Është e vërtetë që Shqipëria, si shumë vende të tjera, të cilat janë në fazën e integritit evropian, po ndikohet nga dukuria e emigracionit. Por unë dua t'ju kujtoj se ju duhet të shihni shifrat. Unë dua t'ju kujtoj se edhe kur ne nuk ishim në këto faza, edhe kur ne nuk i kishim dyert e hapura drejt Europës, shifrat e emigracionit ishin po kaq, por edhe më të larta. Shifrat e emigracionit para vitit 2013 arrinin në mbi 50 mijë emigrantë në vit, ndërsa tani janë më pak se 50 mijë. A është kjo një shifër për të cilën ne krenohemi? Absolutisht jo, aspak jo!

Thuhet këtu se ne kemi krijuar kushtet që të rinjtë të largohen, ndërkohë që vetëm sot ne po paraqesim dy projektligje, të cilat bëjnë të mundur që të rinjtë të kenë një të ardhme më të mirë në vend, kushte më të mira për t'u aftësuar dhe për t'u punësuar nëpërmjet skemës së garancisë rinore, e cila do t'i ndihmojë të rinjtë për t'u

integruar në tregun e punës. Ne po ndërmarrim masa me qëllim që pagat në sektorin publik, por edhe në sektorin privat, të rriten me hapin e kohës. Ne po marrim masa që punonjësit e administratës publike të gjerë, si dhe disa kategori që u përmendën gjerë e gjatë këtu, si ajo e mjekëve, të cilët janë të specializuar, të kenë kushtet e nevojshme për të pasur një jetë të denjë në vend.

Këto janë vetëm një pjesë e politikave që ne jemi duke ndërmarrë, me qëllim që të reduktojmë dukurinë e emigracionit, me qëllim që të rinjtë e të rejtat të zgjedhin të qëndrojnë në Shqipëri.

Ju falënderoj shumë për vëmendjen! Do të doja t'u rikujtoja deputetëve të opozitës që nuk mund të bëhet opozitë me fjalë të rreme dhe me shifra të rreme. Doja të përmendja vetëm një fakt për punësimin, pasi u përmend gjatë papunësia e rinisë në fjalime të ndryshme dhe u krahasua me vendet e BE-së, duke përmendur një shifër të pavërtetë të BE-së. U tha se papunësia e të rinjve në BE është 6%. Jo, nuk është 6% papunësia e të rinjve në BE. Në BE 6% është mesatarja e papunësisë totale, ndërkohë që papunësia e të rinjve është 13,8%, ndërsa në Shqipëri vërtet është më e lartë se kaq, por është ndër më të ulëtat në vendet e rajonit. Papunësia e të rinjve në Shqipëri në fund të tremujorit të parë ishte pak më shumë se 22%, ndërkohë që më mirë se ne është vetëm Serbia, pasi të gjitha vendet e tjera të rajonit kanë të njëjta problematika që kemi ne. Kjo është edhe arsyeja pse në bashkëpunim me BE-në, ne jemi duke ndërtuar skemën e garancisë rinore, e cila ka pasur një impakt të jashtëzakonshëm në të gjitha vendet e BE-së dhe në presim që në 4 vjetët e ardhshëm të ketë një impakt të jashtëzakonshëm edhe në reduktimin e papunësisë rinore.

Këto janë ato që ne bëjmë; këto janë politikatat që ne synojmë, me qëllim që shqiptarët të kenë një jetë më të denjë në vendin e tyre.

Ju faleminderit!

(Drejtimitin e seancës e merr zëvendëskryetarja e Kuvendit, zonja Ermonela Felaj.)

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Çelim debatin për këtë pikë të rendit të ditës. Fjalën e ka ministrja Ogerta Manastirliu.

Të përgatitet zoti Florenc Spaho.

Ogerta Manastirliu – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës,

Të dashur kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Besoj se sot kjo është një ndër iniciativat ligjore që na bën nder të flasim të gjithë, sepse sot miratojmë ndryshime shumë të rëndësishme në ligjin “Për strehimin social”, duke i hapur rrugë mbështetjes me programe të strehimit social për një sërë kategorish që duhen incentivuar, duhen mbështetur, në mënyrë që të kemi dhe të garantojmë edhe në vijim një jetesë të denjë për profesionistët tanë në shumë sektorë. Ndryshimet që propozojmë sot në ligjin “Për strehimin social”, do të hapin rrugën për një sërë programesh dhe lehtësirash për strehimin për kategori të ndryshme të administratës publike dhe asaj shtetërore, pjesë e të cilave do të jenë edhe profesionistët e shëndetësisë, mjekët. Sipas të gjitha parashikimeve ligjore, do të ndërtohen programe specifike të mbështetjes për punonjësit tanë të shëndetësisë, në mënyrë që sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj t’u sigurojmë atyre një mbështetje direkte me kredi të lehtësuara, kredi të buta për të pasur mundësinë e blerjes së një banese. Këto programe strehimi social nga momenti i parë i hartimit të ligjit “Për strehimin” e deri më sot janë programe që janë konsoliduar, të cilat u kanë siguruar kategorive në nevojë mbështetje, kanë mundësuar ndërtimin e banesave sociale, kanë mundësuar dhe mundësojnë sot e kësaj dite bonuset e strehimit, qiratë sociale, si dhe kreditë me kosto të ulëta. Por fakti që sot ne do të hapim një dritare në këtë ligj, është edhe një mundësi tjetër, një alternativë shumë e mirë efektive për të ndërtuar këtë program të ri social pikërisht për adresimin e një prej problematikave të çifteve të reja: për të pasur një banesë të tyre në pronësi dhe për ta përfutur këtë nëpërmjet ndihmës së shtetit. Shteti futet garant në këtë rast për të siguruar banesën për profesionistët e shëndetësisë dhe këto akte nënligjore, që do të dalin në zbatim të këtij ligji, do t’i hapin rrugë këtij programi social, ku mjekët e rinj dhe ata të cilët plotësojnë kriteret e parashikuar në këtë ligj, do të kenë mundësi të gëzojnë shtëpinë e tyre të parë, do të kenë mundësi të mbështeten nga shteti me këto kredi të buta duke siguruar interesa shumë të favorshme dhe duke garantuar që edhe fëmijët, të cilët janë përfutues të statusit të fëmijëve në përkujdesje të Republikës, të mundet t’u sigurojmë një kredi sociale, një kredi me kosto të ulët, me interes zero, si dhe me një kolateral të parë. Është një moment që nuk duhet parë i veçuar

nga të gjitha politikat e tjera që po ndërmarrim. Mbështetja e profesionistëve të shëndetësisë, sikurse edhe të gjithë profesionistëve të tjerë, është në qendër të politikave tona. Ne e dimë shumë mirë që edhe Shqipëria nuk ka pse të mos jetë pjesë e të gjitha fenomeneve globale që po ndodhin. Në fakt, mobiliteti i profesionistëve është një prej fenomeneve që ka prekur rajonin; ka prekur Europën. Sot disa vende europiane janë shumë të shqetësuara për lëvizshmërinë dhe mobilitetin e mjekëve dhe infermierëve në vende të tjera. Sigurisht që edhe ne duhet t’u paraprijmë fenomeneve, të cilat në mund të sjellin në vitet në vazhdim edhe një tkurrje të profesionistëve, ndaj duhet të përgjigjemi sot me programe, të cilat adresojnë këto fenomene dhe këto sfida me të njëjtën prirje, vullnet dhe angazhim që kemi adresuar sfidat e tjera me të cilat jemi përballur këto vite.

Ky është një tjetër element, pjesë e një programi të madh që kemi për mbajtjen e profesionistëve në vend dhe për tërheqjen e profesionistëve, të cilët janë në vend të tjera dhe vijnë studimet apo punojnë atje, në vend me incentiva, të cilat janë pjesë e programeve tona, pikërisht për mbështetjen e profesionistëve. Ky është një tjetër program që do t’u vijë në ndihmë profesionistëve, sepse, duke pasur mundësinë e përfitimit direkt të një kredie me kosto të ulët, të një kredie të zbutur, sigurisht që ky është një moment shumë i mirë për të filluar jetesën dhe për të pasur një jetë të denjë. Dinjiteti i profesionistit, rritja e respektit ndaj tyre dhe rritja e dinjitetit në punën e tyre na orienton në politikat tona. Ne nuk kemi ndalur për asnjë moment në të gjitha angazhimet që kemi marrë për investimet në shëndetësi. Ne kemi spitale të reja, që jo vetëm tashmë janë funksionale, por janë të pajisura me të gjitha aparaturat mjekësore dhe sot aty janë mbi 500 mjekë të rinj specialistë që ofrojnë kujdes shëndetësor, ndërkohë që kemi një sistem meritokratik të punësimit të tyre. Sot kemi mundësinë që të ofrojmë për profesionistët e shëndetësisë bonuse, 2,5 milionë plus pagën, për ata që ofrojnë shërbime jashtë vendbanimit të tyre, ashtu sikurse kemi sistem patronazhimi që mbështet ato spitale, të cilat ende kanë problematika në raport me specialitete të ndryshme. Por ne nuk do të ndalemi këtu, ashtu sikurse ia dolëm të bënim që në pikënisje rritjen historike të pagave për profesionistët e

shëndetësisë, 63%, këtë vit do të rritim pagat për mjekët specialistë, nga viti 2024 do të vijojmë rritjen e pagave me 20 mijë lekë të rinj në muaj për mjekët e përgjithshëm, si dhe do të vijojmë mbështetjen për infermierët. Pra, këto janë një sërë nismash, programesh, politikash, të cilat nuk shihen dot si të veçuara, por janë pjesë e një programi, e një planifikimi strategjik për të adresuar sfidat me të cilat po përballlet sot bota, sfidat që përballlet dhe Shqipëria. Pikërisht në sajë të këtyre angazhimeve që kemi ndërmarrë, të politikave që jemi duke bërë, si dhe të ndryshimeve ligjore që vijnë vetëm për të mundësuar më shumë mbështetje për profesionistët, më shumë mbështetje për grupet në nevojë, më shumë mbështetje për ata që meritojnë të kenë një mbështetje më të madhe nga shteti, mund t'i adresojmë sfidat me të cilat përballemi ne, përballlet rajoni, përballlet Europa. Është kollaj të jesh nihilist, është kollaj që të shohësh me syze të errëta, është kollaj që të evidentosh problemin, por të mos japësh asnjë alternativë zgjidhjeje; është kollaj që të bësh gjithmonë propaganduesin dhe të tregosh të keqen në çdo gjë, por është e vështirë të flasësh dhe të tregosh të vërtetën aty ku, në fakt, e vërteta shihet shumë kollaj. Tashmë është shumë i qartë, i dukshëm ndryshimi në të gjithë sektorët e vendit, sigurisht edhe në atë shëndetësor. A kemi më shumë për të bërë?! Patjetër që ka shumë për të bërë. Shëndetësia është një kantier pa mbarim; ajo ka nevoja shumë të mëdha dhe ne jemi duke adresuar vit pas viti dhe, mbi të gjitha, ajo çfarë jemi duke bërë, është fuqizimi i profesionistëve të shëndetësisë. Fuqizimin e profesionistëve të shëndetësisë, të mjekëve dhe infermierëve tanë nuk jemi duke e bërë me fjalë, nuk jemi duke bërë ato që keni bërë ju në të shkuarën, por tashmë flisni e nxirrni këtu pikërisht ato probleme që i latë pa zgjidhur dhe nuk i adresuat asnjëherë. Ndaj sot e keni shumë kollaj të flisni për mjekët, për mungesën e tyre, kur asnjëherë nuk u kujdesët për të qenë aq largpamës sa për ta parë problemin në sy dhe për ta adresuar, por ne nuk kemi ndër mend të bëjmë të njëjtën gjë, përkundrazi, gjatë gjithë punës sonë shumëvjeçare jemi ballafaquar me problemet. Në fakt, natyra na ka vënë përballë sfida, si tërmeti, pandemia, të cilat nuk i kërkuam ne, ato erdhën, por ditëm t'i përballojmë në sajë të gjithë angazhimit, solidaritetit, por, mbi të gjitha, largpamësisë. Ndaj, në politikat që po

ndërmarrim, duhet të tregohemi shumë largpamës. Sigurisht, edhe pjesa e planifikimit të burimeve tona njerëzore, të menduarit jo vetëm për sot, por edhe për nesër për atë që do t'u lëmë fëmijëve tanë, është shumë e rëndësime. Ndaj, ne nuk do të ndalojmë të marrim masa për të përgatitur dhe për të planifikuar, duke pasur gjithmonë në tryezën tonë të diskutimeve profesionistët, duke pasur grupet e interesit, duke pasur mjekët, infermierët, studentët, sepse kështu i kemi bërë të gjitha punët, ndaj sot ndryshimi është i preکشëm dhe i dukshëm. Sigurisht që mbetet për të bërë akoma më shumë, por e vërteta është e qartë si drita e diellit: ajo çfarë duhet është më shumë impenjim, më shumë punë, sigurisht, na duhet edhe solidariteti dhe mbështetja e opozitës, sidomos për këtë nismë që besoj se ju do të keni dakordësinë maksimale, sepse pikërisht për këtë ishit duke folur, për incentivat e mëtejshme që duhen ndërmarrë dhe për programet e reja që duhen shtuar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Fjalën e ka zoti Spaho!

Të përgatitet zonja Dhori!

Florenc Spaho – E nderuara drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë!

Të dashur qytetarë,

Më vjen mirë që po diskutojmë për dy projektligje shumë të rëndësishme, për projektligjin “Për nxitjen e punësimit” dhe për projektligjin “Për strehimin social”.

Në fakt, një shtet social duket nga politikat që ndjek për ata që janë më të dobët, për shtresat vulnerabël dhe për njerëzit më në nevojë. E nuk mund të shkonte ndryshe, nëse nuk do të ishin bashkë këto dy projektligje të diskutuara sot në parlament. Gjej rastin të falënderoj ministren e Financave, në lidhje me të gjitha teknikalitetet që shpjegoi, se cilat janë grupet e favorizuara që do të përfitojnë!

Ky ligj vjen për të përmirësuar jetën e të gjithë atyre që kanë nevojë për një strehim social. Ky ligj do të reflektojë mbi programet e qeverisë, për familjet e reja, për ata të rinj që kërkojnë lehtësira dhe duan ta ndërtojnë të ardhmen në vendin e tyre. Është pikërisht ky ligj që u vjen në ndihmë. Ne e dimë të gjithë se sa e vështirë është sot të kesh një shtëpi, sa e vështirë është të

ndërtosh të ardhmen në një vend, ku deri shumë vite më parë pagat ishin qesharake.

Ky ligj që vjen sot, sidomos për grupet më vulnerable, mes të cilëve vlen të përmenden të gjithë ata që janë pjesë e shoqatave të paraplegjikëve, të të verbërve, grupeve të komuniteteve romë e egjiptiane, familjeve me përkrahje ekonomike, për të gjithë ata që i plotësojnë këto kritere, por duke futur edhe ata që punojnë në administratën publike, të cilët do të përfitojnë nga ligji “Për strehimin social”, nuk mund të vinte pa një punë të madhe nga i gjithë stafi i Ministrisë së Financave, por edhe ai i Ministrisë së Shëndetësisë. Nëpër komisione është diskutuar shumë për strehimin social, dhe në këtë projektligj janë futur dhe të gjitha mendimet e opozitës, edhe mendimet që na vinin – meqë ne kemi qenë komision përgjegjës për këtë projektligj – nga Komisioni i Ligjeve apo nga komisionet e tjera, si e si të bënim më të mirën për të gjithë ata të rinj e të reja që duan ta ndërtojnë të ardhmen në vendin e tyre dhe që kanë nevojë ta ndiejnë pranë dorën e shtetit.

Në fakt, ky ligj është risi, ndaj nuk mund të themi se nuk ndihmon, por nuk mund të themi as se nuk ka vend për të bërë më shumë rregullime. Patjetër që po. Të gjitha ato grupe, që përfitojnë nga ky projektligj kredi me interes zero apo kredi me interes deri në 3%, kanë nevojë ta ndiejnë pranë dorën e shtetit pikërisht për t’i favorizuar. Ka shumë të rinj që u përkasin grupeve vulnerabël apo të pafavorizuara, ku hyjnë shoqata e paraplegjikëve, shoqata e të verbërve, të rinj të cilët duan ta ndërtojnë të ardhmen duke e lidhur jetën me një person tjetër, por e kanë të pamundur të kenë një banesë. Atëherë, këto grupe përfitojnë nga ky projektligj. Në Shqipëri ka njerëz shumë të nderuar, të cilët janë pjesë e këtyre targetgrupeve, që edhe me ligjin e nxitjes së punësimit do të kenë akoma edhe më shumë mundësi për t’u integruar në shoqëri. Ne kemi njerëz të mrekullueshëm dhe dua t’i veçoj, jo për nga rëndësia, por për të treguar se sa kapacitete kemi pikërisht te këto grupe të pafavorizuara. Ne kemi një punonjëse sociale, e cila punon në Bashkinë e Elbasanit, që e ka emrin Ativie dhe i përket shoqatës së të verbërve. Në fakt, Ativia ka sytë e shpirtit, sepse vetëm me fjalët që thotë të jep një energji, që rrallëkush ta jep. Ne kemi në Bashkinë e Elbasanit një djalë, Dritan Hoxha, i cili punon në zyrat e informacionit të bashkisë. Pikërisht, duke pasur

në institucione këta njerëz, kjo tregon se sa e bukur është jeta, tregon çfarë kemi bërë, por edhe se duhet të bëjmë akoma më shumë për këto targetgrupe.

Kthehemi te shoqata e paraplegjikëve. Skënder Sollaku është një zotëri burrë, i cili është aktivist në ndihmë të njerëzve në nevojë. Kemi një djalë të mrekullueshëm nga Elbasani, Luis Qosja, fizioterapist, i cili ka mbaruar fakultetin. E pse të mos futet te nxitja e punësimit? Kemi një djalë që ka mbaruar degën e fizioterapisë në nivelin ekselent. A nuk ndihmon ky ligj për ta ndihmuar, për të promovuar e stimuluar këtë djalë të ri, i cili mbase nesër do të dojë të krijojë familjen e vet? Duke punuar në qendrat e formimit profesional, në degën për të cilën ai ka mbaruar, ai mund të nxjerrë kursantë. E më besoni: nuk është se ne u bëjmë nder këtyre njerëzve, por janë ata që na bëjnë nder neve, për të kuptuar se ne jemi këtu pikërisht edhe për këta njerëz, për t’i stimuluar, për t’i ndihmuar të integrohen në shoqëri, po edhe për të marrë prej tyre një energji, që vetëm ata dinë ta japin.

Në lidhje me projektligjin “Për strehimin social” është folur gjerë e gjatë edhe nëpër komisione, dhe shpeshherë është përmendur se grupet që do të përfitojnë janë të rinjtë, familjet e reja, por edhe ata që punojnë në administratën publike, absolutisht. Shumë vite më parë, kolegët e mi, të cilët mbase kanë punuar në dy a tri punë, duke e mbaruar Fakultetin e Mjekësisë, por edhe pse që të dy, burrë e grua, ishin të të njëjtit profesion, nuk arrinin dot të paguanin qiranë, le pastaj të mendonin se mund të blinin një shtëpi. Sot, pikërisht nëpërmjet këtij projektligji, ata janë përfitues të kësaj skeme.

Në fakt, zonja Dhori, ne i kemi mbaruar studimet njëkohësisht, dhe ti e di fort mirë se çfarë do të thotë të mbarosh për mjekësi pas gjashtë vjetëve, apo dhe specializimin, e pastaj të gjendesh përballë një situatë në lidhje me profesionin, me krijimin e një familjeje dhe sigurimin e një banese. Por sot, sipas kësaj skeme, shumë nga kolegë tanë do të përfitojnë. Kush është garanti? Unë, ti dhe shumë kolegë të nderuar jemi garanti që ky projektligj të zbatohet. Po si mund të zbatohet, nëse sot nuk do të ishim në epokën e digjitalizimit, i cili është pikërisht mjete që do t’i shikojë, do t’i monitorojë dhe do t’i zhbëjë të gjitha ato mendje të këqija korruptive, që shumë dosje mund t’i linin nëpër zyrat e

institucionit të shtetit apo që aplikimet e tyre nuk i merrnin fare parasysh?

Sa njerëz të komunitetit rom apo egjiptian kemi, që kërkojnë strehim social, që duan të ndërtojnë të ardhmen në vendin e tyre, që duhen përkrahur? Ky ligj vjen në ndihmë pikërisht për këtë. Por kemi edhe persona që kanë një banesë të dytë, të cilët ky ligj i nxjerr përfitues. Këta persona, që kanë një banesë, por ky ligj i nxjerr përfitues, nuk do të marrin më shumë se 60% të vlerës maksimale të kredisë, sepse nuk mund të jenë njësoj një person që ka një banesë dhe një person që nuk ka fare. Por nuk mund të përjashtohet askush nga ligji. Kemi shumë kolegë të nderuar, të cilët kanë humbur jetën në betejën kundër Covid-19, por fëmijët e tyre mund të përfitojnë patjetër nga ky ligj. Pse jo?

Të gjithë fëmijët që janë në përkujdesje dhe që kanë statusin e përkujdesjes në Republikën e Shqipërisë, duhet të përfitojnë nga ky ligj. Në mënyrë absolute, një shtet social duket nga politikat solidare.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Spaho! Zonja Dhori, fjala për ju.

Të përgatitet zonja Buxheli.

Le t'i jepet fjala nga vendi zonjës Dhori.

Ida Dhori – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Jemi duke diskutuar për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social””.

Sikurse e citoi edhe kolegu parafolës, ne si opozitë kemi bërë propozime për të shtuar gamën e kategorive në nevojë, të kategorive më të pambrojtura, në mënyrë që të përfitojnë nga të gjitha lehtësitat, dhe kjo është diçka pozitive. Përmend këtu edhe fëmijët e mjekëve të rënë në krye të detyrës gjatë Covid-19, një amendim i opozitës, që është përkrahur edhe nga të gjithë kolegët e tjerë të komisionit. Po ashtu, gjë pozitive është edhe përfitimi i familjarëve të policëve të rënë në krye të detyrës, i grave të dhunuara e të tjera, që janë disa nga pikat që përmban ky ligj, për të marrë kredi me kushte të lehtësuara, në mënyrë që të kenë mundësinë e strehimit dhe të blerjes së një banese me anë të këtyre kredive.

Në fakt, përveç këtyre aspekteve, unë do të doja të ndalesha tek amendimi që kërkohet të

bëhet sot me anë të këtyre ndryshimeve, që është te neni 18 i ligjit ekzistues, që pas amendimit bëhet neni 8 i ligjit “Për strehimin social”, i cili do të votohet, dhe ka të bëjë pikërisht me tërë kontributin e ndërtuesve privatë në fondin e banesave sociale, i cili është vendosur në vitin 2018 në ligjin aktual, që të jetë 3% e të gjithë hapësirës së ndërtimit për ndërtime që janë mbi 2 mijë metra katrorë. Sipas ligjit aktual, 3% e të gjithë kësaj sipërfaqeje do të duhet të kalojë në fondin e banesave sociale të njësisë vendore përkatëse, pra të bashkisë ku bëhet ndërtimi.

Çfarë bën ky ligj? Siç tha me të drejtë kolegia ime parafolëse, këto janë ligje kozmetike, edhe sipas gjykimit tim vazhdojmë të jemi në kuadrin e ligjeve kozmetike, ligje që për nga forma janë të bukura, kanë edhe disa aspekte pozitive në lidhje me shtresat në nevojë, ndaj të cilave ne si komision jemi të ndjeshëm, të cilat i mbështesim dhe jemi pro tyre, por kam frikë se brenda këtij ligji përfshihen përfituesit më të mëdhenj, për të cilët nuk u tha asnjë fjalë as nga ministrja e as nga parafolësit. Këta përfitues janë ndërtuesit, oligarkët e ndërtimit, të cilët me anë të amendimit që kërkohet të bëhet sot, do t'i shmangen këtij 3-përqindëshit të arritur me luftë në 2018-ën, dhe me ndryshimet që kërkohet të bëhen, ky 3-përqindësh i sipërfaqes funksionale 2 mijë metra katrorë e sipër do të shndërrohet në 3% të sipërfaqes shtesë për ndërtimet në truall mbi 2 mijë metra katrorë. Pra, janë vetëm dy fjalë ato që ndryshojnë amendimin e propozuar të nenit 18 të ligjit aktual, por në thelbin e tyre këto dy fjalë i heqin kaq shumë fondit të banesave sociale të njësisë vendore e bashkive të vendit, duke i dhënë kaq shumë oligarkisë së ndërtuesve në këtë vend.

Kësisoj, unë e përgëzoj ministren, e cila i kuroi shumë bukur amendimet e këtij ligji, po nuk tha asnjë fjalë të vetme për këtë nen, për këtë amendim. E kaloi sikur të ishte dosido, dhe në komision u shpreh se kështu ka qenë dhe kështu do të jetë. Jo, nuk ka qenë kështu, por ka qenë konkretisht siç e citova më sipër. Pra, kjo do të thotë se me këto ndryshime përjashtohen shumë ndërtues privatë nga detyrimi për ta dhënë këtë 3-përqindësh në favor të fondit të banesave sociale. Kjo do të thotë më pak kontribut për këta të pastrehë dhe për këto kategori në nevojë, që e kanë të domosdoshme dhe jetike të kenë një strehë mbi kokë.

Është e trishtë ajo që të qëllon të dëgjosh në komision, kur vetë ministrja e Ekonomisë dhe Financave pohon se ky ligj nuk është zbatuar në shumë bashki. Shumë bashki kanë kërkuar të marrin vlerë monetare në raport me banesat, dhe këtë e kanë rregulluar ashtu, me fjalë, bashkia me ndërtuesit, ndërkohë që ligji është shumë i qartë: në rast se ndërtimi në fjalë nuk është njësi banimi, atëherë do të jepet e njëjta sipërfaqe në një zonë tjetër ku ndërton ndërtuesi, që është njësi banimi. Pra, ligji ka qenë shumë i qartë, ndaj nuk e kuptoj pse duhet bërë amendimi. Nuk e kuptoj ku qëndron ekuivoku, që ministrja shprehet: ka qenë ligji i paqartë dhe nuk është zbatuar. Në gjithë këto vite, në pesë vjet rezultojnë se vetëm nëntë bashki të vendit e kanë zbatuar këtë ligj. Unë nuk e besoj se ndërtesa-njësi banimi mbi 2 mijë metra katrorë janë ndërtuar vetëm në nëntë bashki të vendit. Jam e bindur se po t'i numërojmë bashkitë e mëdha, ato janë shumë më tepër se kaq, që kanë ndërtesa të tilla, kështu që në mënyrë të dukshme, edhe institucioni më i lartë përgjegjës për të kontrolluar zbatueshmërinë e këtij ligji, nuk e ka kryer detyrën ose, le të themi, ka mbyllur njërin sy përballë moszbatueshmërisë së ligjit, që, në fakt, është pika ku cedojmë gjithmonë. Ligjet i kemi të kuruara, i përafrojmë edhe me direktivat e Bashkimit Europian, i kemi tamam siç duhet, por ama cedojmë gjithmonë të zbulueshmëria e tyre. Ligji është gjithmonë i përpiktë në kërkimin e zbatueshmërisë, kur flitet për qytetarët e thjeshtë, kur flitet për ata të pambrojturit. Ligji është vazhdimisht aty, por gjithmonë oligarkët shpëtojnë, dhe të fortët janë ata që diktojnë, madje bëjnë edhe ligje, që pastaj vijnë enkas këtu në parlament për t'u votuar.

Kjo ishte pjesa kryesore, që më shqetësonte mua, por besoj se edhe gjithkënd. Edhe bashkitë duhet të jenë të shqetësuara në lidhje me këtë, sepse do të ketë më pak përfitim për ta, dhe shumë më tepër për ndërtuesit e mëdhenj, që janë shtresa më e pasur, duke privuar kështu shtresën më vulnerable dhe më në nevojë, sepse, në fund të fundit, 3-përqindëshi nuk është një taksë që e vendos bashkia, sikundër është shprehur me të drejtë edhe përfaqësuesja e ministrisë në përballjen me ndërtuesit, si grup interesi, por është vlera e shtuar e truallit, pasi aty jepet një leje zhvillimore dhe një leje ndërtimi. Pra, ajo hapësirë, ai truall nuk ka më të njëjtën vlerë si para ndërtimit, ashtu edhe pas ndërtimit, ndaj me të

drejtë kontributi do të shkojë dhe duhet të shkojë për më të pambrojturit, për kategoritë e shtresave në nevojë, për të pastrehët apo për ata që e kanë të domosdoshme një banesë sociale.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Dhori!

Fjala është për ju, zonja Buxheli.

Të përgatitet zonja Spahiu.

Lindita Buxheli – E nderuar kryetare,

Të nderuar deputetë,

Projektligje “Për strehimin social”, i cili do të miratohet sot, është i një rëndësie të veçantë, pasi strehimi është një e drejtë themelore e njeriut, por ndërkohë dhe një prioritet i qeverisë “Rama”. Po të kthehemi pas, do të shohim përpjekjen e jashtëzakonshme që bëri Kryeministri Rama, pas tërmetit të vitit 2019, me ndihmën e qeverisë turke, duke ndërtuar me qindra apartamente në zonat e ndërtuara.

Ky projektligj ka një shtrirje të gjerë dhe përmbledh në vetvete një sërë programesh, duke nisur nga bonusi i qerasë, që, për hir të së vërtetës, njësitë e vetëqeverisjes vendore e kanë dhënë në masën 80% të shpenzimeve faktike të qirasë, për të gjithë personat që bëjnë pjesë në shtresat në nevojë. Është një program tjetër, i cili bën rikonstrukcionin e banesave të amortizuara deri në ndërtimin e banesave të reja. Ndërkohë, një program tjetër është edhe rregullimi i territorit në zonat ku do të ndërtohen banesa sociale.

Ky projektligj u jep përparësi personave të caktuar dhe grupeve të caktuara qytetare, duke filluar me punonjësit e policisë të rënë në krye të detyrës, me të gjithë fëmijët që kanë statusin e jetimit, me të gjitha familjet njëprindërore, në rastet kur fëmijët i rrit nëna ose babai. Ndërkohë, grupe të caktuara shoqërore, siç janë komunitetet rome dhe egjiptiane, përfitojnë nga strehimi social. Po kështu, emigrantët që kthehen në Shqipëri përfitojnë nga ky ligj.

Ky projektligj ka një risi, që u jep përparësi çifteve të reja. Dihet nga të gjithë se sa e rëndësishme është një banesë për një çift që kërkon ta ndërtojë të ardhmen e tij në Shqipëri. Pikërisht këtë bën edhe ligji që do të miratojmë ne sot: u jep prioritet çifteve të reja, që të kenë banesën e tyre nga ligji “Për strehimin social”.

Po kështu, risi e këtij projektligji janë 130 mijë punonjësit e administratës shtetërore, të cilët favorizohen nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ndërkohë, do të thosha se i favorizon edhe rritja e pagave këta 130 mijë punonjës të administratës shtetërore, pasi pikëzimi i bërë deri dje mund t'i linte jashtë skemës së strehimit social për shkak të të ardhurave të tyre familjare. Ndërkohë, me rritjen e pagave, këta bëhen pjesë e skemës së këtij ligji. Projektligji parashikon kredi me interes 3% për grupet që përmenda më sipër, për punonjësit e administratës shtetërore, ndërkohë që diferencën e subvencionon buxheti i shtetit. Ky ligj parashikon 0% interes për familjet e punonjësve të policisë të rënë në krye të detyrës.

Gjëja e rëndësishme, që do të doja ta thosha, është se, që me miratimin e këtij ligji, puna fillon te pushteti vendor. Pushteti vendor ka bërë një punë deri tani, ka dhënë bonusin e qirasë për familjet në nevojë. Pas miratimit të ligjit duhet një bashkëpunim mes pushtetit vendor dhe pushtetit qendror, për të krijuar *database*-ën dhe për të parë të gjitha familjet që preken nga kjo skemë.

Ndërkohë, punë për administratën vendore është edhe shpërndarja e të gjitha kritereve të sipërpërmendura në këtë ligj, për t'i shpërndarë deri në njësitë administrative, sepse ndodh që deri tani, qytetarë nëpër zona të caktuara nuk janë njohur me kriteret që i bëjnë ata pjesë të strehimit social.

Pavarësisht miratimit të ligjit sot, më duhet të theksoj faktin se qeveria jonë e ka pasur si pikësynim financimin e shtresave në nevojë, duke financuar 2 miliardë lekë në mandatin e tretë, ndërkohë që parashikon që deri në vitin 2025 të financohen edhe 2,5 miliardë lekë të tjerë për rreth 14 mijë familje në nevojë.

Edhe një herë, ju ftoj ta miratojmë këtë ligj kaq të rëndësishëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Buxheli!

Fjalën e ka zonja Spahiu.

Klodiana Spahiu – Përshëndetje, të nderuar kolegë (kaq sa kemi mbetur në sallë)!

Nuk besoj se ka gjë më të rëndësishme se strehimi dhe punësimi, dy tematika të diskutuara shumë gjatë.

Para se të filloj të diskutoj në lidhje me strehimin social, meqenëse ne ishim dhe komisioni përgjegjës për të dyja projektligjet, do të doja të falënderoja në mënyrë të veçantë të gjithë kolegët e komisionit, por, pa dyshim, edhe ata që ishin të ftuar në seanca dëgjimore, përfaqësuesit e të

gjitha shoqatave që ishin të interesuara të dinin se çfarë ndryshimesh do të ndodhnin në ligjin “Për nxitjen e punësimit”, por, mbi të gjitha, ndërtuesit, të cilët kanë dhënë një kontribut shumë të madh, arsye për të cilën do të doja t'i falënderoja, sepse nuk janë pak, por më shumë se 540 apartamente, të cilat janë përfutuar pikërisht nga ndryshimet që i janë bërë ligjit “Për strehimin social”, të miratuar në vitin 2018! Nuk do të doja kurrsesi t'i etiketoja me emrin “oligarkë”, përkundrazi ata janë investitorë dhe besoj se janë më të rëndësishmit, sepse nëse në Shqipëri ecën shumë mirë ndërtimi, pa dyshim që këto janë investime që bëhen kudo në vendin tonë. Besoj se edhe gjatë fjalës time do të sqaroheni që nuk ka ndryshuar asgjë në atë nen dhe nuk bëhet fjalë për ndryshimin e përqindjes së 3-përqindëshit, pasi do të mbetet siç është. I vetmi ndryshim, që ne do ta shohim edhe gjatë sqarimit, është se do të përcaktohen me VKM kriteret më të detajuara në lidhje me nenin ku flitet për kontributin social që japin ndërtuesit në një sipërfaqe mbi 2 metra katrorë. Pra, gjithçka ka mbetur siç ka qenë. Kjo ishte sa për sqarim.

Unë do të theksoja se çështjet e strehimit social janë një problem jo vetëm në vendin tonë, sepse strehimi është një fenomen mbarëbotëror. Një nga objektivat më të rëndësishëm të zhvillimit të qëndrueshëm është objektivi nr.11, që ka të bëjë me krijimin e qyteteve dhe vendbanimeve gjithëpërfshirëse, të sigurt, të afta për t'u ripërtërirë dhe të qëndrueshme. Këto lidhen direkt me zhvillimin urban dhe me strehimin social. Deri në vitin 2030 (është një objektivi i marrë nga OKB-ja) ne duhet të kemi një strehim të sigurt dhe të përbalueshëm, si dhe një shërbim bazë për përmirësimin e vendbanimeve me kushte të përshtatshme. Ndërlidhja dhe integrimi mes politikave të ndryshme të zhvillimit urban me çështjet e strehimit, reduktimi i riskut të fatkeqësive dhe përshtatja me ndryshimet klimatike duhet të jenë çështje që na shqetësojnë, sepse shqetësojnë mbarë botën.

Pak më parë këtu u diskutua shumë gjatë në lidhje me punësimin, për largimin e të rinjve dhe të profesionistëve. Ne nuk na çojnë askund ato deklaratat aq të ashpra të opozitës, sepse duke deklaruar çdo herë që ne vetëm po largojmë, nuk bëjmë gjë tjetër, por vërtet largojmë. A keni ju ndonjë plan konkret se si mund të zgjidhet kjo gjë? Nuk dëgjova asnjë nga kolegët e opozitës të paraqiste një strategji të vetën. Çfarë strategjie ka?

Si do të jetë në të ardhmen? Meqë u përmend shumë gjatë shëndetësia, si e mendojnë ata? A kanë bërë ndonjë bilanc të tyrin që, nëse largohen të gjithë, vendi ynë do të mbetet pa shërbimi shëndetësor? Pa dyshim që është e drejta e gjithkujt që, pasi diplomohet, të shkojë ku të dojë, por mendoj se edhe ata mjekë që formohen në vendin e tyre dhe e marrin diplomën në vendin e tyre, e kanë një detyrim të vogël karshi vendit të tyre për t'u shërbyer këtyre qytetarëve. Këto janë opinione të rëndësishme, që nuk duhet të na ndajnë, por të na bashkojnë, ashtu sikurse çështjet e mëdha, si punësimi, ndryshimet që u diskutuan në atë ligj apo çështja e strehimit, sepse nëse ne nisemi nga të gjitha kategoritë që mbështeten, shohim që janë pjesa më e madhe dhe qëllimi i ligjit ka qenë pikërisht mbështetja e kategorive në nevojë. Ne sot zgjerojmë një kategori të re, që është administrata publike. Kush nuk do të ishte i interesuar nga të punësuarit në administratën publike që t'i rritej rroga? Të gjithë do të ishin, dhe qeveria po e realizon. Kush nuk do të ishte i interesuar që, krahas një rroge më dinjitoze, të kishte edhe një banesë të mirë për të jetuar? Kështu që unë do të thosha që mbështetja e këtyre kategorive, pa cenuar asgjë nga arritjet për kategoritë në nevojë, kjo e deklaruar tashmë në të gjitha ndryshimet ligjore që janë bërë, krijon një mundësi më të mirë që ato të jetojnë më mirë në vendin e tyre, me të ardhura më të mira dhe me një banesë dinjitoze.

U fol shumë gjatë për disa pikëpyetje të ngritura tashmë në lidhje me strehimin social. Ndryshimet e kërkuara për këtë ligj të miratuar fillimisht në vitin 2018 dhe të rivlerësuar e të rikontrolluar shpeshherë, sepse kanë qenë në raportet e KE-së pothuaj çdo vit, edhe në vitin 2022, në fund të fundit janë disa mangësi që janë prezantuar vazhdimisht si të domosdoshme për të mbuluar disa kategori të tjera, sidomos për të pasur një *database* të sigurt. Të gjithë ne e ngritëm në komision pyetjen: "A ka një *database* të sotme se sa familje janë të pastreha?", por nuk ke se si ta kesh atë *database*, se, që ta kesh, duhet të kesh një raport, duhet të kesh të dhëna elektronike nga çdo njësi vendore. Pra, me këto ndryshime në bëjmë të mundur që nesër të kemi një *database* 100% të sigurt se sa familje kanë bërë kërkesë për strehim dhe sa për kredi të butë, si dhe çfarë është bërë nga viti në vit në sajë të raportimit, që do të bëhet i detyrueshëm nga çdo njësi vendore, mbi të gjitha,

edhe një kontroll i përvitshëm që do të bëhet nga ministria që e mbulon, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, për numrin e familjeve që janë strehuar, që kanë pasur mundësi të marrin kredi të butë, si dhe programet e reja. Programet e reja të strehimit dhe ndërtesat e reja do të bëhen me fondet jo vetëm të bashkive, por edhe me mbështetjen e buxhetit që planifikon qeveria për strehimin.

Dua të përmend një fakt: para miratimit të ligjit, pra deri në vitin 2017, ishin vetëm 15 bashki që kishin interes për projekte investimi, ndërsa në vitin 2023 janë 36 bashki që kanë interes për këtë gjë. Pse ndodh kjo? Sepse ka filluar të zbatohet ligji dhe kërkesat për strehim janë rritur në mënyrë të vazhdueshme, edhe për kredi të butë, por mbi të gjitha edhe buxheti për këto programe strehimi është rritur me 77%, krahasuar më vitin 2017.

Nga të gjitha seancat dëgjimore që ne realizuam në komision, arritëm të kuptojmë që kemi akoma shumë punë për të bërë, për të mbështetur familjet në nevojë, mbi të gjitha për të mbështetur atë shtresë, e cila nuk e ka kapacitetin e duhur për të aplikuar për një banesë me qira, pra për një banesë sociale. Atëherë do të jetë detyrë e njësisë vendore që edhe këtë aplikim ta bëjnë punonjësit e njësisë vendore dhe nuk është nevoja të bëhen dokumente apo të harxhohet një shumë e caktuar parash nga kjo kategori për të përfutur këtë banesën sociale, por do të bëhet si deklarim përpara njësisë vendore. Të gjitha këto janë përparësi të ligjit, të cilat unë do të doja t'i votonim bashkë me opozitën. Unë e shikoj përpjekjen e kolegëve të opozitës në komisionin tonë për të bërë propozime për amendime, të cilat janë të drejta dhe në mbështetje të kategorive, dhe ne jemi bërë të gjithë bashkë për t'i votuar, siç e përmendi edhe kolegja, sepse është në nderin tonë që të mbështesim fort ligjin që kemi miratuar për fëmijët në perkujdesje të Republikës, sepse prindërit e tyre kanë humbur jetën duke i shërbyer atdheut, jo vetëm në fushën e shëndetësisë, por në të gjitha fushat. Pra, ne e kemi zgjeruar edhe më tej propozimin e bërë nga kolegët e opozitës.

Ju ftoj të gjithëve që t'i miratoni këto ndryshime kaq të rëndësishme për këtë ligj dhe t'i japim debatit tonë formë më konstruktive.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Spahiu!

Me diskutimin tuaj mbyllem diskutimet për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës: projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 1 0142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Nismëtarin nuk e kemi, as kryetari i komisionit përgjegjës nuk ndodhet në Shqipëri.

Zonja Dhima, dëshironi të shpreheni për projektligjin, sipas Rregullores?

Dakord.

Faleminderit!

Fillojmë me diskutimet.

Me sa shoh të gjithë diskutantët e regjistruar më herët për këtë pikë nuk do të flasin, pra janë tërhequr nga diskutimet.

Kështu që e mbyllim diskutimin formalisht për këtë pikë të rendit të ditës.

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, i ndryshuar”.

As zoti Pëllumbi nuk ndodhet në Shqipëri, kështu që edhe këtu detyrohemi të kalojmë në diskutimin e projektit.

Zoti Bujar Çela, fjala është për ju.

Dëshironi ta merrni fjalën?

Faleminderit!

Të përgatitet zoti Spaho.

Bujar Çela – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi këtu për të kaluar disa ndryshime në ligjin “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, një ligj i vitit 2007, që ka vite që plotësohet me VKM e me vendime të këshillave bashkiakë, por u pa e domosdoshme që qeveria ta sjellë për një rifORMATIM dhe plotësim, në mënyrë që t'i rezistojë kohës. Ligji për zhurmat, të cilin e kemi trajtuar në komisione, nuk është një ligj që bën fjalë vetëm për zhurmat nga muzika në plazh, pasi

zhurmat janë të karaktereve të ndryshme: ka zhurma që vijnë nga mjetet motorike, ka zhurma nga mjete që punojnë vend e pavend, ka zhurma që ndodhin kudo, madje edhe në këtë sallë ka zhurma të panevojshme, kur ne nuk flasim e diskutojmë, por çirremi. Zhurmat janë bërë stres, dhe për të bërë këtë projektligj kanë punuar disa institucione, si: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mjedisit, pushteti vendor, Ministria e Punëve të Brendshme, por janë të interesuar të gjithë qytetarët dhe subjektet që operojnë në sektorin e turizmit. Para se të jemi ligjvënës dhe biznesmenë, në radhë të parë, jemi qytetarë. Turizmi duhet, biznesi po ashtu, nuk duhet frenuar asgjë që i shërben jetës, por vihet re shpesh që ka një papërgjegjshmëri edhe ndaj atyre subjekteve, të cilat, në interesin e tyre personal, bëhen shqetësim për qytetarët e tjerë. Ka një mori sëmundjesh, të cilat vijnë si pasojë e zhurmave të larta, pasi krijojnë stres dhe shqetësim. Duke qenë në qytet, ndodh shpesh të kalojmë mjete me marmita të prodhuara në mënyrë industriale dhe artizanale për të bërë zhurmë. Apo jo, inxhinier? Ato nuk rrisin shpejtësinë, por krijojnë zhurmë, stres, panik, ngritje tensioni, dhe çrregullime të tilla vihen re çdo ditë. Për arsyen e thjeshtë se një pjesë e mirë e të rinjve largohen nga vendi, ne, moshë që nuk e duam shumë zhurmën, pavarësisht se e duam punën, po bëjmë të mundur këtë ndryshim.

Në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese dhe në Komisionin për Integrimin Europian u diskutua çështja e ndryshimit të orareve. Ligji ka qenë, por ky projektligj i plotëson të gjitha ato që ka kërkuar koha. Faktorët që janë intervistuar kanë qenë të interesuar, sepse e kanë turizmin të lidhur me kërkesat e turistëve, të cilët vijnë për të shijuar plazhin, ushqimet tona dhe muzikën. Por a bëhemi shpesh shqetësim? Ka shumë njerëz që abuzojnë. Nuk bëhet fjalë për të ndaluar muzikën, se orari ka qenë deri në orën 23:00. Me këtë projektligj, me të gjitha amendamentet që do të plotësohen në bashkëpunim me strukturat, bëhet fjalë për orën 12:00 deri në orën 24:00. Lind pyetja: po bizneset që kanë dasma e aktivitete? Nuk bëhet fjalë për zhurma muzikore në ambiente të mbyllura, por për ato që shqetësojnë qytetarët, që duan të çlodhen pasi kanë qenë në punë. Ka pasur diskutime në komision edhe nga kolegët e opozitës, edhe nga ne, se, në radhë të parë, jemi qytetarë, që ta afrojmë orarin, se pushuesi nuk e

do muzikën vetëm në orën 12:00, por edhe në orën 10:00. Këtu nuk bëhet fjalë për muzikë, por për ulërima, jo për zhurmë sa të çahen bokset, por për zhurmë që në sfond të qetësojnë edhe Bujar Çelën, edhe Bujar Leskajn.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ne të dy e duam muzikën, por jo me zhurmë.

Cili ka qenë problemi në zbatimin e këtij ligji të bërë në vitin 2007? Ka shumë struktura që marrin pjesë në ekzekutimin, në kujdesin, të cilat herë-herë ia lënë topin njëra-tjetrës. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të kenë ekspertë të miratuar dhe me pajisje të licencuara, jo ta përcaktojë veshi i një polici, i cili shkon për të penalizuar një qytetar, që po zhvillon një biznes të qetë, të pastër, sipas kërkesave të pushuesve. Duhet të jenë të mirëpërcaktuar decibelët (sasia e zhurmës së lejueshme), sepse shpesh jemi objekt edhe i betonierëve. Para se të vihet ky ligj nga këto struktura që përmenda, Ministria e Turizmit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, pushteti vendor, Policia e Shtetit dhe Policia Bashkiake do të bëjnë një sërë amendamentesh, që të bëjnë të mundur zbatimin e tyre. Për sa u përket kërkesave, operatorët kanë miratuar disa.

Ky ligj do 15 ditë që të botohet në Fletoren Zyrtare, por para së gjithash, duhet të bëhet hartëzimi i këtyre objekteve dhe subjekteve, se nuk mund të jenë kudo. Ku janë zhurmat më të mëdha në Tiranë? Në ish-Bllok. Dikur patëm krijuar një këngë, ku thuhej: “Zhurmë, zhurmë, shumë-shumë zhurmë”, dhe ishte një zhurmë stresuese. Në orën 12:00 “vdes” Tirana. Nuk bëhet më fjalë për zhurma të çjerra, por për muzikë të mirëfilltë, se të gjithë e duam muzikën dhe qetësinë.

Duke përfutur nga rasti, u bëj thirrje të gjitha bizneseve që ta zbatojnë ligjin, në mënyrë që të mos ndeshen me ndëshkime. Ndonjëherë ngatërrohen ndëshkuesit, ngatërrohen ata që e ekzekutojnë. Ju thashë që Policia e Shtetit ka shumë detyra, dhe unë shpeshherë “ndiej erë të keqe”, se mund të abuzojnë në zbatimin e ligjit për zhurmat, prandaj strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të Ministrisë së Mjedisit duhet të jenë në krye të zbatimit të këtij ligji.

Ju faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Çela!

Fjalën e ka zoti Spaho.

Edmond Spaho – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë bie dakord me kolegun parafolës për përshkrimin e gjendjes në qytetet më të mëdha të vendit dhe në zonën bregdetare, por nuk jam dakord që ky projektligj do ta pakësojë dhe do të disiplinojë ndotjen akustike (zhurmat), por do ta shtojë edhe me një orë, flas për orarin e muzikës. Zhurmat janë një problem i madh në Shqipëri, sikurse thashë, në qytetet kryesore dhe në zonat bregdetare, madje ndonjëherë të duket sikur Shqipëria është një çmendinë, se ngado që shkon ndeshesh me muzikë në kupë të qiellit, meqë po flasim për muzikën. Ky problem bëhet edhe më i mprehtë në qytetet kryesore dhe në zonat bregdetare, se, përveç zhurmës që prodhojnë lokalet, shtohen edhe ndotja nga makinat, ndotja akustike dhe ndotja mjedisore, shtohen ndotjet nga ndërtime. Betonierët ligjërisht duhet të punojnë natën, por në fakt, i gjen rrugëve të Tiranës 24 orë në 24, shto këtu edhe ambulancat, se edhe spitalet janë shtuar. Kështu krijohet një kakofoni, saqë Tirana dhe zonat urbane në Shqipëri duken si çmendinë. Ne problemin e zhurmave e kemi pasur shumë të mprehtë. Ligjin e kemi, e kemi pasur edhe në të shkuarën, dhe për shkak të situatës shumë të vështirë që u krijuar nëpër qytete, në zonat urbane dhe në plazhe, e reduktuam kohën e të luajturit muzikë në lokale nga ora 24:00 në orën 23:00. Dhe pati një lloj stabiliteti. Por çfarë ndodh tani? Ky është qëllimi i këtyre rregullimeve. Të gjithë ata që pretendojnë për gjoja decentralizim dhe për përcaktimin e zonave ku do të lejohet muzika deri në orën 24:00, e bëjnë për të justifikuar këtë zgjatje. Presioni, lobimi i industrisë së turizmit e ka zgjatur orarin nga ora 23:00 me një orë më shumë.

Por çfarë ndodh kudo ku të hysh? Po të hysh në një kafe, edhe gjatë ditës, është si të hysh në disko, muzika është në kupë të qiellit, nuk bën dot një bisedë, nuk qetësohesh dot, ose po të hysh në një restorant është një lloj si në disko, edhe në bregdet nuk ka hotel që të mos ketë orkestër jashtë, në një kohë kur, po të shkosh në vende të tjera, se nuk bëhet turizëm vetëm në Shqipëri, orkestrat janë në ambiente të mbyllura, nuk ka orkestër në rrëzë apo në pistë, apo buzë pishinës, se ka njerëz që duan vërtet të pushojnë dhe të

rigjenerohen për periudhën e punës, ndërsa këtu të qëllonjë tri hotele në zonën ku ke shtëpinë dhe të tria kanë orkestra, kanë tre këngëtarë të ndryshëm, tre tallava të ndryshme, të cilët do t'i dëgjosh deri në orën 24:00, me ca repertorë që për vite të tëra nuk i ndërrojnë dhe qytetarët e shkretë detyrohen të presin sa të vijë ajo kënga e fundit që të bien të flenë. Kjo nuk ndodh vetëm në plazh, por edhe këtu në Tiranë. Prandaj duhet të jemi seriozë në trajtimin e këtij problemi. Një herë po më thoshte një koleg: “Mirë që janë ngritur çmimet e kanë shkuar kacafiu, por po na shtojnë edhe orarin e muzikës dhe të zhurmave, duke na kufizuar kohën e rikuperimit për të shkuar në punë”. Ju e dini sa problematike janë lokalet e vendosura në katet e para të ndërtesave. Për interesat e një lokali lihet një pallat i tërë pa gjumë. Kështu që ato që ju thoni, se me këtë ligj do të disiplinohen zhurmat, ju lutem, mos na i thoni më, se qëllimi nuk është që të disiplinohen zhurmat dhe të kemi një Shqipëri më të qetë, por që të zgjasë orari nga ora 23:00 deri në orën 24:00. Nga ora 12:00 deri në orën 24:00 të gjitha këto lokale kanë të drejtë të bëjnë muzikë sipas qejfit të tyre.

Për këtë arsye, nuk kam për ta votuar.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Spaho!

Duke parë listën e diskutantëve, ky është diskutimi i fundit dhe mbyllet diskutimet për rendin e ditës.

Më lejoni që, para se ta ndërpres seancën, pasi votimi është njoftuar në orën 19:30, t'ju njoftoj se në Kuvend, rreth orës 15:30, janë depozituar tri akte normative dhe 2 projektligje, të cilat ju ftoj t'i shikoni në sistemin “e-Akte” për t'u njohur me përmbajtjen.

Faleminderit, kolegë!

E ndërpresim këtu seancën për të vijuar me votimin në orën 19:30.

(Pas pushimit.)

(Drejtimitin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Lindita Nikolla.)

Lindita Nikolla – Kalojmë në procesin e votimit.

Ju lutem, kolegë, zini vendet!

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

Janë të pranishëm 84 deputetë.

Vazhdojmë.

Projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin

2022”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 81 vota pro, 1 abstenim dhe 3 kundër.

Miratohet projektrezoluta.

Projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2022”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 69 vota pro, 1 abstenim dhe 16 kundër.

Miratohet projektrezoluta.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për përmirësimin e aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit “GovTech”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Janë 75 vota pro, 1 abstenim dhe 8 kundër.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 75 vota pro, 1 abstenim dhe 8 kundër.

Miratohet në tërësi projektligji.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Shën Nikolla-Pulaj për qarkullimin rrugor ndërkombëtar dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 85 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.
Miratohet në parim projektligji.
Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të propozuesit.
Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.
Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
Janë 85 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.
Miratohet në tërësi projektligji.
Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë.
Hapet votimi në parim me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 71 vota pro, 1 abstenim dhe 8 kundër.
Miratohet në parim projektligji.
Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.
Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
(Nenet nga 2 deri në 7 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)
Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.
Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
Janë 71 vota pro, 1 abstenim dhe 8 kundër.
Miratohet projektligji.
Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë.
Hapet votimi në parim me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 70 vota pro, 1 abstenim dhe 5 kundër.
Miratohet projektligji.
Kalojmë në votimin nen për nen me karton, sipas variantit të komisionit.
Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.
Përpara se të fillojmë me nenin 2, në bazë të nenit 76 të Rregullores, do të votojmë amendamentin e zotit Tritan Shehu, për një ndryshim në pikën 15/1 të nenit 2 të projektligjit.
Autori i amendamentit nuk është prezent?
(Ndërhyrje pa mikrofon)
Hedhim në votim amendamentin.
Hapet votimi me elektronikë.
(Deputeti Braçe flet pa mikrofon nga vendi.)
Mbyllet votimi.
Janë 12 vota pro, 1 abstenim dhe 66 kundër.
Nuk miratohet amendamenti.
Vazhdojmë me votimin nen për nen me karton.
Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
Përpara se të fillojmë votimin e nenit 6, në bazë të nenit 76 të Rregullores, do të votojmë amendamentin e zonjës Orjola Pampuri për një shtesë në nenin 6 të projektligjit, ku në nenin 16, shkronja “b” e ligjit ekzistues, pas ndarjes “b” të shtohet nënndarja “b/i”.
Zonja Pampuri ndodhet në sallë? Nuk është?
Hedhim në votim amendamentin.
Hapet votimi me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 14 vota pro, asnjë abstenim dhe 68 kundër.
Nuk miratohet amendamenti.
Vazhdojmë me votimin me karton.
Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?
Miratohet.
(Nenet nga 7 deri në 23 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)
Përpara se të fillojmë votimin e nenit 24, në bazë të nenit 76 të Rregullores, do të votojmë amendamentin e zonjës Orjola Pampuri për një shtesë neni: pas nenit 59 shtohet neni 59/1 në ligjin ekzistues.
Zonja Pampuri nuk është?
Hedhim në votim amendamentin.
Hapet votimi me elektronikë.
Mbyllet votimi.
Janë 12 vota pro, 2 abstenime dhe 69 kundër.

Nuk miratohet amendamenti.
 Vazhdojmë me votimin me karton.
 Neni 24. Pro? Kundër? Abstenim?
 Miratohet.
(Nenet nga 25 deri në 29 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)
 Përpara se të fillojmë votimin e nenit 30, në bazë të nenit 76 të Rregullores, do të votojmë një amendament, përsëri nga zonja Orjola Pampuri, për një shtesë në nenin 76..
(Deputeti Leskaj ndërhyr pa mikrofon nga vendi.)
 Do ta hedhim në votim.
 Do ta sqarojmë se çfarë po hedhim në votim, zoti Leskaj.
 Hedhim në votim amendamentin.
 Hapet votimi me elektronikë.
(Diskutime në sallë)
 Mbyllet votimi.
 Janë 12 vota pro, 2 abstenime dhe 67 kundër.
 Nuk miratohet amendamenti.
 Vazhdojmë me votimin me karton.
 Neni 30. Pro? Kundër? Abstenim?
 Miratohet.
(Nenet nga 31 deri në 35 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)
 Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.
 Hapet votimi.
 Mbyllet votimi.
 Janë 70 vota pro, 1 abstenim dhe 3 kundër.
 Miratohet projektligji.
 Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.
 Hapet votimi në parim me elektronikë.
 Mbyllet votimi.
 Janë 73 vota pro, 1 abstenim dhe asnjë kundër.
 Miratohet projektligji.

Kalojmë në votimin në parim me karton, sipas variantit të komisionit.
 Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
 Miratohet.
 Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?
 Miratohet.
 Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?
 Miratohet.
 Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?
 Miratohet.
 Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.
 Hapet votimi.
 Mbyllet votimi.
 Janë 74 vota pro, asnjë abstenim dhe asnjë kundër.
 Miratohet projektligji.
 Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zurmës në mjedis”, të ndryshuar”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.
 Hapet votimi në parim me elektronikë.
(Diskutime në sallë)
 Mbyllet votimi.
 Janë 70 vota pro, asnjë abstenim dhe 11 kundër.
 Miratohet projektligji.
 Kalojmë në votimin në parim me karton, sipas variantit të komisionit.
 Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?
 Miratohet.
(Nenet nga 2 deri në 20 u miratuan me të njëjtën procedurë votimi.)
 Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.
 Hapet votimi.
 Mbyllet votimi.
 Janë 70 vota pro, asnjë abstenim dhe 10 kundër.
 Miratohet projektligji.
 Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 67/2021 “Për caktimin e kryesive të komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.
 Deputetja Zheni Gjergji caktohet kryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 83 vota pro, asnjë abstenim dhe asnjë kundër.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr.69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputeti Arbi Agalliu caktohet anëtar i Komisionit për Çështjet Europiane.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 82 vota pro, asnjë abstenim dhe asnjë kundër.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputeti Xhelal Mziu caktohet anëtar i Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 80 vota pro, 1 abstenim dhe asnjë kundër.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputetja Oriela Nebiaj caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Çështjet Europiane.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

(Diskutime në sallë)

Mbyllet votimi.

Janë 81 vota pro, asnjë abstenim dhe asnjë kundër.

(Diskutime në sallë)

Po, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Zonja Kryetare, duke qenë se nga Komisioni për Çështjet Europiane janë larguar dy anëtarë përfaqësues të opozitës, edhe zonja Oriela Nebiaj është anëtare e Komisionit për Çështjet Europiane, jo anëtare zëvendësuese.

Lindita Nikolla – Dakord.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Gazment Bardhi – Janë larguar zoti Luçiano Boçi dhe zoti Belind Këlliçi, dhe janë dy vende të opozitës.

Faleminderit!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla – Ju lutem, kolegë!

Atëherë, bëjmë korrigjimin: deputetja Oriela Nebiaj caktohet anëtare në Komisionin për Çështjet Europiane.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 78 vota, asnjë abstenim dhe asnjë kundër.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputetja Eralda Bano caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Janë 77 vota pro, asnjë abstenim dhe asnjë kundër.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021 “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputetja Merita Baku caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Çështjet Europiane.

Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur.

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 22 QERSHOR 2023

Procedura e votimit: një votim me elektronikë.
Hapet votimi.
Mbyllet votimi.
Janë 78 vota pro, asnjë abstenim dhe asnjë kundër.

Miratohet projektvendimi.
Këtu mbyllet edhe procesi i votimit, edhe seanca.
Seanca e radhës do t'ju njoftohet.
Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 20:00)

Kryetarja e Kuvendit

Lindita Nikolla

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala**